



EASO
Udhëzuesi Praktik
për vlerësimin
e moshës
Botimi i dytë

*Seritë e Udhëzuesve Praktikë
të EASO-s*



This Project is funded by the European Union

Ky dokument u botua falë asistencës së Bashkimit Evropian nëpërmjet projektit "Mbështetje rajonale për menaxhimin e migracionit me fokus te mbrojtja në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi - Faza II". Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e EASO-s dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Ova publikacija prevedena je uz pomoć Evropske unije kroz projekat „Regionalna podrška upravljanju migracijama uz zaštitu prava migranata na Zapadnom Balkanu i Turskoj - faza II”. Za njenu sadržinu isključivo je odgovoran EASO, i ta sadržina nužno ne predstavlja stavove Evropske unije.

Në internet gjeni më shumë informacione për Bashkimin Evropian (<http://europa.eu>).

© Zyra Evropiane për Mbështetjen e Azilit, 2018

EASO si dhe personat që veprojnë në emër të saj nuk mund të mbajnë përgjegjësi për përdorimin që i bëhet informacionit që përmban ky botim.

Print	ISBN 978-92-9485-941-9	doi:10.2847/730654	BZ-02-18-896-SQ-C
PDF	ISBN 978-92-9485-945-7	doi:10.2847/521666	BZ-02-18-896-SQ-N

EASO

Udhëzuesi Praktik për vlerësimin e moshës

Botimi i dytë

*Seritë e udhëzuesve praktikë
të EASO-s*

Udhëzuesi praktik i EASO-s për vlerësimin e moshës mbështetet tek informacionet dhe udhëzimet për procesin e vlerësimit të moshës dhe të përmbledhja e metodave të vlerësimit të moshës, tashmë të analizuar në *Raportin e EASO-s për vlerësimin e moshës në Evropë* (2013). Botimi përmban udhëzime praktike, rekomandime dhe mjete kryesore për zbatimin e interesave më të larta të fëmijës, në momentin që moshë e personit vlerësohet nga pikëpamja shumëdisiplinore dhe globale. Ai gjithashtu sjell informacion të përditësuar për metodat e përdorura në shtetet BE+ dhe për metodat e reja të cilat nuk janë ende në përdorim, por mund të jenë alternativa të mundshme ose të ardhshme.

Përmbajtja

Shkurtime	7
Përmbledhje ekzekutive	11
Hyrje	13
Kreu 1- Rrethanat e vlerësimit të moshës	16
Vlerësimi i moshës nga perspektiva e të drejtave themelore	18
Kreu 2 Interesat më të larta të fëmijës dhe garancitë procedurale.....	20
Interesat më të larta të fëmijës	20
Vlerësimi i interesave më të larta të fëmijës për qëllimet e vlerësimit të moshës	21
Zbatimi i parimit të prezumimit të pafajësisë	22
Kujdestari/përfaqësuesi	26
E drejta për t’u informuar.....	28
E drejta për të shprehur pikëpamjet e veta dhe për t’u dëgjuar	29
Pëlqimi i informuar dhe e drejta për të refuzuar	29
Parimi i ruajtjes së privatësisë dhe mbrojtja e të dhënave për arsye sigurie	31
Profesionistë të kualifikuar që kanë përvojë me fëmijët.....	31
Metoda sa më pak invazive	31
Saktësia dhe marzhi i gabimit.....	35
Kombinimi i karakterit invaziv dhe i saktësisë	36
E drejta për zgjidhje të efektshme ligjore	37
Kreu 3 Procesi i vlerësimit të moshës: zbatimi i një qasjeje shumëdisiplinore dhe globale	38
Zbatimi i një qasjeje shumëdisiplinore dhe globale në procesin e vlerësimit të moshës	38
Skema e procesit të vlerësimit të moshës	40
Udhëzime për procesin e vlerësimit të moshës	41
Çmuarja nëse vlerësimi i moshës është i nevojshëm apo jo.....	41
Kryerja e vlerësimit të moshës.....	42
Kreu 4 Pamja e përgjithshme e metodave të vlerësimit	45
Skema e metodave	45
Orientime për zbatimin gradual të metodave	46
A. Metodat jo mjekësore.....	48
B. Metodat mjekësore pa rrezatim	53
C. Metodat mjekësore me rrezatim.....	58
Kreu 5 Rekomandimet përfundimtare	62
Shtojca 1 Fjalorthi	66
Shtojca 2 Interesat më të larta të fëmijës dhe vlerësimi i moshës: mjetet praktike	73
A. Formulari i vlerësimit të interesave më të larta të fëmijës	75
B. Listë kontrolli të interesave më të larta të fëmijës për qëllimet e vlerësimit të moshës.....	77
Shtojca 3 Kuadri juridik dhe orientimet strategjike.....	81
Shtojca 4 Përmbledhje e metodave dhe garancive procedurale të përdorura në proceset e vlerësimit të moshës	109
Shtojca 5 Bibliografia	118

Shkurtime

ADCS	Association of Directors of Children’s Services Ltd (Shoqata e Drejtorëve të Shërbimeve për fëmijët) është shoqata kombëtare angleze ku marrin pjesë drejtorët statutorë të shërbimeve për fëmijët dhe ekipet të tyre drejtuese
AGFAD	Shoqata e Mjekësisë ligjore Gjermane
ALARA	Shkurtim i përdorur në fushën e sigurisë nga rrezatimi që nënkupton nivelin më të ulët i cili arrihet në mënyrë të arsyeshme
AMIF	Fondi për Azilin, Migracionin dhe Integrimin
DPA (i rishikuar)	Direktiva 2013/32/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 qershor 2013, “Për procedurat e përbashkëta për dhënien dhe tërheqjen e mbrojtjes ndërkombëtare”. Përmendet edhe si Direktiva për Procedurat e Azilit (i rishikuar)
APR	Propozim për një rregullore të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit i cili synon krijimin e një procedure të përbashkët për mbrojtjen ndërkombëtare në Bashkimin Evropian dhe shfuqizimin e Direktivës 2013/32/BE.
AT	Austria
DAT	Direktiva 2011/36/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 5 prill 2011, “Për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, për mbrojtjen e viktimave të tij dhe për zëvendësimin e Vendimit Kuadër të Këshillit 2002/629/JHA”. Përmendet edhe me emrin “Direktiva Anti-Trafik”
BE	Belgjika
BG	Bullgaria
VIL	Vlerësimi i interesave më të larta
ILF	Interesat më të larta të fëmijës
PIL	Përcaktimi i interesave më të larta
CEAS	Sistemi i Përbashkët Evropian të Azilit
KDTBE	Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian
IVO	Informacioni për vendin e origjinës
KDF	Konventa “Për të drejtat e fëmijës”;
CT/CAT	Tomografia e kompjuterizuar /tomografia aksiale e kompjuterizuar (skaneri)
CY	Qipro
DE	Gjermania
DK	Danimarka
Rregullorja Dublin III (i rishikuar)	Rregullorja (BE) Nr. 604/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 qershor 2013, që përcakton kriteret dhe mekanizmat për përcaktimin e Shteteve Anëtare përgjegjëse për shqyrtimin e aplikimeve për mbrojtje ndërkombëtare të dorëzuara pranë një Shteti Anëtar nga një shtetas i një vendi të tretë ose një person pa shtetësi (i rishikuar)
EASO	Zyra Evropiane për Mbështetjen e Azilit
EE	Estonia
EMN	Rrjeti Evropian për Migracionin

ES	Spanja
Shtetet BE+:	Shtetet Anëtare të BE-së plus Norvegjia dhe Zvicra
BE	Bashkimi Evropian
Eurodac	Baza Evropiane e të Dhënave Daktiloskopike të Azilit
Rregullorja Eurodac (i rishikuar)	Rregullorja (BE) Nr. 603/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 qershor 2013, “Për themelimin e ‘Eurodac’ për krahasimin e gjurmëve të gishtave me synimin e zbatimit të efektshëm të Rregullores (BE) 604/2013 e cila përcakton kriteret dhe mekanizmat për përcaktimin e Shteteve Anëtare përgjegjëse për shqyrtimin aplikimeve për mbrojtje ndërkombëtare të dorëzuara pranë një Shteti Anëtar nga një shtetas i një vendi të tretë ose nga një person pa shtetësi dhe për kërkesat për krahasim me të dhënat e Eurodac të paraqitura nga autoritetet e zbatimit të ligjit të Shteteve Anëtare dhe Europol për qëllime të zbatimit të ligjit dhe për të ndryshuar Rregulloren (BE) 1077/2011 e cila krijon një agjenci evropiane për menaxhimin operacional në shkallë të gjerë të sistemeve të Teknologjisë së Informacionit në një hapësirë lirie, sigurie dhe drejtësie” (i rishikuar)
FRA	Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore të Njeriut
FI	Finlanda
FR	Franca
Konventa e Gjenevës e vitit 1951	Konventa e OKB-së “Për statusin e refugjatit” e vitit 1951 (dhe Protokollin e saj i vitit 1967)
HU	Hungaria
ICRC	Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq
IE	Irlanda
Rregullorja zbatuese Nr.118/2014	Rregullorja zbatuese (BE) e Komisionit Nr.118/2014, datë 30 janar 2014, e cila ndryshon Rregulloren (KE) Nr.1560/2003 “Për rregullat e detajuara të zbatimit të Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 343/2003, e cila përcakton kriteret dhe mekanizmat për përcaktimin e Shteteve Anëtare përgjegjëse për shqyrtimin e aplikimeve për azil të dorëzuara pranë një Shteti Anëtar nga një shtetas i një vendi të tretë”
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Migracionin)
MN	Mbrojtje ndërkombëtare
IT	Italia
JRC	Qendra e Përbashkët e Kërkimeve, shërbimi i Komisionit Evropian për shkencën dhe dijen i cili punëson shkencëtarë për të kryer kërkime në mbështetje të politikave të Bashkimit Evropian dhe jep këshilla shkencore të pavarura
LT	Lituania
LU	Luksemburgu
LV	Letonia
MRI	Rezonanca magnetike
MS	Shtete Anëtare të BE-së
MT	Malta

OJF	Organizatë jo-fitimprurëse
NIDOS	Fondacioni NIDOS (instituti i kujdesit për të miturit e pashoqëruar që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare në Holandë)
NL	Holanda
NO	Norvegjia
OHCHR	Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut
PL	Polonia
PT	Portugalia
DK i rishikuar	Direktiva 2011/95/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 13 dhjetor 2011, “Për standardet e kualifikimit të shtetasve nga vendet e treta ose të personave pa shtetësi si përfitues të mbrojtjes ndërkombëtare, për një status refugjati uniform ose për personat që kanë të drejtë të përfitojnë mbrojtje plotësuese dhe për përmbajtjen e mbrojtjes së dhënë” (i rishikuar). Përmendet edhe me emrin “Direktiva e Kualifikimit” (i rishikuar)
DKP (i rishikuar)	Direktiva 2013/33/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 26 qershor 2013, e cila parashikon standardet për pritjen e personave që aplikojnë për mbrojtje ndërkombëtare (i rishikuar). Përmendet edhe me emrin “Direktiva për Kushtet e Pritjes” (i rishikuar)
RO	Rumania
SCEP	Programi “Fëmijët e ndarë në Evropë”
SE	Suedia
SIS	Sistem informacioni në shkallë të gjerë që mbështet kontrollin e kufirit të jashtëm dhe bashkëpunimin për zbatimin e ligjit në hapësirën Shengen
SI	Sllovenia
SK	Sllovakia
SLTD	Bazë të dhënash me të dhëna për dokumentet e vjedhura, të humbura apo të revokuara të udhëtimit, si: pasaporta, letërnjoftime, leje kalimi të OKB-së apo vulat e vizave
THB	Trafikimi i qenieve njerëzore
UAM	I mitur i pashoqëruar
UK	Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut
UNHCR	Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët
Unicef	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
VIS	Sistemi i Informacionit të Vizave

Përmbledhje ekzekutive

Vlerësimi i moshës mbetet një proces kompleks që mund të ketë pasoja të rënda te personat që janë subjekt i këtij vlerësimi. Metodatat dhe proceset e vlerësimit të moshës ndryshojnë nga një Shtet Anëtar në tjetrin dhe jo gjithmonë garantohen procese vlerësimi të besueshme, shumëdisiplinore dhe në pajtim me të drejtat e njeriut. Përballë këtyre sfidave, komunikata e Komisionit drejtuar Parlamentit Evropian dhe Këshillit “Mbrotjtja e fëmijëve migrues” (KOM(2017) 211, datë 12 prill 2017, i kërkoi Zyrës Evropiane për Mbështetjen e Azilit (EASO) të përditësonte udhëzimet e saj për vlerësimin e moshës në vitin 2017.

Fokusi i këtij botimi është të japë udhëzime ku merren në konsideratë interesat më të larta të fëmijës (ILF) jo vetëm kur çmohet nevoja e vlerësimit për përcaktimin e moshës, por edhe kur konceptohet dhe ndërmerret vlerësimi i moshës duke përdorur një qasje globale dhe shumëdisiplinore, ku i kushtohet një vëmendje e veçantë nevojave dhe rrethanave të personit.

Për të mbështetur autoritetet në zbatimin e parimit të interesave më të larta të fëmijës, ky botim:

- analizon ndikimin e vlerësimit të moshës te të drejtat e tjera të azilkërkuesit si dhe motivacionin për këtë vlerësim;
- jep udhëzime për zbatimin e parimeve dhe garancive të nevojshme në procesin e vlerësimit;
- përshkruan mënyrën si kryhet procesi i vlerësimit duke përdorur një qasje globale dhe shumëdisiplinore;
- paraqet një model pamor të procesit potencial ku nxirret në pah përdorimi gradual i metodave që shmangin vlerësimet e panevojshme;
- shqyrton metodatat e reja për vlerësimin e moshës së azilkërkuesit, zhvillimet më të reja në metodatat që janë aktualisht në përdorim dhe ndikimin e secilës metodë të garancitë dhe të drejtat e azilkërkuesit;
- formulon rekomandimet kryesore për të trajtuar vështirësitë praktike që mund të shfaqen para, pas dhe gjatë etapave të ndryshme të procesit;
- përmban një sërë mjetesh dhe dokumente referencë plotësuese të informacionit të parashtruar në këtë udhëzues praktik, si:
 - një fjalorth me termat kryesore,
 - dokumente të kuadrit juridik dhe të politikave ndërkombëtare, evropiane dhe kombëtare, si dhe mbi orientimet strategjike që lidhen me këtë temë,
 - mjete praktike për të siguruar interesat më të larta të fëmijës (një formular dhe një listë kontrolli), dhe
 - një përmbledhje të përditësuar të metodave dhe garancive procedurale që përdoren në territorin e BE+.

Në këtë botim identifikohen dhe trajtohen një sërë sfidash të hasura gjatë kryerjes së procesit të vlerësimit të moshës si: motivacioni i (pa)mjaftueshëm për të kryer një vlerësim të moshës; kufizimet e metodave të përdorura për sa i përket karakterit invaziv dhe saktësisë; vlerësimet e paplota të bazuara vetëm te pamja e jashtme; përdorimi parësor i metodave mjekësore (në disa raste vetëm i atyre jonizuese); ekzaminimet e përsëritura të kryera tek i njëjti azilkërkues në disa Shtete Anëtare ose zbatimi i pamjaftueshëm i garancive kryesore në këtë proces (p.sh. mungesa e kujdestarit/përfaqësuesit ose zgjidhjeve ligjore të efektshme).

Për t’iu përgjigjur këtyre sfidave, EASO ka hartuar disa rekomandime thelbësore të cilat do të trajtohen me detaje në këtë botim. Ato mund të përmbliken si më poshtë.

- Interesat më të larta të fëmijës duhen mbrojtur jo vetëm kur fëmija identifikohet si i tillë, por edhe kur ka dyshime se azilkërkuesi mund të jetë fëmijë i mitur.
- Vlerësimi i moshës nuk duhet të jetë praktikë rutinë. Nevoja për vlerësim duhet të justifikohet me të drejtë duke u bazuar në dyshime të përligjura për moshën e deklaruar.

- Zbatimi i parimit të interesave më të larta të fëmijës kërkon që vlerësimi moshës të ketë në qendër të vëmendjes fëmijën dhe t'i përshtatet nevojave specifike të azilkërkuarit (gjinia, grupmosha e dyshuar, origjina kulturore etj.).
- Personi konsiderohet i pafajshëm në momentin që lindin dyshime për moshën e deklaruar, gjatë vlerësimit të moshës dhe deri sa të dalin rezultatet përfundimtare. Azilkërkuari duhet të konsiderohet dhe trajtohet si i mitur deri sa të provohet se është madhor.
- Fëmijës, ose personit që dyshohet si fëmijë, duhet t'i caktohet një kujdestar/përfaqësues i cili sigurohet se fëmija mund të marrë pjesë në vlerësim, është informuar për procesin e vlerësimit të moshës në mënyrë të përshtatur për një fëmijë, në përputhje me gjininë dhe moshën e tij dhe në një gjuhë që fëmija e kupton. Gjithashtu ai sigurohet se fëmija kupton plotësisht procesin e vlerësimit. Ky informacion është thelbësor në mënyrë që fëmija të shprehë pikëpamjet, dëshirat dhe opinionet e tij dhe të marrë vendime të informuara për pjesëmarrjen në proces.
- Procesi i vlerësimit të moshës duhet të kryhet sipas një qasjeje globale dhe shumëdisiplinore, e cila siguron zbatimin e të gjitha garancive dhe parimeve të parashikuara dhe mbrojtjen e të drejtave të azilkërkuarit.
- Meqenëse aktualisht nuk ekziston një metodë e vetme për të përcaktuar moshën e saktë të njeriut, grupmosha e personit në fjalë mund të ngushtohet duke përdorur një kombinim metodash që vlerësojnë jo vetëm zhvillimin fizik, por edhe pjekurinë dhe zhvillimin psikologjik.
- Për qëllimet e vlerësimit të moshës nuk duhet të përdoret asnjë metodë ku përfshihet zhveshja lakuriq apo ekzaminimi, këqyrja ose matja e organeve gjenitale apo pjesëve intime.

Hyrje

Përse u hartua ky botim i dytë?

Ashtu si përmendet në planin e veprimit të BE-së për të miturit e pashoqëruar (2010-2014) dhe për shkak të shqetësimeve për besueshmërinë dhe karakterin invaziv të metodologjive ekzistuese për vlerësimin e moshës së azilkërkuesve, EASO-s iu besua hartimi i një dokumenti i cili përmbledh praktikën më të mirë për vlerësimin e moshës. Botimi i parë doli në dhjetor të vitit 2013. Shqetësime të ngjashme për sfidat në procesin e vlerësimit të moshës u ngritën përsëri nga autoritetet kombëtare gjatë Konferencës së tretë Vjetore për Fëmijët, organizuar nga EASO në dhjetor 2015, në Maltë. Në praktikë, vlerësimi i moshës, në veçanti disa nga metodat, ka marrë hov të shpejtë që nga viti 2013. Prandaj, ky konsiderohet si momenti i duhur për reflektim dhe analizë të mëtejshme të zhvillimeve më të fundit. Në pajtim me përfundimet e konferencës dhe me komunikatën e Komisionit për mbrojtjen e fëmijëve migrues⁽¹⁾, EASO zhvilloi këtë botim të ri i cili përmban informacion të përditësuar dhe rekomandime të përmirësuara për procesin e vlerësimit të moshës. Për këtë qëllim, EASO ka studiuar metodologjitë e vlerësimit të moshës dhe garancitë procedurale të përdorura në territoret e BE+ në vitin 2016. Zbulimet kryesore të këtij hulumtimi i gjeni përgjatë këtij dokumenti në kutitë e emërtuar “Zbulimet kryesore nga praktikët e shteteve BE+”. Gjithashtu, aty ku është parë me vend dhe në Shtojcën 4 janë shtuar shembuj nga praktika.

Si lidhet ky botim i dytë me mjetet e tjera mbështetëse të EASO-s?

Misioni i EASO-s është të mbështesë Shtetet Anëtare të BE-së dhe shtetet e asociuara (Lihtenshtajni, Norvegjia dhe Zvicra) në zbatimin e Sistemit të Përbashkët Evropian të Azilit (CEAS). Kjo mbështetje jepet, pjesërisht, përmes trajnimeve të përbashkëta, standardeve të përbashkëta të cilësisë dhe informacionit të përbashkët për vendin e origjinës. Sikurse të gjitha mjetet mbështetëse të EASO-s, edhe ky botim bazohet te standardet e përbashkëta të CEAS. Për më tepër, ky botim duhet të shihet si plotësues i mjeteve të tjera të EASO-s që trajtojnë proceset e azilit të përshtatura për fëmijët, veçanërisht i *Udhëzuesit praktik të EASO-s për kërkimin e familjes*⁽²⁾ dhe modulit të trajnimit të EASO-s për intervistën e fëmijëve⁽³⁾.

Çfarë përmban ky botim?

Ky botim i dytë përmban një seri referencash e materiale udhëzuese për vlerësimin e moshës, si dhe paraqet një panoramë të situatës aktuale në shtetet BE+.

Përmbledhtazi, dokumenti është strukturuar rreth pesë shtyllave të ndërlidhura.

- Kreu i parë, me titull **Rrethanat e vlerësimit të moshës**, është një prezantim i temës ku trajtohen parakushtet, motivacionin dhe objektivat e procesit të vlerësimit të moshës.
- Kreu i dytë, me titull **Interesat më të larta të fëmijës dhe garancitë procedurale**, trajton zbatimin në praktikë të parimit të interesave më të larta të fëmijës, sikurse është sanksionuar në Konventën e Kombeve të Bashkuara “Për të drejtat e fëmijës” (KDF) dhe në *acquis* të BE-së për azilin, dhe garancitë procedurale të zbatuara gjatë procesit të vlerësimit të moshës.
- Kreu i tretë, me titull **Procesi i vlerësimit të moshës: zbatimi i një qasjeje shumëdisiplinore dhe globale**, analizon mënyrën si duhet të kryhet procesi duke përdorur një qasje shumëdisiplinore dhe globale, sipas orientimeve që përmban ky botim. Ky kre përmban edhe një grafik të rrjedhës për të parë etapat kryesore që duhet të ndiqen përgjatë kryerjes së vlerësimit të moshës.

⁽¹⁾ Komunikata e Komisionit drejtuar Parlamentit Evropian dhe Këshillit me titull “Mbrojtja e fëmijëve migrues” KOM(2017) 211, datë 12 prill 2017, gjendet këtu: https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/policies/european-agenda-migration/20170412_communication_on_the_protection_of_children_in_migration_en.pdf

⁽²⁾ Mund ta gjeni në faqen e EASO-s: <https://www.easo.europa.eu/training-quality/vulnerable-groups>

⁽³⁾ Informacionet e tjera gjenden në faqen e EASO-s: https://www.easo.europa.eu/sites/default/files/EASO_TRAINING_BROCHURE_EN-2016.pdf

- Kreu i katërt, me titull **Panorama e metodave të vlerësimit të moshës**, mbulon zhvillimet më të fundit në metodat e përshkruara në botimin e parë, si dhe metodat e reja në optikën e ndikimit të tyre potencial (pozitiv ose negativ) te garancitë. Vëmendje e veçantë i kushtohet metodave që nuk kanë qenë në përdorim në vitin 2013 ose që kanë pësuar ndryshime të mëdha që atëherë.
- Kreu i pestë, me titull **Rekomandimet përfundimtare**, përmbledh rekomandimet kryesore që janë formuluar për ta rritur efikasitetin e procesit të vlerësimit të moshës, duke garantuar ndërkohë të drejtat e fëmijëve.

Ky botim përmban një sërë **shtojcash**

- **Shtojca 1: Fjalorthi**
Fjalorthi ka për synim të lehtësojë identifikimin dhe/ose krijimin e një interpretimi të përbashkët të termave më të rëndësishme të përdorura në procesin e vlerësimit të moshës.
- **Shtojca 2: Interesat më të larta të fëmijës dhe vlerësimi i moshës: mjetet praktike**
Kjo shtojcë përmban formularin e vlerësimit të interesave më të larta dhe listën e kontrollit të interesave më të larta të fëmijës për të konstatuar nëse procesi i vlerësimit të moshës garanton zbatimin e garancive të nevojshme procedurale për një mbrojtje të duhur të të drejtave të fëmijës.
- **Shtojca 3: Kuadri juridik dhe i politikave**
Kjo shtojcë synon të shërbejë si pikë reference për identifikimin e instrumenteve dhe dispozitave konkrete të zbatueshme në nivel ndërkombëtar, evropian dhe kombëtar. Për më tepër, kjo shtojcë përmban instrumente orientuese kuazi-ligjore dhe jurisprudencën konkrete. Këtu përmbledhen edhe udhëzimet e politikave si pika reference për temën.
- **Shtojca 4: Përmbledhje e praktikave të shteteve BE+ në vlerësimin e moshës**
Kjo shtojcë përfshin metodologjinë dhe garancitë procedurale të përdorura në shtetet BE+ gjatë kryerjes së procesit.
- **Shtojca 5: Bibliografia**
Përmbledhje e burimeve të konsultuara për të hartuar ose si frymëzim për përmbajtjen e këtij dokumenti.

Cili është qëllimi i këtij botimi të dytë?

Ky botim parashtron udhëzime të mëtejshme për aspektet thelbësore të procesit të vlerësimit të moshës si: qasja globale dhe shumëdisiplinore, zbatimi i parimit të interesave më të larta të fëmijës si dhe përditëson informacionin e mbledhur në botimin e parë të këtij botimi. Ndonëse këtu trajtohen problematikat e vlerësimit të moshës, në mënyrë specifike për qëllimet e procedurave të mbrojtjes ndërkombëtare, ky botim mund të shërbejë si një referencë e dobishme edhe në kontekste të tjera ku kërkohet vlerësimi i moshës, si p.sh. rasti i fëmijëve migrues, pragu i moshës për përgjegjësi penale, etj.

Meqenëse aspektet e rëndësishme, si metodologjitë e zbatueshme, zhvillohen me shpejtësi ky udhëzues nuk merr përsipër të jetë shterues për vlerësimin e moshës. Prandaj, në varësi të nevojave të grupit të synuar, mund të lindë nevoja për botime të tjera.

Si u hartua ky botim i dytë?

Ky botim u hartua nga EASO dhe u rishikua nga Komisioni Evropian, agjencitë e BE-së, ekspertët e shteteve BE+ dhe organizatat jo fitimprurëse ndërkombëtare. Kontribute të vyera u dhanë edhe gjatë dy mbledhjeve të grupeve të punës ad hoc, të mbajtura në shtator 2016. Përbërja e larmishme e grupeve të punës garanton një kontribut gjithëpërfshirës dhe shumëdisiplinor nga ana e ekspertëve. Këtu u përfshinë: punonjës socialë, antropologë të mjekësisë ligjore, kërkues radiologë, përgjegjës për hartimin e politikave ose nëpunës të qendrave të pritjes, si dhe nëpunës që merren me trajtimin e dosjeve të azilkërkuesve, të specializuar për fëmijët, të cilët përfaqësonin shtetet BE + (BE, IE, NL, LT, NO), Agjencinë e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (FRA) dhe Komisionerin e Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR). Në grupe merrnin pjesë edhe ekspertë nga organizatat ndërkombëtare dhe OJF-të e specializuara në këtë fushë, si: Organizata Botërore për Migracionin (IOM), Fondacioni Nidos (NIDOS), Kryqi i Kuq britanik dhe Separated

Children in Europe Programme (SCEP) (Programi për fëmijët e ndarë në Evropë), program i varur nga organizata ndërkombëtare “Defence for Children International” (Mbrojtja Ndërkombëtare për Fëmijët). Ky udhëzues është produkt i kombinimit të ekspertizës ku pasqyrohen standardet e përbashkëta dhe objektivi i njëjtë për të pasur procese të sigurta dhe efikase të vlerësimit të moshës në kuadrin e procedurave të mbrojtjes ndërkombëtare me cilësi të lartë.

Si duhet të përdoret ky udhëzues?

Për qëllimet e këtij udhëzuesi dhe për një kuptim më të mirë, në vijim do të gjeni përkufizimet e disa prej termave të përdorura gjerësisht në këtë botim, (vlerësimi i moshës, mosha biologjike, mosha kronologjike, fëmijë, kujdestar, shtete BE +) me kuptimet e tyre specifike. Fjalorthi (Shtojca 1 e botimit) përmban informacione të mëtejshme për këto terma, si dhe terminologji shtesë që mendohet si e dobishme për palët e interesit në vlerësimin e moshës.

Vlerësimi i moshës është procesi me të cilin autoritetet kërkojnë të vlerësojnë moshën kronologjike ose grupmoshën e një personi, për të përcaktuar nëse ky i fundit është fëmijë apo i rritur.

Mosha biologjike përcaktohet nga situata aktuale e personit lidhur me vitet e tij/saj potenciale të jetës, gjë që do të thotë se individ mund të jetë më i ri ose më i vjetër se mosha e tij kronologjike.

Mosha kronologjike matet me vite, muaj dhe ditë që nga momenti i lindjes së njeriut.

Termet **fëmijë** dhe **i mitur** konsiderohen sinonime (person nën moshën 18 vjeç) dhe në këtë udhëzues përdoren të dy termat. Termi i preferuar nga EASO është “fëmijë”, megjithatë termi “i mitur” përdoret kur përmendet shprehimisht në një dispozitë ligjore. Për qëllimet e këtij botimi, i cili ka në fokus fëmijët azilkërkues, termi i përdorur për t’iu referuar një personi të cilit nuk i është përcaktuar mosha është **azilkërkuesi**.

Siç u përmend edhe më lart, termi **fëmijë i pashoqëruar** përdoret si sinonim i termit **i mitur i pashoqëruar** dhe përkufizohet si një fëmijë/i mitur i cili hyn në territorin e shteteve BE+ i pashoqëruar nga një person madhor përgjegjës për të, qoftë sipas ligjit ose sipas praktikës së shtetit përkatës, si dhe kur personi/i rrituri nuk kujdesohet në mënyrë efektive për fëmijën. Këtu përfshihet fëmija/i mituri që lihet i pashoqëruar pas hyrjes në territorin e BE+.

Sa i takon përkufizimit të termit **kujdestar** nuk ka një konsensus të përgjithshëm. Praktikisht, kujdestari shpesh asimilohet në figurën e **përfaqësuesit** të fëmijës ose në atë të punonjësit social. Megjithatë, për qëllimet e këtij udhëzuesi, **kujdestari** është një person i pavarur, i caktuar nga autoriteti kombëtar përgjegjës për mbrojtjen e interesave më të larta dhe mirëqenien e përgjithshme të fëmijës. Në kontekstin e reformës së CEAS (4), Komisioni Evropian ka propozuar që termi “përfaqësues”, i përdorur në instrumentet ligjore ekzistuese të BE-së për the azilin, të zëvendësohet me termin “kujdestar”. Duke qenë se reforma e CEAS ishte ende në fazë diskutimi në kohën kur u përpilua ky botim, termat **kujdestar/përfaqësues janë përdorur tejet tekstit**.

Acquis i BE-së në fushën e azilit përbëhet nga grupi i mëposhtëm i instrumenteve ligjore të BE-së: Direktiva “Për kushtet e pritjes” (e rishikuar) (DKP), Direktiva “Për procedurat e Azilit” (DPA) (e rishikuar), Direktiva e Kualifikimit (DK)(e rishikuar), Direktiva “Për mbrojtjen e përkohshme”, Rregullorja e Dublinit III dhe Rregullorja “Eurodac” (e rishikuar)⁽⁵⁾. Në Shtojcën 3 të këtij botimi, me titull “Kudri juridik dhe i politikave”, gjendet një përmbledhje të dispozitave dhe instrumenteve ligjore ndërkombëtare, evropiane dhe kombëtare që lidhen me vlerësimin e moshës.

Për qëllimet e këtij udhëzuesi, termi **shtetet BE+ janë** Shtetet Anëtare të BE-së, plus Norvegjia dhe Zvicra.

⁽⁴⁾ Propozimi për një rregullore të Parlamentit Evropian dhe Këshillit për krijimin e një procedure të përbashkët për mbrojtjen ndërkombëtare në Bashkimin Evropian dhe shfuqizimin e Direktivës 2013/32/BE (KOM(2016) 467 final, 2016/0224 (COD)), gjendet këtu <https://ec.europa.eu/transparency/regdoc/rep/1/2016/EN/1-2016-467-EN-F1-1.PDF>. Në momentin kur u shkrua ky botim nuk mund të dihej nëse propozimi i Komisionit do të rezultonte në hartimin e një rregulloreje të re, as cilat do të ishin konkretisht kushtet e saj. Pra, lexuesi duhet të jetë i vetëdijshëm se, në një moment të caktuar në të ardhmen, mundet që DPA-ja (e rregulluar) të shfuqizohet dhe të zëvendësohet me një rregullore me dispozita të ndryshuara.

⁽⁵⁾ Tekstet ligjore dhe përkthimet e tyre (në gjuhët e BE-së) gjenden këtu:
 Direktiva “Për kushtet e pritjes”, e riformuluar <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex:32013L0033>;
 Direktiva “Për Procedurat e Azilit”, e riformuluar <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex:32013L0032>;
 Direktiva e Kualifikimit, e riformuluar <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex:32011L0095>;
 Rregullorja Dublin III <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/ALL/?uri=CELEX:32013R0604>;
 Rregullorja “Eurodac” <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex:32013R0603>

Kreu 1- Rrethanat e vlerësimit të moshës

Mosha është element thelbësor i identitetit të fëmijës. *Acquis* i BE-së ⁽⁶⁾ si dhe Konventa për të Drejtat e Fëmijës (Neni 1) e përkufizojnë fëmijërinë duke u nisur nga mosha:

Një fëmijë/i mitur është çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç.

Nga ky përkufizim rrjedhin dy pasoja kryesore. Pasoja e parë: konventa zbatohet për çdo person nën moshën 18 vjeç. Pasoja e dytë: siç e përcakton *acquis* i BE-së, çdo azilkërkues nën moshën 18 vjeç që kërkon mbrojtje ndërkombëtare ka të drejtë të përfitojë garanci procedurale specifike për fëmijët dhe kushte të veçanta pritjeje.

Pavarësisht ndryshimeve të vazhdueshme, mosha është karakteristikë e lindur e **identitetit të njeriut**. Si pjesë e gjendjes së njeriut, ajo përcakton marrëdhënien midis shtetit dhe njeriut. Kështu, nga ndryshimet në moshë mund të lindin të drejta dhe detyrime specifike, për shembull fakti që personi konsiderohet madhor kur mbush moshën 18 vjeç. Megjithatë, mosha 18 vjeç nuk është gjithmonë faktor përcaktues për të fituar të drejta dhe detyrime të reja ose zotësi të plotë në disa aspekte, si: shërbimi ushtarak, mosha për emancipim ligjor dhe minimumi i moshës për përgjegjësi penale, mosha e pëlqimit për martesë ose mosha për t'u punësuar ose për marrëdhënie seksuale. Në varësi të legjislacionit të brendshëm, këto pragje mund të arrihen në një moshë më të hershme kronologjike.

Kur është e ditur, mosha rregullon marrëdhënien midis individit dhe shtetit. Për pasojë, Neni 7 dhe 8 i Konventës për të Drejtat e Fëmijës përcakton si më poshtë detyrimet kryesore të autoriteteve shtetërore të lidhura me moshën:

- fëmija të regjistrohet menjëherë pas lindjes;
- të respektohet e drejta e fëmijës për të ruajtur identitetin e tij/saj; prandaj
- identiteti i fëmijës duhet të rivendoset sa më shpejt.

Sipas këtyre dispozitave, të gjithë fëmijët duhet të regjistrohen menjëherë pas lindjes dhe të pajisen me dokumente që vërtetojnë identitetin e tyre. Megjithatë, statistikat e Kombeve të Bashkuara ⁽⁷⁾ tregojnë se, gjatë viteve 2003- 2007, më pak se 10% e shteteve afrikane ⁽⁸⁾ raportuan numrin total të lindjeve të gjalla, kurse në Evropë norma e vendeve që i raportuan këto të dhëna ishte 90%. Norma e ulët e regjistrimit të lindjeve në vendet e origjinës është një nga arsytet pse azilkërkuesit mund të mbërrijnë në BE **pa dokumente** ose me dokumente që nuk konsiderohen të besueshme. Norma e regjistrimit të lindjeve nuk është e njëtrajtshme ndër vendet kryesore të origjinës së personave që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare. Për shembull, në Somali vetëm 3% e fëmijëve nën moshën 5 vjeç janë regjistruar menjëherë pas lindjes, ndërsa në Afganistan ky numër arrin në 37% ⁽⁹⁾ (këto norma lidhen me normën aktuale të lindshmërisë). Sipas Divizionit të Statistikave të OKB-së, ky numër bie nën 6-10% për fëmijët e lindur para 14-18 vitesh (grupmosha e fëmijëve të pashoqëruar që vijnë në Evropë). Gjithashtu, një pengesë për mundësinë e regjistrimit menjëherë pas lindjes mund të jenë edhe faktorë të tjerë, si: origjina rurale ose përkatësia në një pakicë ose grup shoqëror të caktuar (kastë, fis etj.). Edhe mungesa e ndërgjegjësimit për rëndësinë e regjistrimit të lindjes ose padituria për mënyrën e regjistrimit të saj thellojnë pabarazinë në regjistrimin e lindjeve edhe brenda të njëjtit vend. Norma e ulët e regjistrimit të lindjeve u shkakton fëmijëve vështirësi për të vërtetuar identitetin dhe moshën e tyre me prova dokumentare dhe për pasojë ata mund të përfundojnë pa mbrojtje dhe të zhveshur nga të drejtat që u takojnë. Përveç mungesës së regjistrimit, nxjerrja e certifikatës së lindjes mund të mos jetë e mundur në vendet në gjendje lufte apo ku ka konflikt të armatosur ose autoritetet e këtyre vendeve nuk kanë vullnetin ta lëshojnë këtë dokument. Mungesa

⁽⁶⁾ Shih Nenin 2, germa d), të DKP-së; Nenin 2, germa l), të DPA-së; Nenin 2, germa k), të DK-së; Nenin 2, germa i), të Rregullores Dublin III dhe Nenin 2, paragrafi 6, të DAT-së.

⁽⁷⁾ http://unstats.un.org/unsd/demographic/CRVS/VS_availability.htm

⁽⁸⁾ Ibidem, bazuar në sistemet e sistemet e plota të regjistrimit.

⁽⁹⁾ http://data.unicef.org/wp-content/uploads/2015/12/Birth_registration_May-2016.xlsx

e dokumenteve që vërtetojnë se fëmija është nën moshën 18 vjeç mund të ketë pasoja të drejtpërdrejta në njohjen e të drejtave të tij si fëmijë. Kështu, fëmija mund të trajtohet si i rritur për çështje si shërbimi ushtarak, martesë, hyrja në tregun e punës dhe drejtësia.

Duke qenë se moshë kronologjike jo në të gjitha kulturat luan rol të rëndësishëm në përfitim të statusit të personit të rritur, është e rëndësishme të marrim në konsideratë faktorët kulturorë. Në disa kultura, fëmijët trajtohen si të rritur sapo ata pësojnë disa ndryshime fizike ose bëhen pjesë e një familjeje tjetër (për shembull me anë të praktikës së martesës së fëmijëve). Për këto arsye, është e zakonshme që ata të mos e njohin moshën e tyre kronologjike dhe ta kenë të vështirë të kuptojnë rëndësinë e saj në kulturat perëndimore. Meqenëse moshë kronologjike mund të mos jetë tipar identifikues për pozitën e tyre brenda komunitetit ose për marrëdhëniet me të tjerët (në disa vende të botës fëmijët regjistrohen gjithmonë sikur të kenë lindur më 1 janar të vitit të lindjes, pavarësisht muajit në të cilin kanë lindur në të vërtetë). Ky **dallim kulturor** mund të shkaktojë paqartësi për datën e lindjes ose moshën e deklaruar.

Në kontekstin e mbrojtjes ndërkombëtare, moshë e azilkërkuesit është tregues kyç për **nevoja mbrojtjeje** të veçanta ⁽¹⁰⁾ (fëmijë, të moshuar). Përkatesia në një grupmoshë të caktuar aktivizon zbatimin e disa garancive procedurale të veçanta/shtesë gjatë procedurave të mbrojtjes ndërkombëtare, si dhe të kushteve të veçanta të pritjes si: e drejta për t'u vendosur në një strehim të përshtatshëm dhe të sigurt, e drejta për arsim dhe kujdes shëndetësor specifik, kufizimi i paraburgimit administrativ për qëllime migracioni në raste të jashtëzakonshme dhe detyrimi për të kërkuar fillimisht alternativa të qëndrueshme ndaj paraburgimit. Në rastin e fëmijëve ose kur ka dyshime për moshën e azilkërkuesit, gjëja e parë që duhet marrë parasysh gjatë procedurës janë interesat më të larta të fëmijës. Për më tepër, moshë ka shumë rëndësi për disa lloje kërkesash specifike për fëmijët (martesë e detyruar/në moshë të vogël, rekrutimi me forcë, gjymtimi i organeve gjenitale femërore, trafikimi i fëmijëve, dhuna në familje, puna e detyruar, prostitucioni dhe pornografia me të mitur.) ⁽¹¹⁾.

Përtej kontekstit të mbrojtjes ndërkombëtare, moshë e njeriut ka pasoja kur autoritetet përfshihen në procedura të tjera, si p.sh. në dhënien e pëlqimit për martesë, në raportimin e marrëdhënieve seksuale me të mitur, pranimin ose refuzimin e trajtimeve shëndetësore, hyrjen në tregun e punës, sigurimin e qasjes në të drejta të tjera (e drejta për arsim, etj.) dhe në pasojat për përgjegjësinë penale (moshë minimale për përgjegjësi penale etj.).

Prandaj, kur moshë nuk dihet ose ka **dyshime të bazuara** për moshën, autoritetet mund të kenë nevojë të vlerësojnë moshën e personit për të përcaktuar nëse është madhor apo i mitur. Në rastet kur azilkërkuesi duket qartë se është fëmijë ose, në mungesë të provave kundërshtuese, pamja fizike, sjellja dhe pjekuria psikologjike e azilkërkuesit tregojnë përtej çdo dyshimi se azilkërkuesi është shumë më i madh se 18 vjeç, vlerësimi i moshës nuk është i nevojshëm. Megjithatë, nëse ka prova kundërshtuese përtej pamjes fizike, për shembull në rast se personi duket se është shumë më tepër se 18 vjeç, por ka dokumente që tregojnë se është fëmijë, vlerësimi i moshës mund të kërkohej gjithsesi. Në fakt, nevojë për vlerësim të moshës nënkupton ekzistencën e dyshimit për moshën, pra ekziston mundësia që azilkërkuesi të jetë fëmijë.

Dyshimet mund të lindin jo vetëm kur azilkërkuesi pretendon se është fëmijë, por edhe kur ai pretendon se është madhor. Fëmijët migruer mund të pretendojnë se janë madhorë për të **shmangur masat mbrojtëse** të autoriteteve. Kjo mund të ndodhë për arsye të ndryshme, për shembull ata mund të duan të vazhdojnë migrimin drejt vendit të synuar, pra duan të shmangin strehimin nën mbikëqyrje kur në disa raste ka liri të kufizuar lëvizjeje, ose vendet ku mund t'i ndajnë nga të rriturit që i shoqërojnë. Shpesh, fëmijët pretendojnë të jenë madhorë që t'u lejohet të punojnë, të martohen ose sepse e konsiderojnë veten të rritur dhe përgjegjës për mirëqenien e familjes që kanë lënë pas. Megjithatë, në disa raste të tjera, fëmijët thjesht mund të jenë duke ndjekur udhëzimet e dhëna nga kontrabandistë ose trafikantë. Në këto raste, kontrabandistët ose trafikantët mundohen t'i mbajnë fëmijët të fshehur që ata të jenë pa mbrojtje, duke u bërë kështu pre e lehtë për shfrytëzimin e tyre më pas. Ndërgjegjësimi për këtë dukuri mund të ndihmojë

⁽¹⁰⁾ Shih si shembull listën jo shteruese të azilkërkuesve të pambrojtur parashikuar nga Neni 21 i Direktivës për Kushtet e Pritjes, e rishikuar.

⁽¹¹⁾ Dokumenti i UNHCR-së "Guidelines on international protection: child asylum claims under Articles 1(A)2 and 1(F) of the 1951 convention and/or 1967 protocol relating to the status of refugees", datë 22 dhjetor 2009, HCR/GIP/09/08 gjendet këtu: <http://www.refworld.org/docid/4b2f4f6d2.html>

për identifikimin e hershëm ⁽¹²⁾ të një viktime ose të një viktime të mundshme të trafikimit të qenieve njerëzore dhe për prishjen e zinxhirit të shfrytëzimit.

Si përfundim, **vlerësimi i moshës** është procesi me të cilin autoritetet përpiqen të vlerësojnë moshën kronologjike ose grupmoshën e një personi për të përcaktuar nëse ky i fundit është fëmijë apo i rritur.

Identifikimi i saktë i një individi si fëmijë ose i rritur është kritik për të siguruar mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të fëmijës, si edhe për të parandaluar vlerësimin e të rriturve si fëmijë dhe përfitimin nga ana e tyre e të drejtave dhe garancive shtesë (si e drejta për arsim, caktimi i një kujdestari/përfaqësuesi) të cilat nuk u jepen të rriturve.

Vlerësimi i moshës nga perspektiva e të drejtave themelore

Një sërë të drejtash themelore të sanksionuara nga Konventa për të Drejtat e Fëmijës (KDF) dhe Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (KDTBE) ⁽¹³⁾ kanë rëndësi të veçantë në procesin e vlerësimit të moshës.

Interesat më të larta të fëmijës (Neni 3 i KDF-së dhe Neni 24 i KDTBE-së)

Në të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, së pari duhen konsideruar interesat më të larta të fëmijës. Pra, këto interesa zbatohen që në momentin kur mendohet se azilkërkuesi mund të jetë nën moshën 18 vjeç, gjatë kohëzgjatjes së vlerësimit të moshës (nëse ky vlerësim është i nevojshëm) dhe zgjat deri sa rezultatet përfundimtare tregojnë se azilkërkuesi është i rritur.

E drejta për të mos u diskriminuar (Neni 2 i KDF-së dhe Neni 21 i KDTBE-së)

Çdo person duhet të trajtohet me objektivitet dhe individualisht. Kur kryhet vlerësimi i moshës, është thelbësore të shmangen paragjykimet për disa kombësi ose etni, etj.

E drejta për identitet (Nenet 1, 7 dhe 8 të KDF-së)

Mosha është pjesë e identitetit të njeriut, njësoj si emri, kombësia, shtetësia dhe situata familjare. Ajo përcakton të drejtat dhe detyrimet e personit si dhe detyrimet e Shtetit kundrejt personit (p.sh. detyrimi për të ofruar mbrojtje, arsim, kujdes shëndetësor). Ndër këto detyrime është rivendosja e identitetit të personit, identiteti i të cilit është hequr pa të drejtë, gjë që e detyron shtetin të prodhojë prova për këtë identitet dhe të garantojë njohjen dhe respektimin e këtyre të drejtave nga të tjerët. Vlerësimi i pasaktë i moshës mund të shkaktojë dëme të përhershme nëse personi privohet nga të drejtat e tij dhe nga mundësia për t'i ushtruar ato ose kur këto të drejta nuk i njihen. Vlerësimi i moshës i kryer në mënyrë të pasaktë mund të rezultojë në vënien e fëmijëve në situata me rrezik. Kjo do të thotë se fëmijët mund të përfundojnë duke ndërvepruar me të rritur ose gjenden midis të rriturve, ose të rriturit mund të vendosen gabimisht midis fëmijëve, skenar ky veçanërisht shqetësues.

E drejta për të shprehur lirish pikëpamjet e tyre dhe e drejta për t'u dëgjuar (Nenet 12 dhe 14 të KDF-së dhe Nenet 24 dhe 41 të KDTBE-së)

Kjo është një e drejtë themelore me pasoja të konsiderueshme. Këtu përfshihet e drejta e fëmijës për të shprehur lirish pikëpamjet e tij dhe e drejta që këto pikëpamje të merren parasysh dhe të peshohen siç duhet në përputhje me moshën dhe pjekurinë e fëmijës. Në rastet kur ka dyshime për moshën e azilkërkuesit,

⁽¹²⁾ EASO ka zhvilluar një platformë në internet për të ndihmuar autoritetet kombëtare të identifikojnë në kohë personat me nevoja të veçanta procedurale dhe/ose pritjeje (IPSN), të cilën mund ta gjeni këtu <https://ipsn.easo.europa.eu/>

⁽¹³⁾ Tekstin e KDTBE-së e gjeni këtu <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:12012P/TXT>

duhet bërë kujdes i veçantë për të shmangur konsideratat subjektive ose arbitrare (për shembull ato lidhur me moshën në të cilën fëmija mund të krijojë pikëpamjet e tij) kur merren parasysh pikëpamjet e fëmijës në funksion të nivelit të pjekurisë,. Vëmendje e veçantë i duhet dhënë personave me aftësi të kufizuara dhe personave me nevoja të veçanta (p.sh. analfabetët).

E lidhur shumë ngushtë me të drejtën për të shprehur pikëpamjet dhe me të drejtën për zgjidhje ligjore të efektshme është e drejta për t'u dëgjuar, kjo para se të merren masa individuale të dëmshme kundrejt tij/saj gjatë procedurave administrative ose gjyqësore.

E drejta për informacion

Informacioni është thelbësor që personat të mund të kuptojnë procesin e vlerësimit të moshës, së bashku me të drejtat e detyrimit që ky proces sjell si pasojë. Për më tepër, nëse do t'i kërkohet pëlqimi, personi duhet ta japë këtë pëlqim në bazë të informacionit të saktë dhe të plotë, në liri të plotë, pa asnjë trysni ose kusht.

Respekti për dinjitetin dhe e drejta për integritet (Nenet 3 dhe 37 të KDF-së dhe Nenet 1, 3 dhe 5 të KDTBE-së)

Procesi i vlerësimit të moshës duhet të respektojë dinjitetin e azilkërkuarit dhe integritetin e tij fizik. Duke qenë se ekzaminimet e kryera për vlerësimin e moshës, në të cilat është e nevojshme të tregohen pjesë intime ose zhveshja lakuriq, konsiderohen tepër invazive dhe nuk kanë asnjë qëllim mjekësor, ato duhen shmangur. Të treguarit e pjesëve intime është veçanërisht traumatike dhe e vështirë për t'u kuptuar nga fëmijët, adoleshentët dhe azilkërkuarit me origjinë të ndryshme kulturore. Këto ekzaminime janë shumë stresuese dhe mund të shkaktojnë një traumë të re te fëmijët që mund të jenë ekspozuar ndaj abuzimit ose situatave të tjera të rrezikshme gjatë përvojës së tyre emigruese ose që kanë përjetuar përndjekje ose lëndime të rënda.

Respekti për jetën private dhe mbrojtja e të dhënave personale (Neni 16 i KDF-së dhe Nenet 7 dhe 8 të KDTBE-së)

Kjo e drejtë mbron jetën private të fëmijëve nga ndërhyrja arbitrare e autoriteteve publike dhe e organizatave private si mediat. Kjo lloj mbrojtjeje mbulon katër fusha të mëvetësishme: jetën private, jetën familjare, shtëpinë dhe letërkëmbimin. Ndërhyrja e autoriteteve në jetën personale duhet të jetë e justifikuar, e kufizuar në maksimumin e mundshëm dhe e rregulluar me norma të detajuara. Sipas së drejtës së BE-së, të dhënat personale mund të mblidhen ligjërisht nën kushte të rrepta, për qëllime të ligjshme, mund të merren me pëlqimin e vetë personit ose të përfaqësuesit të tij, ose duhet të kenë justifikim ligjor. Në të kundërt kjo ndërhyrje konsiderohet arbitrare ose e paligjshme. Personat ose organizatat që mbledhin dhe trajtojnë të dhënat personale duhet të sigurojnë mbrojtjen nga keqpërdorimi dhe duhet të respektojnë të drejtat e subjektit të të dhënave, të cilat garantohen nga legjislacioni i BE-së. Fëmijët dhe kujdestarët/përfaqësuesit e tyre duhet të njoftohen për të dhënat që mblidhen në pajtim me kuadrin ligjor kombëtar përkatës. Në kontekstin e mbrojtjes ndërkombëtare, duhet bërë kujdes kur mblidhen të dhëna për të parandaluar përhapjen e informacioneve, gjë që mund të vërë në rrezik azilkërkuarin ose familjen e tij/saj.

E drejta për zgjidhje ligjore të efektshme (Nenet 12 dhe 47 të KDTBE-së)

Kjo e drejtë parashikon kundërshtimin e rezultateve të procesit dhe se fëmijëve u vihet në dispozicion informacioni dhe ndihma e nevojshme për ta ushtruar këtë të drejtë. Kostot financiare për të kundërshtuar vendimin për vlerësimin e moshës nuk mbulohen nga azilkërkuari; përndryshe e drejta për zgjidhje ligjore të efektshme nuk do të mund të ushtrohej.

Pjesa më e madhe e këtyre të drejtave themelore pasqyrohen te parimet (interesat më të larta të fëmijës) dhe te garancitë procedurale në legjislacionin evropian dhe ndërkombëtar, veçanërisht në *acquis* e BE-së për azilin, siç tregohet në kreun vijues.

Kreu 2 Interesat më të larta të fëmijës dhe garancitë procedurale

Interesat më të larta të fëmijës

Parimi i interesave më të larta të fëmijës është i rrënjësor thellë në legjislacionin evropian për të drejtat e njeriut dhe për azilin si dhe në kuadrin ligjor ndërkombëtar ⁽¹⁴⁾.

“Në të gjitha aktet e ndërmarrura në lidhje me fëmijët e mitur, si nga autoritetet publike, ashtu edhe nga institucionet private, interesat më të larta të fëmijës gëzojnë vëmendje parësore.” (Neni 24 i KDTBE-së)

Interesat më të larta të fëmijës, si parim mbizotërues, duhen mbrojtur vazhdimisht, që nga momenti i gjetjes së fëmijës deri në momentin e gjetjes së një zgjidhjeje të qëndrueshme për të.

Në kontekstin e mbrojtjes ndërkombëtare, për çdo tregues se azilkërkuesi mund të jetë fëmijë duhet të nxisë menjëherë marrjen në konsideratë të interesave më të larta të fëmijës në të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me të dhe për pasojë edhe gjatë të gjithë procedurës së azilit. Në këtë kuadër, shtetet pritëse të BE+ janë përgjegjëse për respektimin e interesave më të larta të fëmijës, jo vetëm në procedurat e azilit por edhe në të gjitha proceset dhe vendimet e marra për fëmijën, si për shembull procesi i vlerësimit të moshës.

Siç e pohon edhe Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijës ⁽¹⁵⁾, parimi i interesave më të larta të fëmijës është koncept i trefishtë.

(a) Është e drejtë materiale: e drejta e fëmijës që interesat e tij më të larta të vlerësohen dhe të merren në konsideratë me përparësi kur shqyrtohen interesat e ndryshme me qëllim që të merret një vendim për çështjen në fjalë dhe garancia se kjo e drejtë do të zbatohet sa herë të merret një vendim për një fëmijë, për një grup fëmijësh identiteti i të cilëve njihet ose jo ose për fëmijët në përgjithësi.

(b) Është parim juridik themelor dhe i interpretueshëm: në rast se një dispozitë ligjore ka më shumë se një interpretim, të zgjidhet interpretimi që i shërben më me efektivitet interesave më të larta të fëmijës.

(c) Është rregull procedural: kurdo që duhet të merret një vendim që do të ketë pasojë për një fëmijë në veçanti, për një grup fëmijësh të caktuar apo edhe për fëmijë në përgjithësi, procesi i vendimmarrjes duhet të përmbajë një vlerësim të ndikimit (pozitiv ose negativ) të mundshëm të vendimit të fëmija ose fëmijët në fjalë.

Vlerësimi dhe përcaktimi i interesave më të larta të fëmijës kërkon garanci procedurale. Përveç kësaj, justifikimi i vendimit duhet të tregojë se interesat më të larta të fëmijës janë marrë shprehimisht parasysh. Në këtë aspekt, autoritetet duhet të shpjegojnë si është respektuar kjo e drejtë në vendim, p.sh. cilat janë konsideruar si interesat më të larta të fëmijës; në cilat kritere janë mbështetur këto konsiderata dhe si janë peshuar interesat e fëmijës kundrejt konsideratave të tjera, qofshin këto çështje të gjera të politikës ose raste individuale.

Për rrjedhojë dhe në përputhje me komentimin e përgjithshëm të Komitetit të OKB-së për të drejtat e fëmijës, vendimi për të kryer vlerësimin e moshës dhe metodat e zgjedhura për këtë vlerësim duhet të marrin në konsideratë në mënyrë parësor interesin më të lartë të fëmijës.

⁽¹⁴⁾ Neni 3 i KDF-së, Neni 24 i KDTBE-së; *acquis* i BE-së në fushën e azilit: Neni 23 dhe 11 të DKP-së (reformular), Neni 25, paragrafi 6, i DPA-së (reformular), Neni 20, paragrafi 5, i DK-së dhe Neni 6 i Rregullores Dublin III (rishikuar).

⁽¹⁵⁾ Komenti i Përgjithshëm Nr. 14 (2013) për të drejtat e fëmijës që interesat e tij më të larta të merren në konsideratë me përparësi (Neni 3, paragrafi 1), gjendet në adresën: http://www2.ohchr.org/English/bodies/crc/docs/GC/CRC_C_GC_14_ENG.pdf

Vlerësimi i interesave më të larta të fëmijës për qëllimet e vlerësimit të moshës

Vlerësimi i interesave më të larta verifikon se procesi i vlerësimit të moshës i shërben interesave më të larta të fëmijës, se ekzistojnë garancitë e nevojshme procedurale, se të drejtat e fëmijës në fjalë janë mbrojtur dhe se rezultatet e vlerësimit pritet të largojnë dyshimet për moshën e azilkërkuarit. Vlerësimi i interesave më të larta duhet të marrë në konsideratë rrethanat specifike të fëmijës dhe të sigurojë se interesat më të larta të fëmijës merren parasysh me përparësi kur merret vendimi për të kryer vlerësimin e moshës dhe për mënyrën si kryhet ky vlerësim. Për këtë arsye, procesi i vlerësimit të moshës duhet të ketë në qendër të vëmendjes fëmijën dhe të marrë në konsideratë rrethanat specifike dhe nevojat e azilkërkuarit.

Bazuar në sa më lartë, vlerësimi i interesave më të larta duhet të kryhet para se të merren vendime që kanë pasoja për fëmijën, pra para se të merret vendimi për të ndërmarrë procesin e vlerësimit të moshës.

Në rast se nevojiten veprime të tjera, vlerësimi i interesave më të larta do të kërkojë ndjekje të mëtejshme për t'u siguruar se interesat më të larta janë marrë në konsideratë. Vendimi për të ndërmarrë vlerësimin e moshës duhet të marrë në konsideratë rezultatit e intervistës për vlerësimin e interesave më të larta dhe të gjitha informacionet që gjenden në dosjen e fëmijës. Në rast se vlerësimi i moshës nuk konsiderohet i nevojshëm dhe i dobishëm nisur nga rezultatet e pritshme, ky vlerësim **nuk duhet të ndërmerret**.

Gjithashtu, kur merren në konsideratë interesat më të larta të fëmijës për qëllimin specifik të vlerësimit të moshës në kontekstin e mbrojtjes ndërkombëtare, faktorët e mëposhtëm kanë një rëndësi të veçantë:

- **aspektet e lidhura me sigurinë dhe sigurimin** ⁽¹⁶⁾: në momentin e mbërritjes apo në një fazë të mëvonshme, fëmijët ndonjëherë pretendojnë se janë të rritur për të shmangur vendosjen në strehë për fëmijë. Këto streha kanë masa mbrojtëse shtesë, si kufizimi i lirisë së lëvizjes, dhe kanë personel të dedikuar që përkujdeset për fëmijët. Kjo ndodh për një sërë arsyesh, për shembull nga dëshira për të mbetur të pazbuluar në mënyrë që të vazhdojnë udhëtimin drejt vendit të synuar. Në raste të tjera pretendimi për të qenë madhor mund të jetë pjesë e një skenari të parapërgatitur që u është udhëzuar t'ua japin autoriteteve ose palëve të tjera kur t'i pyesin për moshën. Burimet e këtyre skenarëve të parapërgatitur mund të jenë shumë të larmishme. Fëmijët mund të jenë udhëzuar nga të afërmit ose nga të rriturit që i shoqërojnë, të cilët duan të shmangin ndarjen prej tyre, ose nga kontrabandistë. Megjithatë, burimi mund të jetë edhe një anëtar i rrjetit të trafikut, i cili kërkon të mbajë nën kontroll fëmijën dhe ta kontaktojë atë gjatë qëndrimit në territor. Prandaj është shumë e rëndësishme të mos harrohet se dyshimi për moshën e pretenduar madhore mund të jetë një sinjal se azilkërkuari është viktimë potenciale e trafikut të qenieve njerëzore dhe autoritetet duhet të veprojnë sipas kësaj rrethane (sinjalizimi dhe referimi i rastit të shërbimit kombëtarë përgjegjës, duke përfshirë vlerësimin e mundshëm si një viktimë e trafikut të qenieve njerëzore).
- **mirëqenia e fëmijës** ⁽¹⁷⁾: në rast se vlerësimi i moshës është i justifikuar, metodat e përdorura duhet të jenë sa më pak invazive për fëmijën, sa më të sakta për të vlerësuar grupmoshën, transparente dhe të përcaktuara në pajtim me standardet e miratuara, të kontrollueshme dhe të verifikueshme. Për t'u siguruar që rezultatet e metodave të jenë realiste, marzhi i gabimit duhet të identifikohet dhe të dokumentohet. Duhet të merren në konsideratë dyshimet dhe shqetësimet e fëmijës, duhet të sqarohen arsyet e refuzimit për t'iu nënshtruar vlerësimit të moshës dhe duhen dhënë alternativa, nëse ka. Kërkesat e fëmijës ose të kujdestarit/përfaqësuesit të tij duhet të merren në konsideratë sa më shumë të jetë e mundur për të ruajtur mirëqenien e fëmijës dhe për të ulur ankthin e shkaktuar nga ekzaminimet (duke ulur numrin e personave të pranishëm në dhomën e ekzaminimit/intervistës dhe duke ftuar kujdestarin/përfaqësuesin të jetë i pranishëm në dhomë nëse e kërkon fëmija etj.).
- **origjinat e fëmijës** ⁽¹⁸⁾: është me rëndësi që procesi t'i përshtatet origjinës kulturore të fëmijës (duke caktuar ekzaminues dhe përkthyes në gjuhën e preferuar nga fëmija) si dhe përvojave të tij (largimi dhe migracioni drejt Evropës mund ta bëjnë të ndihet i pambrojtur ose t'ia përkeqësojnë këtë ndjesi).

⁽¹⁶⁾ Neni 23, paragrafi 2, i DKP-së, Neni 6 dhe deklamimi 13 i Rregullores Dublin III dhe deklamimi 18 i DK-së.

⁽¹⁷⁾ Siç parashikohet në Nenin 23, paragrafi 2, të DKP-së, Nenin 6 të Rregullores Dublin III dhe deklamimin 18 të DK-së, 33 të DPA-së, 13 të Rregullores Dublin III dhe 20 të APR-së

⁽¹⁸⁾ Neni 23, paragrafi 2 i DKP-së dhe deklamimi 33 i DPA-së, 13 i Dublin III dhe 18 i DK-së.

- **rrethanat specifike:** autoritetet duhet të shqyrtojnë rrethanat dhe nevojat specifike të azilkërkuarit (grupmosha e vënë në pikëpyetje, gjinia e azilkërkuarit etj.), pasojat e mundshme pozitive dhe negative, pikëpamjet e azilkërkuarit dhe duhet të përcaktojnë nëse metodat e përdorura për rastin konkret janë të përshtatshme.

Si një reflektim i koncepteve të lartpërmendura, kornizat ligjore ndërkombëtare dhe evropiane identifikojnë standardet dhe garancitë e mëposhtme për vlerësimin e moshës.

Prezumimi i pafajësisë duhet të zbatohet sa më gjerë të jetë e mundur në rastin e fëmijëve të pashoqëruar, të cilët kanë më pak gjasa të kenë prova dokumentare.

Fëmijës i caktohet menjëherë një **përfaqësues dhe/ose kujdestar** i kualifikuar dhe i pavarur i cili duhet të veprojë në **interesin** më të lartë të fëmijës. Ai mbikëqyr mirëqenien e tij dhe ushtron kapacitetin juridik.

E drejta për të marrë **informacion** në pajtim me moshën dhe në një gjuhë që azilkërkuari e kupton.

E drejta që të marrë pjesë në proces, që **t'i dëgjohet mendimi** dhe t'i merret në konsideratë në varësi të moshës dhe pjekurisë.

Pëlqimi i informuar dhe **e drejta për të refuzuar** ekzaminimet mjekësore.

Privatësia, mbrojtja e të dhënave dhe konsideratat për sigurinë

Procedura të përshtatura për fëmijët të drejtuar nga **profesionistë të kualifikuar** të cilët njohin veçoritë kulturore dhe etnike të azilkërkuarit.

Zbatimi i **metodës dhe i proceseve më pak invazive** (procese me zbatim gradual), të përshtatura me gjininë dhe kulturën e azilkërkuarit.

Saktësia dhe marzhi i gabimit të zbatohet në favor të azilkërkuarit.

E drejta për **zgjidhje të efektshme ligjore** sipas rastit.

Kur procesi dhe burimet e disponueshme nuk i sigurojnë dot garancitë e lartpërmendura, për shembull kur ka flukse të mëdha apo zbarkime masive, vlerësimi i moshës mund të kryhet në një fazë të mëvonshme ose në dy etapa (një ekzaminim paraprak në momentin e mbërritjes dhe një vlerësim i plotë sapo ta lejojnë kushtet). Në këtë skenar, prezumimi i pafajësisë zbatohet plotësisht dhe mosha e deklaruar duhet të pranohet deri sa kushtet të lejojnë kryerjen e një vlerësimi të sigurt dhe të efektshëm të moshës⁽¹⁹⁾.

Duhet theksuar se, teksa udhëzimet dhe mjetet e përmendura në këtë botim përqendrohen vetëm te procesi i vlerësimit të moshës, vlerësimi i interesit më të lartë të fëmijës duhet të vazhdojë deri sa të gjendet një zgjidhje e qëndrueshme për fëmijën. Për më tepër, vlerësimi i interesave më të larta nuk zëvendëson përcaktimin e interesave më të larta, gjë që kërkohet kur merren në konsideratë zgjidhje të qëndrueshme për fëmijën.

Zbatimi i parimit të prezumimit të pafajësisë

Prezumimi i pafajësisë është parimi dhe garancia kryesore në fushën vlerësimit të moshës, pasi asnjë nga metodat ekzistuese të vlerësimit të moshës nuk është në gjendje të përcaktojë moshën me saktësi.

⁽¹⁹⁾ Mund të gjeni udhëzime të mëtejshme dhe rekomandime praktike në Kreun 4 dhe Shtojcën 2 (mjetet për interesat më të larta të fëmijës).

Për shkak të rëndësisë që ka, parimi i prezumimit të pafajësisë shfaqet vazhdimisht si garanci thelbësore procedurale në çështjet që lidhen me fëmijët dhe në procesin e vlerësimit të moshës në *acquis* të BE-së për azilin (Neni 25, paragrafi 5, i DPA-së, i rishikuar). Për më tepër, direktiva antitrafik (DAT) ⁽²⁰⁾ parashikon në mënyrë të qartë se në rastet kur mosha është e paqartë, prezumimi i pafajësisë duhet të zbatohet si më poshtë.

“Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë se kur mosha e një personi viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore është e paqartë dhe ka arsye për të besuar se ky person është fëmijë, personi në fjalë konsiderohet fëmijë në mënyrë që të përfitojë asistencë, mbështetje dhe mbrojtje të menjëhershme.” (Neni 13, paragrafi 2, DAT).

Çështja bëhet edhe më e ndërlikuar pasi dyshimet për moshën e azilkërkuesit janë shpesh pasojë e mungesës së dokumenteve vërtetuese. Kjo ndodh rëndom në rastet e fëmijëve. Megjithatë, procesi i vlerësimit të moshës mund të mos i largojë të gjitha dyshimet (rezultatet shpesh dalin 1 ose 2 vjet nën ose mbi 18 vjeç) për shkak të kufizimeve të metodave ekzistuese.

Vlerësimi i moshës nuk duhet të jetë praktikë rutinë. Nevoja për vlerësimin e moshës duhet të jetë **e justifikuar në formën e duhur** në bazë të **dyshimeve të përligjura** mbi moshën e deklaruar. Vlerësimi i moshës duhet bërë vetëm në rastet kur ka mungesë provash dhe/ose kur disa elemente të provave kundërshtojnë moshën e deklaruar nga azilkërkuesi. Në rast se provat që disponohen nuk e kundërshtojnë moshën ose e pohojnë moshën e deklaruar, atëherë ajo duhet pranuar.

Në rastet kur ka mungesë provash dokumentare, si: pasaportë, letërnjoftim, leje qëndrimi ose dokumente udhëtimi si ato të lëshuara nga UNHCR-ja, certifikata nga vende të tjera ose certifikata të lëshuara nga gjendja civile ose fetare të cilat vërtetojnë gjendjen civile (certifikata e martesës, certifikata e lindjes, certifikata familjare e azilkërkuesit apo e pjesëtarëve të familjes ku jepet mosha e azilkërkuesit), autoritetet mund të jenë të paqarta ose të kenë **dyshime të thjeshta** për moshën e personit.

Dyshimet e thjeshta

Kur ka mungesë dokumentesh të vlefshme, në rast se mosha e pretenduar (nga deklaratimet e azilkërkuesit) mbështetet ose pohohet nga të paktën një prej elementeve të mëposhtme të provës së mbledhur nga autoritetet, atëherë mosha e deklaruar mund të pranohet pa qenë nevoja për të kryer vlerësimin e moshës.

- Informacione nga baza të tjera të dhënash.
- Deklarime nga pjesëtarët e tjerë të familjes, të afërm ose nga kujdestari i fëmijës.
- Vlerësimet e para të pamjes fizike.

Elementet mund të kenë peshë të ndryshme në bazë të besueshmërisë të elementit specifik në krahasim me të tjerët.

Në raste të tjera, kur dokumentacioni mungon dhe mosha e deklaruar nuk mbështetet nga disa elemente të provave të mbledhura nga autoritetet apo kundërshtohet prej tyre, dyshimet duhet të konsiderohen **të justifikuara**. Në rastet kur personi konsiderohet gabimisht i rritur ose fëmijë dhe kjo shkakton pasoja të dëmshme, fillimi i vlerësimit të moshës duhet të konsiderohet i nevojshëm, me kusht që të jetë në interesin më të lartë të fëmijës .

⁽²⁰⁾ Direktiva 2011/36/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 5 prill 2011, “Për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, për mbrojtjen e viktimave të tij dhe për zëvendësimin e Vendimit Kuadër të Këshillit 2002/629/JHA” gjendet këtu: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2011:101:0001:0011:EN:PDF>.

Dyshimet e justifikuara

Në rast mungese të dokumenteve të vlefshme, nëse moshë e pretenduar (nga deklaratimet e azilkërkuarit) nuk mbështetet ose kundërshtohet nga disa elemente të provës të mbledhura nga autoritetet, atëherë moshë e deklaruar nuk mund të pranohet dhe do të jetë e nevojshme të kryhet vlerësimi i moshës.

- Informacione nga baza të tjera të dhënash.
- Deklarime nga pjesëtarët e tjerë të familjes, të afërm ose nga kujdestari i fëmijës.
- Vlerësimet e para të pamjes fizike (të ekzaminohet vetëm në kombinim me elementet e mësipërme, jo më vete).






Elementet mund të kenë peshë të ndryshme në bazë të besueshmërisë së elementit specifik në krahasim me të tjerët.

Pas analizës së elementeve të mësipërme, autoritetet mund të kenë dyshime të justifikuara për moshën e deklaruar, prandaj mund të nevojitet vlerësimi i moshës për të gjetur moshën e azilkërkuarit.

Moshë e azilkërkuarit si fakt material

Në disa raste të veçanta, si p.sh. arsyet për mbrojtje ndërkombëtare specifike për fëmijët (martesa e detyruar, fëmijët ushtarë, etj.), moshë e azilkërkuarit përbën një fakt material⁽²¹⁾ dhe si i tillë ka rëndësi në shqyrtimin e aplikimit për mbrojtje ndërkombëtare. Në këto raste, edhe nëse deklaratimet e azilkërkuarit nuk mbështeten në dokumente ose në prova të tjera, ato do të konsiderohen të besueshme dhe do të pranohen pa qenë nevoja e kryerjes së vlerësimit të mëtejshëm të moshës, me kusht që të përmbushen kushtet e mëposhtme (siç e parashikon Neni 4, paragrafi 5, i DK-së).

Kushtet që deklaratimet e azilkërkuarit të quhen të besueshme, edhe nëse nuk mbështeten në prova

 <p>Azilkërkuari vërtet përpiqet të përligjë aplikimin.</p>	 <p>Azilkërkuari ka paraqitur elemente me vlerë dhe të disponueshëm dhe ka dhënë shpjegime të kënaqshme për elementet që mungojnë.</p>	 <p>Deklarimet e azilkërkuarit janë koherente dhe të besueshme.</p> <p>p.sh. pamja fizike dhe pjekuria psikologjike janë në koherencë me moshën e deklaruar, informacioni është në pajtim me</p>	 <p>Azilkërkuari ka aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare sapo iu dha mundësia.</p> <p>ose ka dhënë justifikime të vlefshme për mungesën e</p>	 <p>Përgjithësisht azilkërkuari si është i besueshëm.</p>
---	--	--	--	---

Kjo është dispozitë veçanërisht e rëndësishme për fëmijët e pashoqëruar të cilët kanë më pak gjasa për të pasur prova dokumentare, sidomos në rastin e atyre që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare.

Informacioni duhet të vlerësohet nga nëpunësit e ngarkuar me çështjet e azilit ose migracionit dhe duhet të marrë në konsideratë situatën individuale dhe kontekstuale të azilkërkuarit. Në rastet e fëmijëve ose të atyre të hamendësuar si të tillë, sidomos kur janë të pashoqëruar, niveli i pritshmërisë për provat e disponueshme dhe për koherencën në deklaratime duhet të jetë më i ulët.

Prezumimi i pafajësisë gjatë gjithë procesit të vlerësimit të moshës

Për shkak të pasaktësisë ose faktorët potencial invaziv të metodologjive ekzistuese, zbatimi sistematik i prezumimit të pafajësisë gjatë gjithë vlerësimit të moshës është kritik. Është e nevojshme që të njihet dhe përcaktohet marzhi i gabimit të metodave ekzistuese që përdoren në proces dhe ndikimi i tij në rezultat.

⁽²¹⁾ Sipas përkufizimit të bërë në Udhëzuesin praktik të EASO-s: vlerësimi i provave, faktet materiale janë fakte (të pretenduara) të lidhura me një ose më shumë kushte të parashtruara në përkufizimin e refugjatit ose të personit që ka të drejtë të përfitojë mbrojtje plotësuese.


Këto pasaktësi nuk duhet të shkaktojnë dëme në të drejtat apo dëshmitë e azilkërkuesit; përkundrazi, zbatimi i duhur i prezumimit të pafajësisë duhet t'i orientojë autoritetet drejt një interpretim në favor të azilkërkuesit kur rezultatet janë jo, *in dubio pro refugio* ose *in dubio pro minore*.

“Shtetet anëtare mund të përdorin ekzaminimet mjekësore për të përcaktuar moshën e të miturve të pashoqëruar brenda kornizës së shqyrtimit të aplikimit për mbrojtje ndërkombëtare në rastet kur, bazuar në deklaratimet e përgjithshme ose në elemente të tjerë të lidhur me të, Shtetet Anëtare kanë dyshime për moshën e azilkërkuesit. Në rast se, edhe më pas, Shtetet Anëtare kanë përsëri dyshime për moshën e azilkërkuesit, ata duhet ta konsiderojnë të mitur azilkërkuesin.” Neni 25, paragrafi 5, i DPA-së

Një nga avantazhet kryesore për fëmijët që ky parim të zbatohet që në fazën e identifikimit është përgjigja e menjëhershme ndaj çdo dyshimi dhe shmangia e procedurave të gjata dhe të kushtueshme për marrjen e përgjigjes. Përveç kësaj, ky parim mund dhe duhet të zbatohet para dhe gjatë të gjitha fazave të procesit të vlerësimit të moshës, nëse ekspertët e përfshirë në proces ngrenë edhe më të voglin dyshim (gjatë vlerësimit të moshës ose gjatë interpretimit të rezultateve). Kjo është me shumë rëndësi në situatat me flukse të mëdha, në të cilat autoritetet duhet të marrin vendime të shpejta dhe burimet janë nën sforcë maksimale. Megjithatë, të përballur me mundësinë se kemi të bëjmë me një fëmijë, personi nuk duhet konsideruar si i rritur dhe për rrjedhojë nuk duhet vendosur në qendra strehimi për të rritur ose në një qendër burgimi, as para e as gjatë vlerësimit të moshës.

Azilkërkuesi duhet të konsiderohet dhe trajtohet si fëmijë përgjatë të gjitha këtyre etapave:

Zbatimi praktik i parimit të prezumimit të pafajësisë



Prandaj **prezumimi i pafajësisë** zbatohet në rastet e mëposhtme:

Kur moshë e deklaruar (nga deklaratimet e azilkërkuarit) nuk mbështetet në dokumentacion, por është koherent me elementet e tjera të mbledhura nga autoritetet, zbatohet drejtpërdrejt prezumimi i pafajësisë, gjë që do të thotë se nuk ka nevojë për vlerësim të moshës.

- Në rastet kur është ndërmarrë vlerësimi i moshës, individit duhet të prezumohet i pafajshëm dhe të trajtohet si fëmijë gjatë të **gjithë zhvillimit të procesit dhe për atë kohë sa ka ende dyshime**.
- Nëse rezultati i **vlerësimit të moshës** përmes një prej metodave të përdorura është se kemi të bëjmë me një fëmijë, vlerësimi duhet të ndërpritet dhe **mosha më e ulët e grupmoshës** do të merret si e vlefshme.
- Si përfundim, nëse edhe **pas mbarimit të procesit** rezultatet ende **nuk janë bindëse**, vlerësimi i moshës do të konsiderojë si **të vlefshme moshën më të ulët të grupmoshës**⁽²²⁾.

Zbulimet kryesore nga praktika e shteteve BE+

Azilkërkuari konsiderohet fëmijë gjatë vlerësimit të moshës në 17 shtete BE+.

Një Shtet Anëtar zbaton një marzh gabimi prej 2 vitesh në favor të azilkërkuarit, pasi të jenë marrë rezultatet.

Dy shtete BE+ nuk e zbatojnë prezumimin e pafajësisë.

Informacione të tjera mund të gjenden në Shtojcën 4 të këtij botimi

Kujdestari/përfaqësuesi

Si garanci thelbësore për fëmijët e pashoqëruar, personit të konsideruar fëmijë duhet **t'i caktohet një kujdestar/përfaqësues i pavarur dhe i kualifikuar sa më shpejt të jetë e mundur** (shih Nenin 25, paragrafi 1, i DPA-së).

Përfaqësuesi është një person apo organizatë e caktuar nga organi kompetent për të ndihmuar dhe përfaqësuar fëmijën e pashoqëruar gjatë procedurave. Përfaqësuesi siguron interesat më të larta të fëmijës dhe, aty ku është e nevojshme, ushtron kapacitetin juridik për fëmijën⁽²³⁾. Përfaqësuesi duhet të caktohet sa më shpejt të jetë e mundur dhe para fillimit të çfarëdo ekzaminimi për vlerësimin e moshës. Përveç kësaj, përfaqësuesi duhet të jetë **i pavarur**, të mos ketë asnjë konflikt interesi dhe të sigurohet se po vepron sipas interesave më të larta të fëmijës, siç e parashikojnë Neni 24, paragrafi 1 dhe Neni 25, paragrafi 1, germa a, të DPA-së (rishikuar) dhe Neni 24 i DPK-së (rishikuar). Kur, për arsye praktike, fëmijës nuk mund t'i caktohet menjëherë kujdestari, duhen marrë masat që t'i caktohet një person i cili përmbush përkohësisht detyrat e kujdestarit. Në këto raste, kujdestari i përkohshëm duhet të përmbushë të njëjtat kushte si kujdestarët e përhershëm (për kualifikimet dhe pavarësinë). Përfaqësuesi duhet **të njoftohet dhe t'i merret mendimi** për të gjitha aspektet e procesit të vlerësimit të moshës dhe duhet t'i jepet mundësia të shoqërojë fëmijën gjatë ekzaminimeve, nëse fëmija e dëshiron këtë. Kur vlerësimi i moshës konsiderohet së është në interesin më të lartë të fëmijës, por fëmija e refuzon atë, kujdestari/përfaqësuesi mund gjithsesi **të japë pëlqimin** për kryerjen e vlerësimit. Megjithatë, kjo gjë duhet të sqarohet mirë midis fëmijës dhe përfaqësuesit të tij, në mënyrë që të mos komprometohet marrëdhënia e besimit midis tyre.

Kujdestari/përfaqësuesit duhet gjithashtu të jetë i pranishëm në intervistën për vlerësimin e interesit më të lartë, nëse është e mundur. Edhe këshilltari ligjor i fëmijës, nëse e ka një të tillë, duhet të kontaktohet dhe të marrë pjesë në intervistën për vlerësimin e interesit më të lartë⁽²⁴⁾.

⁽²²⁾ Shih Nenin 25, paragrafi 5, të DPA-së (riformular) dhe Komentin e Përgjithshëm Nr. 6 të komitetit të OKB-së.

⁽²³⁾ Neni 2, germa n), i DPA-së.

⁽²⁴⁾ Për këtë qëllim mund të përdoret listë kontrolli për VIL-në në Shtojcën 2.

Procesi duhet të vazhdojë në prani të kujdestarit/përfaqësuesit, nëse fëmija nuk kërkon të kundërtën. Sidoqoftë, kujdestari/përfaqësuesi duhet të ndjekë nga afër procesin që të mund t'i japë këshilla azilkërkuesit kur ai të ketë nevojë.

Zbulimet kryesore nga praktika e shteteve BE+

Në 23 shtete BE+ lejohet prania e një personi të pavarur për të mbështetur azilkërkuesin gjatë ekzaminimeve. Në 12 prej tyre, ky rol ushtrohet nga kujdestari ose përfaqësuesi.

Një shtet BE+ lejon praninë e këtij personi të pavarur vetëm për rastet që i nënshtrohen rregullores së Dublinit.

Një shtet BE+ lejon praninë e një personi mbështetës gjatë ekzaminimeve mjekoligjore.

Një shtet BE+ e ndalon një prani të tillë.

Informacione të tjera mund të gjenden në Shtojcën 4 të këtij dokumenti.

Udhëzime të tjera për rolin e kujdestarit në procesin e vlerësimit të moshës mund të gjenden në broshurën e FRA-së “Kujdestaria e fëmijëve të privuar nga kujdesi prindëror”⁽²⁵⁾, i cili jep udhëzimet e mëposhtme.

Veprime të mundshme që kujdestari ndërmerret në raport me vlerësimin e moshës:

- kontrollon që të ketë **arsye legjitime** për vlerësimin e moshës dhe kërkon që fëmijët të cilët duken qartë që janë të mitur të mos i nënshtrohen këtij vlerësimi;
- sigurohet që fëmija të marrë të gjithë **informacionin e duhur** për procedurën e vlerësimit të moshës, duke përfshirë këtu informacionin e qartë për qëllimin, për procesin në vetvete dhe për pasojat e mundshme. Informacioni duhet të jepet në formë të përshtatur për një fëmijë dhe në gjuhën që kupton fëmija;
- sigurohet se vlerësimi i moshës kryhet pasi të merret **pëlqimi i informuar** i fëmijës dhe i kujdestarit të tij;
- kontrollon që vlerësimi të ndërmerret dhe kryhet në mënyrë të sigurt, të përshtatur për moshën dhe gjininë e fëmijës dhe në respekt të dinjitetit të fëmijës, nga profesionistë të pavarur, me **ekspertizën e duhur**, të cilët njohin mirë origjinën etnike dhe kulturore të fëmijës;
- nëse pas përfundimit të procesit të vlerësimit të moshës ka ende dyshime për moshën e fëmijës, kujdestari këmbëngul që personi të konsiderohet **fëmijë**;
- sigurohet që **rezultati** i procedurës t'i shpjegohet fëmijës në mënyrë të përshtatshme për një fëmijë dhe në gjuhën që ai kupton.
- kërkon që **rezultatet** e procedurës së vlerësimit t'i jepen edhe kujdestarit dhe ato të përfshihen në dosjen e fëmijës;
- shqyrton bashkë me fëmijën **mundësinë për ankim** kundër vendimit për vlerësimin e moshës, në pajtim me legjislacionin e brendshëm;
- me pëlqimin e fëmijës, **është i pranishëm** gjatë procedurës së vlerësimit të moshës.

Shembuj nga praktika

Danimarka — Në rastet e fëmijëve të pashoqëruar, mund të ketë vonesa në emërimin e një kujdestari për shkak të mosmarrëveshjeve që lidhen me moshën e fëmijës. Kjo gjë mund të ndodhë kur procedurat për vlerësimin e moshës duhen kryer para se të emërohet kujdestari. Për të shmangur këto vonesa, Kryqi i Kuq danez është organizata e ngarkuar për emërimin e një vëzhguesi, i quajtur “bisidder”.

Mbretëria e Bashkuar — Shërbimi skocez për kujdestarinë (The Scottish Guardianship Service), punon me fëmijët dhe të rinjtë që mbërrijnë në Skoci të pashoqëruar dhe të ndarë nga familjet e tyre. Ky

⁽²⁵⁾ Broshura gjendet në adresën http://fra.europa.eu/sites/default/files/fra-2014-guardianship-children_en_0.pdf

shërbim mbështet dhe punon me të rinj nën moshën 18 vjeç, të cilët kërkojnë azil ose janë trafikuar nga jashtë BE-së. Shërbimi punon me këdo që trajtohet si fëmijë nën 18 vjeç, por mosha e të cilëve është në pikëpyetje dhe i nënshtrohet vlerësimit të moshës. Fëmijëve dhe të rinjve u caktohet një kujdestar që t'i ndihmojë të kuptojnë, të marrin pjesë dhe të përshkojnë proceset e ndërlikuara ligjore dhe ato që lidhen me emigracionin dhe me asistencën sociale.

E drejta për t'u informuar

Para se të shqyrtohet aplikimi për mbrojtje ndërkombëtare, fëmija duhet të marrë të gjitha **informacionet përkatëse në mënyrë të përshtatur për fëmijët** dhe në një gjuhë që fëmija e kupton. Duhet pasur kujdes që fëmija të ketë kuptuar informacionin para se të kryhet vlerësimi. Ky informacion duhet të jepet pa pagesë dhe u duhet dhënë përgjigje të gjitha pyetjeve që mund të ketë azilkërkuesi apo kujdestari/përfaqësuesi. Është thelbësore që azilkërkuesi të kuptojë procesin, objektivat dhe pasojat e tij (p.sh. duke i kërkuar që ta shpjegojë me fjalët e veta). Disa azilkërkues mund të mos kenë guximin për të bërë pyetje për shkak të moshës, origjinës kulturore nga vijnë apo për shkak të gjendjes psikologjike. Përdorimi i materialeve të përshtatura për fëmijët ose për nevojat specifike të personit mund të jetë i dobishëm që azilkërkuesi të kuptojë procesin. Megjithatë, në praktikë, aftësitë dhe sjellja mbështetëse dhe me empati e personit që e jep informacionin ka rëndësi parësore për një rezultat të suksesshëm. Informacioni duhet dhënë në mënyrë sistematike gjatë të gjithë procesit dhe dhënia e tij duhet të dokumentohet (kur është dhënë, nga kush etj.). Informacioni duhet të mbulojë së paku përmbajtjen në vijim:

- dyshimet për moshën dhe arsyet e këtyre dyshimeve;
- mundësinë që mosha të vlerësohet me procedurë vlerësimi, e cila përfshin edhe një ekzaminim mjekësor, nëse azilkërkuesi jep pëlqimin;
- detaje për metodën dhe procesin (cilat metoda përdoren, përse janë përzgjedhur pikërisht këto metoda, saktësia dhe karakteri invaziv i metodës, ndikimi që një metodë specifike mund të ketë, etj.);
- dyshimet dhe shqetësimet që duhet të trajtohen (dhënia sistematike e informacionit dhe të kuptuarit mirë të procesit dhe qëllimit të tij janë thelbësore për ta pasur më të lehtë marrjen e pëlqimit);
- të drejtat dhe detyrimet që lidhen me procesin (pasoja nuk duhet të jenë tepër të dëmshme, në të kundërt ato do të ndikonin në dhënien e pëlqimit nga azilkërkuesi);
- të drejtën për të refuzuar kryerjen e ekzaminimeve mjekësore dhe pasojat e këtij refuzimi;
- mundësinë për të kundërshtuar rezultatet e vlerësimit të moshës;
- etapat e mëtejshme që duhen ndjekur.

Zbulimet kryesore nga praktika e shteteve BE+

Shumica e shteteve që u përgjigjën (15 shtete BE+) dhanë informacione për të gjitha metodat e përdorura në procesin e vlerësimit të moshës, ndërsa 9 shtete BE+ dhanë informacione vetëm kur metodat mjekësore u vunë në zbatim.

Në 22 shtete BE+ azilkërkuesi merr informacion në një gjuhë që ai e kupton ose mendohet se e kupton.

Një shtet BE+ informon azilkërkuesin vetëm kur rezultatet e vlerësimit tregojnë se mosha e tij është më e madhe nga ajo e deklaruar.

Një shtet BE+ kujdeset që vendimi zyrtar të shpjegohet nga punonjësit socialë.

Informacione të tjera mund të gjenden në Shtojcën 4 të këtij dokumenti.

E drejta për të shprehur pikëpamjet e veta dhe për t'u dëgjuar

Sipas parashikimit të Nenit 12 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës dhe sipas analizës së bërë në Komentin e Përgjithshëm Nr. 12 të Komitetit të OKB-së, e drejta për t'u dëgjuar zbatohet për çdo fëmijë që ka aftësi të krijojë pikëpamjet e tij. Informimi dhe mbështetja janë vendimtare në zhvillimin e aftësisë së fëmijës për të krijuar pikëpamjet e tij.

Pasi azilkërkuesi ka marrë informacionin dhe e ka kuptuar atë, pikëpamjet e tij duhet të mblidhen dhe të merren në konsideratë për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me të, në pajtim me nivelin e tij të pjekurisë. Kjo e drejtë duhet zbatuar në mënyrë sistematike gjatë të gjithë procedurës dhe më së paku në momentet e mëposhtme.

- Pikëpamjet duhet të merren sa herë autoritetet të kenë **dyshime** për deklaratimet ose provat e dhëna nga azilkërkuesi. Thjesht përpjekja për të shkëmbyer mendime dhe për të shpjeguar në mënyrë konstruktive arsyet e mospranimit të moshës së deklaruar ose të pamjaftueshmërisë së informacionit mund të ndihmojë azilkërkuesin të kuptojë procesin dhe të rrisë vullnetin e tij për bashkëpunim.
- Në rastet kur ka **mungesë konsekuence** në moshën e azilkërkuesit, atij i duhet dhënë mundësia dhe koha të shpjegojë mungesën e konsekuencës me shkrim ose me gojë.
- Ndonjëherë azilkërkuesi mund të **japë prova për moshën e deklaruar** duke paraqitur dokumente, prova apo shpjegime të besueshme shtesë. Në këto raste, këto shpjegime dhe kushte do ta bënin të panevojshëm vlerësimin e moshës.
- Në rastet kur azilkërkuesi **refuzon t'i nënshtrohet** ekzaminimit mjekësor, duhet të sqarohen arsyet e këtij refuzimi dhe, përveç kësaj, azilkërkuesi duhet dëgjuar. Ndonjëherë ky ngurrim mund të kapërcehet duke i dhënë azilkërkuesit më shumë informacion ose duke përshtatur procesin me nevojat e tij, për shembull duke zgjedhur një metodë alternative.
- Meqenëse pasojat e identifikimit si i rritur ose si fëmijë janë të konsiderueshme, azilkërkuesit i duhet dhënë mundësia për **të kundërshtuar rezultatet** menjëherë dhe pa pengesa në rast se rezultatet përfundimtare të vlerësimit të moshës janë të ndryshme nga moshja e deklaruar.
- Përfshirja dhe pjesëmarrja e vazhdueshme në proces ndihmon në uljen e ndjenjës së pasigurisë dhe ankthit dhe në ndërtimin e besimit midis azilkërkuesit dhe autoriteteve të shteteve pritëse BE+. Fëmijët që intervistohen shpesh ndihen në ankth për mundësinë se mund të perceptohen si "gënjeshhtarë". Për më tepër, ata mund të jenë duke përjetuar stres post-traumatik. Prania e përfaqësuesit është thelbësore për të garantuar që pikëpamjet e azilkërkuesit **të dëgjohen dhe të merren parasysh** në funksion të nivelit të tij të pjekurisë dhe që fëmija të ndihmohet në marrjen e vendimit të informuar për t'iu nënshtuar ekzaminimeve përmes metodave specifike që përdoren.

Meqenëse për të përcaktuar nevojën e vlerësimi të moshës është thelbësore që fëmija të inkurajohet të japë informacion për moshën e tij, nëpunësit që ndërveprojnë drejtpërdrejt me fëmijën duhet të jenë të trajnuar për të përdorur **teknikat e intervistave me fëmijët**. Për të vlerësuar siç duhet informacionin për moshën e deklaruar nga fëmija, këta zyrtarë duhet të kenë informacionin dhe ekspertizën e nevojshme për kontekstin e lidhur me vendin e origjinës së fëmijës ⁽²⁶⁾. Sa herë të jetë e mundur, edhe përkthyesi duhet të jetë i familjarizuar me intervistat e fëmijëve.

Pëlqimi i informuar dhe e drejta për të refuzuar

Pëlqimi i informuar është një vendim i marrë lirisht, vullnetarisht dhe i bazuar në informacion. Sipas Nenit 25, paragrafi 5, i DPA-së, azilkërkuesit dhe/ose përfaqësuesit e tyre duhet të japin pëlqimin për ekzaminimet mjekësore. Marrja e pëlqimit për vlerësimin e moshës rekomandohet gjithmonë kur përdoren metoda jo mjekësore, edhe pse ky pëlqim nuk është kërkesë ligjore. Pëlqimi mund të merret nëse jepet informacion sistematik dhe i efektshëm dhe nëse kuptohet mirë procesi dhe qëllimet e tij.

⁽²⁶⁾ EASO mbledh dhe zhvillon informacione për vendet e origjinës, të cilat gjenden në faqen e saj zyrtare: <https://www.easo.europa.eu/information-analysis/country-origin-information/country-reports>

Pëlqimi i informuar duhet të merret nga azilkërkuesi dhe/ose përfaqësuesi i tij para se të ndërmerret vlerësimi i moshës dhe pasi azilkërkuesit i është dhënë informacioni i duhur për të marrë një **vendim të informuar**. Veçanërisht duhet shpjeguar që të kuptohet mirë ndikimi i ekzaminimit mjekësor, e drejta për të refuzuar kryerjen e ekzaminimeve mjekësore dhe pasojat e këtij refuzimi.

Siç u tha më lart, azilkërkuesi ka të drejtën të refuzojë që t'i nënshtrohet ekzaminimeve mjekësore. Ndonjëherë ky ngurrim për t'iu nënshtrohet ekzaminimeve mjekësore mund të fashitet duke i dhënë azilkërkuesit më shumë informacion ose duke përshtatur procesin me nevojat e tij, për shembull duke zgjedhur një metodë alternative. Fakti që azilkërkuesi ka refuzuar t'i nënshtrohet këtyre ekzaminimeve nuk duhet të pengojë autoritetet përgjegjëse që të marrin vendim për aplikimin për mbrojtje ndërkombëtare (Neni 25, paragrafi 5, i DPA-së). Përveç kësaj, aplikimi për mbrojtje ndërkombëtare nuk duhet rrëzuar vetëm sepse azilkërkuesi ka refuzuar t'u nënshtrohet ekzaminimeve mjekësore. Asnjë hamendësim apo pasojë nuk duhet të dalë automatikisht nga ky refuzim. Për më tepër, në rast refuzimi, azilkërkuesi nuk duhet konsideruar automatikisht i rritur, por duhen sqaruar arsyet e refuzimit, situata e tij duhet vlerësuar në baza individuale dhe pasojat e refuzimit nuk duhet të sjellin dëme aq të shpërpjesëtuara sa të ndikojë në vlerësimin e azilkërkuesit. Në rast se azilkërkuesi vendos të mos i nënshtrohet vlerësimit të moshës dhe e bën këtë pa dhënë justifikime, vlerësimi duhet të vazhdojë me elementet që autoritetet kanë në dispozicion.

Zbulimet kryesore nga praktika e shteteve BE+

- 11 shtete BE+ e marrin pëlqimin e informuar të azilkërkuesit, pavarësisht nga metoda e vlerësimit të moshës.
- 12 shtete BE+ kërkojnë pëlqimin e azilkërkuesit vetëm nëse përdoren metoda mjekësore.
- Katër shtete BE+ nuk e kërkojnë pëlqimin për asnjë metodë (dy prej tyre nuk kërkojnë pëlqim sepse nuk përdorin fare metoda mjekësore).
- Nga ana tjetër, gjashtë shtete BE+ kërkojnë pëlqimin nga përfaqësuesi për çdo rast.
- Shtatë shtete BE+ e kërkojnë pëlqimin e përfaqësuesit vetëm kur përdoren metodat mjekësore.
- Një shtet BE+ kërkon pëlqimin e përfaqësuesit nëse azilkërkuesi duket se është nën moshën 14 vjeç.
- Pesë shtete BE+ nuk e kërkojnë fare pëlqimin e përfaqësuesit.
- 15 shtete BE+ i japin azilkërkuesit mundësinë të refuzojë vlerësimin e moshës pavarësisht nga metoda e përdorur.
- Shtatë shtete BE+ e japin mundësinë e refuzimit, por vetëm për ekzaminimet mjekësore.
- Në tre shtete BE+ kjo mundësi nuk ofrohet fare.
- Sa u takon pasojave të refuzimit për t'iu nënshtrohet vlerësimit mjekësor të moshës:
 - në 15 shtete BE+ azilkërkuesi nuk konsiderohet automatikisht i rritur;
 - në gjashtë shtete BE+ azilkërkuesi konsiderohet i rritur nëse nuk jep justifikime për refuzimin apo nuk ka të dhëna të tjera që tregojnë se azilkërkuesi është fëmijë;
 - në gjashtë shtete BE+ azilkërkuesi konsiderohet automatikisht i rritur nëse ai refuzon t'i nënshtrohet vlerësimit të moshës;
- Në shtatë shtete BE+ në momentin e marrjes së vendimit për aplikimin për mbrojtje ndërkombëtare refuzimi nuk merret në konsideratë, ndërsa në 14 shtete BE+ merret në konsideratë.
- Një shtet BE+ ka sqaruar se e merr parasysh refuzimin vetëm nëse të qenët i mitur ka rëndësi për thelbin e kërkesës (arsye për përndjekje ose lëndim serioz specifike për fëmijët).

Informacione të tjera mund të gjenden në Shtojcën 4 të këtij botimi.

Parimi i ruajtjes së privatësisë dhe mbrojtja e të dhënave për arsye sigurie

Privatësia lidhet me përpunimin e informacionit. Kur informacioni trajtohet në mënyrë sekrete, ai mund të nxirret vetëm me pëlqim të subjektit të informacionit ose mund t'u jepet palëve të autorizuara, nëse është parashikuar sipas legjislacionit të brendshëm. Informacioni që nxirret kufizohet vetëm te informacionet e nevojshme që u lejojnë këtyre autoriteteve të kryejnë funksionet e tyre. Nëse ligji nuk e lejon këtë, kontrolluesit të informacionit do t'i duhet pëlqimi i subjektit të të dhënave për të transmetuar informacionin te një palë tjetër. Para se të transmetohen të dhënat me natyrë sensitive, duhet marrë pëlqimi i fëmijës në një mënyrë të përshtatur për moshën e tij. Të gjithë pjesëmarrësit në procesin e vlerësimit duhet të kuptojnë dhe të respektojnë detyrimet për mbrojtjen e të dhënave. Përveç kësaj, pëlqimi i informuar duhet t'i merret individit para se të përhapet më tej informacioni. Informacioni duhet të mbledhet dhe të përdoret vetëm për qëllimet e vlerësimit të moshës.

Parimi i privatësisë është pazgjidhshmërisht i lidhur me çështjet e sigurisë. Garancia për siguri dhe privatësi duhet të vendoset si garanci e rëndësishme në procesin e vlerësimit të moshës. Kjo merr vlerë edhe më të madhe në rastin e fëmijëve të pashoqëruar që mund të kenë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare.

Ky aspekt merr peshë edhe më të madhe kur kërkohet informacion për vendin e origjinës së fëmijës i cili ka aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare.

Nëse azilkërkuesi nuk ka dokumentacion për të vërtetuar moshën dhe deklaratimet e tij nuk konsiderohen të mjaftueshme si provë, autoritetet duhet të përpiqen të jenë aktive duke kërkuar informacion në rrugë të tjera. Larmia e mjeteve që mund të përdoren është e madhe: bazë të dhënash kombëtare ose të shteteve BE+, pjesëtarë të familjes që mund të kenë dokumente shtesë ose ambasada të shteteve të tjera.

Megjithatë, siç theksohet në Komentin e përgjithshëm Nr. 6 të Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Fëmijës⁽²⁷⁾, vlerësimi i moshës duhet kryer pa përmendur statusin e fëmijës si azilkërkues apo refugjat (paragrafi 80). Në rast se nuk respektohet parimi i ruajtjes së privatësisë, siguria e pjesëtarëve të familjes së fëmijës që kanë mbetur në vendin e origjinës mund të vihet në rrezik; fëmija mund të bëhet refugjat *sur place (aty për aty)* (paragrafi 23) që do të thotë se, nëse fëmija kërkon mbrojtje ndërkombëtare, transmetimi i këtij informacioni tek autoritetet e vendit të origjinës mund të nënkuptojë që azilkërkuesi mund të përndiqet ose mund të pësojë lëndime serioze pas kthimit.

Pasojat e dëmshme të mosrespektimit të parimit të ruajtjes së privatësisë për informacionin e mbledhur brenda procedurës së mbrojtjes ndërkombëtare, përfshirë këtu edhe informacionin e mbledhur për qëllime të vlerësimit të moshës, mund të ketë pasoja të rënda jo vetëm për një fëmijë të caktuar dhe familjen e tij, por edhe për integritetin e gjithë sistemit të azilit.

Profesionistë të kualifikuar që kanë përvojë me fëmijët

Të gjithë ata që punojnë me dhe për fëmijët duhet të ndjekin një formim fillestar dhe të vazhdueshëm për të drejtat dhe nevojat e fëmijës. Brenda fushës së tyre të ekspertizës, ata duhet të tregojnë aftësitë e tyre në përdorimin e kësaj ekspertize për qëllimet specifike të vlerësimit të moshës ose duhet të jenë të trajnuar për të.

Metoda sa më pak invazive

Siç e pranon edhe Direktiva për Procedurat e Azilit (e rishikuar), vlerësimi i moshës duhet të kryhet me ekzaminime sa më pak invazive krahasuar me nivelin e kërkuar të sigurisë. Vlerësimi duhet kryer në respekt të plotë të dinjitetit të individit.

Termi **ndërhyrje** përdoret rëndom në procedurat mjekësore për t'iu referuar futjen e instrumenteve apo ose objekteve të tjera në trup ose në zgavrat e trupit. Këtu përfshihet edhe prerja e indeve. Ky term mund të


⁽²⁷⁾ Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Fëmijës, Komenti i Përgjithshëm Nr. 6 (2005) për trajtimin e fëmijëve të pashoqëruar dhe të ndarë nga familja jashtë vendit të tyre të origjinës

përdoret si sinonim i termit “invaziv” dhe në këtë kontekst të dy termat mund të shihen si të këmblyeshëm midis tyre. Meqenëse pasojat negative të metodave të vlerësimit të moshës nuk nënkuptojnë gjithmonë pasoja fizike, por ndërhyrjen në privatësinë e individit, termi i preferuar është **invaziv** për shkak të **spektrit** të tij më të gjerë.

Shkalla e karakterit invaziv mund të vlerësohet në funksion të pasojave të metodës në privatësinë e personit (p.sh. intervista e thelluar) të cilat janë të ndryshme nga pasojat në shëndetin fizik të personit (p.sh. jonizimi) ose nga pasojat në shëndetin psikologjik (p.sh. ripërjetimi i ngjarjeve traumatike). Këto aspekte individuale e bëjnë shumë të vështirë arritjen e një konsensusi se cilat metoda janë më shumë invazive se të tjerat dhe për rrjedhojë edhe vlerësimin në mënyrë objektive për këtë kriter. Për këtë arsye, karakteri invaziv mund të vlerësohet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të secilit azilkërkues. Për shembull, për disa azilkërkues me një të shkuar traumatike, një radiografi e kyçit të dorës mund të mos perceptohet si invazive nga ana psikologjike, ndërsa një intervistë me elemente të forta psikologjike, gjatë së cilët duhen rikujtuar ngjarje të shkuara, mund t’u shkaktojë ankth. Në raste të tjera, përdorimi i një aparature të caktuar imazherie për rezonancën magnetike (MRI) mund të shkaktojë klaustrofobi dhe për rrjedhojë është i papërshtatshëm për disa azilkërkues.

Për këtë arsye, përzgjedhja e metodës më pak invazive dhe e procesit të vlerësimit të moshës që t’i përgjigjet nevojave individuale të azilkërkuesve mbetet një sfidë për azilkërkuesit. Megjithatë, Neni 25, paragrafi 5, i DPA-së (i rishikuar) parashtron udhëzime të vlefshme për këtë pikë specifike.

“Shtetet Anëtare mund të përdorin ekzaminimet mjekësore për të përcaktuar moshën e të miturve të pashoqëruar [...], aty ku, sipas pohimeve të përgjithshme ose të dhënave të tjera, Shtetet Anëtare kanë dyshime për moshën e azilkërkuesit.” (Neni 25, paragrafi 5, i DPA-së, i rishikuar)



Si rezultat, autoritetet duhet fillimisht të shqyrtojnë provat ekzistuese, duke përfshirë pohimet dhe të dhënat me rëndësi, para se të vendosin nëse duhet kryer vlerësim i mëtejshëm.


Prandaj, autoritetet janë të detyruara të kenë një qasje aktive për të **mbledhur dhe analizuar të gjitha provat ekzistuese** që kanë në dispozicion. Këtu përfshihen jo vetëm dokumentet e personit, por edhe informacionet nga pjesëtarë të tjerë të familjes të cilët mund të kenë informacione dhe dëshmi për moshën e personit (p.sh. një vëlla apo motër më i madh në moshë që ka dokumentacion për moshën e vet), informacionet nga baza të tjera të dhënash etj. Ky informacion duhet të mblidhet me kusht që azilkërkuesi ose familja e tij/saj të mos vihen në rrezik. Gjatë mbledhjes së këtij lloji informacioni, autoritetet nuk kryejnë

vlerësim të moshës; përkundrazi, këto veprime konsiderohen si analizë e rregullt e provave nga autoritetet e azilit ose emigracionit, si pjesë e punës së tyre.

Kur dokumentacioni ose provat e disponueshme nuk japin informacion të drejtpërdrejtë për moshën, kërkohet një analizë ose hetim më i thellë dhe pas tyre nevojitet **një analizë e mëtejshme e provave**. Ky ushtrim duhet të konsiderohet si metodë vlerësimi e moshës që dallon nga mbledhja e zakonshme e informacionit, të cilit i jemi referuar në paragrafin e mësipërm. Kjo metodë, bashkë me të tjerat, do të shqyrtohet me më shumë detaje në Kreun 4 ku analizohen avantazhet dhe kufizimet e çdo metode individuale.

Disa nga metodat mjekësore të përdorura për qëllimet e vlerësimit të moshës përfshijnë përdorimin e rrezatimit, si p.sh. radiografi të kockës karpale, klavikulës, kockave të legenit ose radiografitë dentare. Përdorimi i këtyre metodave mbart rrezikun e pasojave të dëmshme potenciale që rrezatimi mund të ketë në shëndetin e azilkërkuesit. Për këtë arsye, në fillim duhen përdorur metodat më pak invazive (jo mjekësore) dhe, nëse lind nevoja për të përdorur metodat mjekësore, u duhet dhënë përparësi metodave pa rrezatim. Në ilustrimin e mëposhtëm paraqitet radha e përparësisë së metodave që duhen përdorur.

Përparësia e metodave të vlerësimit



Përdorimi i metodave me rrezatim duhet konsideruar i nevojshëm vetëm si zgjidhje e fundit. Nëse është i nevojshëm përdorimi i tyre, duhen marrë të gjitha masat dhe duhet treguar kujdesi i domosdoshëm për të parandaluar rrezikun e pasojave negative. Në praktikë, doza e ekspozimit të azilkërkuesit ndaj rrezatimit ndryshon në varësi të zonës së ekspozuar, pajisjes së përdorur dhe legjislacionit të brendshëm. Në këtë aspekt mbetet kritik zbatimi i parimit të nivelit më të ulët të mundshëm (ALARA). ALARA është parim sigurie në fushën e rrezatimit, i bazuar në uljen në minimum të dozës së rrezatimit dhe në kufizimin e çlirimit të grimcave radioaktive në mjedis duke përdorur të gjitha “metodat e arsyeshme”. ALARA nuk është vetëm një parim i shëndetshëm sigurie në fushën e rrezatimit, por është edhe kërkesë rregullatore për të gjitha programet e mbrojtjes nga rrezatimi. Koha, distanca dhe mbrojtja janë tre faktorët madhorë që përdoren për të mbajtur dozat e rrezatimit në nivelin më të ulët të mundshëm:

1. Koha: ulja e kohëzgjatjes së ekspozimit ndaj rrezeve çon në uljen e dozës së rrezatimit.
2. Distanca: rritja e distancës midis të ekzaminuarit dhe burimit të rrezatimit ul nivelin e ekspozimit në vlerën e distancës në fuqi katrore. Dyfishimi i distancës midis trupit dhe burimit të rrezatimit e ul katërfish ekspozimin ndaj rrezatimit.

3. Mbrojtja: ekzistojnë lloje të ndryshme mjeteve mbrojtëse për të ulur ekspozimin ndaj rrezatimit si: përparëse plumbit, panele mbrojtëse lëvizëse me plumb, syze dhe barriera me plumb. Kur punohet në hapësira me rrezatim të lartë është me rëndësi të përdoren mjetet mbrojtëse, sa herë të jetë e mundur.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm që duhet të merret në konsideratë rreth çështjes së karakterit invaziv, lidhet jo vetëm me metodën e zgjedhur, por edhe me mënyrën si kryhen ekzaminimet.

- Ekzaminimet nuk duhet të jenë kurrë me detyrim apo në mospërputhje me kulturën e azilkërkuesit; profesionistët duhet të jenë të kualifikuar dhe të trajnuar për problematikat e lidhura me dallimet gjinore dhe kulturore.
- Udhëzimet e brendshme për mënyrën e kryerjes së ekzaminimit duhet të marrin në konsideratë masat e nevojshme për të garantuar që, nëse është e nevojshme, ekzaminuesi dhe përkthyesi të jenë në gjininë e preferuar nga azilkërkuesi ose të ulet numri i ekzaminuesve të pranishëm në dy persona, në mënyrë që azilkërkuesi të mos ndihet i frikësuar.
- Mjediset ku kryhet metoda ose praktika duhet të kenë kushtet e përshtatshme për të siguruar në maksimum privatësinë për sa i përket parimit të fshehtësisë dhe të drejtave të fëmijës, të cilat përfshijnë të drejtën për mbrojtje.
- Ekzaminimet që kërkojnë zhveshjen lakuriq, vëzhgimin ose matjen antropometrike të organeve gjenitale apo pjesëve intime duhet të përjashtohen sepse janë tepër invazive, veçanërisht për personat me sfond të ndryshëm kulturor dhe për personat që kanë pësuar episode abuzimi.



Për këtë arsye, asnjë metodë që kërkojnë vëzhgimin ose ekzaminimin e organeve gjenitale, të tilla si vëzhgimi i pjekurisë seksuale, nuk do të përdoret për qëllime të vlerësimit të moshës.

Shembuj nga praktika

Francë — Sipas ligjit të datës 14 mars 2016 për mbrojtjen e fëmijës, përdorimi i rrezeve X tani është i kufizuar dhe vëzhgimi i pjekurisë seksuale është shprehimisht i ndaluar për vlerësimin e moshës së personave që deklarojnë se janë nën 18 vjeç.

Mbretëria e Bashkuar — Nëpunësve të imigracionit në kufi u lejohej të bëjnë një vlerësim fillestar kur hasin një të ri të pashoqëruar për herë të parë. Ky vlerësim bazohet te deklaratimet e individit, dokumentet që disponon dhe vlerësimet e vetë nëpunësit të emigracionit për pamjen fizike dhe sjelljen e të riut. Ky vlerësim nuk është ligjërish i detyrueshëm sepse mund të vihet në diskutim ose të kundërshtohet nga i interesuari. Përveç kësaj, nëpunësit e emigracionit mund të kërkojnë sqarime shtesë për sa i takon opinionin të krijuar për moshën e individit. Në të dyja këto situata, nëse individit kundërshton ose nëpunësi i emigracionit dyshon se individit është nën 18 vjeç, zbatohet parimi i prezumimit të pafajësisë dhe individit trajtohet si i mitur. Kjo do të thotë se ai do të transferohet te departamenti i shërbimeve për fëmijë të autoritetit vendor, të cilit më pas do t'i kërkohej të kryejë vlerësimin e moshës. Mjetet me të cilat autoriteti kryen vlerësimin nuk parashikohen me ligj, por nga praktika është përcaktuar që vlerësimin ta kryejnë dy punonjës socialë dhe mosha të përcaktohet në bazë të këtij vlerësimi. Për të dalë në një përfundim, këta punonjës përdorin trajnimet dhe përvojën e punës me të rinjtë.

Qipro — Procedura mbështetet në një qasje globale dhe përmban ekzaminime mjekësore dhe jo mjekësore.

Ekzaminimet jo mjekësore:

1. dokumentet e paraqitura nga azilkërkuesi;
2. shënimet nga zyra e shërbimeve sociale të rrethit;
3. intervistat për vlerësimin e moshës të kryera nga shërbimet e azilit.

Në rast se shërbimet e azilit, pasi të kenë shteruar ekzaminimet jo mjekësore (1-3), përsëri vazhdojnë të vënë në pikëpyetje moshën e azilkërkuesit, ata mund të përdorin ekzaminimet mjekësore për të përcaktuar moshën e këtij të fundit sipas Nenit 10, paragrafi 1, germa G të ligjit kombëtar për refugjatët.

Të gjitha ekzaminimet mjekësore kryhen në prani të një përkthyesi dhe të kujdestarit të të miturit.

Saktësia dhe marzhi i gabimit

Termi “saktësi” përkufizohet si “**cilësia ose vetia e të qenët i përpiktë ose i saktë**”. Kjo është një çështje thelbësore në procesin e vlerësimit të moshës. Ende nuk ekziston një metodë vlerësimi që të japë rezultate të sakta për moshën kronologjike të njeriut. Metodatat aktuale munden vetëm të japin një përlllogaritje të moshës, prandaj kundrejt shprehjes “përcaktim i moshës” preferohen shprehjet “vlerësim i moshës” ose “përlllogaritje e moshës”. Duke qenë se të gjitha metodatat kanë një marzh gabimi, ky aspekt duhet të dokumentohet gjithmonë, sidomos kur rezultatet nuk dalin në një përfundim. Meqenëse jo të gjitha metodatat mund të vlerësojnë të gjitha grupmoshat, përzgjedhja e metodës duhet të varet nga grupmosha në fjalë (disa metoda janë më të sakta në disa grupmosha se të tjerat). Gjinia e azilkërkuesit që i nënshtrohet vlerësimit është një tjetër faktor që duhet marrë në konsideratë pasi metoda mund të ketë një mundësi të ndryshme gabimi, në varësi të gjinisë së personit që ekzaminohet ⁽²⁸⁾.

Sipas udhëzimeve të propozuara nga Ritz-Timme et al. ⁽²⁹⁾, që një metodë vlerësimi të konsiderohet e pranueshme, ajo duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

1. metoda duhet të jetë transparente, e verifikueshme dhe parimisht i paraqitet komunitetit shkencor përmes botimit në një revistë ku t’i jetë bërë kritika nga ekspertët e fushës;
2. duhet të vihen në dispozicion informacione të qarta për saktësinë e metodës së vlerësimit të moshës;
3. metoda duhet të jetë mjaftueshëm e saktë sa t’i japë përgjigje pyetjeve me nënkuptim dhe të përmbushë kërkesat specifike të rastit specifik;
4. në rastin e vlerësimit të moshës së individëve të gjallë, duhet të zbatohen parimet e etikës mjekësore dhe rregulloret ligjore, sidomos kur bëhet fjalë për ndërhyrje mjekësore.

Sipas Schmeling et al. 2011 ⁽³⁰⁾, që të konsiderohet **i saktë**, çdo material referencë duhet të përmbushë disa kërkesa (Solari, A. C. dhe Ambramovitch, K., “The accuracy and precision of third molar development as an indicator of chronological age in Hispanics”, *Journal of Forensic Sciences*, (2002), Vëll. 47, Nr. 3, fq. 531-535):

- madhësi e përshtatshme e kampionit,
- moshë e verifikuar e personave të testuar,
- shpërndarje të njëtrajtshme të moshave,
- ndarje sipas gjinisë,
- detaje të datës së ekzaminimit,
- përcaktim të qartë të karakteristikave të studiuara,
- përshkrim të saktë të metodologjisë,
- detaje për origjinën gjenetike/gjeografike të popullsisë së marrë si referencë,
- gjendja socio-ekonomike,
- gjendja shëndetësore,
- detaje të madhësisë së grupit, vlera mesatare ose e mesme dhe shkalla e ndryshueshmërisë për çdo karakteristikë të studiuar.

⁽²⁸⁾ Tscholl, P.M, Junge, A., Dvorak, J. dhe Zubler, V., “MRI of the wrist is not recommended for age determination in female football players of U-16/U-17 competitions”, *Scand J Med Sci Sports*, 2015, doi:10.1111/sms.12461.

⁽²⁹⁾ Ritz-Timme, S., Cattaneo, C., Collins, M.J. et al., “Age estimation: the state of the art in relation to the specific demands of forensic practice”, *Int J Legal Med*, 2000, 113(3), fq. 129-136.

⁽³⁰⁾ Schmeling, A., Garamendi, P. M., Prieto, J. L. dhe Landa, M. I., “Forensic age estimation in unaccompanied minors and young living adults”, *Forensic medicine — From old problems to new challenges*, Vieira, D. N. (ed.), InTech, (2001), në adresën <https://www.intechopen.com/books/forensic-medicine-from-old-problems-to-new-challenges/forensic-age-estimation-in-unaccompanied-minors-and-young-living-adults>

Marzhi i gabimit të vlerësimit duhet të dokumentohet dhe të përfshihet në raport në mënyrë që të kuptohet lehtë nga lexuesi. Kjo bëhet që profesionistë të tjerë që nuk kanë ekspertizë mjekësore, si: oficerët e policisë, gjyqtarët, prokurorët, kujdestarët/përfaqësuesit ose nëpunësit e azilit apo të emigracionit, të mund të interpretojnë saktë dhe të kuptojnë rezultatet e vlerësimit.

Gjermani — Nëse pas ekzaminimit të parë nuk është arritur në një përfundim, duhet zbatuar prezumimi i pafajësisë dhe duhen zbatuar metoda të tjera vlerësimi si pjesë të procesit. Në këtë mënyrë, vendimi do të bazohet në një gamë më të gjerë provash dhe do të ishte më i besueshëm. Shtetet federale (*Länder*) janë përgjegjëse për përcaktimin e moshës së fëmijëve të pashoqëruar. Ky përcaktim kryhet në momentin e marrjes së tyre në ngarkim (*Inobhutnahme*), sapo ata vihen në kontakt me autoritetet gjermane. Vendimi i marrë prej tyre shërben edhe si bazë për procedurën e azilit.

Në parathënien e ligjit që ndryshon Kodin e Sigurimeve Shoqërore të vitit 2015, përmenden rekomandimet e Grupit të Punës të Shërbimeve Federale për Mbrojtjen e Rinisë (*Bundesarbeitsgemeinschaft landesjugendämter*: http://www.bagljae.de/downloads/118_handlungsempfehlungen-umf_2014.pdf).

Kështu, Seksioni 42 i Kodit të sigurimeve Shoqërore përbën themelin e procesit të përcaktimit të moshës, i cili zhvillohet me etapa. Grupi i Punës së Shërbimeve Federale për Mbrojtjen e Rinisë rekomandon që, për procesin e përcaktimit të moshës, të merren parasysh rekomandimet e grupit të studimit për diagnostikimin mjekoligjor të moshës (*Arbeitsgemeinschaft für Forensische Altersdiagnostik*, AGFAD; http://campus.uni-muenster.de/fileadmin/einrichtung/agfad/empfehlungen/empfehlungen_ausserhalb_strafverfahren.pdf).

Norvegji — Departamenti mjekoligjor i spitalit universitar të Oslos ka zhvilluar një metodë të re për leximin e shkallës së zhvillimit, nisur nga radiografitë e duarve dhe të dhëmballëve të pjekurisë. Bëhet fjalë për një model statistikor, i cili kombinon të dhënat e dy metodave radiologjike: metoda e Demirjian-it e bazuar në zhvillimin e dhëmballës së pjekurisë dhe atlasit i Greulich-it dhe Pyle-s për dorën dhe kyçin e dorës. Në total përmasa e mostrës tejkalon numrin e 14 000 individëve (të të dyja gjinive). Modeli statistikor bazohet në përshtatjen e një modeli tranzicioni me disa seri të dhënash të kombinuara për të dyja gjinitë. Teorema e Bayes-it përdoret për të përfutur shpërndarjet e moshave kronologjike në funksion të shkallës së zhvillimit. Rezultatet paraqiten si intervale parashikimi me 95% dhe 75% dhe si përqindje subjektsh nën moshën 18 vjeç dhe nën moshën 16 vjeç. Për shkak të ndryshueshmërisë së lartë biologjike, e cila shkon përtej përmbajtjes së materialeve referencë, rezultatet nuk mund të jenë plotësisht përfundimtare. Megjithatë, në vlerësimin e përgjithshëm, rezultateve të qarta u jepet një peshë relativisht të madhe. Spitali universitar i Oslos ka botuar së fundmi një manual të plotë për këtë metodë vlerësimi të moshës, e titulluar “BioAlder”.

Zbulimet kryesore nga praktika e shteteve BE+


Aty ku rezultatet e procesit të vlerësimit të moshës nuk janë përfundimtare, 16 shtete BE+ zbatojnë prezumimin e pafajësisë, ndërsa 6 shtete BE + nuk e zbatojnë atë dhe marrin në konsideratë vetëm provat ose informacionin që kanë në dispozicion.

Informacione të tjera mund të gjenden në Shtojcën 4 të këtij botimi.

Kombinimi i karakterit invaziv dhe i saktësisë

Metodat duhet të zgjidhen pasi të merret parasysh karakteri i tyre invaziv dhe saktësia. Metodat që janë më pak invazive dhe më të sakta duhet të zgjidhen të parat, ndërsa metodat që janë më pak invazive, por edhe më të pasakta duhet të zgjidhen të fundit. Vlerësimi duhet të ndërpritet në momentin kur metoda bëhet tepër invazive, pavarësisht se sa e saktë mund të jetë. Edhe pse të zhveshurit lakuriq ose të treguarit të organeve gjenitale mund të jetë stresues për të gjithë njerëzit, ato bëhen edhe më traumatike për fëmijët që kanë pësuar abuzime si pjesë e përndjekjes në vendin e tyre të origjinës ose gjatë migrimit të tyre. Niveli i lartë i karakterit invaziv dhe rreziku i lartë për të shkaktuar traumë si pasojë e përdorimit të këtyre metodave i bën ato të papranueshme për qëllimet e vlerësimit të moshës.

Karakteri invaziv dhe saktësia



E drejta për zgjidhje të efektshme ligjore

Në rast se vendimi është negativ (nuk përputhet me moshën e deklaruar), autoritetet duhet të shpjegojnë arsyet për këtë vendim dhe të njoftojnë azilkërkuesin për mënyrën si mund të ankimohet. Meqenëse moshë e azilkërkuesit mund të ndikojë te zhvillimi i procedurës së mbrojtjes ndërkombëtare (përparësitë, garancitë etj.), vendimi për vlerësimin e moshës duhet të nxirret veçmas dhe para vendimit për mbrojtjen ndërkombëtare. Në rast se nuk ekziston një e drejtë e veçantë për të ankimuar rezultatin e vlerësimit të moshës në vetvete, duhet të ekzistojë mundësia për të kundërshtuar këtë rezultat në rrugë gjyqësore ose për të ankimuar rezultatin në kuadrin e shqyrtimit të aplikimit për mbrojtje ndërkombëtare. Individit duhet të ketë mundësinë të përfaqësohet ose të ketë këshilltar ligjor në këtë procedurë. Kur shpallet ky vendim, informacioni për mënyrat e kundërshtimit të vendimit duhet të jetë pa pagesë dhe në pajtim me nivelin e të kuptuarit të azilkërkuesit. Azilkërkuesi duhet t'i jepet mundësia për t'u dëgjuar.

Zbulimet kryesore nga praktika e shteteve BE+

Sa i takon zgjidhjeve ligjore që azilkërkuesi ka në dispozicion për të kundërshtuar vendimin për vlerësimin e moshës:

- 8 shtete BE+ ofrojnë mundësinë për të kundërshtuar veçmas vendimin për vlerësimin e moshës;
- 9 shtete BE+ ofrojnë mundësinë për të kundërshtuar vendimin për vlerësimin e moshës si pjesë e vendimit për mbrojtjen ndërkombëtare ose në të njëjtën kohë;
- 2 shtete BE+ nuk i ofrojnë azilkërkuesit zgjidhje ligjore për të kundërshtuar vendimin për vlerësimin e moshës.

Informacione të tjera mund të gjenden në Shtojcën 4 të këtij botimi.

Kreu 3 Procesi i vlerësimit të moshës: zbatimi i një qasjeje shumëdisiplinore dhe globale

Zbatimi i një qasjeje shumëdisiplinore dhe globale në procesin e vlerësimit të moshës

Qasja globale merr në konsideratë sistemin si një i tërë, jo thjesht pjesët përbërëse. Ndryshe nga një vlerësim i thjeshtë i moshës, i cili ka për objektiv kryesor vlerësimin e moshës kronologjike, procesi i vlerësimit të moshës që mbështetet në qasjen globale nuk përqendrohet thjesht te mosha, por merr në konsideratë një spektër më të gjerë faktorësh. Në këtë qasje, në vlerësimin e moshës kronologjike merren në konsideratë edhe nevojat e fëmijëve dhe të rinjve në kontekstin e emigracionit. Për këtë arsye, vlerësimi global i moshës le hapësirë për elasticitet dhe për të individualizuar procesin e vlerësimit të moshës, duke e mbështetur procesin e vlerësimit në rrethanat specifike dhe në nevojat e azilkërkuetit (për shembull nëse duhet bërë ose jo vlerësimi i moshës, duke ndikuar te metoda e vlerësimit, ekzaminuesit etj.).

Si rezultat, vlerësimi i moshës i kryer sipas qasjes globale përforcon vënien në zbatim të parimit të interesave më të larta të fëmijës gjatë procesit. Respektimi sistematik dhe i vazhdueshëm i interesave më të larta të fëmijës duhet të pasqyrohet në të gjitha veprimet që lidhen me fëmijët. Prandaj, proceset e vlerësimit të moshës duhet së pari të marrin parasysh mënyrën e zbatimit të këtij parimi për të identifikuar fëmijën në mënyrë të saktë dhe të shpejtë (sidomos në rastet e fëmijëve të pashoqëruar). Për të pasur një pamje të plotë të nevojave të fëmijës, duhet të miratohen disa masa, për shembull:

- personat në kontakt me fëmijët (mësuesit, personeli që kujdeset për ta, kujdestarët/përfaqësuesit, profesionistët e shëndetësisë, autoritetet pritëse, autoritetet e azilit dhe imigracionit dhe forcat e rendit) duhet të përpiqen të mbledhin sa më shpejt të gjithë informacionin e nevojshëm për të identifikuar aspektet e rëndësishme ose shqetësuese (si historiku i abuzimeve ose përvojave traumatike). Gjatë procesit fëmijët duhet të dëgjohen jo vetëm për çështjet e lidhura me moshën, por edhe për nevojat dhe shqetësimet që kanë.
- ky informacion duhet t'u transmetohet pjesëmarrësve në proces (kujdestarëve/përfaqësuesve, profesionistëve të shëndetësisë, autoriteteve pritëse, autoriteteve të azilit dhe imigracionit dhe forcave të rendit) gjatë gjithë procesit, sa herë të jetë e mundur dhe duke respektuar rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale, për të ulur në minimum numrin e intervistave dhe shmangur pyetjet e përsëritura;
- përveç kësaj, bazuar në ekspertizën dhe përvojën e tyre, këta profesionistë duhet të kenë mundësinë të shprehin mendimet dhe të shkëmbejnë pikëpamjet, nëse është nevoja;
- procesi i ngritur duhet të përpunohet në konsultim me të gjitha palët e interesuara; në këtë pikë, qasja globale lidhet me qasjen shumëdisiplinore në vijim.

Qasja shumëdisiplinore bashkon ose përfshin njëherësh disa disiplina akademike ose specializime profesionale për të trajtuar një temë ose një problematikë.

Qasja shumëdisiplinore për qëllimet e vlerësimit të moshës nënkupton studimin e aspekteve ose faktorëve të ndryshëm, si ata fizikë, psikologjikë, zhvillimorë, mjedisorë dhe kulturorë ⁽³¹⁾. Pra, procesi i vlerësimit të moshës i bazuar vetëm në metodat mjekësore nuk mund të konsiderohet shumëdisiplinor. Duke qenë se nuk ekziston ndonjë metodë që tregon me siguri moshën e personit, gjatë përdorimit të metodave të ndryshme duhen vlerësuar shumë faktorë. Kjo garanton që vendimi të mbështetet në një gamë më të gjerë provash, duke rritur kështu besueshmërinë e vlerësimit. Në këtë kuadër, vlerësimi shumëdisiplinor kërkon

⁽³¹⁾ Shih si shembull dokumentin *Statement of good practice* të programit "Fëmijët e ndarë në Evropë" (2009), në adresën <http://www.scepnetwork.org/p/1/69>

që gjatë procesit, në ekzaminime dhe në vendimmarrjen, pas nxjerrjes së rezultateve të ekzaminimeve të ndryshme, të përfshihen profesionistët e kualifikuar për vlerësimin e moshës në fushat e tyre përkatëse.

Në varësi të metodës, mund të kërkohet pjesëmarrja e punonjësve socialë, mjekëve, radiologëve, psikologëve për fëmijë, pediatërve ose nëpunësve të kualifikuar, të pajisur me ekspertizë në fushën e zhvillimit të fëmijëve dhe vlerësimit të moshës. Për të bashkërenduar kontributin e ekspertëve të ndryshëm, gjatë zbatimit praktik të qasjes shumëdisiplinore duhet vënë në punë një mekanizëm bashkërendimi.

Ashtu si për të gjitha çështjet që lidhen me shqyrtimin e aplikimit për mbrojtje ndërkombëtare dhe në pajtim me Nenin 4 të DK-së (të rishikuar), duhen marrë në konsideratë të gjitha provat ekzistuese. Përzgjedhja e profesionistëve që duhet të marrin pjesë në vlerësim duhet kryer me qëllimin që saktësia e përgjithshme e vlerësimit të rritet sa më shumë, duke kufizuar në maksimum efektet invazive të procedurës te azilkërkuesi.

Kur bëhet fjalë për përzgjedhjen e metodës së vlerësimit të moshës, interesat më të larta të fëmijës duhet të konsiderohen me përparësi. DPA-ja specifikon se “Shtetet Anëtare mund të përdorin ekzaminimet mjekësore për të përcaktuar moshën e të miturve të pashoqëruar brenda kornizës së shqyrtimit të aplikimit për mbrojtje ndërkombëtare në rastet kur, bazuar në deklaratimet e përgjithshme ose në elemente të tjerë të lidhur me to, Shtetet Anëtare kanë dyshime për moshën e azilkërkuesit”. Meqenëse zhvillimi psikologjik dhe pjekuria e azilkërkuesit janë aspekte thelbësore që duhen studiuar gjatë procesit, vlerësimi psikosocial duhet përzgjedhur para metodave të tjera.

Nëse pas vlerësimit shumëdisiplinor një Shtet Anëtar ka ende dyshime për moshën e azilkërkuesit, atëherë azilkërkuesi do të konsiderohet i mitur.


Sipas IOM-it ⁽³²⁾, ekzistojnë tre metoda kryesore për vlerësimin e moshës:

- metoda e parë, e cila përshkruhet si **jo mjekësore**, mbështetet te vlerësimi i dokumentacionit ekzistues, te vlerësimi pamor i pamjes fizike dhe te intervistat që japin informacione për jetën dhe rrethanat e jetës së individit;
- e dyta është kryesisht **mjekësore** dhe mbështetet në ekzaminimin fizik dhe në radiografitë e kockave dhe/ose dhëmbëve;
- e treta përpiqet të integrojë të dhënat e metodave mjekësore me ato të metodave jo mjekësore duke pranuar se **bashkëpunimi shumëdisiplinor** është parakusht për të siguruar rezultate të mira për fëmijët dhe të rinjtë e pambrojtur.

⁽³²⁾ Grupi i Punës së EASO-s për Vlerësimin e Moshës, shtator 2016.

Skema e procesit të vlerësimit të moshës

Procesi, siç është përshkruar në seksionin e mësipërm, bashkë me etapat dhe garancitë e nevojshme për të siguruar një vlerësim efektiv dhe të sigurt të moshës, ilustron në skemën e mëposhtme.



Udhëzime për procesin e vlerësimit të moshës

Çmuarja nëse vlerësimi i moshës është i nevojshëm apo jo

Duhet të ekzistojnë disa parakushte dhe garanci para se të merret vendimi për procesin apo para kryerjes së vlerësimit të moshës.

- Azilkërkuesi ka bërë aplikimin për **mbrojtje ndërkombëtare** dhe janë regjistruar të dhënat personale si identiteti, moshë dhe lidhjet familjare.
- Moshë e deklaruar nga azilkërkuesi (si i rritur apo si i mitur) nuk **vërtetohet** nga dokumentet ose nuk janë paraqitur prova të tjera për të vërtetuar moshën e deklaruar.
- Moshë që azilkërkuesi ka deklaruar është **vënë në dyshim**.
- Si masë provizore, azilkërkuesit i **regjistrohen gjurmët e gishtave** në bazën e të dhënave të gjurmëve të gishtave të azilkërkuesve në BE (Eurodac), nëse grupmosha e vënë në pikëpyetje është qartësisht më e lartë se moshë e parashikuar për këtë qëllim në legjislacionin e brendshëm dhe/ose të BE-së.⁽³³⁾
- Në zbatim të **prezumimit të pafajësisë**, azilkërkuesi duhet të konsiderohet nën 18 vjeç dhe, nëse është i pashoqëruar, i caktohet menjëherë një **kujdestar/përfaqësues**.
- **Interesat më të larta të fëmijës**, duhen mbrojtur nga ky moment e tutje, deri sa rezultatet përfundimtare do të tregojnë se azilkërkuesi është në moshë madhore.

Për shkak të moshës personi mund të konsiderohet i cenueshëm (fëmijë, moshë e tretë) ose mund të theksohet cenueshmëria që vjen nga gjinia, rrethanat familjare, orientimi seksual, identiteti gjinor, aftësitë e kufizuara, sëmundjet e rënda ose pasi ka pësuar tortura ose forma të tjera të rënda dhune. Duke pasur parasysh se kjo cenueshmëri mund të ndikojnë negativisht në aftësinë e azilkërkuesit për të paraqitur dhe mbështetur aplikimin për mbrojtje ndërkombëtare, *acquis* i BE-së në fushën e azilit parashikon garanci shtesë për siguruar procedura të drejta azili për azilkërkuesit me nevoja të veçanta. Për të garantuar që azilkërkuesit me nevoja të veçanta të paraqesin dhe përlijin aplikimin e tyre, duhet të jetë i ngritur një **mekanizëm i hershëm identifikimi** dhe, sipas rastit, vlerësimi i cenueshmërisë. Megjithatë, autoritetet duhet të jenë vigjilentë për të identifikuar me shpejtësi shenjat e cenueshmërisë që mund të shfaqen në etapat e mëvonshme të procedurës dhe të veprojnë shpejt. Ky mekanizëm duhet të jetë i disponueshëm gjatë të gjithë etapave të procedurës për të siguruar që identifikimi i mëvonshëm të jetë i mundur dhe të jepet mbështetja e duhur pa humbur kohë.

Nevojat specifike të azilkërkuesit të cenueshëm duhet të luajnë rol kyç në marrjen e vendimit për metodën që do të përdoret, për mënyrën si duhet kryer vlerësimi dhe në pikën ku duhet kuptuar nëse do të ketë pasoja negative të ky azilkërkues specifik. Një pjesë e informacioneve të mbledhura gjatë vlerësimit të nevojave të veçanta mund të përdoret gjatë vlerësimit të moshës. Nëse veprohet kështu, shmangen vonesat dhe mbivendosi e procedurave për të njëjtin person. Kur zbatohet në përputhje me qasjen globale dhe shumëdisiplinore, vlerësimi i moshës mund edhe të ndihmojë në identifikimin e nevojave të tjera dhe të cenueshmërisë, të cilat nuk u zbuluan gjatë vlerësimeve të mëparshme.

Në këtë etapë, nëse moshë e deklaruar nuk mund të verifikohet, nëpunësit duhet të përpiqen të gjejnë informacion nga burime të tjera pasi të sigurohen se kërkimet e ndërmarrja nuk do ta dëmtonin azilkërkuesin ose familjen e tij. Gjatë kësaj etape paraprake, e njohur si **analizimi i provave**, merren parasysh të gjitha provat në dispozicion të autoriteteve (dokumentet, dëshmitë e azilkërkuesit dhe pjesëtarëve të familjes për moshën dhe identitetin që ka, deklaratimet e kujdestarit, informacionet nga bazat e tjera të të dhënave dhe vlerësimet e para bazuar në pamjen fizike). Kur merren me rastet e azilkërkuesve të mitur, sidomos me fëmijë të pashoqëruar, nëpunësit duhet të sillen në mënyrë proaktive dhe me ndjeshmëri.

⁽³³⁾ Aktualisht rregullorja "Eurodac" parashikon regjistrimin e gjurmëve të gishtave të të gjithë personave mbi 14 vjeç; në propozimin për riformulimin e rregullores moshë propozohet të ulet në 6 vjeç.

Bazuar në analizën e lartpërmendur, autoritetet përgjegjëse do të mund të bëjnë dallimin midis rasteve ku moshën e deklaruar është e dyshimtë dhe rasteve ku nuk ka asnjë dyshim.

Zbatimi i **prezumimit të pafajësisë** duhet të kryhet sapo të shfaqen dyshime për moshën e deklaruar. Pra, azilkërkuesi konsiderohet fëmijë deri sa të përftohen rezultate bindëse nga ekzaminimet e tjera.

Meqenëse azilkërkuesi konsiderohet fëmijë, duhet t'i caktohet menjëherë një **kujdestar/përfaqësues** në mënyrë që të sigurohet se interesat më të larta të fëmijës respektohen në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën. Këtu përfshihet edhe çështja nëse duhet kryer ose jo vlerësimi i moshës.

Edhe pse objektivi kryesor i vlerësimit të moshës është vlerësimi i nivelit të pjekurisë së azilkërkuesit dhe duhen konsideruar të gjithë faktorët e lidhur me vlerësimin, mirëqenia e fëmijës duhet të merret gjithashtu në konsideratë. Për këtë arsye, midis analizës së parë të provave, e cila mund të kryhet menjëherë pas mbërritjes, dhe vlerësimit të plotë të moshës, është me rëndësi të sigurohet një **periudhë pushimi dhe rikuperimi**. Kështu, procesi i vlerësimit i kryer me dy faza konsiderohet mënyra më e përshtatshme për të kryer një vlerësim të efektshëm dhe të sigurt të moshës. Kjo vlen sidomos në kontekste me flukse të mëdha, në të cilat është kritike nevoja e kryerjes së një procesi efektiv identifikimi dhe regjistrimi.

Periudha e pushimit dhe rikuperimit mund të ndihmojë edhe për të ndërtuar besimin midis fëmijës dhe kujdestarit/përfaqësuesit të tij. Kjo periudhë ndihmon edhe fëmijën që të fillojë të ndihet i sigurt dhe të japë informacionet që kërkohen për të vlerësuar nevojat e tij. Gjatë kësaj periudhe duhet kryer **vlerësimi i interesave më të larta të fëmijës** ⁽³⁴⁾, për t'u siguruar që procesi i vlerësimit të moshës që mendohet të kryhet është në pajtim me rrethanat individuale të azilkërkuesit dhe që rezultatet e pritshme janë në dobi të procesit dhe nuk e dëmtojnë fëmijën.

Procesi duhet të garantojë që **pikëpamjet e fëmijës të dëgohen sistematikisht**, qoftë kur mendimi shprehet vetë nga ai apo me ndërmjetësinë e kujdestarit/përfaqësuesit të tij. Kjo e drejtë kërkon zbatim sistematik jo vetëm gjatë procedurës, por që në etapat më të hershme, madje edhe para se të merret vendimi për kryerjen e vlerësimit.

- Pikëpamjet duhet të dëgohen sa herë autoritetet kanë **dyshime** për deklaratimet ose provat e dhëna nga azilkërkuesi. Thjesht përpjekja për të shkëmbyer mendime dhe për të shpjeguar në mënyrë konstruktive arsyet e mospranimin të moshës së deklaruar ose të pamjaftueshmërisë së informacionit mund të ndihmojë azilkërkuesin të kuptojë procesin dhe të ketë vullnet për bashkëpunim.
- Në rastet kur ka **mungesë konsekuence** në moshën e azilkërkuesit, atij i duhet dhënë mundësia dhe koha të shpjegojë mungesën e konsekuencës me shkrim ose me gojë.
- Ndonjëherë azilkërkuesi mund të vërtetojë moshën e deklaruar duke paraqitur dokumente, prova apo shpjegime të besueshme shtesë. Kështu, këto **shpjegime dhe elemente shtesë** do ta bënin të panevojshëm vlerësimin e moshës.

Pas vlerësimit të të gjitha provave, pasi të jenë vërtetuar dyshimet për moshën e azilkërkuesit, pasi të jenë dëgjuar pikëpamjet e azilkërkuesit dhe të jetë plotësuar formulari i vlerësimit të interesave më të larta, mund të merret vendimi për të filluar ose jo procesin e vlerësimit të moshës.

Kryerja e vlerësimit të moshës

Në rast se **vlerësimi i moshës konsiderohet i nevojshëm dhe rekomandohet nga vlerësimi i interesave më të larta**, procesi i vlerësimit të moshës duhet të fillojë pa humbur kohë. Autoritetet duhet të sigurohen që azilkërkuesi dhe kujdestari/përfaqësuesi të jenë pajisur me **informacionin** e duhur dhe që ky informacion të shprehet me fjalë të thjeshta dhe të jetë kuptuar. Pyetjet që mund të kenë azilkërkuesi dhe/ose kujdestari/përfaqësuesi i tij duhet të marrin përgjigje dhe duhen dhënë sqarimet e nevojshme.

⁽³⁴⁾ Si shembull shih dokumentin *Position paper on age assessment in the context of separated children in Europe*, të programit "Fëmijët e ndarë në Evropë" (2012), që gjendet në adresën <http://www.scepnetwork.org/images/16/163.pdf>

Pas kësaj, azilkërkuesi dhe/ose kujdestari/përfaqësuesi i tij do të jenë më në gjendje të japin **pëlqimin e informuar** për procesin. Në rastet kur azilkërkuesi nuk mund të japë pëlqimin për shkak të një pengese të justifikuar, mjafton pëlqimi i informuar i kujdestarit/përfaqësuesit të tij. Në rast se ka rezerva për procesin, ato duhet të sqarohen, cilado qoftë etapa e procesit. **Refuzimi për t'iu nënshtruar** vlerësimit nuk duhet t'i çojë automatikisht autoritetet drejt përfundimit se azilkërkuesi është madhor. Në këto raste, azilkërkuesi duhet të **dëgjohet** përsëri dhe duhen sqaruar plotësisht arsyet për këtë refuzim. Ngurrimi mund të fashitet duke i dhënë azilkërkuesit dhe/ose kujdestarit/përfaqësuesit më shumë informacion ose duke e përshtatur procesin me nevojat e fëmijës, për shembull duke përzgjedhur një metodë alternative.

Sidoqoftë, refuzimi për t'iu nënshtruar vlerësimit nuk mund të jetë arsyeja e vetme për të rrëzuar aplikimin (Neni 25, paragrafi 5, i DPA-së).

Pasi të merret **pëlqimi i informuar**, duhet të bëhet i mundur procesi bashkë me garancitë e nevojshme dhe, sipas rastit, duhet përshtatur me nevojat ose rrethanat e veçanta të fëmijës, në pajtim me praktikën kombëtare dhe me *acquis* ligjor të BE-së.

Përzgjedhja e metodave duhet të jetë sa më e individualizuar dhe i duhet dhënë përparësi metodës që është më pak invazive dhe më e saktë. Kur duhet të vendoset se cila metodë është ajo **më pak invazive**, duhen marrë në konsideratë jo vetëm pasojat fizike, por edhe pasojat psikologjike të azilkërkuesit (shih Nenin 25, paragrafi 5, nënparagrafi i dytë, të DPA-së). Duhen marrë në konsideratë edhe faktorët mjedisorë dhe kulturorë.

Ekzaminimet duhet të kryhen në mënyrë graduale, duke i dhënë përparësi metodave jo mjekësore. Nëse këto nuk prodhojnë rezultate bindëse, mund të përdoren metodat mjekësore që nuk kërkojnë përdorimin e rrezatimit. Përdorimi i metodave mjekësore me rrezatim duhet të jenë zgjedhja e fundit fare dhe, siç u pa më lart, duhen zgjedhur ato metoda që kërkojnë përdorimin e dozave më të ulëta të rrezatimit. Rezultatet e testeve për pjekurinë psikologjike duhet të kenë të njëjtën peshë me rezultatet e testeve për zhvillimin fizik. Kështu, pas marrjes së rezultateve përfundimtare nga një metodë, nuk ka më nevojë të kryhen ekzaminime shtesë të panevojshme.

Ekzaminimet nuk duhet të bëhen kurrë me detyrim apo në mospërputhje me kulturën e azilkërkuesit. Profesionistët duhet të jenë **të kualifikuar**, të trajnuar për çështjet gjinore dhe dallimet kulturore si dhe të njohin protokollet dhe/ose udhëzimet e nxjerra për këto çështje⁽³⁵⁾. Ekzaminimet që kërkojnë zhveshjen lakuriq, vëzhgimin dhe/ose matjen e organeve gjinitale apo të pjesëve intime duhet të përjashtohen sepse janë tepër invazive.

Në rast se një prej metodave të përdorura gjatë vlerësimit të moshës nxjerr rezultatin se personi është nën 18 vjeç, vlerësimi duhet të ndalojë. Në këto raste, nëse mosha e deklaruar është brenda grupmoshës së nxjerrë nga metoda, ajo duhet pranuar; nëse nuk është, duhet konsideruar si e vlefshme **mosha më e ulët e grupmoshës**.

- Kur kërkohet kryerja e disa ekzaminimeve për shkak të një serie rezultatesh jo bindëse, rezultatet përfundimtare duhen analizuar nga një **panel ekspertësh**. Këta ekspertë kanë fusha të ndryshme specializimi dhe njohuri ose përvojë të përbashkët në punën me fëmijët. Paneli i ekspertëve duhet të përbëhet nga punonjës socialë, ekspertë mjekoligjorë, specialistë të mbrojtjes së fëmijëve dhe nëpunës të specializuar në trajtimin e dosjeve të fëmijëve.
- Kur kjo nuk është e mundur ose në rastet kur përdoret vetëm një metodë, vlerësimi duhet kryer nga të paktën **dy ekspertë**. Duhet të garantohet që të dy ekspertët e kualifikuar kanë shprehur pikëpamjet e tyre dhe të dy kanë rënë dakord për vendimin. Në rast se të dy ekspertët nuk arrijnë të bien dakord për një vendim përfundimtar, rekomandohet që rasti t'i transferohet një eprori me përvojë dhe të kualifikuar, i cili merr vendimin.

Në rast se nuk arrihet në një marrëveshje, vlerësimi i moshës mund të konsiderohet jo përfundimtar dhe të zbatohet prezumimi i pafajësisë. Në këto raste azilkërkuesi duhet konsideruar fëmijë.

⁽³⁵⁾ Si shembull shih dokumentin *Position paper on age assessment in the context of separated children in Europe*, të programit “Fëmijët e ndarë në Evropë” (2012), në adresën: <http://www.scepnetwork.org/images/16/163.pdf> or <http://www.scepnetwork.org/p/1/76/position-papers>

Vendimi duhet të jetë i arsyetuar, të jepet me shkrim dhe të shpjegohet verbalisht. Në vendim duhet të përmenden kualifikimet profesionale, përvoja dhe trajnimet e ekspertëve si dhe marzhi i gabimit të metodës së përdorur. Azilkërkuesi duhet të njoftohet për rrugët e ankimit të vendimit dhe, sipas rastit, t'i jepet ndihmë juridike për ta ankimuar.

Meqenëse pasojat e identifikimit si i rritur ose si fëmijë janë të konsiderueshme, azilkërkuesit i duhet dhënë mundësia për **të kundërshtuar rezultatin** menjëherë dhe pa pengesa. Rrugët nëpër të cilat azilkërkuesi mund të kundërshtojë rezultatin e vlerësimit janë ankimi ose shqyrtimi gjyqësor.

Për më tepër, procesi duhet të marrë në konsideratë mundësinë që mund të dalin informacione të reja pas përfundimit të vlerësimit; për këtë arsye duhet të ekzistojë mundësia për një **rishikim** të mëvonshëm të moshës së vlerësuar.


Në rastet kur mosha është vlerësuar në mënyrë të pasaktë, duhet të ndërmerren veprime të menjëhershme që informacioni të korrigojë në mënyrë të shpejtë dhe të efektshme që ndryshimet të pasqyrohen edhe në bazat e të dhënave të nevojshme.

Kreu 4 Pamja e përgjithshme e metodave të vlerësimit

Metodat që përdoren aktualisht ndahen në metoda mjekësore dhe jo mjekësore, në varësi të nevojës ose jo për ndërhyrjen e një mjeku. Te metodat mjekësore bëhet dallimi midis metodave pa përdorimin e rrezatimit dhe metodave me përdorimin e rrezatimit.

Ky klasifikim dhe përdorimi gradual i metodave për të parandaluar ekzaminimet e panevojshme janë pasqyruar në ilustrimin e mëposhtëm. Këtu nuk përmenden garancitë dhe të drejtat gjatë procesit sepse ato janë analizuar në dy krerët e mëparshëm dhe në ilustrimin e skemës së procesit të vlerësimit të moshës.

Skema e metodave



Orientime për zbatimin gradual të metodave

Sapo azilkërkuesi shpreh dëshirën të aplikojë për mbrojtje ndërkombëtare, atij i linden disa të drejta (e drejta për të qëndruar brenda territorit, për të përfituar kushtet materiale bazë të pritjes dhe për t'iu vlerësuar ose identifikuar nevojat e veçanta). Në rastet kur mund të kemi të bëjmë me një fëmijë, ka përparësi identifikimi i nevojave të veçanta procedurale dhe ofrimi i kushteve të veçanta të pritjes për shkak të cenueshmërisë që e karakterizon. Në pajtim me Nenin 25, paragrafi 5, të DPA-së (i rishikuar), të gjitha provat e marra mund të ndihmojnë për përcaktimin e moshës së fëmijës dhe për eliminimin ose pakësimin e nevojës për të kryer vlerësime të tjera të moshës; për këtë arsye, ato duhet të ekzaminohen para se të vendoset nëse ka apo jo nevojë për vlerësim të moshës.

Analizimi i provave të disponueshme dhe çmuarjet e para

Sipas parashikimeve të Nenit 24 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Nenit 7 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës:

“Fëmija regjistrohet menjëherë pas lindjes dhe qysh atëherë ka të drejtën për të fituar një kombësi.”

Certifikata e lindjes është dokumenti që vërteton lindjen e personit, datën dhe vendin e lindjes, gjininë dhe prindërit. Qëllimi kryesor i regjistrimit në gjendjen civile është krijimi i një dokumenti ligjor i cili mund të përdoret për të krijuar dhe mbrojtur të drejtat e individit.

Siç u përmend më parë, disa shtete nuk i regjistrojnë ngjarjet jetësore të shtetasve të tyre në mënyrë sistematike (lindjet, martesat dhe vdekjet), ndërsa disa shtete të tjera i regjistrojnë shumë rrallë ose shumë vonë. Për rrjedhojë, për autoritetet e shteteve BE+, këto regjistrime mund të mos përmbushin standardet e regjistrave publikë (parandalimi i regjistrimit dy herë i të njëjtës ngjarje, boshllëqet ose mungesa konsekuente në regjistra etj.). Për më tepër, për shkak të ngjarjeve që kanë ndodhur në vendin e tyre të origjinës ose të rrethanave të largimit të tyre (konflikte të armatosura ose përndjekje dhe/ose diskriminim nga autoritetet kombëtare etj.), këto dokumente ligjore mund të mos jenë të disponueshme për personat që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare, kështu ata nuk do të jenë në gjendje të vërtetojnë identitetin e tyre me certifikata të vlefshme ose prova të besueshme.

Duke marrë në konsideratë rrethanat e mësipërme dhe përpjekjet e azilkërkuesit për të paraqitur të gjithë informacionin që ka në dorë, si provë mbështetëse autoritetet, ndër të tjera, duhet të pranojnë këto dokumente:

- pasaportat,
- letërnjoftimet,
- lejet e qëndrimit,
- dokumentet e udhëtimit, si ato të lëshuara nga UNHCR-ja,
- certifikatat e vendeve të tjera ose certifikatat civile ose fetare të cilat provojnë gjendjen civile (certifikata e martesës, lindjes, familjare) të azilkërkuesit apo të pjesëtarëve të familjes me të dhëna për moshën e azilkërkuesit.

Përveç këtyre dokumenteve, mund të ketë baza të tjera të dhënash që mund të kenë informacion për moshën e azilkërkuesit (për shembull Sistemi i Informacionit të Schengenit ⁽³⁶⁾, Eurodac ose baza e të dhënave të Dokumenteve të Vjedhura dhe të Humbura të Udhëtimit të Interpolit ⁽³⁷⁾).

⁽³⁶⁾ SIS: Sistem informacioni në shkallë të gjerë që mbështet kontrollin e kufirit të jashtëm dhe bashkëpunimin për zbatimin e ligjit në hapësirën Shengen.

⁽³⁷⁾ SLTD: bazë të dhënash që përmban të dhëna për dokumentet e vjedhura, të humbura apo të revokuara të udhëtimit si pasaporta, letërnjoftime, leje kalimi të OKB-së apo vulat e vizave.

Po ashtu, pohimet ose dokumentet që ndodhen në dosjen e pjesëtarëve të familjes ose të afërmeve të azilkërkuesit mund të përdoren për të sqaruar dhe/ose pohuar moshën e deklaruar pa pasur nevojë për vlerësime të mëtejshme. Duhet bërë kujdes i veçantë në mbledhjen e të dhënave të tilla në mënyrë që fëmija ose familja e tij të mos rrezikohen. Kujdes i veçantë duhet bërë në kontekstin e mbrojtjes ndërkombëtare.

Për të përforcuar analizën fillestare mund të përdoren vlerësimet paraprake të bazuara në pamjen fizike, kur ato kryhen nga specialistë që kanë përvojë në punën me fëmijët. Këto vlerësime, kur përdoren bashkë me informacione të tjera të disponueshme, mund të shërbejnë për të mbështetur rezultatet e ekzaminimit paraprak.

Megjithatë, duke qenë se çmuarja bazohet tërësisht në karakteristikat fizike dhe se mund të çojë në rezultate arbitrare, subjektive dhe të pasakta, duhet bërë jashtëzakonisht kujdes në momentin e interpretimit të këtyre konsideratave. Për këtë arsye, vëzhgimi i pamjes fizike në vetvete nuk mund të konsiderohet si metodë për vlerësimin e moshës dhe as mund të përdoret e vetme sepse nuk mund të përcaktojë me siguri moshën kronologjike.

Pamja fizike mund të shërbejë për të ndarë ose bërë dallimin midis rasteve të qarta (persona me karakteristika të padyshimta të rrituri ose fëmije), por nuk duhet përdorur për adoleshentët në prag të moshës madhore ose për të rinjtë. Në këto raste, duhet të zbatohet parimi i prezumimit të pafajësisë (duke konfirmuar moshën e deklaruar ose duke e referuar rastin drejt vlerësimit të plotë të moshës) deri sa të dalin rezultatet përfundimtare.

IOM dhe ekspertë të tjerë paralajmërojnë se përvojat jetësore të fëmijëve mund të kenë ndikuar te zhvillimi i tyre. Domethënë se ata mund të kenë prapambetje në disa aspekte dhe të jenë më të zhvilluar në aspekte të tjera. Kërkimet në këtë fushë tregojnë se çrregullimi i stresit post-traumatik mund të shkaktojë plakje të parakohshme biologjike nga 5 deri në 10 vjet ⁽³⁸⁾.

Meqenëse kufizimet e metodave ekzistuese mund të çojnë drejt një vlerësimi ose çmuarje të pasaktë të moshës, duhet krijuar një mekanizëm rishikimi për të korrigjuar moshën e pasaktë të hedhur në sistem. Nga momenti që vlerësimi i moshës është identifikuar si i pasaktë, duhet të merren masa të menjëhershme (ndryshohet vendstrehimi, nëse azilkërkuesi zbulohet se është fëmijë i caktuar në kujdestar etj.).

Gjermani — Linjat e zbatueshme të orientimit:

1. verifikim i dokumenteve personale, kërkim për informacione shtesë;
2. intervistë (nga dy anëtarë të personelit të kualifikuar dhe me përvojë) dhe përshtypje e përgjithshme për zhvillimin, duke përfshirë inspektimin pamor të kualifikuar;
3. në rast dyshimi, ekzaminim mjekësor me metodën që ka ndikimin më të ulët në shëndetin e fëmijës.

Norvegji — Të gjithë fëmijët e pashoqëruar që nuk paraqesin një dokument të vlefshëm identiteti të njohur duhet t'i nënshtrohen një hetimi të mëtejshëm për identitetin e azilkërkuesit, i cili ndër të tjera përfshin edhe vlerësimin e moshës. Bazë për këtë vlerësim të moshës është informacioni i marrë për azilkërkuesin gjatë procesit të azilit, p.sh.:

- informacioni i dhënë nga vetë azilkërkuesi për moshën e tij;
- dokumentet e identitetit,
- informacionet për identitetin të dhëna nga Shtete të tjera Anëtare (në rast se azilkërkuesi është identifikuar në një shtet tjetër);
- verifikimi i identitetit të azilkërkuesit në vendin e tij të origjinës;
- pohimet ose komentet e bëra për moshën e azilkërkuesit nga palë të tjera, si: kujdestari ligjor, avokati, shërbimet sociale ose nëpunësit e shëndetësisë;

⁽³⁸⁾ Ladwig, K.-H., Brockhaus, A.C., Baumert, J. et al., "Post-traumatic stress disorder and not depression is associated with shorter leukocyte telomere length: findings from 3 000 participants in the population-based KORA F4 study", Ouellette, M.M. (ed.), *PLOS ONE*, 2013, 8(7), e64762. doi:10.1371/journal.pone.0064762.

- deklaratimet ose komentet e bëra për moshën e azilkërkuesit nga policia e emigracionit (e cila kryen regjistrimin e azilkërkuesve) dhe nga nëpunësi i ngarkuar me dosjen i cili drejton intervistën në kuadrin e procedurës së azilit;
- ekzaminimi mjekësor për moshën;
- vlerësimi mjekësor i moshës.

Në rastet ku kryhet ekzaminimi mjekësor për moshën, vlerësimi mjekësor i moshës duhet të kryhet duke e kombinuar me informacionet e tjera që ndodhen në dosje. Politikat e miratuara për këtë çështje japin udhëzime si të baraspeshohen elementet e ndryshme të lartpërmendura.

Zbulimet kryesore nga praktika e shteteve BE+

27 shtete BE+ marrin në konsideratë dokumentet e paraqitura si provë të moshës së azilkërkuesit.

Përveç dokumenteve, në 19 shtete BE+ bëhen vlerësimet e para të bazuara në pamjen fizike.

Mosha e deklaruar vihet në dyshim: nevojë potenciale për vlerësimin e moshës

Kur ka dyshime të bazuara për moshën e deklaruar të azilkërkuesit, mund të lindë nevoja për vlerësimin e moshës (mosha e deklaruar është vënë në dyshim, dokumentet që disponohen nuk e mbështesin moshën e deklaruar ose e kundërshtojnë atë). Në këto raste, autoritetet duhet të zgjedhin metodën ose metodat që duhet të përdorin për këtë qëllim.

Në seksionin vijues prezantohen metodat që përdoren aktualisht bashkë me një përshkrim të shkurtër të procedurës që zbatohet nga secila metodë. Metodatat ndahen në “mjekësore” dhe “jo mjekësore”, në varësi të faktit nëse nevojitet ndërhyrja e mjekut ose jo. Vetë metodat mjekësore klasifikohen në funksion të përdorimit ose mospërdorimit të rrezatimit në procedurat e tyre.

Në Komentin e përgjithshëm Nr.6 të Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Fëmijës thuhet se identifikimi i fëmijës si i pashoqëruar ose i ndarë nga familja përfshin vlerësimin e moshës, i cili duhet të marrë parasysh pamjen fizike dhe pjekurinë psikologjike.

A. Metodatat jo mjekësore


Zbulimet kryesore nga praktika e shteteve BE+

3 shtete BE+ përdorin vetëm metoda jo mjekësore për të vlerësuar moshën e azilkërkuesve.

Informacione të tjera mund të gjenden në Shtojcën 4 të këtij botimi.

1. Vlerësimi i mëtejshëm i provave

Kur dokumentet e mbledhura fillimisht ose informacioni i disponueshëm nuk përmban të dhëna për moshën, mund të jetë i nevojshëm vlerësimi i mëtejshëm i dokumenteve të tjera nga nëpunësit e azilit ose imigracionit. Disa lloje dokumentesh, edhe nëse nuk e kanë të shënuar moshën, mund të japin informacion për moshën e përafërt të azilkërkuesit, p.sh. dëftesa shkollore, kartela familjare e vaksinave ose të dhëna të tjera mjekësore. Për shembull, duke ditur se disa vakcina kryhen te fëmijët e një moshe të caktuar ose brenda një grupmoshe të caktuar, mund të llogaritet me përafërsi mosha e titullarit të kartelës së vaksinave.



2. Intervista e vlerësimit të moshës

Kjo metodë ka të bëjë me mbledhjen dhe analizimin e fakteve të dhëna nga personi moshë e të cilit është vënë në diskutim.

Dallimet kryesore midis metodave të vlerësimit psikosocial janë formimi dhe ekspertiza specifike e personit që kryen vlerësimin si dhe fushat që ekzaminohen. Në rast se vlerësimi psikologjik kryhet nga ekspertë të psikologjisë ose zhvillimit të fëmijëve, intervista e vlerësimit të moshës kryhet kryesisht nga nëpunësit që punojnë në autoritetet e azilit dhe imigracionit dhe që kanë përvojë në intervistat me fëmijët në kuadrin e procedurës për azil.

Gjatë intervistës së vlerësimit të moshës, intervistuesi përpqet të ndërtojë sekuencat kronologjike të ngjarjeve jetësore prej të cilave mund të deduktohet ose vlerësohet moshë e personit. Për të llogaritur me përafërsi datëlindjen e fëmijës, nëpunësve, azilkërkuessit ose pjesëtarëve të familjes së tij mund t'u vijë në ndihmë një kalendar lokal ngjarjesh⁽³⁹⁾ (kalendar i personalizuar që përmban datat e ngjarjeve më të rëndësishme për një zonë gjeografike) i kombinuar me pyetjet të tipit “para dhe pas”⁽⁴⁰⁾ të cilat kanë për qëllim të identifikojnë dy ngjarje të njohura, njëra nga të cilat ka ndodhur para dhe tjetra pas datës së lindjes së fëmijës (këto pyetje njihen edhe me termin “pyetje sanduiç”).

- Për të mësuar pikëpamjen e fëmijëve në një mënyrë të përshtatur për ta dhe për t'i inkurajuar të japin informacione, nëpunësit që merren drejtpërdrejt me fëmijët duhet të trajnohen për përdorimin e **teknikave të intervistave të përshtatura për fëmijët**⁽⁴¹⁾. Brenda mundësive, edhe përkthyesi duhet të jetë i familjarizuar me intervistat e fëmijëve.
- Për të garantuar pjesëmarrjen e personit, për të zhvilluar qëndrimin bashkëpunues dhe për të ndërtuar besimin midis personave pjesëmarrës është me shumë rëndësi që azilkërkuessit t'i jepet informacion i duhur para se të fillojë intervista. Intervistuesi duhet t'ia japë informacionin me fjalë të thjeshta (për qëllimin e intervistës, rolin e personave të përfshirë dhe të pranishëm dhe arsyet pse moshë e deklaruar është vënë në dyshim). Ai duhet të sigurohet se azilkërkuessi e kupton informacionin dhe përkthyesin, si dhe duhet të sigurohet se nevojat e azilkërkuessit janë plotësuar brenda të gjitha mundësive (gjinia e intervistuesit dhe e përkthyesit, masat e nevojshme për intervistën, etj.). Është gjithashtu e rëndësishme që azilkërkuessit t'i jepet mundësia për të sqaruar mungesën e konsekuencës gjatë intervistës.
- Kur merret vendimi për të ndërmarrë procesin e vlerësimit të moshës, duhet të garantohet që, në rastin e të miturve, barra e provës të kalohet në ngarkim të autoriteteve. Fëmijët nuk mund t'i shpjegojnë gjërat njësoj si të rriturit dhe ky kufizim është shumë i dukshëm kur flitet për fëmijë me origjinë të ndryshme kulturore, ku moshë mund të mos jetë kaq e rëndësishme sa në

⁽³⁹⁾ Për më shumë informacion lexoni dokumentin e FAO-s “Guidelines for estimating the month and year of birth of young children” (2008).

⁽⁴⁰⁾ Për më shumë informacion lexoni dokumentin e FAO-s “Guidelines for estimating the month and year of birth of young children” (2008).

⁽⁴¹⁾ Për më shumë informacion shih modulën e trajnimit të EASO-s “Interviewing children” në adresën <https://www.easo.europa.eu/training-quality/training>

kulturat perëndimore (për shembull, në kultura të ndryshme përdoren kalendarë të ndryshëm). Për më tepër, ata mund ta konsiderojnë veten të rritur ose mund të konsiderohen të rritur nga bashkësitë ku jetojnë.

- Intervistuesi duhet të njohë mirë informacionin për vendin e origjinës që të mund të zbulojë problematikat e rëndësishme gjatë intervistës.⁴²
- Në fund, nëse përfundimi i vlerësimit nuk është në favor të azilkërkuesit, arsyet duhet të shpjegohen nëpërmjet përkthyesit dhe në prani të përfaqësuesit/kujdestarit/avokatit të fëmijës. Azilkërkuesi duhet të njoftohet verbalisht dhe me shkrim për mundësinë dhe procedurën që duhet të ndjekë për ta kundërshtuar vendimin.

Zbulimet kryesore nga praktika e shteteve BE+


17 shtete BE+ kryejnë intervistën e vlerësimit të moshës për të vlerësuar moshën e azilkërkuesve.

Informacione të tjera mund të gjenden në Shtojcën 4 të këtij botimi.

Shembuj nga praktika

Irlandë — Nëse një person deklaron se është nën 18 vjeç, por nga International Protection Office (Zyra për Mbrojtjen Ndërkombëtare) konsiderohet më i madh për nga pamja, një anëtar me përvojë i personelit, i ndihmuar nga një përkthyes nëse është nevoja, kryen një intervistë jo formale në përpjekje për të krijuar një opinion nëse personi është i mitur ose jo dhe nëse ka nevojë të kalohet nën kujdesin e TUSLA-s (Agjencia e Shërbimeve ndaj Fëmijëve dhe Familjes). Intervista përmban pyetje për fëmijërinë e hershme, arsimin dhe moshën e pjesëtarëve të tjerë të familjes. Nëse pas intervistës ka ende dyshime, për azilkërkuesin zbatohet prezumimi i pafajësisë dhe rasti i tij i kalohet agjencisë TUSLA.

Maltë — Etapa e parë është intervista që mbahet brenda 10 ditëve punë me panelin e ekspertëve të vlerësimit të moshës. Në rast se mosha mbetet ende e diskutueshme, atëherë përfshihen profesionistë të tjerë, madje rasti i referohet edhe departamentit të radiologjisë për radiografi të dorës dhe kyçit të dorës. Procedura aktuale mbështetet në një përpjekje shumëdisiplinore që përfshin autoritetet e policisë, profesionistët e sektorit të kujdesit dhe të mjekësisë. Intervista, një prej mjeteve kryesore që përdoren për këtë vlerësim, mund të konsiderohet globale sepse ajo përpiqet të ndërtojë një profil sa më të plotë të të miturit. Rezultatet pasuese të metodave të përzgjedhura nga ekipi i vlerësimit të moshës merren në konsideratë në mënyrë kolektive.



⁽⁴²⁾ EASO mbledh dhe zhvillon informacione për vendet e origjinës, të cilat gjenden në faqen e saj zyrtare <https://www.easo.europa.eu/information-analysis/country-origin-information/country-reports> dhe në Portalin "EASO COI" me të drejta të kufizuara hyrjeje.

3. Vlerësimi psikosocial

Qëllimi i kësaj metode është vlerësimi i pjekurisë mendore dhe jo fizike. Teknikat e vlerësimit të moshës mbështeten në ekzaminimin e aftësive njohëse (konjitive) dhe të sjelljes, si dhe në vlerësimin psikologjik të azilkërkuesit. Prandaj, vlerësuesi duhet të ketë ekspertizën specifike në psikologji ose në etapat e zhvillimit të fëmijëve dhe të rinjve.

Baza e kësaj metode është intervista e gjysmë strukturuar, gjatë së cilës vlerësuesi me përvojë dhe i trajnuar (zakonisht një punonjës social ose psikolog) hulumton disa aspekte të jetës së personit të intervistuar. Gjatë intervistës/intervistave, vlerësuesi çmon shkallën e pjekurisë psikologjike të personit bashkë me sjelljen e tij. Rezultatet mund edhe të pasqyrojnë disa vlerësime të bazuara në pamjen fizike.

Që vlerësimi të jetë i efektshëm, besimi midis të ekzaminuarit dhe vlerësuesit është thelbësor. Për këtë arsye, vlerësimi duhet të shtrihet përgjatë një periudhe kohore dhe në të duhet të marrin pjesë edhe profesionistë të tjerë që janë në kontakt me personin e vlerësuar, si personeli pritës ose mësuesit. Në këtë drejtim, vendimi i dhënë nga Gjykata e Lartë e Mbretërisë së Bashkuar për çështjen Merton, i cili ka krijuar edhe referencë në jurisprudencë, jep orientime me vlerë⁽⁴³⁾. Ky vendim jep orientime për kushtet që duhet të plotësojnë autoritetet vendase për të kryer një vlerësim të ligjshëm të moshës së një azilkërkuesi, i cili deklaron se është nën 18 vjeç. Sipas vendimit Merton, të gjitha autoritetet (vendore) duhet të sigurojnë që vlerësimet e tyre të jenë të plota dhe gjithëpërfshirëse dhe që procesi i vlerësimit të moshës të jetë i qartë, transparent dhe i drejtë.

Që vlerësimi të jetë në pajtim me vendimin “Merton” duhet të përmbajë normalisht një takim ballë për ballë me të riun, takim i cili synon të kuptojë situatën e përgjithshme të azilkërkuesit dhe respekton standardet e së drejtës⁽⁴⁴⁾. Në këtë aspekt është me vlerë konsiderata e mëposhtme.

Është me rëndësi të kihen parasysh “udhëzimet” që azilkërkuesi mund të ketë marrë para intervistës për mënyrën sesi të silltet apo çfarë të thotë. Pasi të sqarohet roli i shërbimeve sociale, është me rëndësi të krijohet një kontakt me personin dhe të ndërtohet një marrëdhënie për aq sa e lejojnë rrethanat. Ky proces njihet edhe me emrin “joining” (të krijosh marrëdhënie).

Në jurisprudencën e lartpërmendur janë nënvizuar disa aspekte që duhen respektuar kur kryhet vlerësimi:

- sa herë të jetë e mundur, në proces duhet të marrin pjesë dy vlerësues;
- informacioni për rolin e vlerësuesit/vlerësuesve dhe të përkthyesit duhet të jepet në përputhje me nivelin arsimor dhe me pjekurinë e personit;
- duhet bërë kujdes për shkallën e lodhjes, traumës, hutimit dhe ankthit të personit që vlerësohet;
- gjatë të gjithë vlerësimit duhet të respektohen etnia, kultura dhe zakonet e personit që vlerësohet; në këtë aspekt, për të identifikuar temat e rëndësishme për diskutim mund të ndihmojë informacioni për vendin e origjinës;
- kur kryen vlerësimin, vlerësuesi duhet të bëjë pyetje të hapura dhe jo pyetje sugjeruese;
- vlerësuesi mund të përdorë mjete të ndryshme për t’ia bërë më të lehtë rrëfimin personit (vizatime, mjete shprehëse).

Gjatë intervistës, elementet e mëposhtme mund të përbëjnë burim të dobishëm informacioni për vlerësimin e moshës :

- pamja fizike dhe sjellja e azilkërkuesit, vëzhgimi i dinamikës së grupit (në aktivitetet me bashkëmoshatarët e tjerë);
- mënyra e ndërveprimit me vlerësuesin;
- historiku social dhe përbërja e familjes;

⁽⁴³⁾ Çështja *B v. London Borough of Merton* (2003) EWHC 1689 (admin), vendimin e së cilës e ka shpallur Lord Justice Stanley Burnton në Gjykatën e Lartë, më 14 korrik 2003.

⁽⁴⁴⁾ Shprehja “në pajtim me vendimin Merton” përdoret shpesh për të treguar se një procedurë vlerësimi moshe është në pajtim me jurisprudencën. Autoritetet vendore nuk kanë detyrime ligjore për mënyrën e kryerjes së vlerësimit të moshës. Megjithatë, gjykata ka dhënë orientime për autoritetet vendore në një çështje që përfshinte Këshillin e Mertonit (*B v. London Borough of Merton* (2003) EW HC 1689 (admin)). Të gjitha vlerësimet e moshës të kryera nga autoritetet vendore duhet të jenë në pajtim me jurisprudencën Merton dhe me jurisprudencën e krijuar pas këtij vendimi.

- aspektet e zhvillimit (p.sh. informacion për llojet e aktiviteteve në të cilat personi ka qenë i përfshirë para mbërritjes në Evropë);
- niveli arsimor, shkalla e pavarësisë dhe kujdesi për veten;
- vlerësimi i gjendjes shëndetësore dhe mjekësore;
- përvojat jetësore dhe ngjarjet traumatike që mund të kenë ndikuar në procesin e plakjes.

Ky informacion duhet të merret në konsideratë bashkë me informacionin e përftuar nga analiza e provave të tjera dhe më pas të përdoret për të nxjerrë përfundimet e vlerësimit. Përfundimet e vlerësimit duhen dhënë me shkrim dhe aspektet e lartpërmendura duhet të përfshihen në raport, së bashku me vëzhgimet ose informacionet shtesë që kërkojnë ndjekje të mëtejshme. Është tepër e rëndësishme që vlerësuesit të kenë aftësitë dhe përvojën e nevojshme me problematikat e mbrojtjes së të rinjve.

Në rast se përfundimet e vlerësimit nuk janë në favor të azilkërkuarit, arsyet duhet të shpjegohen qartë nëpërmjet përkthyesit, në prani të përfaqësuesit/kujdestarit/avokatit të fëmijës. Azilkërkuari duhet të njoftohet verbalisht dhe me shkrim për mundësinë dhe procedurën që duhet të ndjekë për të kundërshtuar vendimin.

Mbretëri e Bashkuar — Orientimet për kryerjen e intervistës në pajtim me vendimet e përgjithshme gjyqësore. Personat që vlerësojnë moshën duhet:


1. t'ia shpjegojnë azilkërkuarit qëllimin e intervistës, siç është specifikuar në vendimin Merton, paragrafi 55;
2. të përpiqen të kuptojnë situatën e përgjithshme të azilkërkuarit, sidomos rrethanat dhe historikun e familjes, nivelin e tij arsimor dhe aktiviteteve të azilkërkuarit gjatë viteve të mëparshme (edhe informacionet për etninë dhe kulturën e tij mund të shihen si të vlefshme), sipas parashikimeve të vendimit Merton, paragrafi 37;
3. të kryejnë vlerësime duke bërë pyetje për të testuar besueshmërinë e azilkërkuarit, nëse ka arsye për të vënë në dyshim deklaratimet e tij për moshën, sipas parashikimeve të vendimit Merton, paragrafi 37;
4. t'i japin azilkërkuarit mundësinë të shpjegojë mospërputhjet në rrëfimet e tij ose në çdo gjë që do të komprometonte besueshmërinë e tij (sa më shpejt të jetë e mundur dhe për sa kohë azilkërkuari "e ka mendjen të freskët") sipas parashikimeve të:
 - vendimit Merton, paragrafi 55,
 - vendimit të çështjes *R (FZ) v London Borough of Croydon* (2011) EWCA Civ 59, paragrafi 20,
 - vendimit të çështjes *R (NA) v London Borough of Croydon* (2009) EWHC 2357 (admin), paragrafi 52;
5. të mbajnë mend se rastet ndryshojnë nga njëri-tjetri dhe niveli i hetimit të kërkuar për një rast mund të mos jetë i nevojshëm për një rast tjetër, siç e parashikon edhe vendimi Merton, paragrafi 50.

Shoqata e Drejtorëve të Shërbimeve për Fëmijët (ADCS) në Mbretërinë e Bashkuar ka miratuar udhëzimet e mëposhtme për punonjësit socialë që merren me kryerjen e vlerësimeve të moshës.

http://adcs.org.uk/assets/documentation/Age_Assessment_Guidance_2015_Final.pdf

http://adcs.org.uk/assets/documentation/information_sharing_proforma_april_2015.doc

Një variant më i shkurtër gjendet në adresën: <http://www.makeitlooknice.co.uk/adcs/age-assessment-guidance/index.html>



Zbulimet kryesore nga praktika e shteteve BE+


11 shtete BE+ përdorin ekspertizën e punonjësve socialë për të vlerësuar moshën e azilkërkuesit. Po ashtu, rezultatet kanë treguar se gjashtë shtete BE+ kryejnë intervista psikologjike për të vlerësuar moshën, siç është pasqyruar në botimin e mëparshëm (njëri prej shteteve e përdor këtë metodë për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore).

Informacione të tjera mund të gjenden në Shtojcën 4 të këtij botimi.

B. Metodatat mjekësore pa rrezatim

1. Kontrolli i dhëmbëve

Kjo metodë është një kontroll pamor i dhëmbëve për të përcaktuar pjekurinë e tyre dhe nuk përfshin përdorimin e radiografisë. Një dentist i trajnuar krahason zhvillimin e dhëmbëve të azilkërkuesit me etapat zhvillimore të përcaktuara në grafikun e daljes së dhëmbëve ose me vlerat referencë dhe përcakton grupmoshat e mundshme. Studimet prirën të mbulojnë, ose zhvillimin e dhëmbëve të fëmijëve në periudhën midis 3 dhe 16 vjeç, ose zhvillimin e dhëmbëllëve të pjekurisë në grupmoshën 15-23 vjeç ⁽⁴⁵⁾.



⁽⁴⁵⁾ Për më shumë informacion: Unicef, *Age assessment practices: a literature review and annotated bibliography*, në adresën http://www.unicef.org/protection/Age_Assessment_Practices_2010.pdf; SCEP, *Position paper on age assessment in the context of separated children in Europe* (2012), në adresën <http://www.scepnetwork.org/images/16/163.pdf>; Norwegian Computing Centre, *Age estimation in youths and young adults* (2012), në adresën http://publications.nr.no/1355995517/Age_estimation_methods-Eikvil.pdf; Baccetti, T., Franchi, L. dhe McNamara, J.A. (Jr), "The cervical vertebral maturation (CVM) method for the assessment of optimal treatment timing in Dentofacial orthopaedics", *ScienceDirect*, (2005), Vol. 11, Numri 3, fq. 119-129; Cameriere, R., Ferrante, L. dhe Cingolani, M., "Age estimation in children by measurement of open apices in teeth", *PubMed*, (2005), Vol. 120, Numri 1, fq. 49-52.

Zbulimet kryesore nga praktika e shteteve BE+

16 shtete BE+ përdorin kontrollin e dhëmbëve si metodë për vlerësimin e moshës.

Informacione të tjera mund të gjenden në Shtojcën 4 të këtij botimi.

2. Rezonanca magnetike

MRI ose MR (rezonanca magnetike) bashkon një magnet të fuqishëm, një sistem të përparuar kompjuterik, dhe valët e radios për të prodhuar pamje të sakta të organeve, indeve, kockave dhe strukturave të tjera të brendshme të trupit. Në të kundërt me rrezet X ose skanerët CT/CAT (tomografia e kompjuterizuar ose e quajtur ndryshe tomografia aksiale e kompjuterizuar), pajisjet e rezonancës magnetike (MRI) nuk kanë rrezatim.

Fuqia e magnetit të rezonancës magnetike quhet “fuqia e fushës magnetike” dhe matet me njësi të quajtur “Tesla” ose “T”. Ekzistojnë dy lloje skanerësh: skanerët 1 T. dhe 1.5 T. (më të zakonshmit dhe me kosto të ulët) dhe skanerët 3 T. (më të shtrenjtë dhe jo të zakonshëm). Fuqia më e lartë e fushës magnetike do të thotë se skaneri ka magnet më të fortë dhe aftësi për të prodhuar imazhe më të detajuara në një kohë më të shkurtër. Procedura e skanerit mund të zgjasë nga më pak se 10 minuta deri në 1 orë, gjë që varet nga një sërë faktorësh si: lloji i imazhit që duhet përfutur (prerje të tërthorta apo “copa” të veçanta të trupit), lloji i teknologjisë së përdorur (rezonancë me fushë të lartë ose e hapur ose e hapur-vertikale) dhe rezultati që kërkohet të përftohet nga rezonanca dhe nëse pacienti mund të lëvizë ose jo.

Sipas George et al. ⁽⁴⁶⁾, shkalla e ngjitjes së kockave duket në një fazë më të avancuar në radiografi sesa në rezonancë magnetike. Për pasojë, rezultati i rezonancës do të nxirrte një moshë më të ulët sesa rezultati që do të nxirrte radiografia. Ky rezultat është i pranueshëm sepse nuk e dëmton azilkërkuesin.

Duhet të zbatohet një procedure përzgjedhëse. Rezonanca magnetike mund të mos jetë e përshtatshme për të gjithë pacientët, si p.sh. azilkërkuesit me stimulues kardiak të implantuar në zemër, me tatuazhe dhe me implante metalike ose ata që kanë nevojë për kujdes të veçantë për shkak të fushës magnetike.

Duke qenë se azilkërkuesit duhet të qëndrojnë të shtrirë mbi një shtrat të fortë për një kohë të gjatë dhe meqë makineria prodhon tinguj të lartë goditës, pacientët që vuajnë nga klaustrofobia, sidomos fëmijët, përjetojnë ankth kur i nënshtrohen procedurës me skanerin tradicional në formë tuneli. Ky problem mund të zgjidhet duke përdorur skanerin e hapur.

Dorë/kyç: qasja tradicionale bazohet në vlerësimin e moshës me anë të imazheve me rreze X; megjithatë, janë kryer eksperimente që përdorin imazherinë alternative si rezonanca magnetike (për shembull në vlerësimin e moshës së lojtarëve të futbollit në kampionatet e grupmoshave të ndryshme). U krijua një sistem me gjashtë shkallë bashkimi (Dvorak, 2007) ⁽⁴⁷⁾. Në një studim tjetër për lojtarët e futbollit të kryer nga “Fédération Internationale de Football Association” (Federata Ndërkombëtare e Shoqatës së Futbollit-FIFA), u hulumtuan për efekt krahasimi imazhet e kyçit të dorës të të njëjtit person të përfutur me rezonancë dhe me radiografi ⁽⁴⁸⁾.

Studimet e kohëve të fundit kanë pohuar vlerën e këtij ekzaminimi dhe tregojnë një lidhje të fortë midis fazave të rezonancës dhe moshës kronologjike; megjithatë, për të rritur saktësinë e rezultateve rekomandohet kombinimi i rezonancës magnetike me teknika të tjera ⁽⁴⁹⁾.

Duke qenë se gjinia e azilkërkuesit që i nënshtrohet vlerësimit është një tjetër faktor që mund të ndikojë në marzhin e gabimit të metodës ⁽⁵⁰⁾, gjinia e azilkërkuesit është faktor që duhet marrë parasysh kur përzgjidhet metoda.

⁽⁴⁶⁾ George, J., Nagendran, J. dhe Azmi, K., “Comparison study of growth plate fusion using MRI versus plain radiographs as used in age determination for exclusion of overaged football players”, *Br J Sports Med*, (2012), Vol. 46, Numri 4, fq. 273-278, doi:10.1136/bjsm.2010.074948.

⁽⁴⁷⁾ Dvorak, J. dhe George, J., “Age determination by magnetic resonance imaging of the wrist in adolescent male football players”, *British Journal of Sports Medicine*, (2007), Vol. 41, Numri 1, fq. 45-52.

⁽⁴⁸⁾ Ibidem.

⁽⁴⁹⁾ Serin, J., Rérolle, C., Puchoux, J., Dedouit, F., Telmon, N., Savall, F., dhe Saint-Martin, P., “Contribution of magnetic resonance imaging of the wrist and hand to forensic age assessment”, *International Journal of Legal Medicine*, (2016).

⁽⁵⁰⁾ Tscholl, P.M., Junge, A., Dvorak, J. and Zubler, V., “MRI of the wrist is not recommended for age determination in female football players of U-16/U-17 competitions”, *Scand J Med Sci Sports*, (2015), doi:10.1111/sms.12461.

Zhvillimet e fundit trajtojnë përcaktimin automatik të moshës së kockës. Ky përcaktim mbështetet në analizën e imazheve mjekësore përmes kompjuterit dhe në teknikën e të mësuarit automatik. Këto zhvillime e kanë bërë më të lehtë klasifikimin e imazheve në faza dhe kanë ulur mospërputhjet *ndër vëzhgues* dhe *nga i njëjti vëzhgues* (përkufizuar në Shtojcën 1, Fjalorthi).

Gjuri: kjo metodë bazohet në bashkimin e kërcit të pllakës së rritjes gjatë procesit të pjekurisë së gjurit.


U krijua sistemi i përcaktimit të pjekurisë së kockave të gjurit me anë të rezonancës magnetike (Dedouit, 2012) ⁽⁵¹⁾. Ky është një sistem me pesë faza, besueshmëria dhe vlefshmëria e të cilit është vlerësuar në një grupmoshë midis 10-30 vjeç. Raporti tregon për një korrelacion të lartë me moshën dhe homogjenitet të mirë *ndër vëzhgues* dhe *nga i njëjti vëzhgues*, por duhen ende studime të tjera për ta verifikuar këtë qasje.

Shembuj nga praktika

Suedia — Ky shtet përdor aktualisht rezonancën magnetike për artikulacionet e gjurit bashkë me radiografinë e dhëmballëve të pjekurisë për procedurën e vlerësimit të moshës së fëmijëve të pashoqëruar. Vlerësimi mjekësor i moshës kryhet nga Këshilli Kombëtar Suedez i Mjekësisë Ligjore dhe përbëhet nga dy ekzaminime të ndryshme. Ekzaminimi i parë është radiografia panoramike e dhëmballëve të pjekurisë dhe i dyti është rezonanca e gjurit. Të dy ekzaminimet synojnë të përcaktojnë nëse personi e ka arritur moshën 18 vjeç. Imazhet analizohen nga dy dentistë ose radiologë të pavarur. Që analiza të përbëjë bazë të kënaqshme për vlerësimin përfundimtar të moshës nga mjeku, ata duhet të bien dakord për shkallën e pjekurisë në zonën e rritjes. Ky është një mekanizëm i integruar mbrojtjeje dhe shprehje e parimit të prezumimit të pafajësisë.

Për të përcaktuar se mosha e azilkërkuesit është mbi 18 vjeç, duhet që rrënja e dhëmbit të ketë arritur shkallën përfundimtare të pjekurisë, edhe pse kjo shkallë zhvillimi më së shumti ndodh 1-2 vjet pas moshës 18 vjeç. Për sa i përket rezonancës së gjurit studiohet e njëjta shkallë pjekurie në zonën e rritjes (1-2 vjet pas moshës 18 vjeç). Këto janë garanci shtesë për t'iu përgjigjur më mirë nevojës për të zbatuar parimin e prezumimit të pafajësisë sa herë që lind nevoja.

Klavikula: janë kryer eksperimente duke përdorur një sistem klasifikimi me katër faza. Këto eksperimente kanë treguar se vlerësimi i moshës është i mundur, por nevojiten studime referencë specifike për rezonancën magnetike. Kërkimet më të fundit kanë treguar një korrelacion pozitiv midis fazave të rezonancës dhe moshës kronologjike ⁽⁵²⁾. Megjithatë, ekzaminimet kërkojnë vëzhgues më me përvojë se në metodat e tjera sepse mund të jetë e vështirë të dallohet faza fillestare nga fazat më të fundit të kockëzimit.



⁽⁵¹⁾ Dedouit, F. dhe Auriol, "Age assessment by magnetic resonance imaging of the knee: a preliminary study", *Forensic Science International*, (2012), fq. 217-232.


⁽⁵²⁾ Hillewig, E., Degroote, J., Van der Paelt, T., Visscher, A., Vandemaele, P., Lutin, B., D'Hooghe, L., Vandriessche, V., Piette, M. dhe Verstraete, K., "Magnetic resonance imaging of the sternal extremity of the clavicle in forensic age estimation: towards more sound age estimates", *Int J Legal Med.*, (2013), Vol. 127, Numri 3, fq. 677-689, doi:10.1007/s00414-012-0798-z. 2. Hillewig, E., De Tobel, J., Cuche, O., Vandemaele, P., Piette, M. dhe Verstraete, K., "Magnetic resonance imaging of the medial extremity of the clavicle in forensic bone age determination: a new four-minute approach", *Eur Radiol.*, (2011), Vol. 21, Numri 4, fq. 757-767, doi:10.1007/s00330-010-1978-1.

3. Ultratingujt

Ekografia me ultratingujt (e njohur edhe me emrat sonografi ose ultrasonografi) është një teknike diagnostikuese me imazhe e bazuar në përdorimin e ultratingujve për të parë strukturat e brendshme të trupit, si: tendinat, muskujt, kyçet, enët e gjakut dhe organet e brendshme.

Ekografia përdor valët e zërit me frekuencë më të lartë se ato që percepton veshi i njeriut (> 20 000 Hz). Imazhet e dala nga ultratingujt, të njohur edhe me emrin *sonograme*, përftohen duke dërguar impulse me ultratinguj brenda indit me anë të një sonde. Indi e rikthen tingullin; indet e ndryshme e rikthejnë tingullin në shkallë të ndryshme. Këto kumbime regjistrohen dhe i shfaqen mjekut si imazhe. Kjo metodë pa rrezatim është provuar për vlerësimin e moshës në dorë dhe në kyçin e dorës ⁽⁵³⁾, në klavikul ⁽⁵⁴⁾ dhe në kreshtën çapokore (iliake) ⁽⁵⁵⁾.

Studimet dolën në përfundimin se vlerësimi me ekografi **nuk duhet të konsiderohet si zëvendësues i vlefshëm i vlerësimit të moshës së kockës**, pasi etapat e rritjes nuk janë gjithmonë të dukshme.



Zbulimet kryesore nga praktika e shteteve BE+

Asnjë shtet BE+ nuk e ka raportuar përdorimin e ultratingujve ose sonografisë për vlerësimin e moshës. Informacione të tjera mund të gjenden në Shtojcën 4 të këtij botimi.

4. Vlerësimi i zhvillimit fizik

Vlerësimi i zhvillimit fizik përfshin krahasimin e gjatësisë, peshës dhe lëkurën e individëve ose popullatave me një grup vlerash referencë. Në varësi të praktikës në shtetet BE+, vlerësimi i zhvillimit fizik mund të përfshijë një ekzaminim fizik të përgjithshëm për të përshkruar ndonjë shenjë të mundshme të një gjendjeje që mund të ndikojë në shpejtësinë e pjekurisë ⁽⁵⁶⁾.

⁽⁵³⁾ Mentzel, H.J., Vilser, C., Eulenstein, M., Schwartz, T., Vogt, S., Böttcher, J., Yaniv, I., Tsoref, L., Kauf, E. dhe Kaiser, W.A., "Assessment of skeletal age at the wrist in children with a new ultrasound device", *Pediatr Radiol*, (2005), Vol. 35, Numri 4, fq. 429-433; Khan, K.M., Miller, B.S., Hoggard, E., Somani, A. dhe Sarafoglou, K., "Application of ultrasound for bone age estimation in clinical practice", *J Pediatr*, (2009), Vol. 152, Numri 2, fq. 243-247, doi:10.1016/j.jpeds.2008.08.018.

⁽⁵⁴⁾ Quirnbach, F., Ramsthaler, F. dhe Verhoff, M.A., "Evaluation of the ossification of the medial clavicular epiphysis with a digital ultrasonic system to determine the age threshold of 21 years", *Int J Legal Med.*, (2009), Vol. 123, Numri 3, fq. 241-245, doi: 10.1007/s00414-009-0335-x.; Schulz, R., Zwiesigk, P., Schiborr, M., Schmidt, S. dhe Schmeling, A., "Ultrasound studies on the time course of clavicular ossification", *Int J Legal Med.*, (2008), Vol. 122, Numri 2, fq. 163-167, doi: 10.1007/s00414-007-0220-4.

⁽⁵⁵⁾ Schmidt, S., Schmeling, A., Zwiesigk, P., Pfeiffer, H. dhe Schulz, R. "Sonographic evaluation of apophyseal ossification of the iliac crest in forensic age diagnostics in living individuals", *Int J Legal Med.*, (2011), Vol. 125, Numri 2, fq. 271-276, doi: 10.1007/s00414-011-0554-9.

⁽⁵⁶⁾ Për më shumë informacion: Unicef, *Age assessment practices: a literature review and annotated bibliography* (2011), gjendet në adresën http://www.unicef.org/protection/Age_Assessment_Practices_2010.pdf; SCEP, *Position paper on age assessment in the context of separated children in Europe* (2012), gjendet në adresën <http://www.scepnetwork.org/images/16/163.pdf>; Norwegian Computing Centre, *Age estimation in youths and young adults* (2012), gjendet në adresën http://publications.nr.no/1355995517/Age_estimation_methods-Eikvil.pdf; Professor Sir Al Aynsley-Green Kt., *The assessment of age in undocumented migrants* (2011), gjendet në adresën [https://www.humanrights.gov.au/sites/default/files/content/ageassessment/submissions/Sir%20Al%20Aynsley-Green%20Kt%20\(Submission%2038\).pdf](https://www.humanrights.gov.au/sites/default/files/content/ageassessment/submissions/Sir%20Al%20Aynsley-Green%20Kt%20(Submission%2038).pdf).

Matja dhe vlerësimi i shenjave të pjekurisë seksuale quhet edhe **vëzhgimi i pjekurisë seksuale**.

- Te djemtë, ekzaminimi bazohet në zhvillimin e penisit dhe të testikujve, në daljen e qimeve pubike dhe të qimeve nën sqetull, në rritjen e mjekrës dhe në daljen e arrëzës së fytit.
- Te vajzat, ekzaminimi përqendrohet në zhvillimin e gjirit, në qimet pubike, në qimet nën sqetull dhe në formën e ijëve. Mesatarisht, vajzat arrijnë pjekurinë e plotë seksuale në moshën 16 vjeç, ndërsa djemtë rreth moshës 17 vjeç ⁽⁵⁷⁾.

Në varësi të praktikës dhe ekzaminimeve të kryera në një shtet të caktuar BE+, përveç pediatri mund të përfshihen edhe mjekë të tjerë si për shembull gjinekologu.



Siç pasqyrohet në rekomandimet përfundimtare dhe gjatë të gjithë udhëzuesit, EASO konsideron se në asnjë rrethanë nuk duhen përdorur metodat që kërkojnë zhveshjen lakuriq apo ekzaminimin e organeve gjenitale për vrojtimin e pjekurisë seksuale.

ASPEKTET POSITIVE

Përdoret për të diktuar çrregullimet e rritjes që mund të jenë të rëndësishme për vlerësimin e moshës, por jo për të vlerësuar moshën kronologjike

Kur vlerësimi kryhet nga mjekët pediatër, merret në konsideratë mirëqenia fizike e fëmijëve sepse ata janë specialistë në zhvillimin fizik dhe psikologjik të fëmijëve

Metoda fizikisht invazive, mund të shkaktojë shumë stres dhe traumë te personat me origjinë të ndryshme kulturore ose që kanë pësuar abuzime dhe shfrytëzim gjatë ose para emigracionit të tyre. Në rast ekzaminimi të pjesëve intime ose organeve gjenitale, ky ekzaminim do të hynte në konflikt me të drejtën për privatësi dhe dinjitet, për integritet fizik dhe mendor për shkak të natyrës shumë instruzive të ekzaminimit. Matja antropometrike nuk merr parasysh dallimet midis etnive, racave, marrjen e vlerave ushqyese dhe sfondin shoqëror dhe ekonomik

Mungesa e protokolleve: në disa raste vlerësimi i zhvillimit seksual kryhet, në raste të tjera jo

Vlerësimi i pjekurisë seksuale ka mundësi të madhe gabimi.

Nga të gjitha metodat mjekoligjore të marra në analizë, vlerësimi i moshës në bazë të tipareve fizike është metoda më e pasaktë

ASPEKTET NEGATIVE

Zbulimet kryesore nga praktika e shteteve BE+

11 shtete BE+ pohuan përdorimin e vlerësimit të zhvillimit fizik për të vlerësuar moshën e azilkërkuesit. Shtatë shtete BE+ përdorin vrojtimin e pjekurisë seksuale për të vlerësuar moshën e personit.

Informacione të tjera mund të gjenden në Shtojcën 4 të këtij botimi.

⁽⁵⁷⁾ Për më shumë informacion: SCEP, *Position paper on age assessment in the context of separated children in Europe* (2012); Unicef, *Age assessment practices: a literature review and annotated bibliography*; Schmeling et al., "Forensic age estimation in unaccompanied minors and young living adults" in *Forensic medicine — From old problems to new challenges* (2011); Schmeling et al., "Age estimation of unaccompanied minors — Part 1. General considerations", *Forensic Science International*, (2006). The Royal College of Paediatrics and Child Health (Kolegji Mbretëror i Pediatriisë dhe Shëndetit të Fëmijës) ka dalë në përfundimin se përgjithësisht nuk është e mundur të parashikohet moshja e një individi nga matja antropometrike dhe përpjekjet për ta bërë një gjë të tillë duhen shmangur (The King's Fund and the Royal College of Paediatrics and Child Health, 1999:40).

C. Metodatat mjekësore me rrezatim

1. Radiografia

Në radiografi çlirohen doza të kufizuara rrezesh (të quajtura valë elektromagnetike) për të përfutur imazhe të brendisë së trupit në nuanca të ndryshme të së bardhës dhe të zezës. Kjo ndodh sepse inde të ndryshme përthithin sasi të ndryshme rrezatimi. Kalciumi në kocka përthith më shumë rreze, prandaj në radiografi kockat duken të bardha. Dhjami dhe indet e tjera të buta përthithin më pak rreze dhe duken gri. Ajri përthith sasinë më të vogël të rrezeve, prandaj mushkëritë duken të zeza.

Mosha e skeletit përcaktohet nga grada e zhvillimit të kockave. Këto ekzaminime vlerësojnë gradën e zhvillimit nisur nga bashkimi/pjekuria e kockave. Metodatat kryesore të radiografisë janë: radiografia karpale, e klavikulës, e dhëmbëve ose e ijëve. Edhe pse mjaft shtete BE+ i përdorin këto metoda, ata nuk i përdorin në të njëjtën mënyrë dhe shpesh përdorin kombinime të ndryshme dhe jo në të njëjtën renditje. Kjo larmi praktikash vjen kryesisht nga fakti se procedurat e vlerësimit të moshës përcaktohen gjerësisht nga legjislacionet e brendshme dhe procedurat përparojnë në funksion të jurisprudencës së shteteve.

Radiografia karpale (e dorës dhe e kyçit)

Kjo procedurë shërben për të vlerësuar formën, madhësinë e elementeve kockore dhe shkallën e kockëzimit të epifizës me anë të radiografisë së dorës. Imazhi krahasohet me elementet e mëposhtme:

- (a) me atlasin radiografik, i cili përbëhet nga imazhe standarde për moshën dhe gjininë përkatëse, për të përcaktuar etapat e zhvillimit. Për këtë qasje shërben si standard referencë atlas i zhvilluar nga Greulich dhe Pyle. Kjo metodë ishte rezultat i një studimi të vitit 1935, i cili synonte vlerësimin e pjekurisë së skeletit dhe jo të moshës dhe nuk merrte parasysh dallimet midis racave dhe ato ekonomiko-shoqërore.
- (b) me kockat individuale (sipas metodës së kockave individuale), shkalla e pjekurisë së të cilave përcaktohet individualisht dhe kombinohet për të llogaritur fazën e pjekurisë. Për këtë qasje, referenca kryesore është qasja Tanner- Whitehouse (e cila gjendet në tre botime). Botimi i dytë bazohet në vlerësimin e pjekurisë së skeletit dhe në parashikimin e gjatësisë së të rriturit. Secila prej 20 kockave të dorës krahasohet individualisht me një seri fotografish të zhvillimit të asaj kocke. Vlerat referencë u përcaktuan midis viteve 1950 dhe 1960. Mesatarisht, zhvillimi skeletor i kockave të dorës quhet i përfunduar në moshën 17 vjeç për vajzat dhe 18 vjeç për djemtë ⁽⁵⁸⁾.

Nëse origjina etnike nuk ushtron ndonjë ndikim të veçantë në shkallën e kockëzimit, situata ekonomiko-shoqërore luan një rol kyç në të. Pozita e lartë ekonomiko-shoqërore përshpejton shkallën e kockëzimit, ndërsa pozita e ulët ekonomiko-shoqërore e vonon atë. Për rrjedhojë, zbatimi i normave të radiografisë te individët me pozitë të ulët ekonomiko-shoqërore mund të çojë te nënvlerësimi i moshës së personit. Kjo konsiderohet e pranueshme sepse nuk shkakton pasoja negative te personi i ekzaminuar ⁽⁵⁹⁾.

Radiografia e klavikulës

Kjo metodë merret me vlerësimin e bashkimit të klavikulës. Që individi të quhet i rritur, duhet që të dy klavikulat e individit të jenë të bashkuara. Sistemet tradicionale të klasifikimit dallojnë katër etapa zhvillimi; etapa e fundit është ndarë në dy etapa të tjera. Në rast se bashkimi është i plotë dhe duket një vrazë, mund të supozohet se individi është të paktën 20 vjeç nëse është femër dhe të paktën 21 vjeç nëse është mashkull. Për herë të parë bashkimi i plotë i klavikulës dhe zhdukja e vrazës, për të dy gjinitë, u vu re duke nisur nga mosha 26 vjeç ⁽⁶⁰⁾.

⁽⁵⁸⁾ Për më shumë informacion: Tanner, J.M. et al., "Reliability and validity of computer-assisted estimates of Tanner-Whitehouse skeletal maturity (CASAS): comparison with the manual method", *Karger*, (1994), Vol. 42, Nr. 6; Frisch, H. et al., "Computer-aided estimation of skeletal age and comparison with bone age evaluations by the method of Greulich-Pyle and Tanner-Whitehouse", *Pediatric Radiology*, (1996), Vol. 26, Numri 3, fq. 226-231; Gertych, A. et al., "Bone age assessment of children using a digital hand atlas", *Computerised Medical Imaging and Graphics*, (2007), Vol. 31, Numrat 4-5, fq. 322-331.

⁽⁵⁹⁾ Schmeling, A., Garamendi, P.M., Prieto, J.L. and Landa, M. I., "Forensic age estimation in unaccompanied minors and young living adults", in *Forensic medicine — From old problems to new challenges*, Professor Duarte Nuno Vieira (Ed.), *InTech*, (2011), gjendet në adresën: <http://cdn.intechopen.com/pdfs-wm/19163.pdf>.

⁽⁶⁰⁾ Për më shumë informacion: Schmeling, A. et al., "Studies on the time-frame for ossification of the medial clavicular epiphyseal cartilage in conventional radiography", *International Journal of Legal Medicine*, (2004), Vol. 118, Numri 1, fq. 5-8.

Radiografia dentare

Kjo metodë merret me studimin e radiografisë së dhëmbëve, e njohur si *ortopantomogram*. Zhvillimi i skeletit matet me anë të ndryshimeve sekuenciale në daljen dhe strukturën e dhëmbit gjatë rritjes së fëmijës. Deri në moshën 16-20 vjeç formohen plotësisht të gjithë dhëmbët, me përjashtim të dhëmballëve të pjekurisë. Në këtë fazë është e dukshme larmia në zhvillimin e kurorave dhe rrënjëve.

Më poshtë mund të gjeni dy metodat kryesore:


- (a) Gleiser-i dhe Hunt-i (1955) ⁽⁶¹⁾ e përshkruajnë zhvillimin e dhëmbëve në 15 faza;
- (b) Demirjian-i (1973) ⁽⁶²⁾ e përshkruan zhvillimin e dhëmbit në tetë faza dhe secilës fazë rritjeje i jepet një notë në funksion të modelit statistikor ⁽⁶³⁾.

Sa i takon daljes dhe mineralizimit të dhëmballëve të pjekurisë, është vërtetuar se popullsia me ngjyrë e Afrikës shfaq zhvillim më të shpejtë krahasuar me evropianët; në të kundërt, aziatikët shfaqin vonesë në zhvillim. Për këtë arsye, për vlerësimin e dhëmballëve të pjekurisë në praktikën e vlerësimit të moshës duhen përdorur studime referencë specifike për popullsitë ⁽⁶⁴⁾.

Pavarësisht larmisë së madhe, studime të ndryshme kanë treguar se zhvillimi i dhëmballëve të pjekurisë mund të jetë mënyra më e mirë për të bërë dallimin midis një të rrituri dhe një fëmije dhe duhet të jetë një nga procedurat më të përdorura për vlerësimin e moshës së të rinjve në fund të adoleshencës.

Radiografia e kockës iliake (të legenit)

Duke qenë se pozicioni i kockave ndryshon teksa personi i afrohet moshës madhore ⁽⁶⁵⁾, moshë e skeletit mund të përcaktohet nga pamja e disa prej kockave të legenit.



⁽⁶¹⁾ Gleiser, I. and Hunt, E. E. "The permanent mandibular first molar: its calcification, eruption and decay", *Am. J. Phys. Anthropol.*, (1955), Vol. 13, fq. 253-283, doi:10.1002/ajpa.1330130206.

⁽⁶²⁾ Demirjian, A., Goldstein, H. dhe Tanner, J. M., "A new system of dental age assessment", *Human Biology*, (1973), Vol. 45, Numri 2, pp. 211-227, gjendet në adresën <http://www.bristol.ac.uk/media-library/sites/cmm/migrated/documents/dental-age-assessment.pdf>.

⁽⁶³⁾ Për më shumë informacion: (al n.d.), "Assessment of dental maturity of Brazilian children age 6 to 14 years using Demirjian's method", *Int J Paediatr Dent*, (2002), Vol. 12, Numri 6, fq. 423-428; Liversidge, H.M., "The assessment and interpretation of Demirjian, Goldstein and Tanner's dental maturity", *Ann Hum Biol.*, (2012), Vol. 39, Numri 5, fq. 412-431, doi:10.3109/03014460.2012.716080..

⁽⁶⁴⁾ Olze, A., Schmeling, A., Taniguchi, M., Maeda, H., van Niekerk, P., Wernecke, K-D. dhe Geserick, G., "Forensic age estimation in living subjects: the ethnic factor in wisdom tooth mineralization", *Int J Legal Med*, (2004), Vol. 118, fq. 170-173; Olze, A., van Niekerk, P., Ishikawa, T., Zhu, B.L., Schulz, R., Maeda, H. dhe Schmeling, A., "Comparative study on the effect of ethnicity on wisdom tooth eruption", *Int J Legal Med*, (2007), Vol. 121, fq. 445-448

⁽⁶⁵⁾ Për më shumë informacion: Schmeling, A. et al., "Age estimation of unaccompanied minors — Part 1. General considerations", *Forensic Science International*, (2006); Schmidt, S. et al., "Sonographic evaluation of apophyseal ossification of the iliac crest in forensic age diagnostics in living individuals", *International Journal of Legal Medicine*, (2011).

Zbulimet kryesore nga praktika e shteteve BE+

Ndërmjet ekzaminimeve mjekësore, radiografia karpale është metoda më e përdorur nga shtetet BE+. 23 shtete e pohuan përdorimin e saj në territorin e tyre.

Së dyti, radiografia dentare është e zakonshme ndër shtete, me 19 përgjigje pozitive.

Së treti, 12 shtete BE+ përdorin radiografinë e klavikulës.

Së fundi, tre shtete BE+ kanë shtuar radiografinë e legenit si metodë alternative për t'u përdorur me raste në procesin e vlerësimit.

Shembuj nga praktika

Finlandë — Vlerësimi i moshës së azilkërkuesit kryhet nga Departamenti i mjekësisë ligjore të Universitetit të Helsinkit, me kërkesë të policisë, Rojës së Kufirit ose Shërbimit Finlandez të Emigracionit. Metodot e përdorura janë kontrolli i dhëmbëve, radiografia karpale dhe radiografia dentare. Vlerësimi hartohet bashkërisht nga dy ekspertë. Të paktën njëri prej ekspertëve duhet të jetë punonjës i Departamentit të mjekësisë ligjore të Universitetit të Helsinkit. Ekspertët mund të jenë mjekë ose dentistë të miratuar dhe me kualifikimet e nevojshme.

Holanda — Vlerësimi mjekësor i moshës nuk përpiqet të përcaktojë moshën e azilkërkuesit, por të përcaktojë nëse bëhet fjalë për një të rritur ose një të mitur. Radiografia e dorës/kyçit analizohet nën këtë perspektivë. Në rast se kyçi nuk është bashkuar plotësisht, ekzaminimi mbyllet aty dhe azilkërkuesi konsiderohet i mitur. Nëse kyçi është bashkuar plotësisht, do të bëhen tre radiografi shtesë për klavikulën. Duhet që dy radiologë të pavarur të dalin individualisht në përfundimin se të dy klavikulat janë të bashkuara. Pas marrjes së përfundimeve të të dy radiologëve, një ekspert shtesë (antropolog mjekoligjor) merr vendimin në bazë të rezultateve të tyre. Në rast se rezultatet nuk janë përfundimtare ose raportohet se midis radiologëve ka mosmarrëveshje, azilkërkuesi konsiderohet i mitur. Vendimi mund të ankimohet.

Disa vërejtje plotësuese

MRI (rezonanca magnetike), radiografia dhe tomografia e kompjuterizuar (CT/CAT) janë teknika të ndryshme të përdorura për të kapur imazhin e rritjes së kockës. Këto imazhe do të krahasohen me studimet referencë për të përcaktuar etapën e rritjes së imazhit dhe në fund për të përcaktuar grupmoshën e lidhur me këtë etapë të rritjes.

MRI ose MR

- Rezonanca magnetike bashkon një magnet të fuqishëm, një sistem të përparuar kompjuterik dhe valët e radios për të prodhuar pamje të sakta të organeve, indeve, kockave dhe strukturave të tjera të brendshme të trupit. Kjo metodë përdor fushat magnetike dhe frekuencat e radios për të prodhuar imazhe të tejpërtejme.
- Është e përshtatshme për të përfutur imazhe të organeve, indeve të buta dhe strukturave të brendshme.
- Nuk përdor rrezatimin.

Radiografia

- Radiografia përdor një sasi të kufizuar rrezatimi që kalon përmes trupit për të kapur një imazh të vetëm të anatomisë së të ekzaminuarit.
- Objektet me dendësi si kockat e bllokojnë rrezatimin dhe në radiografi duken të bardha.
- Është metodë me rrezatim.

CT/CAT (tomografia e kompjuterizuar)

- Është ekzaminim që kombinon rrezet X me kompjuterin për të prodhuar pamje në 360 gradë dhe të tejpërtejme të trupit përmes shumë radiografive të marra në kënde të ndryshme.
- E përshtatshme për imazhet e kockave, të indeve të buta dhe të enëve të gjakut të marra të gjitha njëkohësisht. I jep radiologut detaje për strukturat kockore ose për traumat. Për shkak të ekspozimit ndaj rrezatimit tomografia nuk rekomandohet për gratë shtatzëna ose për fëmijët, me përjashtim të rasteve kur është absolutisht e domosdoshme.

Një tjetër faktor i rëndësishëm që duhet marrë parasysh është zhvillimi më i fundit në përdorimin e kompjuterit për interpretimin e radiografive ose imazheve të rezonancës magnetike me anë të kompjuterit. Qëllimi i këtij programi është të ulë devijimin ndër vëzhgues (ose ndër vlerësues) dhe nga i njëjti vëzhgues, kështu i njëjti imazh kategorizohet në të njëjtën mënyrë pavarësisht gabimeve nga i njëjti vëzhgues (i njëjti vëzhgues vlerëson të njëjtin imazh në momente të ndryshme) ose ndër vëzhgues (vëzhgues të ndryshëm që vlerësojnë të njëjtin imazh).

Kreu 5 Rekomandimet përfundimtare

Rekomandimet përfundimtare nuk synojnë të përmbledhin orientimet për garancitë procedurale të përshkruara në Kreun 2 dhe 3, por të japin përgjigje konkrete vështirësive praktike që vë përpara procesi i vlerësimit të moshës. Në këtë perspektivë rekomandimet janë grupuar si më poshtë, sipas temës dhe vështirësisë praktike të cilave u japin përgjigje:



Rekomandimet kryesore të EASO-s

A.	Tema	Zbatimi praktik i interesave më të larta të fëmijës
	Vështirësia praktike	Dallimet në zbatimin e këtij parimi në të gjithë territorin BE+
	EASO rekomandon	<ol style="list-style-type: none"> Vlerësimi i interesave më të larta të fëmijës duhet të kryhet për t'u siguruar që procesi i vlerësimit të moshës që mendohet të kryhet të jetë në pajtim me rrethanat individuale të azilkërkuarit dhe që rezultatet e pritshme të jenë në dobi të procesit dhe të mos dëmtojnë fëmijën. Vlerësimi i interesave më të larta të fëmijës duhet të verifikojë se ekzistojnë të gjitha garancitë dhe se respektohen interesat më të larta të fëmijës: <ul style="list-style-type: none"> është caktuar një përfaqësues dhe/ose kujdestar i kualifikuar dhe i pavarur për të vepruar në pajtim me interesat më të larta të fëmijës dhe për të ushtruar zotësinë juridike; procedurat janë të përshtatura për fëmijët dhe kryhen nga profesionistë të kualifikuar; informacioni për procesin, pasojat e tij dhe për të drejtën e refuzimit jepet rregullisht me fjalë të thjeshta dhe i përshtatur me moshën dhe me kulturën e fëmijës, nën mbikëqyrje, mund të jetë e dobishme prania e një ndërmjetësi kulturor; pikëpamjet e azilkërkuarit merren parasysh dhe mbahen në konsideratë sipas moshës dhe pjekurisë së tij; parimi i prezumimit të pafajësisë zbatohet para, gjatë dhe pas procesit, deri sa të dalë një rezultat përfundimtar; pëlqimi i informuar duhet të merret të paktën për ekzaminimet mjekësore, e drejta për të refuzuar ekzaminimet mjekësore respektohet dhe sqarohen arsyet e këtij refuzimi; rekomandohet veçanërisht që pëlqimi të merret nga fëmija dhe nga kujdestari, sipas rastit, dhe të dokumentohet (me shkrim ose me çfarëdolloj forme tjetër provuese); duhet të merren në konsideratë privatësia, mbrojtja e të dhënave dhe siguria përzgjidhet metoda më pak invazive që edhe procesi të jetë sa më pak invaziv dhe të zbatohet në mënyrë graduale; përzgjidhet metoda më e saktë dhe dokumentohet marzhi i gabimit; zgjidhja e efektshme ligjore është e disponueshme.

B.	Tema	Motivacioni/nevoja e vlerësimit
	Vështirësia praktike	Nevoja e vlerësimit të moshës duhet të jetë e justifikuar dhe e përligjur nga dyshime serioze
	<i>EASO rekomandon</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerësimi i moshës nuk duhet të kryhet si praktikë rutinë. Nevoja dhe përfitimet e një vlerësimi të caktuar moshe duhet të vlerësohen dhe të dokumentohen. 2. Duhet të shterohen të gjitha burimet e disponueshme të informacionit para se të merret vendimi për të kryer vlerësimin e moshës. 3. Të gjitha provat duhet të shqyrtohen në kombinim me një gamë më të gjerë faktorësh (faktorë fizikë, psikosocialë, zhvillimorë, mjedisorë dhe kulturorë, gjinorë) për të shmangur nevojën e kryerjes së vlerësimit të moshës më vonë. 4. Kur ka dyshime për moshën e azilkërkuetit, duhet që ai të konsiderohet si fëmijë (prezumimi i pafajësisë). 5. Kostoja financiare e vlerësimit nuk duhet të mbulohet nga azilkërkueti.
C	Tema	Profesionistët e kualifikuar
	Vështirësia praktike	Nuk gjenden gjithmonë profesionistë të specializuar në vlerësimin e moshës
	<i>EASO rekomandon</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Profesionistët duhet të jenë të specializuar jo vetëm në fushën e metodës që mendohet të përdoret, por edhe në zbatimin e saj specifik për qëllimet e vlerësimit të moshës. Profesionistët duhet të trajnohen vazhdimisht për zhvillimet më të fundit të metodës, për të drejtat e fëmijës dhe për mënyrën e kryerjes së vlerësimit në funksion të gjinisë dhe kulturës së fëmijës. 2. Në rastet ku ka mosmarrëveshje, ekzaminuesit mund t'ia referojnë rastin një eprori ose një paneli shumëdisiplinor. 3. Personeli përgjegjës për përcaktimin e moshës duhet të jetë i trajnuar siç duhet për të kuptuar rezultatet dhe mundësitë e tyre të gabimit.
D.	Tema	Karakterin invaziv
	Vështirësia praktike	<p>Nuk ka konsensus për karakterin invaziv të metodave të ndryshme</p> <p>Disa prej metodave në përdorim janë fizikisht ose psikologjikisht invazive</p>
	<i>EASO rekomandon</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Së pari duhen analizuar provat ekzistuese para se të ndërmerret një vlerësim i thelluar. 2. Kur vlerësimi konsiderohet i nevojshëm, të parat që zbatohen janë metodat jo mjekësore dhe të fundit, nëse ende ka dyshime, metodat mjekësore. Në këto raste, të parat që zgjidhen janë metodat pa rrezatim; metodat me rrezatim janë zgjedhja e fundit për t'u konsideruar. 3. Metodat duhet të përzgjidhen në funksion të rrethanave ose nevojave të rastit individual (gjinia, grupmosha e hamendësuar) dhe procesi duhet të respektojë identitetin etnik dhe kulturor të fëmijës. 4. Për qëllimet e vlerësimit të moshës nuk duhet përdorur asnjë metodë ku përfshihen zhveshja lakuriq apo ekzaminimi, këqyrja ose matja e organeve gjentile apo të pjesëve intime.

E.	Tema	Saktësia e metodave dhe/ose procesit
	Vështirësia praktike	Aktualisht asnjë metodë nuk mund të përcaktojë saktësisht moshën e personit Dokumentimi dhe interpretimi i marzhit të gabimit
	<i>EASO rekomandon</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Zbatohet parimi i prezumimit të pafajësisë dhe azilkërkuesi konsiderohet fëmijë që nga momenti kur lindin dyshime për moshën e tij deri sa të dalin rezultatet përfundimtare të vlerësimit. 2. Aspektet e ndryshme të zhvillimit psikologjik dhe fizik duhet të shqyrtohen si pjesë e procesit për të rritur saktësinë, në mënyrë që vlerësimi të bazohet në një gamë më të gjerë provash. 3. Profesionistët e kualifikuar dhe me përvojë duhet të tregojnë vazhdimisht aftësitë e tyre dhe duhet të trajnohen enkas për larminë kulturore dhe nevojat e veçanta të fëmijëve. 4. Sa herë të jetë e mundur, rastet e vështira duhet t'i referohen shërbimit kompetent për një konsultim të mëtejshëm. 5. Moshë e deklaruar e azilkërkuesit duhet të pranohet nëse është brenda grupmoshës së përcaktuar nga vlerësimi i moshës. Përndryshe duhet përzgjedhur moshë më e ulët e grupmoshës që ka dalë si rezultat i vlerësimit. 6. Duhet pranuar marzhi i gabimit dhe duhet zbatuar prezumimi i pafajësisë. 7. Marzhi i gabimit duhet të dokumentohet dhe të përfshihet te rezultatet, t'i komunikohet autoritetit përcaktues dhe të kuptohet prej tij.
F.	Tema	Qasje shumëdisiplinore dhe globale
	Vështirësia praktike	Qasja shumëdisiplinore dhe globale nuk zbatohet në shkallë të gjerë
	<i>EASO rekomandon</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Të analizohen aspektet e ndryshme (vlerësimi i zhvillimit psikologjik dhe fizik pa përdorur vetëm metoda mjekësore) si pjesë e procesit shumëdisiplinor për të rritur saktësinë, në mënyrë që vlerësimi të bazohet në një gamë më të gjerë provash. 2. Në procedurë duhen përfshirë ekspertë në aspekte të ndryshme të zhvillimit, të cilët dinë si duhet të vlerësojnë moshën brenda specialitetit të tyre. 3. Kur zbatohen disa metoda bashkë gjatë vlerësimit, vendimi duhet bazuar në përfundimet e panelit të ekspertëve shumëdisiplinorë. 4. Për zbatimin praktik të qasjes shumëdisiplinore duhen krijuar mekanizmat e bashkërendimit.
G.	Tema	Vlerësimet e përsëritura për të njëjtin azilkërkues në shtete të ndryshme BE+
	Vështirësia praktike	Vlerësimet e moshës të kryera në shtetet e tjera BE+ nuk njihen gjithmonë
	<i>EASO rekomandon</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kur ekzistojnë, rezultatet e vlerësimeve të moshës të kryera nga shtete të tjera BE+ duhet të njihen për të shmangur vlerësimet e panevojshme, sidomos në rastet që trajtohen në kuadrin e rregullores së Dublinit. 2. Informacioni për vlerësimin e moshës që i transferohet një shteti tjetër BE+ duhet të jetë i plotë, të përmbajë referencat e metodave të zbatuara dhe arsyetimin që i ka çuar ekspertët drejt rezultatit përfundimtar.
H.	Tema	Refuzimi për t'iu nënshtruar vlerësimit
	Vështirësia praktike	Rreziku që personi të konsiderohet automatikisht si i rritur
	<i>EASO rekomandon</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Duhet të sqarohen arsyet e refuzimit dhe, sipas rastit, vlerësimi duhet t'i përshtatet për të marrë pëlqimin e azilkërkuesit. 2. Refuzimi nuk duhet automatikisht të çojë drejt vendimit që personi është madhor.

I.	Tema	Zgjidhja e efektshme ligjore
	Vështirësia praktike	Rezultatet e vlerësimit të moshës nuk i nënshtrohen gjithmonë rishikimit administrativ ose gjyqësor
	EASO rekomandon	<ol style="list-style-type: none"><li data-bbox="499 318 1402 405">1. Vendimi për vlerësimin e moshës duhet të nxirret para vendimit mbi aplikimin për mbrojtje ndërkombëtare, sepse konsiderimi si i rritur ose si fëmijë mund të ndikojë te procedura e azilit.<li data-bbox="499 421 1402 454">2. Ky vendim duhet të jetë subjekt i rishikimit administrativ ose gjyqësor.

Shtojca 1 Fjalorthi

Ky fjalorthi synon identifikimin dhe/ose zhvillimin e një kuptim të përbashkët të termave më të rëndësishme që përdoren në procesin e vlerësimit të moshës. Përveç kësaj, ai përmban terma që janë përmendur në tekstin e udhëzuesit, por pa u sqaruar gjerësisht (për shembull termat “përcaktimi i interesave më të larta”, “barra e provës”, etj.). Qëllimi i përkufizimeve të fjalorthit është që ato të shërbejnë si burim reference për aktorët përkatës në fushën e vlerësimit të moshës, siç janë politikëbërësit e shteteve BE+, ekspertët që kryejnë ekzaminimet, nëpunësit dhe paneli i ekspertëve që vlerësojnë rezultatet dhe profesionistët e tjerë në përgjithësi.

Termi	Përkufizimi	Burimi
Saktësi	<p>Vetia ose gjendja e diçkaje që është e saktë ose e përpiktë</p> <p>Shkalla sipas së cilës një matje ose një vlerësim i bazuar në matje përfaqëson vlerën e vërtetë të atributit të matur.</p> <p>Informacione shtesë</p> <p>Ende nuk ekziston asnjë metodë për vlerësimin e moshës që të japë rezultate të sakta për moshën kronologjike të njeriut. Për këtë arsye termi i preferuar është vlerësim i moshës dhe jo përcaktim i moshës.</p> <p>Në kontekstin e ekzaminimeve mjekësore të përdorura si metoda vlerësimi të moshës, studimet referencë duhet të plotësojnë disa kërkesa që të mund të konsiderohen të sakta:</p> <ul style="list-style-type: none"> — madhësi e përshtatshme e mostrës, — verifikim i moshës së personave të testuar, — shpërndarje të njëtrajtshme të moshave, — ndarje sipas gjinisë, — detaje të datës së ekzaminimit, — përcaktim të qartë të karakteristikave të studiuara, — përshkrim të saktë të metodologjisë, — detaje për origjinën gjenetike/gjeografike të popullsisë së marrë si referencë, — situata ekonomiko-shoqërore dhe gjendja shëndetësore, — detaje të madhësisë së grupit, vlera mesatare ose e mesme dhe shkalla e ndryshueshmërisë për secilën, — karakteristika e studiuar. 	<p>Fjalori i Oxford-it në internet https://en.oxforddictionaries.com/definition/accuracy</p> <p>Fjalori mjekësor në internet http://medical-dictionary.thefreedictionary.com/accuracy</p> <p>Schmeling et al., 2011.</p>

Termi	Përkufizimi	Burimi
Moshë	<p>Gjatësia e kohës që një person ka jetuar ose që diçka ka ekzistuar.</p> <p>Informacione shtesë: për qëllimet e këtij mjeti, moshja është element thelbësor i identitetit të fëmijës sepse edhe Konventa për të Drejtat e Fëmijës e përkufizon fëmijërinë duke u nisur nga moshja.</p> <p>Moshja kronologjike matet me vite, muaj dhe ditë që nga momenti i lindjes së njeriut.</p> <p>Moshja biologjike përcaktohet nga situata aktuale e personit kundrejt jetëgjatësisë potenciale të tij, gjë që do të thotë se individ mund të jetë më i ri ose më i vjetër se moshja e tij kronologjike.</p> <p>Moshja shoqërore përcaktohet nga rolet, përgjegjësitë dhe zakonet e një individi krahasuar me anëtarët e tjerë të shoqërisë ku ai bën pjesë. Kështu, individ mund të jetë më i vjetër ose më i ri, në funksion të shkallës me të cilën ai shfaq sjelljen që shoqëria ose kultura e vet pret prej tij dhe kjo sjellje përcaktohet nga moshja.</p> <p>Moshja psikologjike përcaktohet nga aftësitë e individit për t'u përshtatur me kërkesat për ndryshim dhe përfshin përdorimin e kapaciteteve të përshtatjes së kujtesës, nxënies, inteligjencës, aftësive, ndjenjave, motivacioneve dhe emocioneve për të ushtruar kontroll mbi sjelljen dhe për ta vetërregulluar atë.</p>	<p>https://en.oxforddictionaries.com/definition/age</p> <p>Settersen et al., 1997:240</p> <p>Smith, T. and Brownlees, L., Unicef, 2011, fq. 7-8.</p>
Vlerësim i moshës	Procesi me të cilin autoritetet përpiqen të vlerësojnë moshën kronologjike ose grupmoshën e një personi për të përcaktuar nëse personi është fëmijë apo i rritur.	Komenti i përgjithshëm Nr. 6 i Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Fëmijës
Moshë (minimale) për përgjegjësi penale	Moshja minimale nën të cilën fëmijët prezumohen se nuk kanë aftësinë për të shkelur legjislacionin penal.	Fjalori i Rrjetit Evropian të Migracionit (EMN Glossary) Neni 40, paragrafi 3, i Konventës për të Drejtat e Fëmijës (KDF)
Prezumimi i pafajësisë	<p>Parim ligjor që u bën të mundur autoriteteve që, në rast paqartësie, të pranojnë/konsiderojnë deklaratimet e azilkërkuesit si fakte materiale, deri në provën e kundërt.</p> <p>Nëse ekziston një mundësi që individ të jetë fëmijë, ai duhet të trajtohet si i tillë.</p> <p>Nëse, edhe pas vlerësimit të moshës, Shtetet Anëtare kanë përsëri dyshime për moshën e azilkërkuesit, ata duhet ta konsiderojnë azilkërkuesin si të mitur.</p>	<p>Përkufizimi i EASO-s</p> <p>Komenti i përgjithshëm Nr. 6 i Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Fëmijës</p> <p>Neni 25, paragrafi 5, i DPA-së</p>

Termi	Përkufizimi	Burimi
<p>Vlerësimi i interesave më të larta (VIL)</p>	<p>(a) Një aktivitet unik që duhet të ndërmerret në çdo rast individual, në funksion të rrethanave specifike të çdo fëmije, të një grupi fëmijësh apo të fëmijëve në përgjithësi. Këto rrethana lidhen me karakteristikat individuale të fëmijës ose fëmijëve në fjalë.</p> <p>(b) Ky aktivitet ka të bëjë me vlerësimin dhe baraspeshimin e të gjithë elementeve të nevojshme për të marrë një vendim në një situatë të caktuar, për një fëmijë ose grup specifik fëmijësh.</p> <p>(c) Bëhet fjalë për një procedurë të vazhdueshme, e cila mundëson marrjen e vendimeve për veprimet e menjëhershme që duhen ndërmarrë për të mbrojtur interesat më të larta të fëmijës, p.sh. ndërhyrjet në çështjet e mbrojtjes dhe kujdesit. Kjo është procedurë globale dhe e drejtuar nga profesionistë me ekspertizën e duhur.</p> <p>Informacione shtesë</p> <p>Sipas <i>acquis</i> së BE-së në fushën e azilit, kur vlerësojnë interesat më të larta të fëmijës, Shtetet Anëtare duhet të kenë parasysh në veçanti elementet e mëposhtme:</p> <p>(a) mundësitë për bashkim familjar;</p> <p>(b) mirëqenien dhe zhvillimin shoqëror të të miturit, duke i dhënë vëmendje të veçantë situatës së tij personale;</p> <p>(c) konsideratat për sigurinë dhe mbrojtjen, sidomos në rastet kur i mituri ka rrezik të bëhet viktimë e trafikut të qenieve njerëzore;</p> <p>(d) pikëpamjet e të miturit, në varësi të moshës dhe pjekurisë së tij.</p> <p>Koncepti i vlerësimit të interesave më të larta (VIL) dhe ai i përcaktimit të interesave më të larta (PIL) mund të kuptohen si pjesë e të njëjtit proces, i cili në parim fillon që nga zbulimi i fëmijës së pashoqëruar apo të ndarë nga familja dhe mbaron kur fëmijës i është dhënë një zgjidhje e qëndrueshme për situatën e ndarjes nga familja dhe të zhvendosjes nga vendi i origjinës ose vendi i zakonshëm i banimit.</p>	<p>(a) dhe (b) Komenti i Përgjithshëm Nr. 14, 2013 i Komisionit të OKB-së për të Drejtat e Fëmijës http://www.refworld.org/docid/51a84b5e4.html</p> <p>(c) UNHCR, “Safe and Sound”, http://www.refworld.org/docid/5423da264.html</p> <p>Komenti i përgjithshëm Nr. 6, paragrafi 31, i Komisionit të OKB-së për të Drejtat e Fëmijës</p> <p>Neni 3 dhe Neni 3, paragrafi 1, i KDF-së</p> <p>Deklamimi 9 dhe 22, Neni 2, germa j) dhe Neni 23, paragrafi 2 i DKP-së</p> <p>Deklamimi 33 dhe Neni 25, paragrafi 6, i DPA-së</p> <p>Deklamimi 18, 19 dhe 38 dhe Neni 20, paragrafi 5 dhe Neni 31 i DK-së,</p> <p>Deklamimi 35 i rregullores Eurodac</p> <p>Deklamimi 13 dhe Neni 6 i Rregullores së Dublinit</p> <p>Neni 24 i Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian</p> <p>UNHCR, “Safe and Sound”, http://www.refworld.org/docid/5423da264.html</p>
<p>Interesat më të larta të fëmijës</p>	<p>(a) Këtu kemi të bëjmë me një koncept të trefishtë: një e drejtë thelbësore, një parim juridik themelor si bazë për interpretim dhe një rregull procedural që ka për synim të garantojë realizimin e plotë të të gjitha të drejtave të njohura nga Konventa për të Drejtat e Fëmijës dhe zhvillimin e përgjithshëm të fëmijës;</p> <p>(b) Këtu kemi të bëjmë me mirëqenien e fëmijës: në një kuptim të gjerë, ku hyjnë nevojat bazë të fëmijës si nevojat materiale, fizike, arsimore dhe emocionale si dhe nevojat për dashuri dhe siguri.</p>	<p>(a) Komenti i përgjithshëm Nr. 14, 2013 i Komisionit të OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (http://www.refworld.org/docid/51a84b5e4.html)</p> <p>(b) UNHCR, “Udhëzime për Përcaktimin e Interesave më të Larta të Fëmijës” (http://www.unhcr.org/4566b16b2.pdf)</p>
<p>Përcaktimi i interesave më të larta (PIL)</p>	<p>Ky është proces formal, me garanci të rrepta procedurale, që ka për objekt vlerësimin e interesave më të larta të fëmijës në vendime veçanërisht të rëndësishme për të, vendime të cilat do të kenë ndikim përcaktues në të ardhmen e fëmijës si identifikimi i zgjidhjeve të qëndrueshme. Për shkak të peshës së madhe të vendimit, PIL kërkon mbledhjen e informacioneve të plota për fëmijën gjatë të gjithë procesit të përcaktimit të interesave më të larta.</p>	<p>Komenti i Përgjithshëm Nr. 14, 2013 i Komisionit të OKB-së për të Drejtat e Fëmijës http://www.refworld.org/docid/51a84b5e4.html</p> <p>UNHCR “Safe and Sound” http://www.refworld.org/docid/5423da264.html</p>

Termi	Përkufizimi	Burimi
Barra e provës ose detyrimi i përligjjes	<p>Në kontekstin e mbrojtjes ndërkombëtare barra e provës është një koncept që përmbledh, nga njëra anë, detyrimin e azilkërkuarit për të përligjur aplikimin e tij dhe, nga ana tjetër, detyrimin e autoriteteve të azilit për hetim. Në këtë kuptim, kjo është një barrë prove e ndarë midis të dy palëve dhe në bazën e këtyre dy elementeve qëndron parimi i bashkëpunimit.</p> <p>Në varësi të rrethanave individuale dhe të kontekstit, autoritetet mund të marrin mbi vete një barrë më të rëndë hetimi.</p> <p>Informacione shpeshë</p> <p>Edhe pse barra e provës për azilkërkuarit në moshë madhore zakonisht ndahet midis autoritetit që shqyrton aplikimin dhe azilkërkuarit, në aplikimet e fëmijëve mund të jetë e nevojshme që autoriteti shqyrtues të marrë mbi vete një barrë më të rëndë prove, sidomos nëse fëmija nuk është i shoqëruar. Në rast se faktet e dosjes nuk mund të vërtetohen dhe/ose fëmija nuk është në gjendje të artikulojë plotësisht kërkesën e tij, autoriteti që shqyrton dosjen duhet të marrë një vendim të bazuar në rrethanat e njohura, gjë që mund të justifikojë zbatimin e gjerë të parimit të prezumimit të pafajësisë. Po ashtu, fëmijës i njihet prezumimi i pafajësisë edhe nëse disa pjesë të kërkesës së tij kanë probleme besueshmërie.</p>	<p>Moduli i EASO-s për vlerësimin e provave</p> <p>Deklamimi 25, Nenet 12 germa a), 13 germa a) dhe 25, paragrafi 5, të DPA-së, Neni 4, paragrafi 1 i DK-së</p> <p>UNHCR: “Note on Burden and Standard of Proof in Refugee Claims”, UNHCR 16 dhjetor 1998</p> <p>Shih edhe UNHCR, “The Heart of the Matter – Assessing Credibility when Children Apply for Asylum in the European Union”, dhjetor 2014: http://www.refworld.org/docic/55014t434.html [vizituar më 2 korrik 2017]</p>
Fëmijë/i mitur	Është çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç	<p>Neni 2, paragrafi 6, i DAT-së</p> <p>Neni 2, germa d), i DKP-së</p> <p>Neni 2, germa l), i DPA-së</p> <p>Neni 2, germa k), i DK-së</p> <p>Neni 2, germa i), i rregullores së Dublinit</p> <p>Neni 2, germa f), i Direktivës për Bashkimin Familjar</p> <p>Neni 1 i Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës, 1989</p>
Informacion për vendin e origjinës (IVO)	Informacion i përdorur nga autoritetet e Shteteve Anëtare për të analizuar situatën politiko-shoqërore në vendet e origjinës së azilkërkuarëve (dhe, nëse është e nevojshme, në vendet ku ata kanë kaluar tranzit) gjatë vlerësimit individual të aplikimit për mbrojtje ndërkombëtare.	Metodologjia e EASO-s për raportimet e IVO-ve Fjalori i Rrjetit Evropian të Migracionit (EMN Glossary)
Tomografi e kompjuterizuar (aksiale) (CT/CTA)	Procedurë imazherie që përdor pajisje të specializuara me rreze X për të krijuar pamje të detajuara ose skanime të zonave të caktuara brenda trupit.	“Radiology info” https://www.radiologyinfo.org , burim publik informacioni i zhvilluar nga mjekët e “Radiology Society of North America” (RSNA) dhe të “American College of Radiology” (ACR)
Pëlqim	Pranim i lirë, i vullnetshëm dhe pasi janë marrë të gjitha informacionet e nevojshme. Pëlqimi i fëmijës dhe përfaqësuesit ose kujdestarit të tij, në rastin e fëmijëve të pashoqëruar, kërkohet për ekzaminimet mjekësore në kuadrin e vlerësimit të moshës.	Neni 25, paragrafi 5, i DPA-së Komisionieri i Lartë i OKB-së për Refugjatët (UNHCR), “Field Handbook for the Implementation of UNHCR BID Guidelines”, nëntor 2011, në adresën http://www.refworld.org/docid/4e4q57d02.html

Termi	Përkufizimi	Burimi
Ndërmjetës kulturor	Profesionist me njohuri të thella për traditat e komuniteteve, i cili i bën ndërhyrjet më të përshtatshme nga ana kulturore, duke mbyllur hendeqet midis këndvështrimeve kulturore dhe profesionale.	Bazuar te Al-Krenawi, A. dhe Graham J. R., 2001.
Kujdestar	<p>(a) Kujdestaria ka të bëjë me delegimin e përgjegjësisë të një person madhor ose të një organizatë për t'u siguruar që interesat më të larta të fëmijës të jenë plotësisht të përfaqësuara.</p> <p>(b) Kujdestari konsiderohet si person i pavarur i cili mbron interesat më të larta dhe mirëqenien e përgjithshme të fëmijës dhe që, për këtë qëllim, plotëson kapacitetin e cinguar juridik të fëmijës, kur është e nevojshme, njësoj siç e bën edhe prindi (përkufizim i agjencisë FRA).</p> <p>Informacione shtesë</p> <p>Kujdestari shërben si garanci procedurale thelbësore për të siguruar respektimin e interesave më të larta të një fëmije të pashoqëruar ose të ndarë nga familja.</p>	<p>(a) Grup pune me bashkëpunim në nivel agjencie për fëmijët e pashoqëruar ose të ndarë. <i>Inter-agency guiding principles on unaccompanied and separated children</i>, 2004, http://www.refworld.org/docid/4113abc14.html</p> <p>(b) Komenti i përgjithshëm Nr. 6 i Komisionit të OKB-së për të Drejtat e Fëmijës, 2005</p> <p>(c) FRA, "Guardianship for Children Deprived of Parental Care", 2014, http://fra.europa.eu/en/publication/2014/guardianship-children-deprived-parental-care-handbook-reinforce-guardianship</p>
Besueshmëri ndër vëzhgues	<p>I referohet matjeve statistikore që përcaktojnë sa të ngjashme janë të dhënat e mbledhura nga vëzhgues të ndryshëm.</p> <p>Informacione shtesë</p> <p>Për vëzhguesit është me shumë rëndësi që të dhënat e mbledhura të jenë sa më të përafërta me vëzhgimet, kështu eksperimenti i tyre do të jetë i vlefshëm. Në rast se vlerësuesit kanë dallime të mëdha në vëzhgimet e tyre, atëherë matjet ose metodologjia nuk janë të sakta dhe duhet të korrigjohen.</p>	Bazuar në librin e Russell K. Schutt <i>"Investigating the social world: the process and practice of research"</i> , University of Massachusetts Boston, botimi i 8-të, 2015.
Besueshmëria nga i njëjti vëzhgues	<p>Aftësia e një vëzhguesi për të marrë të njëjtat rezultate në mënyrë të vazhdueshme kur ai i bën vëzhgimet në kohë të ndryshme.</p> <p>Informacione shtesë</p> <p>Për shembull, një mjek me shkallë të lartë besueshmërie nga i njëjti vëzhgues interpreton testimet diagnostikuese ose radiografinë e një pacienti në të njëjtën mënyrë, edhe kur e interpreton javë më pas. Besueshmëria nga i njëjti vëzhgues quhet edhe vetëbesueshmëri ose besueshmëria nga i njëjti vlerësues.</p>	Bazuar në librin e Russell K. Schutt, <i>"Investigating the social world: the process and practice of research"</i> , University of Massachusetts Boston, botimi i 8-të, 2015.

Termi	Përkufizimi	Burimi
Ndërhyrje/ invazive	<p>Termi “ndërhyrje” përdoret rëndom në procedurat mjekësore për të treguar futjen e instrumenteve ose objekteve të tjera në trup ose në zgavrat e trupit, duke nënkuptuar madje edhe prerjen e indeve.</p> <p>Termi “invaziv” mund të lidhet me një sjellje, veprim, gjendje ose prirje me karakter invaziv (që acaron dikë ose e bezdis), që ndërpret dhe shqetëson të tjerët duke u cenuar hapësirat personale ose duke ndërhyrë në jetët e tyre private.</p> <p>Informacione shtesë</p> <p>Termi invaziv mund të përdoret si sinonim i termit ndërhyrje, pra këto terma mund të jenë të shkëmbyeshëm në këtë kontekst.</p> <p>Meqenëse pasojat negative të metodave të vlerësimit të moshës nuk i përfshijnë gjithmonë efektet fizike të ndërhyrjes (futjen e instrumenteve ose objekteve të tjera në trup ose në zgavrat e trupit, duke nënkuptuar madje edhe prerjen e indeve), por mund të përfshijnë cenimin e privatësisë së dikujt, termi i preferuar në këtë botim është “invaziv” sepse ka spektër më të gjerë.</p>	<p>Përkufizimi i fjalorit të Oxford-it në internet https://en.oxforddictionaries.com/definition/us/invasive</p>
Ekzaminim mjekësor	<p>Për qëllimet e këtij dokumenti, te termi ekzaminim mjekësor përfshihen ekzaminimet, kontrollet e plota mjekësore dhe vlerësimet e kryera nga mjekë profesionistë (doktorë, radiologë, mjekë të përgjithshëm ose pediatër etj.)</p>	<p>Përkufizimi i EASO-s</p>
Përfaqësues	<p>Person ose organizatë që ndihmon dhe përfaqëson një fëmijë të pashoqëruar gjatë procedurës së azilit, duke siguruar respektimin e interesave më të larta të fëmijës dhe duke ushtruar kapacitetin juridik të fëmijës sa herë të jetë e nevojshme.</p> <p>Informacione shtesë</p> <p>Përfaqësuesit ose përfaqësuesit ligjore dallojnë nga avokatët e kualifikuar ose nga juristët e tjerë që japin ndihmë juridike. Ata flasin në emër të fëmijës dhe e përfaqësojnë atë ligjërisht me shkrim dhe personalisht përpara autoriteteve administrative dhe gjyqësore në procedimet penale, në ato të lidhura me azilin ose në procedimet e tjera ligjore të parashikuara nga legjislacioni i brendshëm.</p>	<p>Neni 24, paragrafi 1, i DPK-së dhe Neni 25, paragrafi 1, i DPA-së (i rishikuari rishikuari).</p> <p>FRA, “Guardianship for Children Deprived of Parental Care”, 2014.</p> <p>http://fra.europa.eu/en/publication/2014/guardianship-children-deprived-parental-care-handbook-reinforce-guardianship</p>
Fëmijë ose i mitur i pashoqëruar	<p>Fëmijë/i mitur i cili hyn në territorin e Shteteve Anëtare i pashoqëruar nga asnjë person madhor përgjegjës, të cilit ligji ose praktika e shtetit në fjalë i atribuon përgjegjësi për të. Ky kualifikim zbatohet për sa kohë që fëmija vërtet nuk merret në ngarkim nga ky person madhor; këtu përfshihet fëmija/i mituri që është lënë i pashoqëruar pasi ka hyrë në territorin e Shtetit Anëtar.</p>	<p>Neni 2, germa e), i DPK-së</p> <p>Neni 2, germa m), i DPA-së</p> <p>Neni 2, germa l), i DK-së</p> <p>Neni 2, germa i), i rregullores së Dublinit</p> <p>Direktiva për Bashkimin Familjar</p> <p>Komenti i përgjithshëm Nr. 6 i Komisionit të OKB-së për të Drejtat e Fëmijës, 2005</p> <p>UNHCR, “Safe and Sound”, fq. 22, http://www.refworld.org/docid/5423da264.html</p>

Termi	Përkufizimi	Burimi
Studim për vlefshmërinë	Punë kërkimore të kryera me procese të cilat vërtetojnë besueshmërinë dhe lidhjen e një procedure me qëllimet specifike.	Enciklopedia e koncepteve mjekësore http://www.reference.md/files/D023/mD023361.htm
Fëmijë të ndarë	Fëmijë që janë ndarë nga të dy prindërit ose nga kujdestari i mëparshëm sipas ligjit ose zakonisht nga të afërm të tjerë. Prandaj ky term mund të përfshijë fëmijë të shoqëruar nga pjesëtarë të tjerë të familjes që janë në moshë madhore.	Komenti i përgjithshëm Nr. 6 i Komisionit të OKB-së për të Drejtat e Fëmijës, 2005 UNHCR, "Safe and Sound", fq. 22 Neni 2, paragrafi 5, i Direktivës Anti Trafik Frontex, VEGA Handbook: Children at Airports, 2015 http://frontex.europa.eu/assets/Publications/Training/VEGA_Children_Handbook.pdf
Trafikim i fëmijëve	Trafikimi i fëmijëve është rekrutimi, transporti, transferimi, fshehja ose pritja e fëmijëve, duke përfshirë shkëmbimin ose transferimin e kontrollit mbi fëmijët, për qëllime shfrytëzimi. Në kontrast me shfrytëzimin e të rriturve, kur subjekti i shfrytëzimit janë fëmijët konsiderohet krim i dënueshëm edhe nëse nuk ka pasur kërcënime ose detyrim, rrëmbim, mashtrim, gënjeshtëri, abuzim me pushtetin, abuzim me cënueshmërinë, pagesa ose përfitime të ofruara për të marrë pëlqimin e një personi. Informacione shtesë Edhe pse kontrabanda ka ngjashmëri me trafikun e fëmijëve , këto dy lloje aktiviteteve kriminale nuk duhet të ngatërrohen. <ul style="list-style-type: none"> • Kalimi kontrabandë i fëmijëve është aktiviteti i kriminalizuar i ndihmës për të hyrë në mënyrë të parregullt në territorin e një shteti, që shpesh kryhet kundrejt një pagese. Qëllimi i trafikimit është shfrytëzimi i fëmijës dhe konsiderohet krim kundër personit. • Trafikimi përgjithësisht kryhet duke përdorur shtrëngimin dhe/ose gënjeshtëri. Me kontrabandën ndodh e kundërta. • Trafikimi përmban qëllimin për të shfrytëzuar fëmijën, i cili bëhet viktimë pasi ka mbërritur në territorin e shtetit, ndërsa roli i kontrabandistit përfundon sapo fëmija mbërrin në vendin për ku ishte nisur. • Trafikimi mund të ndodhë brenda dhe përgjatë kufijve shtetërorë, ndërsa për kontrabandën kalimi ndërkombëtar përbën një kriter. • Hyrja e një fëmije në territorin e një shteti mund të jetë e rregullt ose e parregullt në rastin e trafikimit, ndërsa kontrabanda zakonisht karakterizohet nga hyrja e parregullt. Trafikimi i fëmijëve nuk është krim vetëm ndërkufitar; duke qenë se qëllimi i aktivitetit kriminal është shfrytëzimi i fëmijëve, ata mund të trafikohen edhe brenda kufijve shtetërorë.	Articolul 2 alineatul (5) din ATD Frontex, VEGA Handbook: Children at Airports (Manualul VEGA: Copii în aeroporturi), 2015 http://frontex.europa.eu/assets/Publications/Training/VEGA_Children_Handbook.pdf

Shtojca 2 Interesat më të larta të fëmijës dhe vlerësimi i moshës: mjetet praktike

Duke qenë se fokusi i këtij botimi është që, kur merret vendimi për të kryer vlerësimin e moshës së fëmijës, së pari të merren parasysh interesat më të larta të fëmijës dhe kryerja e procesit pa rreziqe, EASO ka zhvilluar mjetet e mëposhtme praktike për të ndihmuar personat përgjegjës që duhet të vlerësojnë nëse procesi respekton interesat më të larta të fëmijës.

- A. **Formulari për vlerësimin e interesave më të larta (formulari VIL)** është përpiluar për të garantuar që autoritetet përgjegjëse ose palët e deleguara prej tyre të kenë kryer ose të kenë marrë në konsideratë të gjitha etapat kyçe për të përcaktuar nëse vlerësimi i moshës është ose jo i nevojshëm. Në këtë kuptim, formulari VIL synon të shërbejë si dokument mbështetës që vlerësuesit të mund të verifikojnë nëse informacioni dhe garancitë e duhura janë marrë në konsideratë para se të merret vendimi për kryerjen e vlerësimit të moshës.

Formulari për vlerësimin e interesave më të larta ka strukturën e mëposhtme.

- Informacionet e mbledhura.
 - Parakushtet e procesit.
 - Lista e faktorëve që duhen marrë parasysh për të përcaktuar nëse procesi është i përshtatshëm për fëmijën apo nëse ka nevojë të bëhen korrigjimet e nevojshme.
 - Rezultati i VIL-së: rezultati i vlerësimit të interesave më të larta për procesin potencial të vlerësimit të moshës (vlerësimi i moshës duhet kryer, nuk duhet kryer ose duhet pezulluar).
- B. Mjeti i dytë, **listë kontrolli për interesat më të larta të fëmijës në vlerësimin e moshës (listë kontrolli)**, është konceptuar për të garantuar se garancitë procedurale respektohen gjatë të gjithë procesit të vlerësimit të moshës. Kjo listë kontrolli duhet të përdoret gjatë të gjithë procesit të vlerësimit të moshës.
- Listë kontrolli i interesave më të larta të fëmijës** përmbledh garancitë procedurale dhe aspektet e rëndësishme të cilat duhet të respektohen për të mbrojtur interesat më të larta dhe të drejtat e tjera të fëmijës, gjatë procesit të vlerësimit të moshës së fëmijës.

Këto mjete janë konceptuar duke u nisur nga supozimi se vlerësimet do të kryhen nga nëpunës të trajnuar për trajtimin e dosjeve të azilit (të trajnuar dhe me përvojë specifike në punën me fëmijët) ose nga një palë tjetër e kualifikuar, e ngarkuar nga autoriteti përgjegjës për vlerësimin ose nga një autoritet tjetër. Gjithashtu, supozohet se këto mjete do të përdoren në kombinim me legjislacionin evropian, ndërkombëtar dhe atë kombëtar.

Duhet theksuar se, teksa udhëzimet dhe mjetet e përmendura në këtë botim përqendrohen vetëm te procesi i vlerësimit të moshës, vlerësimi i interesit më të lartë të fëmijës duhet të vazhdojë deri sa të gjendet një zgjidhje e qëndrueshme për fëmijën. Për rrjedhojë, vlerësimi i interesave më të larta nuk zëvendëson përcaktimin e interesave më të larta, gjë që kërkohet kur merren në konsideratë zgjidhjet e qëndrueshme për fëmijën.

ASPEKTE TË RËNDËSISHME TË VLERËSIMIT TË INTERESAVE MË TË LARTA TË FËMIJËS TË KRYER PËR QËLLIMET E VLERËSIMIT TË MOSHËS

Fëmijët kanë të drejtë të dëgohen për të gjitha vendimet që kanë ndikim në jetën e tyre. Gjatë kryerjes së VIL-it është e rëndësishme të merren në konsideratë pikëpamjet, ndjenjat dhe mendimet e fëmijës. Kujdestari/përfaqësuesi luan rol thelbësor për të garantuar që fëmija të informohet ashtu si duhet dhe të kuptojë procedurat, proceset dhe rezultatet e tyre të mundshme. Më poshtë do të gjeni të renditura disa aspekte të rëndësishme që duhen marrë parasysh.

- Informacioni duhet të jepet në mënyrë të thjeshtë, të drejtpërdrejtë dhe të qartë. Duhet të verifikohet sa e kupton fëmija informacionin, sepse disa fëmijë mund t'u tremben figurave që përfaqësojnë autoritetet dhe nuk guxojnë të bëjnë pyetje ose të pranojnë se nuk e kanë kuptuar informacionin, për arsye që lidhen me moshën, kulturën e origjinës ose me gjendjen psikologjike.
- Vlerësuesit duhet që **me nismën e tyre të marrin informacione** nga burime të rëndësishme për qëllimet e vlerësimit, sidomos prej burimeve që janë në dijeni për situatën e fëmijës (si kujdestari/përfaqësuesi, personi që kujdeset për fëmijën, punonjësit socialë në qendrat e pritjes, pjesëtarë të familjes etj.); prandaj duhet që të dhënat e kontaktit të palëve të interesuara të mblidhen para vlerësimit të interesave më të larta të fëmijës.
- Vlerësimi i interesave më të larta të fëmijës duhet të marrë në konsideratë edhe të dhënat ekzistuese për fëmijën si raportet mjekësore, vlerësimet e cënueshmërisë ose çdo dokument tjetër të disponueshëm gjatë procesit, para se të kryhet vlerësimi i interesave më të larta të fëmijës.
- Vlerësimi i interesave më të larta të fëmijës është vlerësim individual dhe duhet të kryhet veçan për çdo fëmijë. Ky vlerësim duhet të kryhet në një **ambient të fshehtë dhe të përshtatur për fëmijët** çka ndihmon të ndërtohet marrëdhënia e besimit me fëmijën. Nëpunësit dhe përkthyesit kanë detyrimin të ruajnë sekretin, koncept ky që duhet t'i shpjegohet fëmijës dhe të kuptohet prej tij.
- Fëmija duhet të ndihet rehat. Nëpunësi kompetent dhe përkthyesi duhet të sillen sa më natyrshëm dhe **me empati**.
- Nëse e kërkon fëmija dhe nëse është e mundur, intervistat me fëmijën për VIL-in mund të kryhen nga një nëpunës dhe përkthyes **të gjinisë për të cilën fëmija ka shprehur preferencë**.
- Në rast se fëmija ka pësuar traumë, mund të mos ketë dëshirë të shprehë ndjenjat ose mendimet e veta. Duhet konsultuar dhe kërkuar specialistë për intervistat që përdorin **metoda alternative intervistash**.
- Është me rëndësi t'i shpjegohet fëmijës se jo të gjitha dëshirat mund të , por nëse është e mundur ato do të përdoren për të orientuar procesin, ndërsa vendimi përfundimtar do të varet nga rrethanat e çështjes.

A. Formulari i vlerësimit të interesave më të larta të fëmijës

Formulari i VIL-së	
INFORMACIONET BAZË	
Numri i çështjes/dosjes	
Azilkërkuesi	
Kujdestari/përfaqësuesi	
Vlerësuesi	
Përkthyesi	
Data	
INFORMACIONET E MBLEDHURA	
Të dhënat anagrafike të mbledhura (kombësia, etnia, arsimit, gjuha, shëndeti, historiku i familjes)	<input type="checkbox"/>
Informacionet e mbledhura për moshën nga pjesëtarë të tjerë të familjes ose burime të tjera	<input type="checkbox"/>
Raportet e ekspertëve (raportet mjekësore, raportet administrative etj.)	<input type="checkbox"/>
Nëse nuk është mbledhur apo nuk është i disponueshëm asnjë prej informacioneve të mësipërme, të jepen arsyet:	
Informacione shtesë ose të reja:	
PARAKUSHTET PËR PROCESIN E VLERËSIMIT TË MOSHËS	
Individi ka dorëzuar një aplikim për mbrojtje ndërkombëtare.	<input type="checkbox"/>
Mosha e azilkërkuesit nuk është përcaktuar.	<input type="checkbox"/>
Të gjitha provat e disponueshme janë mbledhur dhe janë marrë në konsideratë, duke përfshirë rezultatet e identifikimit dhe, sipas nevojës, vlerësimin e cenueshmërisë, problemet shëndetësore, ndikimin në vlerësim, kapacitetin mendor, kapacitetin juridik dhe aftësinë për t'iu nënshtruar vlerësimit të moshës.	<input type="checkbox"/>
Fëmijës i është dhënë një periudhë pushimi dhe rikuperimi, sidomos në rastet ku azilkërkuesi shfaq shenja traume ose abuzimi në të shkuarën.	<input type="checkbox"/>
Zbatohet prezumimi i pafajësisë	<input type="checkbox"/>
Ka dyshime të përligjura për moshën e deklaruar nga azilkërkuesi.	<input type="checkbox"/>
Lutemi saktësoni:	
Është caktuar dhe është përfshirë në proces një kujdestar/përfaqësues i kualifikuar dhe i pavarur.	<input type="checkbox"/>
Fëmijës i jepet rregullisht informacioni për procesin, për pasojat e mundshme dhe të drejtën për të refuzuar, me fjalë të thjeshta dhe i përshtatur me moshën dhe kulturën e tij.	<input type="checkbox"/>
Pikëpamjet e azilkërkuesit janë marrë dhe mbahen parasysht, në varësi të moshës dhe pjekurisë së tij;	<input type="checkbox"/>
Përkthimi është i disponueshëm gjatë të gjithë procesit.	<input type="checkbox"/>
Nëse ndonjëri prej parakushteve nuk përmbushet, shpjegoni arsyet:	
Masat për ndjekje të mëtejshme nëse shihet e nevojshme:	
FAKTORËT QË DUHEN MARRË PARASYSH PËR TË ÇMUAR NËSE VLERËSIMI I MOSHËS ËSHTË NË INTERESAT MË TË LARTA TË FËMIJËS	
Procedura e vlerësimit të moshës mbështetet në një qasje globale dhe shumëdisiplinore, e cila lejon përshtatjen me nevojat dhe rrethanat specifike të azilkërkuesit (gjinia, origjina kulturore nga vjen dhe cenueshmëri të tjera).	<input type="checkbox"/>
Të paktën për ekzaminimet mjekësore, duhet marrë dhe dokumentuar pëlqimi i informuar nga fëmija dhe kujdestari, sipas rastit, (me shkrim dhe me çdo formë tjetër prove); ose të respektohet e drejta për të refuzuar ekzaminimet mjekësore dhe sqarohen arsyet e refuzimit.	<input type="checkbox"/>
Është përcaktuar dhe zbatohet në mënyrë graduale procedura më pak invazive.	<input type="checkbox"/>
Janë marrë në konsideratë fshehtësia, mbrojtja e të dhënave dhe siguria	<input type="checkbox"/>
Funksionarët dhe ekspertët kanë përvojë në punën me fëmijët dhe janë trajnuar në mënyrën e duhur.	<input type="checkbox"/>
Do të zgjidhet metoda më pak invazive.	<input type="checkbox"/>
Do të përzgjidhet metoda më e saktë dhe marzhi i gabimit është i pranueshëm për këtë azilkërkues (grupmosha në fjalë, gjinia, etj.).	<input type="checkbox"/>
Rezultatet e pritshme janë në dobi të procesit dhe nuk e dëmtojnë fëmijën.	<input type="checkbox"/>
Zgjidhja e efektshme ligjore është e disponueshme.	<input type="checkbox"/>
ALTERNATIVA 1	Është në interesat më të larta të azilkërkuesit që të bëhet vlerësimi i moshës së tij
<input type="checkbox"/>	Detaje: (shpjegoni arsyet për këtë rekomandim)

ALTERNATIVA 2	Procesi i vlerësimit të moshës nuk është në interesat më të larta të azilkërkuesit
<input type="checkbox"/>	Detaje: (shpjegoni arsyet për këtë rekomandim)
ALTERNATIVA 3	Vlerësimi i moshës së azilkërkuesit duhet të pezullohet përkohësisht
<input type="checkbox"/>	Detaje: (shpjegoni arsyet për këtë rekomandim)
Emri	
Organizata	
Data	
Nënshkrimi	
VLERËSIMI I MIRATUAR NGA	
Emri	
Organizata	
<p>Rezultati i vlerësimit (alternativa 1, 2 ose 3) duhet të kushtëzojë vendimin për të kryer ose jo vlerësimin e moshës, prandaj duhet të shënohet në dosje. Pasi çmohet si i nevojshëm (pas vlerësimit të dyshimit), vlerësimi i moshës duhet kryer në pajtim me garancitë e zbatueshme, duke marrë parasysh rrethanat individuale të azilkërkuesit dhe rekomandimet e EASO-s.</p>	

B. Listë kontrolli të interesave më të larta të fëmijës për qëllimet e vlerësimit të moshës

Listë kontrolli të interesave më të larta të fëmijës	
Është në interesat më të larta të fëmijës që të kryhet vlerësimi i moshës (alternativa 1 sipas formularit të VIL-it).	
PREZUMIMI I PAFAJËSISË	
<ul style="list-style-type: none"> ■ Nga momenti që ka arsye për të besuar se personi mund të jetë fëmijë, azilkërkuesi trajtohet si i tillë gjatë procedurës së azilit dhe të vlerësimit të moshës. <input type="checkbox"/> ■ Në rast se rezultatet e ekzaminimeve nuk janë përfundimtare, azilkërkuesi konsiderohet fëmijë. <input type="checkbox"/> 	
KUJDESTARI/PËRFAQËSUESI	
<ul style="list-style-type: none"> ■ Para vlerësimit të moshës caktohet një përfaqësues ose kujdestar i kualifikuar dhe i pavarur; ai është i pranishëm dhe përfshihet në proces me pëlqimin e azilkërkuesit. <input type="checkbox"/> ■ Roli dhe përgjegjësitë e kujdestarit/përfaqësuesit (garantimi i “interesave më të larta të azilkërkuesit” dhe ushtrimi i kapacitetit juridik) u shpjegohen vetë atyre dhe azilkërkuesit; këto informacione kuptohen nga të gjithë këta. <input type="checkbox"/> ■ Përfaqësuesi/kujdestari është i pranishëm gjatë intervistës së VIL-it, nëse azilkërkuesi shprehet se e dëshiron këtë prani. <input type="checkbox"/> ■ Përfaqësuesi/kujdestari informohet në formën e duhur. Ai e kupton mirë procesin e vlerësimit të moshës dhe është sqaruar për pyetjet e bëra. <input type="checkbox"/> ■ Përfaqësuesi/kujdestari mund të ndalojë vlerësimin e moshës nëse gjykon se është i papërshtatshëm dhe jo në interesin më të lartë të azilkërkuesit. <input type="checkbox"/> ■ Përfaqësuesi/kujdestari njoftohet për rezultatet dhe kupton si mund t’i kundërshtojë ato. <input type="checkbox"/> 	
NË RAST SE AZILKËRKUESI SHFAQ SHENJA TRAUME OSE KA QENË VIKTIMË ABUZIMI	
<ul style="list-style-type: none"> ■ Pasi vlerësohen kushtet psikosociale dhe fizike, azilkërkuesi konsiderohet i përshtatshëm për t’iu nënshtruar vlerësimit të moshës, me përshtatjet e nevojshme. <input type="checkbox"/> ■ Kur përcaktohet procesi konkret i vlerësimit të moshës, merren parasysh këto aspekte. <input type="checkbox"/> <ul style="list-style-type: none"> • Ekzaminimet që kërkojnë zhveshjen lakuriq, vëzhgimin ose matjen e pjesëve intime janë totalisht të ndaluara. <input type="checkbox"/> • Të kujtuarit e ngjarjeve të shkuara ose rindërtimi i historisë së jetës mund të mos jenë të efektshme për shkak të boshllëqeve në kujtesë dhe mund të jenë tepër stresuese për azilkërkuesin. <input type="checkbox"/> • Metodat e vlerësimit të moshës që vlerësojnë zhvillimin psikologjik mund të mos jenë të përshtatshme nëse nuk kryhen nga specialistë të trajnuar dhe me përvojë. <input type="checkbox"/> • Metodat e vlerësimit të moshës që merren me zhvillimin fizik mund të jenë stresuese ose veçanërisht invazive për viktimat e abuzimit. <input type="checkbox"/> ■ Janë të disponueshme metoda ose teknika alternative të përshtatura me nevojat e veçanta të azilkërkuesit. <input type="checkbox"/> ■ Prezumimi i pafajësisë zbatohet në shkallë të gjerë <input type="checkbox"/> ■ Garantohej një periudhë pushimi dhe rikuperimi, madje zgjatet nëse është e nevojshme. <input type="checkbox"/> ■ Bashkë me azilkërkuesin lejohet të ndjekë procesin një person i besuar, para se të verifikohet përshtatshmëria e këtij personi. <input type="checkbox"/> ■ Janë përzgjedhur funksionarë dhe ekspertë të trajnuar enkas për t’u marrë në mënyrë të veçantë me personat e pambrojtur. <input type="checkbox"/> 	

<p>INFORMACIONET</p> <ul style="list-style-type: none"> ■ Azilkërkuesi dhe përfaqësuesi/kujdestari janë informuar për sa më poshtë. ■ Për ekzistencën dhe arsyet e dyshimeve. Personi përgjegjës e informon fëmijën me shkrim dhe me gojë, në një gjuhë që ai kupton dhe të përshtatur për fëmijët. ■ Për mundësinë e vlerësimit të moshës dhe çfarë do të thotë kjo në praktikë, bashkë me një përshkrim të ekzaminimeve të ndryshme, mjekësore ose jo. ■ Për metodën dhe procesin (cilat metoda përdoren, përse janë përzgjedhur pikërisht këto metoda, saktësia dhe karakteri invaziv i metodës, ndikimi dhe rreziqet potenciale në shëndetin e njeriut që mund të ketë metoda dhe rolet e ekspertëve të përfshirë). ■ Për të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga procesi, sidomos: <ul style="list-style-type: none"> • për të drejtën e refuzimit për t'iu nënshtruar ekzaminimeve mjekësore dhe pasojat e refuzimit. • për mundësinë për të kundërshtuar rezultatet e vlerësimit të moshës dhe hapat që duhen ndjekur; • për pasojat e mundshme të rezultatit të ekzaminimit te procedura e aplikimit për mbrojtje ndërkombëtare. ■ Informacioni i dhënë është kuptuar nga azilkërkuesi dhe kujdestari/përfaqësuesi i tij. Dhënia e informacionit dokumentohet në dosje. 	<input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>
Listë kontrolli të interesave më të larta të fëmijës për qëllimet e vlerësimit të moshës (faqe 2 nga 3)	
<p>PIKËPAMJET E AZILKËRKUESIT JANË DËGJUAR</p> <ul style="list-style-type: none"> ■ Pas shpjegimit në mënyrë konstruktive dhe me empati të arsyeve të dyshimeve për moshën e deklaruar: <ul style="list-style-type: none"> • kur ka mungesë konsekuence të moshës; • kur del një dokument ose provë e re që lidhet me vlerësimin e moshës; • kur haset në refuzim për t'iu nënshtruar ekzaminimit mjekësor; • pasi vlerësimi i moshës ka mbaruar dhe rezultatet janë të ndryshme nga mosha e deklaruar; ■ azilkërkuesit i jepet mundësia dhe mjetet për ta kundërshtuar vendimin, pra edhe për t'iu dëgjuar. 	<input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>
<p>PËLQIMI I INFORMUAR — nga azilkërkuesi dhe/ose përfaqësuesi</p> <ul style="list-style-type: none"> ■ Duke marrë parasysh situatën shëndetësore/arsimore dhe pjekurinë, azilkërkuesi është në pozitën për të dhënë një pëlqim të menduar mirë. ■ Azilkërkuesi përfshihet në vendimin për të ndërmarrë vlerësimin e moshës, në pajtim me pjekurinë e tij, gjë që kërkon t'i merret mendimi atij dhe/ose kujdestarit/përfaqësuesit të tij. ■ Pëlqimi për ekzaminimet mjekësore merret kur ky ekzaminim kryhet në kuadrin e vlerësimit të moshës. ■ Është e mundur që pëlqimi të refuzohet nëse mendohet se procesi nuk është në interesat më të larta të azilkërkuesit. 	<input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>
<p>PASOJAT E REFUZIMIT</p> <ul style="list-style-type: none"> ■ Azilkërkuesi ka mundësinë të refuzojë procesin dhe duhet të sqarohen arsyet për këtë refuzim. ■ Refuzimi mbështetet nga kujdestari/përfaqësuesi ligjor. ■ Është tërësisht e provuar se vendimi për të rrëzuar aplikimin për azil/mbrojtje ndërkombëtare nuk bazohet vetëm te refuzimi i azilkërkuesit për t'iu nënshtruar vlerësimit të moshës. ■ Refuzimi nuk çon automatikisht drejt supozimit se personi është madhor. 	<input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>
<p>QASJE SHUMËDISIPLINORE DHE GLOBALE</p> <ul style="list-style-type: none"> ■ Procesi merr në konsideratë nevojat dhe rrethanat e veçanta të azilkërkuesit dhe përshtatet sa herë të jetë nevoja (në funksion të grupmoshës, gjinisë, etnisë, origjinës kulturore të personit, cenusshmërisë dhe nevojave të tjera). ■ Procesi nuk përmban ekzaminime të panevojshme. Në rast se ka ende dyshime, metodat mjekësore përdoren pasi të jenë shtuar alternativat e tjera jo mjekësore. ■ Në rast se është vërtet nevoja për të kryer vlerësimin e moshës, procesi bashkon metodat që vlerësojnë llojet e ndryshme të zhvillimit (pjekurinë, zhvillimin psikologjik dhe fizik, sjelljen, etj.). ■ Vlerësimi kryhet nga specialistë shumëdisiplinorë, të cilët përdorin shumë metoda nëse është nevoja dhe mbledhin mendimet e personave që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me azilkërkuesin. 	<input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>

<p>METODA MË PAK INVAZIVE DHE MË E SAKTË</p> <ul style="list-style-type: none"> ■ Metodat më pak invazive dhe më të sakta përcaktohen në funksion të grupmohës që do të vlerësohet, të gjinisë së personit, etnisë, kulturës, nevojave dhe rrethanave të tij të veçanta. <input type="checkbox"/> ■ Ekzaminimet respektojnë integritetin fizik dhe dinjitetin e individit. <input type="checkbox"/> ■ Personat e përfshirë në procedurë kuptojnë kulturën dhe origjinën etnike të azilkërkuesit dhe mund t'i përdorin njohuritë e tyre brenda kontekstit të vlerësimit të moshës. <input type="checkbox"/> ■ Ekzaminimet ku kërkohet zhveshja lakuriq, këqyrja e organeve gjenitale dhe e zhvillimit të gjirit përjashtohen nga procesi. <input type="checkbox"/> ■ Metodat që përmbajnë ekzaminime me radiografi përdoren vetëm si zgjidhje e fundit dhe duhet të justifikohen në mënyrë specifike për rastin individual. <input type="checkbox"/> ■ Marzhi i gabimit dokumentohet dhe interpretohet nga ekspertët ose paneli i ekspertëve që vendosin për rezultatet përfundimtare. <input type="checkbox"/> ■ Gjatë vlerësimit respektohet privatësia dhe ruajtja e të dhënave të azilkërkuesit. <input type="checkbox"/> 	
<p>MBROJTJA E TË DHËNAVE</p> <ul style="list-style-type: none"> ■ Për qëllimet e vlerësimit të moshës, informacioni për kërkesën e azilkërkuesit për azil apo edhe fakti se është dorëzuar një kërkesë e tillë nuk u është bërë me dije autorëve të hamendësuar të përndjekjes ose autoriteteve shtetërore të vendit të origjinës apo funksionarëve dhe punonjësve të këtyre autoriteteve (për shembull duke kërkuar nxjerrjen e një certifikate lindjeje ose dokumenteve të tjera të identifikimit që pohojnë moshën e azilkërkuesit). <input type="checkbox"/> ■ Informacioni është mbledhur me ndershmëri, në rrugë ligjore dhe për qëllimet specifike të vlerësimit të moshës. <input type="checkbox"/> ■ Mbledhja dhe ndarja e informacionit dhe provave për çdo vlerësim moshe janë në pajtim me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave. <input type="checkbox"/> 	
Listë kontrolli të interesave më të larta të fëmijës për qëllimet e vlerësimit të moshës (faqe 3 nga 3)	
<p>PROFESIONISTËT E KUALIFIKUAR</p> <ul style="list-style-type: none"> ■ Profesionistët e përfshirë në proces kanë kryer trajnimet e duhura për të drejtat dhe nevojat e fëmijëve ku përfshihen interesat më të larta të fëmijës dhe zhvillimi i fëmijës. <input type="checkbox"/> ■ Personat e përfshirë në proces, duke përfshirë ata që kryejnë vlerësimin e moshës dhe kujdestarin/përfaqësuesin, nuk kanë konflikt interesi. <input type="checkbox"/> ■ Është verifikuar ekspertiza e nevojshme e personave në kontakt me azilkërkuesin (ekspertiza e përkthyesit, përfaqësuesit dhe ekspertëve që kryejnë vlerësimin e moshës). <input type="checkbox"/> ■ Merren dhe respektohen preferencat e azilkërkuesit për gjininë dhe origjinën e nëpunësve që kryejnë vlerësimin. <input type="checkbox"/> ■ Në rastin e një ekzaminimi të vetëm, për rezultatet bien dakord dy ekspertët. <input type="checkbox"/> ■ Në rast se është nevojë për ekzaminime të ndryshme, ekspertët e panelit përgjegjës për interpretimin e rezultateve të ndryshme duhet të kenë formim shumëdisiplinor. <input type="checkbox"/> 	
<p>RASTET QË TRAJTOHEN SIPAS RREGULLORES SË DUBLINIT</p> <ul style="list-style-type: none"> ■ Kur mosha e një azilkërkuesi që trajtohet në pajtim me rregulloren e Dublinit, zbatohet prezumimi i pafajësisë. <input type="checkbox"/> ■ Në rast transferimi, informacioni dhe provat (bashkë me metodat e zbatuara për vlerësimin e moshës) i transmetohen shtetit përgjegjës, në pajtim me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave. <input type="checkbox"/> ■ Në rastet ku shtetet kanë dalë në përfundime të ndryshme për moshën e azilkërkuesit, para se të arrihet në një vendim përfundimtar merren parasysh të gjitha provat e disponueshme. <input type="checkbox"/> ■ Në pajtim me legjislacionin evropian, në rast se shtete të ndryshme dalin në rezultate të ndryshme për moshën, ajo më e ulëta do të konsiderohet si mosha e azilkërkuesit. <input type="checkbox"/> ■ Kur merr vendimin përfundimtar, gjatë vlerësimit të provave, shteti përgjegjës merr parasysh: <ul style="list-style-type: none"> — burimet dhe metodat e përdorura për të arritur te mosha, — besueshmërinë dhe/ose mundësinë e marzhit të gabimit, — kualifikimet e personave përgjegjës për ekzaminimet ose vlerësimin e moshës, — çdo informacion tjetër të disponueshëm që lidhet me moshën, — arsyet dhe/ose shpjegimet e dhëna për diferencat në moshë, — pikëpamjet e azilkërkuesit, sidomos nëse diferencat në moshë lindin nga fakti se ai ka deklaruar moshë të ndryshme. <input type="checkbox"/> <p>Nëse pas këtij shqyrtimi ka ende dyshime, azilkërkuesi trajtohet si i mitur, bazuar në parimin e prezumimit të pafajësisë.</p>	

MUNDËSITË PËR TË KUNDËRSHTUAR VENDIMIN

- | | |
|--|--------------------------|
| ■ Vendimi për vlerësimin e moshës jepet me shkrim dhe i shpjegohet verbalisht azilkërkuesit. | <input type="checkbox"/> |
| ■ Rezultatet dhe moshë që ka dalë nga vlerësimi mund të rishikohen nëse dalin prova të reja. | <input type="checkbox"/> |
| ■ Ankimimi/rishikimi i vendimit të vlerësimit të moshës i jepet azilkërkuesit subjekt vlerësimi. Ky informacion i jepet edhe përfaqësuesit/kujdestarit të tij. | <input type="checkbox"/> |
| ■ Kur vendimi nuk e pohon moshën e deklaruar, azilkërkuesit dhe përfaqësuesit/kujdestarit i jepen arsyet që sqarojnë vendimin. | <input type="checkbox"/> |
| ■ Në rast vendimi negativ, jepet edhe një shpjegim për mënyrën si mund të kundërshtohet ky vendim | <input type="checkbox"/> |
| ■ Në rast se vendimi kundërshtohet ose ankimohet, azilkërkuesit i jepet mundësia për të shprehur veten dhe pikëpamja e tij merret në konsideratë. | <input type="checkbox"/> |
| ■ Gjatë procesit të ankimit azilkërkuesi ndihmohet nga përfaqësuesi. | <input type="checkbox"/> |

Në rast se nuk ekziston asnjë prej garancive të mësipërme procedurale, në raportin e VIL-it duhen dhënë informacione të tjera ku përfshihen:

- veprimet e mëtejshme vijuese (nëse ka);
- vërejtjet ose shqetësimet e ngritura nga ekzaminuesi ose nga paneli i ekspertëve gjatë vlerësimit të rezultateve të ekzaminimeve;
- çdo shqetësim ose problem tjetër të lidhur me mirëqenien e fëmijës;
- informacione shtesë ose të reja.

Shtojca 3 Kuadri juridik dhe orientimet strategjike

Kjo shtojcë përmbledh dispozitat më të rëndësishme për fëmijët të parashikuara në instrumentet ligjore ndërkombëtare dhe evropiane. Megjithëse kjo shtojcë përfshin kuadrin ligjor dhe jurisprudencën kombëtare të përmendur nga autoritetet kombëtare në anketën e kryer në vitin 2016, përmbajtja e saj nuk duhet konsideruar shteruese. Këtu janë përfshirë referencat e instrumenteve kuazi-ligjore dhe materialeve të tjera me vlerë për qëllimet e vlerësimit të moshës si dhe hiperlidhjet e tyre për t'ia lehtësuar leximin përdoruesit, kur ato ekzistojnë. Në fund, gjendet një seksion bosh i cili mund të plotësohet nga përdoruesi i këtij udhëzuesi me dispozitat dhe instrumentet përkatëse që janë zhvilluar në nivel kombëtar.

1. Legjislacioni ndërkombëtar

Instrumenti ligjor	Të drejtat dhe garancitë	Neni përkatës
Konventa e OKB-së "Për të drejtat e fëmijës" (KDF), 20 nëntor 1989	Familja	Parathënia
	Përkufizimi i fëmijës	Neni 1
	Parimi i mosdiskriminimit	Neni 2
	Interesat më të larta të fëmijës	Neni 3, paragrafi 1; Neni 9, paragrafi 3; Neni 18, paragrafi 1; Neni 20
	E drejta për të jetuar, për të mbijetuar dhe për t'u zhvilluar	Neni 6
	Regjistrimi, emri, shtetësia dhe kujdesi prindëror	Neni 7
	Ruajtja e identitetit dhe marrëdhënieve familjare	Neni 8
	E drejta për të mbajtur marrëdhënie dhe kontakte personale	Neni 9
	Rivendosja e lidhjeve familjare	Neni 10; Neni 22, paragrafi 2
	Respektimi i pikëpamjeve të fëmijës: e drejta për t'u dëgjuar	Neni 12
	Mbrojtja nga të gjitha format e dhunës	Neni 19
	Përkujdesja dhe strehimi	Neni 20
	Fëmijët refugjatë dhe kërkimi i familjes	Neni 22
	E drejta për arsim	Neni 28
	Mbrojtja nga shfrytëzimi ekonomik	Neni 32
	Ndalimi i torturës dhe mbajtja në burg si masë e fundit	Neni 37
Lufta dhe konfliktet e armatosura	Neni 38	
Drejtësia për të mitur	Neni 40	
Konventa e OKB-së "Për statusin e refugjatit" e vitit 1951 dhe Protokollin për Statusin e Refugjatit i vitit 1967	Refugjatët Fëmijët e pashoqëruar	Germa B, paragrafi 2, i Aktit Final Nr. 2545 të Konferencës së të Plotfuqishmëve për statusin e refugjatëve dhe personave pa shtetësi.

2. “Acquis” i Bashkimit Evropian

Instrumenti ligjor	Të drejtat dhe garancitë	Neni përkatës
Traktati për Bashkimin Evropian	Të drejtat e fëmijës	Neni 3, paragrafi 5
Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian	E drejta për azil	Neni 18
	Të drejtat e fëmijës	Neni 24
Kodi i Kufijve Shengen (Rregullorja 562/2006)	Masat procedurale të përshtatura për moshën e fëmijëve	Neni 19, paragrafi 1, germa f), Shtojca VII
Direktiva për Kushtet e Pritjes (2013/33/BE) e rishikuar	I mitur	Neni 2, germa d)
	I mitur i pashoqëruar	Neni 2, germa e)
	Pjesëtarët e familjes	Neni 2, germa c)
	Përfaqësues	Neni 2, germa j)
	Interesat më të larta të fëmijës dhe uniteti i familjes	Deklamimi 9
	Interesat më të larta të fëmijës	Deklamimi 22; Neni 2, germa j); Neni 11, paragrafi 2; Nenet 23 dhe 24
	Personat e pambrojtur	Nenet 21 dhe 22
	Regjistrimi dhe dokumentacioni	Neni 6
	Kërkimi i familjes	Neni 24, paragrafi 3
	Direktiva për Procedurat e Azilit (2013/32/BE) e rishikuar	I mitur
I mitur i pashoqëruar		Neni 2, germa m)
Përfaqësues		Neni 2, germa n) dhe Neni 25
Interesat më të larta të fëmijës		Deklamimi 33; Neni 2, germa n); Neni 25, paragrafi 1, germa a); Neni 25, paragrafi 6
E drejta për informacion		Neni 25, paragrafi 4
Vlerësimi i moshës		Neni 25, paragrafi 5
Direktiva e Kualifikimit 2011/95/BE	I mitur	Neni 2, germa k)
	Pjesëtarë të familjes	Neni 2, germa j)
	I mitur i pashoqëruar	Neni 2, germa l)
	Interesat më të larta të fëmijës dhe uniteti i familjes	Deklamimi 18
	Interesat më të larta të fëmijës	Deklamimi 19, 27 dhe 38; Neni 20, paragrafi 5; Neni 31, paragrafët 4 dhe 5
	E drejta për t’u dëgjuar/për pjesëmarrje, e drejta për informacion	Nenet 22 dhe 31
	Ruajtja e unitetit të familjes	Neni 23
Kërkimi i familjes	Neni 31, paragrafi 5	

Rregullorja e Dublinit (604/2013) e rishikuar	I mitur	Neni 2, germa i)
	I mitur i pashoqëruar	Neni 2, germa j)
	Pjesëtarë të familjes	Neni 2, germa g)
	I afërm	Neni 2, germa h)
	Përfaqësues	Neni 2, germa k)
	Interesat më të larta të fëmijës dhe uniteti i familjes	Deklamimi 16
	Interesat më të larta të fëmijës	Deklamimi 13, 24 dhe 35; Neni 2, germa k); Nenet 6, 8 dhe 20, paragrafi 3
	E drejta për informacion	Deklamimi 4 dhe Shtojca XI e Rregullores Zbatuese 118/2014
	Identifikimi i pjesëtarëve të familjes dhe i të afërmeve	Deklamimi 35
	Kërkimi i familjes, identifikimi i pjesëtarëve të familjes dhe i të afërmeve	Neni 6, paragraf 4; Neni 8
Rregullorja Zbatuese 118/2014	Shkëmbimi i informacionit për fëmijën	Shtojca VII e Rregullores Zbatuese 118/2014
	Kërkimi i familjes, identifikimi i pjesëtarëve të familjes dhe i të afërmeve	Neni 1, paragrafi 7; Shtojca II, lista A(I), lista B(I)
	Shkëmbimi i informacionit për fëmijën	Shtojca VII
Rregullorja Eurodac (603/2013) i rishikuar	Informacion për procedurën e Dublinit drejtuar fëmijëve të pashoqëruar	Shtojca XI
	Interesat më të larta të fëmijës	Deklamimi 35
Direktiva Anti-Trafik (2011/36/BE)	Identifikimi i fëmijës viktimë e trafikut dhe masat mbrojtëse	Deklamimi 23
	Fëmija	Neni 2, paragrafi 6
	Cenueshmëria	Neni 2, paragrafi 2
	Interesat më të larta të fëmijës	Deklamimi 8, 22 dhe 23; Neni 13; Neni 16, paragrafi 2
	Garancitë procedurale në hetimet penale	Neni 15
	Mbrojtja e fëmijëve të pashoqëruar, viktimë të trafikut të qenieve njerëzore	Neni 16
	Direktiva për lejet e qëndrimit të viktimave të trafikut të qenieve njerëzore (2004/81/KE)	I mitur i pashoqëruar
Interesat më të larta të fëmijës		Neni 10, germa a)
Identifikimi i fëmijëve të pashoqëruar		Neni 10, germa c)
Kërkimi i familjes		Neni 10, germa c)

Direktiva për Bashkimin Familjar (2003/86/KE)	I mitur i pashoqëruar	Neni 2, germa f)
	Bashkimi familjar	Neni 2, germa d)
	Pjesëtarët e familjes	Neni 4
	Interesat më të larta të fëmijës	Neni 5, paragrafi 5
	Rivendosja e lidhjeve familjare	Nenet 4 dhe 10
	Direktiva 2011/92/BE, datë 13 dhjetor 2011 “Për luftën kundër abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë me fëmijë” e cila zëvendëson Vendimin Kuadër të Këshillit 2004/68/JHA	articolul 3.9
Directiva 2011/92/UE a Parlamentului European și a Consiliului din 13 decembrie 2011 privind combaterea abuzului sexual asupra copiilor, a exploatării sexuale a copiilor și a pornografiei infantile și de înlocuire a Deciziei-cadru 2004/68/JAI a Consiliului	Mosha për dhënien e pëlqimit për marrëdhënie seksuale	Deklamimi 8 Neni 2, germa b) dhe Neni 3, paragrafi 2

3. Legjisllacioni dhe jurisprudenca kombëtare

Shteti	Legjisllacioni përkatës	Legjisllacioni dhe jurisprudenca kombëtare	Jurisprudenca përkatëse
<p>Austri</p>	<p>Sipas Neni 13, paragrafi 3, të Aktit Federal për rregullat e përgjithshme të procedurës së zyrës federale për imigracionin dhe azilin, Zyra Federale për Imigracionin dhe Azilin ose Gjykata Federale Administrative mund të urdhërojë edhe ekzaminime radiologjike, në kuadrin e metodës me shumë ekzaminime (Neni 2, paragrafi, pika 25 e Aktit austriak për Azilin 2005), kryesisht radiografi me qëllimin e përcaktimit të moshës, nëse i huaji nuk arrin të provojë, duke paraqitur dokumente të pakundërshtueshme ose mjete të tjera të përshtatshme dhe të barasvlershme prove, se është i mitur sikurse pretendon, pasi procedura paraprake ka dalë në përfundim se moshë e mitur është e diskutueshme. Çdo metodë ekzaminimi duhet të kryhet me nivelin më të ulët të ndërhyrjes. Bashkëpunimi i të huajit për ekzaminimet radiologjike nuk mund të përfitohet me detyrim. Në rast se dyshimet e bazuara vazhdojnë edhe pas ekzaminimeve për të përcaktuar moshën, i huaji hamendësohet i mitur. Kjo dispozitë ligjore u miratua fillimisht në vitin 2009 me ish Nenin 15, paragrafi 1, pika 6 i Aktit austriak për Azilin 2005. Që prej vitit 2014 rregullohet në Aktin Federal për rregullat e përgjithshme të procedurës së zyrës federale për imigracionin dhe azilin.</p> <p>Neni 2, paragrafi 1, pika 25, i Aktit austriak për Azilin 2005 përcakton metodën me shumë ekzaminime si modelin më të avancuar për përcaktimin e moshës, bazuar në tre ekzaminime mjekësore individuale: në ekzaminimin fizik, dentar dhe atë radiologjik. Kjo dispozitë ligjore u miratua në vitin 2009.</p> <p>Neni 29, paragrafi 6, pika 2, i Aktit austriak për Azilin 2005 parashikon se nëse është nevojë, duhet kryer pa vonesa të panevojshme metoda me shumë ekzaminime për përcaktimin e moshës që në fillim të procedurës së pranimit (Neni 2, paragrafi 1, pika 25, i Aktit austriak për Azilin 2005, Neni 13, paragrafi 3, i Aktit Federal për rregullat e përgjithshme të procedurës së zyrës federale për imigracionin dhe azilin). Kjo dispozitë ligjore u miratua në vitin 2015.</p>	<p>Gjykata e Lartë Administrative në Austri është shprehur se në mungesë të provave të mjaftueshme për të verifikuar moshën e mitur të azilkërkuetit, gjykata e shkallës së parë duhet të kërkojë vlerësimin e moshës. Hamendësimi i moshës i bazuar vetëm në pamjen e jashtme të azilkërkuetit nga një përfaqësues i ligjit nuk mjafton (VwGH 16.4.2007, Ra 2005/01/0463; www.ris.bka.gv.at/Dokument.wxe?Abfrage=Vwgh&Dokumentnummer=JW_T_2005010463_20070416X00)</p> <p>Gjykata e Lartë Administrative është shprehur se, në rast se rezultatet e procedurës hetimore justifikojnë hamendësimin se azilkërkueti është madhor, zyra federale për imigracionin dhe azilin nuk është e detyruar të urdhërojë metodën me shumë ekzaminime për të përcaktuar moshën e azilkërkuetit dhe nuk zbatohet as prezumimi i pafajësisë. (VwGH 25.2.2015, Ra 2014/20/0045, www.ris.bka.gv.at/Dokumente/Vwgh/JWR_2014200045_20150225L02/JWR_2014200045_20150225L02.pdf)</p> <p>Gjykata e Lartë Administrative për përcaktimin e moshës së azilkërkuetit, shihet si pjesë e procedurës në tërësi për të vërtetuar rrethanat e çështjes dhe për të marrë vendim. Mungesa e një hetimi të mirëfilltë ose arsyetimi me të meta në një vendim për vlerësimin e moshës së azilkërkuetit, çon në një vendim të paligjshëm. (VwGH 25.2.2016, Ra 2016/19/0007, www.ris.bka.gv.at/Dokument.wxe?Abfrage=Vwgh&Dokumentnummer=JW_T_2016190007_20160225L00)</p>	

Legjislacioni dhe jurisprudenca kombëtare	
Belgjikë	<p>Ligji për kujdestarinë i datës 24 dhjetor 2002 “Për krijimin e Shërbimit të Kujdestarisë” si institucion përgjegjës për të marrë në ngarkim të miturit e pashoqëruar dhe për të caktuar kujdestarët.</p> <p>Neni 7 i Ligjit për kujdestarinë parashikon sa më poshtë:</p> <p>§ 1. Kur Shërbimi i Kujdestarisë ose autoritetet kompetente për azilin, për hyrjen në territorin shtetëror, për të drejtën e banimit dhe për largimin nga territori shtetëror kanë dyshime të arsyeshme për moshën e personit, Shërbimi i Kujdestarisë urdhëron menjëherë ekzaminimin mjekësor, të kryer nga një mjek, për të verifikuar nëse personi është ose jo nën moshën 18 vjeç. Ekzaminimi mjekësor do të kryhet nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Kujdestarisë.</p> <p>Kostot për ekzaminimet mjekësore janë në ngarkim të autoritetit që i ka kërkuar ato. Në rast se Shërbimi i Kujdestarisë urdhëron ekzaminimin me nismën e vet, kostot janë në ngarkim të këtij shërbimi.</p> <p>§ 2. Në rast se ekzaminimi mjekësor tregon se personi i ekzaminuar është nën moshën 18 vjeç, atëherë zbatohet Neni 8. Në rast se ekzaminimi mjekësor tregon se personi i ekzaminuar është mbi moshën 18 vjeç, sipas ligjit kujdestaria e Shërbimit të Kujdestarisë mbaron aty. Shërbimi i Kujdestarisë njofton menjëherë personin e interesuar dhe autoritetet kompetente për azilin, për hyrjen në territorin shtetëror, për të drejtën e banimit dhe për largimin nga territori dhe autoritetet e tjera të interesuara.</p> <p>§ 3. Në rast dyshimi për rezultatet e ekzaminimeve mjekësore, merret në konsideratë moshë më e vogël.</p>
Bullgari	<p>Ligji për Azilin dhe Refugjatët, <i>në fuqi që më datë</i> 01.12.2002 Neni 61, paragrafi 3 (i shtuar — SG 101/ 2015). Në rast se ka dyshime të arsyeshme se i huaji nuk është i mitur ose nën moshën ligjore, autoriteti intervistues do të marrë opinionin e një eksperti për të përcaktuar moshën e personit.</p>
Kroaci	<p>Ligji për Mbrojtjen Ndërkombëtare dhe të Përkohshme (Fletorja Nr. 70/2015)</p>
	<p>Duhet përmendur edhe se, më datë 18 korrik 2013, Gjykata Kushtetuese ka saktësuar se përcaktimi i moshës me synimin për të caktuar një kujdestar është zbatim i ligjit për policinë dhe sigurinë. Shërbimi i Kujdestarisë në asnjë rast nuk mund të përcaktojë pozitën personale të të miturit dhe as mund të marrë vendim për një mosmarrëveshje mbi një të drejtë civile. Sipas Neni 144 të Kushtetutës, vetëm gjykatat kanë kompetencë për këto lloj masash ligjore. Kështu, nëse i mituri dëshiron që emri dhe data e lindjes t’i konfirmohen nga një autoritet (kundrejt Shërbimit të Kujdestarisë dhe autoriteteve të imigracionit), ai duhet të nisë procedurat ligjore përpara gjykatës kompetente, në pajtim me Nenin 46 të Kodit Civil dhe/ose me Nenin 27 të Kodit belg të së Drejtës Ndërkombëtare.</p>
	<p>Nuk ka vendime gjyqësore të tilla.</p>
	<p>E padisponueshme</p>

Legjislacioni dhe jurisprudenca kombëtare	
Qipro	<p>Zbatimi i procesit të vlerësimit të moshës bazohet në dispozitat e mëposhtme ligjore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sipas Nenit 10, paragrafi 1, germa G) të Ligjit për Refugjatët në Qipro, Shërbimi i Azilit mund të përdorë ekzaminimet mjekësore për të përcaktuar moshën e të miturit të pashoqëruar, në kuadrin e shqyrtimit të zbatimit të tij për mbrojtje ndërkombëtare. - Neni 4, paragrafi 3, pikat a), b) të Rezolutës së Këshillit, datë 26 qershor 1997, "Për fëmijët e pashoqëruar nga vendet e treta" parashikon se: "a) personat e pashoqëruar që kanë aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare, të cilët pretendojnë se janë të mitur, duhet të sjellin prova për moshën e tyre, b) në rast se prova të tilla nuk ekzistojnë ose ka ende dyshime serioze, Shtetet Anëtare mund të vlerësojnë objektivisht moshën e personave që kanë aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare. Për këtë qëllim, Shteti Anëtar, me pëlqimin e vetë të miturit ose të përfaqësuesit që i është caktuar, mund ta referojë atë për ekzaminime mjekësore të vlerësimit të moshës, të kryera nga ekipe mjekësore të specializuara".
Republikë Çeke	<p>325/1999 seksioni 89 326/1999 seksioni 124 109/2002 seksioni 23</p> <p>Vendimet gjyqësore janë individuale</p>
Danimarkë	<p>Sipas Ligjit danez për të Huajt (seksioni 40, paragrafi 2), Policia kombëtare dhe Shërbimi i Imigracionit mund të kërkojnë që i huaji i pashoqëruar, i cili pretendon se është i mitur, të marrë pjesë në ekzaminimet mjekësore për të përcaktuar moshën e të huajt.</p> <p>Nuk ka</p>
Estoni	<p>Ligji për ekzaminimet mjekoligjore, miratuar më datë 1 janar 2002 Ligji për dhënien e mbrojtjes ndërkombëtare të huajve, miratuar më datë 1 korrik 2006</p> <p>Nuk ka ende vendime gjyqësore për aspektet e vlerësimit të moshës</p>
Finlandë	<p>Vlerësimi mjekësor i moshës ekziston në Ligjin finlandez për të Huajt që në vitin 2010. Seksioni 6, pika a) thotë se: Vlerësimi mjekësor i moshës mund të kryhet për të përcaktuar moshën e një sponsori ose të një të huaji që aplikon për leje qëndrimi, nëse ka dyshime të arsyeshme për besueshmërinë e informacionit që personi ka dhënë në lidhje me moshën e tij.</p> <p>- Aktualisht në Finlandë nuk ka ndryshime legjislacioni në proces për vlerësimin e moshës.</p> <p>Nuk ka vendime të rëndësishme gjyqësore. Në përgjithësi, rezultatet e vlerësimit të moshës gjykojnë në Gjykatën Administrative, por në disa raste rezultatet janë rrëzuar.</p>

Legjislacioni dhe jurisprudenca kombëtare	
<p>Francë</p> <p>Ligji i datës 14 mars 2016 për mbrojtjen e fëmijës. Tani përdorimi i radiologjisë është i kufizuar dhe vrojtimi i pjekurisë seksuale është i ndaluar për vlerësimin e moshës së personave që deklarohen se janë nën 18 vjeç.</p>	<p>Ligji i datës 14 mars 2016 ka plotësuar Nenin 388 të Kodit Civil. Nuk ka çështje gjyqësore për këtë problematikë që me hyrjen në fuqi të ligjit të ri.</p> <p>Vendimi më i fundit për këtë çështje është ai i Gjykatës së Apelit në Rennes, më 13 janar 2015 (https://www.legifrance.gouv.fr/affichJuriludi.do?oldAction=rechJuriludi&idTexte=JURITEXT000030123464&fastReqId=1477313596&fastP_os=2)</p> <p>Paraqitja e situatës: Personi i interesuar deklaroi se kishte lindur më 26 tetor 1996 në Kinshasa, pra ishte i mitur. Për të vërtetuar identitetin e tij, paraqiti një kopje të certifikatës së lindjes, e nxjerrë më 9 gusht 2012 nga Kryetari i bashkisë së Bumbus (RDK). Procedura për kujdestarinë nisi dhe Presidenti i Këshillit të Përgjithshëm (të departamentit) paraqiti një mocion për të ndaluar mbikëqyrjen.</p> <p>Analiza e dokumenteve doli në përfundimin se dokumentet ishin origjinale, por tërhoqi vëmendjen se certifikata e lindjes bazohej vetëm në deklarinë e thjeshtë me gojë nga prindërit dhe, si e tillë, nuk kishte vlerë për autoritetet gjyqësore. Dokumenti nuk ishte i mjaftueshëm për të përcaktuar moshën për shkak të mungesës së vlerës provuese dhe nuk mund të provonte se i interesuari kishte arritur moshën për të dhënë pëiqimin. Megjithatë, përdorimi i radiografisë (për kyçin dhe dorën e majtë), ekzaminimet klinike dhe analiza e pllakave të rritjes bënë të mundur vlerësimin e moshës.</p> <p>Në të gjitha veprimet përmendet raporti i datës 16 janar 2007 i Akademisë Kombëtare të Mjekësisë, i cili shprehet se ekzaminimi i moshës së kockës me radiografi të kyçit dhe dorës së majtë (e përshkruar në atlasin e Greulich-it dhe Pyle-s), mbetet metoda më e thjeshtë dhe më e besueshme. Kjo metodë përdoret në të gjithë botën. Dihet se deri më sot nuk janë shfaqur dallime raciale. Akademia u shpreh se “është shumë e rrallë që të ketë mospërputhje midis zhvillimit të kockës dhe moshës aktuale, por kur kjo ndodh, moshja reale vlerësohet më e ulët nga sa është për pjesën më të madhe të rasteve”.</p> <p>Të gjitha elementet që iu paraqitën gjykatës për shqyrtim përbënin provë dhe bënë të mundur që të arrihej në përfundimin për moshën e pëliqimit të interesuarit. Vendime të tjera me të njëjtin arsyetim:</p> <p>Gjykata e Apelit Rennes — 28 tetor 2014 https://www.legifrance.gouv.fr/affichJuriludi.do?oldAction=rechJuriludi&idTexte=JURITEXT000029685707&fastReqId=698863264&fastPos=3</p> <p>Gjykata e Apelit Rennes — 28 tetor 2014 https://www.legifrance.gouv.fr/affichJuriludi.do?oldAction=rechJuriludi&idTexte=JURITEXT000029685066&fastReqId=1179022326&fastPos=4</p> <p>Gjykata e Apelit Limoges — 3 mars 2014 https://www.legifrance.gouv.fr/affichJuriludi.do?oldAction=rechJuriludi&idTexte=JURITEXT000028708995&fastReqId=1179022326&fastPos=9</p>

Legjislacioni dhe jurisprudenca kombëtare	
Gjermani	<p>Duhet theksuar se ligji i datës 14 mars 2016 u jep përgjigje pyetjeve të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> – radiografia përdoret si mjet alternativ, kur mungojnë dokumente të vlefshme të identitetit dhe kur moshë e deklaruar nuk është e sigurt – procedura ndiqet nga autoritetet gjyqësore dhe pasi individi ka dhënë pëlqimin e tij – ekzaminimi duhet të përdoret me kujdes (çdo dyshim duhet të shkojë në favor të individit, duke marrë parasysh të dhënat e tjera mjekësore dhe shoqërore) <p>(a) Oberlandesgericht (Gjykata më e lartë rajonale) në Karlsruhe, vendim i datës 26 gusht 2015 — 18 UF 92/15</p> <p>Shënimi hyrës</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Hetimet e mëtejshme që rrjedhin nga detyrimi për hetime kryesisht varen nga dyshimet për moshën e subjektit. Në rast se deklarimi se është i mitur është qartësisht i gabuar ose në rast se subjekti nuk arrin të shpjegojë rrethanat që dëshmojnë moshën e pretenduar me besueshmëri të mjaftueshme, detyrimi për të hetuar kryesisht nuk nënkupton se duhet hetuar “pa bërë dallime”. (Shënimi anësor nr. 25) 2. Edhe pse ekziston parimi i prezumimit të pafajësisë (gjë që do të thotë se subjekti do të konsiderohet nën 18 vjeç në favor të tij), në rast se dyshimet se personi është madhor nuk mund të fshihen tërësisht, ky parim do të zbatohet vetëm nëse gjykata nuk krijon sigurinë e arsyeshme për moshën reale të personit edhe pasi janë shteruar të gjitha mundësitë për hetime të realizueshme dhe të pranueshme nga ana procedurale, në varësi të rrethanave. (Shënimi anësor nr. 33) 3. Në kuadër të detyrimit të subjektit për të bashkëpunuar në përcaktimin e moshës së tij në pajtim me seksionin 27 të Ligjit “Për procedimet në çështjet familjare dhe në çështjet e juridiksionit me natyrë jo gjyqësore”. (Shënimi anësor nr. 24) 4. Për domethënien dhe vlefshmërinë e një ekzaminimi radiografik të skeletit të dorës. (Shënimi anësor nr. 31) (Shënimi anësor nr. 32) <p>Pika të tjera të rëndësishme</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Detyrimi për bashkëpunim, i parashikuar në seksionin 27 të Ligjit “Për procedimet në çështjet familjare dhe në çështjet e juridiksionit me natyrë jo gjyqësore”, zakonisht përfshin nënshkrimin ndaj ekzaminimeve mjekësore për të verifikuar moshën e deklaruar, deri në masën ku ekzaminimi është i arsyeshëm dhe jo poshtëruës (në pajtim me OLG Hamm, datë 25 shkurt 2014, 1 UF 213/13). (Shënimi anësor nr. 24) 2. Ekzaminimi mjekësor i kërkuar për të përcaktuar moshën e mitur të subjektit si parakusht për marrjen e tij nën kujdestari sipas seksionit 42 të Kodit të Sigurimeve Shoqërore VII (seksioni 62, paragrafi 1, i Kodit të Sigurimeve Shoqërore I) mund të jetë ekzaminim radiografik. Leximi i një radiografi ekzistuese për të përcaktuar moshën e subjektit është gjithashtu i pranueshëm (në pajtim me OVG Hamburg, 9 shkurt 2011, 4 Bs 9/11JAmt 2011, 472). (Shënimi anësor nr. 32) 3. Nuk është e mundur të përcaktohet me besueshmëri të plotë nëse individi e ka arritur ose jo moshën madhore vetëm duke u mbështetur te një ekzaminim radiografik të pjekurisë së skeletit të dorës. (Shënimi anësor nr. 31) <p>https://www.juris.de/jpporta/?quelle=jlink&docid=KORE221492015&psml=jurisw.psm1&max=true</p> <p>Seksioni 42, pika f) e Kodit të Sigurimeve Shoqërore VIII përsëritur rregullat për përcaktimin e moshës në procesin e marrjes në ngarkim nga Shërbimet për Mbrojtjen e Rinisë (hyrë në fuqi më datë 1 nëntor 2016)</p> <p>http://www.bgb1.de/xaver/bgb1/start.xav?startbk=Bundesanzeiger_BGB#_bgb1__%2F%2F*%5B%40attr_id%3D%27bgb115s1802.pdf%27%5D__1467628916541</p>

Legjislacioni dhe jurisprudenca kombëtare	—
<p>(b) Gjykata më e Lartë Administrative, Bremen, Vendim i datës 22 shkurt 2016 — 1 B 303/15</p> <p>Pikat më të rëndësishme për këtë pyetësor</p> <ul style="list-style-type: none"> • Moshë e mitur është përkufizuar qartësisht me ligj, kur hyri në fuqi seksioni 42, pika f) e Kodit të Sigurimeve Shoqërore VIII më datë 1 nëntor 2015. • Moshë e mitur duhet të përcaktohet nga dokumentet e identifikimit (ndërmjet të tjerave fotografia duhet të provojë identitetin me besueshmëri të arsyeshme). Në mungesë të dokumenteve të identifikimit, mbeten informacionet e dhëna nga vetë subjekti. Në rast se ky informacion është i dyshimtë, duhet kryer inspektimi i kualifikuar përmjet të vlerësuar dhe përcaktuar moshën (nisur nga pamja e jashtme, duke bërë pyetje nëpërmjet përkthyesit, duke lexuar dokumente të tjera, nëse ka). Gjithmonë mbetet i vlefshëm "parimi i katër syve" të dy pjesëtarëve me përvojë të personelit të zyrës për mbrojtjen e të rinjve. Nëse pas inspektimit përmjet ende dyshime për informacionin e dhënë nga vetë subjekti, por përgjithësisht mund të hamendësohet me probabilitet të arsyeshme se ai është i mitur, kërkesat për të zbatuar ligjin për të miturit konsiderohen të përmbyshura. • Inspektimi i kualifikuar përmjet mund gjithashtu të ketë për rezultat hamendësimin e moshës madhore sepse pamja e jashtme shfaq shenja të qarta se personi është në atë moshë. Po ashtu edhe vlerësimi i informacionit të marrë gjatë intervistës mund të çojë drejt këtij rezultati, nëse deklarimet e subjektit nuk mund të japin prova përfundimtare dhe të besueshme për procesin e zhvillimit. Pohimet e përgjithshme dhe mospërputhjet, së bashku me pamjen e jashtme, mund të çojnë tek i njëjti rezultat (Gjykata më e lartë administrative, Bremen, Vendim i datës 18 nëntor 2015 — 2 B 221/15). • Inspektimi i kualifikuar përmjet që merr parasysh më shumë elemente se thjesht karakteristikat e jashtme fizike, në fakt mund të jetë metodë e përshtatshme për të vlerësuar moshën e personit (Gjykata më e lartë administrative, Mynih, Vendim i datës 23 shtator 2014 — 12 CE 14.1833). • Në rast se inspektimi i kualifikuar përmjet nuk arrin në një rezultat të besueshëm në mënyrë të arsyeshme, duhet të kërkohet ekzaminimi mjekësor. Memorandumi shpjegues për seksionin 42, germa f) e Kodit të Sigurimeve Shoqërore VIII (Botim i Bundestagut 18/6392) detajon kriteret për këtë ekzaminim dhe parashikon se duhet zgjedhur metoda më e butë dhe më e besueshme, brenda kufijve të së mundshmes. • Kjo procedurë me etapa përkon me standardin përkatës teknik (rekomandimet e Grupit të Punës të Shërbimeve Federale për Mbrojtjen e Rinisë), standard të cilit i referohet memorandumit shpjegues për seksionin 42 të Kodit të Sigurimeve Shoqërore VIII. <p>https://www.juris.de/jportal/?quelle=jlink&docid=JURE160008628&psml=jurisw.psm1&max=true</p>	

Legjislacioni dhe jurisprudenca kombëtare	
Greqi	Neni 13, paragrafët 4, 5, 6, 7
Hungari	Ligji LXXX i vitit 2007 për Azilin, Dekreti i Qeverisë 301/2007. (Xi. 9.) për ekzekutimin e Ligjit LXXX të vitit 2007 për Azilin, Ligji XXIX i vitit 2016 për dëshmitarët ekspertë.
Irlandë	<p>Ligji për Refugjatët 1996</p> <p>Seksioni 8, paragrafi 5, germa a), i Ligjit për Refugjatët parashikon se kur një nëpunës i autorizuar i Komisionierit ose një nëpunës i migracionit ka bindjen se personi që ka hyrë në territorin e shtetit është nën 18 vjeç, ky i mitur duhet t'i referohet Agjencisë së Shërbimeve ndaj Fëmijëve & Familjes (TUSLA), e cila më pas vendos nëse do të aplikojë ose jo për azil në emër të ë miturit. Në rast se ky aplikim do të kryhet, Agjencia e Shërbimeve ndaj Fëmijëve & Familjes (TUSLA) bashkë me një përfaqësues nga Shërbimi Ligjor për Refugjatët asistojnë të miturin gjatë të gjithë procesit të azilit, madje edhe duke e shoqëruar atë gjatë intervistës.</p> <p>Ligji për mbrojtjen ndërkombëtare e vitit 2015 (nuk ka hyrë ende në fuqi).</p> <p>Seksioni 14 parashikon, ndër të tjera, se nëse nëpunësit, të përmendur në seksionin 13, i duket se personi që kërkon të aplikojë për mbrojtje ndërkombëtare ose personi që është subjekt i intervistës paraprake është nën 18 vjeç dhe nuk është i shoqëruar nga një person në moshë madhore, i cili ka marrë përgjegjësinë për t'u kujdesur dhe për të mbrojtur të miturin, sa më shpejt të jetë e mundur, nëpunësi duhet të njoftojë Agjencinë e Shërbimeve ndaj Fëmijëve & Familjes për këtë fakt.</p> <p>Seksioni 15, paragrafi 4, parashikon se kur Agjencia e Shërbimeve ndaj Fëmijëve & Familjes gjykon, bazuar në informacionet dhe këshillat ligjore që ka në dispozicion, se duhet bërë aplikim për mbrojtje ndërkombëtare në emër të një personi që nuk e ka arritur moshën 18 vjeç (në këtë nënseksion përmendet me emrin "i mitur"), të cilin Agjencia e ka nën kujdesin dhe mbrojtjen e saj, ajo duhet të caktojë një punonjës të saj ose një person të tretë të zgjedhur prej saj për ta bërë këtë aplikim në emër të fëmijës, për ta përfaqësuar dhe për të asistuar fëmijën gjatë shqyrtimit të aplikimit.</p> <p>Seksioni 24, paragrafi 1, parashikon se Ministri ose një nëpunës i shërbimit të mbrojtjes ndërkombëtare, nëse konsideron në mënyrë të arsyeshme se duhet kryer, për të përcaktuar nëse azilkërkuesi i përmendur në seksionin 15, paragrafi 4, nuk e ka arritur moshën 18 vjeç, mund të organizojë ekzaminimet për të përcaktuar moshën e azilkërkuetit, në pajtim me këtë seksion.</p>
	<p>Nuk ka</p> <p>AM kundër Komisionierit të Aplikimeve për Azil Azilkërkuesi/Paditësi: A.M. I padituri: Komisionieri i Aplikimeve për Azil Dokumenti i cituar: [2005] IEHC 317 URL: http://www.courts.ie/judgments.nsf/0/2BF9FBFDC5B14F8802571030053653E</p> <p>Një azilkërkuet pretendonte të ishte i mitur në momentin e aplikimit për azil. Komisionieri i Aplikimeve për Azil e mori në intervistë për të vlerësuar moshën dhe doli në përfundimin se personi ishte mbi 18 vjeç. Më pas, azilkërkuesi u trajtua si i rritur nga komisionieri dhe brenda afateve u njoftua se kërkesa e tij për azil ishte refuzuar. Azilkërkuesi ankimoi vlerësimin e moshës, por edhe vendimin për t'i refuzuar statusin e refugjatit.</p> <p>Gjykata e rrëzoi vendimin e vlerësimit të moshës së azilkërkuetit dhe çmoi se procedura e vlerësimit të moshës duhet të përmbushë kushtet minimale të mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. azilkërkuesi duhet të njoftohet, me fjalë të thjeshta, për qëllimin e intervistës; 2. azilkërkuesi ka të drejtën që t'i thuhet me fjalë të thjeshta arsyeja ose motivet sipas të cilave intervistuesi konsideron të pasaktë moshën e deklaruar dhe t'i jepet mundësia të shpjegohet për këtë çështje; 3. azilkërkuesi ka të drejtën të vihet në dijeni për rezervat që mund të ketë intervistuesi kundrejt dokumenteve të identitetit dhe t'i jepet mundësia të shpjegohet për këtë çështje; 4. në rast se vendimi është në kundërshtim me aplikimin e azilkërkuetit, ai duhet të njoftohet në mënyrë të qartë dhe të menjëhershme për vendimin dhe arsyet e tij; dhe 5. mundësia dhe procedura e rivlerësimit i komunikohen me gojë dhe me shkrim.

Legjislacioni dhe jurisprudenca kombëtare	
<p>Seksioni 24, paragrafi 2 parashikon se ekzaminimi sipas nënseksionit 1:</p> <p>(a) duhet të kryhet në respekt të plotë të dinjitetit të azilkërkuetit,</p> <p>(b) duhet t'i përgjigjet nevojës për të arritur një rezultat të besueshëm, të jetë sa më pak invaziv, dhe</p> <p>(c) në rastin e ekzaminimeve mjekësore, ato duhet të kryhen nga mjekë të licencuar ose nga profesionistë të tjerë mjekësorë të kualifikuar, sipas kërkesës.</p> <p>Seksioni 24, paragrafi 7, parashikon se shkaku i arsyeshëm mund të lindë nga deklaramë të përgjithshme ose të dhëna të tjera të cilat nxisin dyshime për moshën e azilkërkuetit.</p> <p>Seksioni 24, paragrafi 3, parashikon se pëiqimi për ekzaminimin mjekësor duhet të merret nga: (a) azilkërkueti, (b) nga i rrituri përgjegjës për t'u kujdesur dhe për ta mbrojtur azilkërkuetin ose (c) nga nëpunësi ose personi tjetër i caktuar nga Agjencia e Shërbimeve ndaj Fëmijëve dhe Familjes e cila ka bërë aplikimin për mbrojtje ndërkombëtare në emër të ë miturit.</p> <p>Seksioni 24, paragrafi 4, përcakton se i mituri duhet të njoftohet në gjuhën që ka arsye të mendohet se ai kupton, për elementet e mëposhtme:</p> <p>(a) për mundësinë që moshë e tij të përcaktohet me anë të ekzaminimeve, (b) për metodën ose metodat e ekzaminimit,</p> <p>(c) për pasojat e mundshme të rezulttit të ekzaminimit në procedurat e aplikimit për mbrojtje ndërkombëtare, dhe</p> <p>(d) pasojat e refuzimit nga ana e fëmijës për t'iu nënshtruar ekzaminimit.</p> <p>Pasojat e refuzimit për t'iu nënshtruar ekzaminimit janë specifikuar në seksionin 24, paragrafi 5, ku konkretisht ministri ose nëpunësi i mbrojtjes ndërkombëtare mund të procedojë me vlerësimin e moshës së azilkërkuetit për të përcaktuar nëse ai e ka arritur ose jo moshën 18 vjeç.</p> <p>Seksioni 25 përmban dispozitat specifike, të ngjashme me ato të seksionit 24, për ekzaminimin mjekësor të personave në paraburgim, moshë e të cilëve është e dyshuar.</p> <p>Ndër të tjera, seksioni 25 parashikon se për qëllimet e gurmës b) te seksionit 20, paragrafi 7, ministri mund të marrë masat për kryerjen e ekzaminimit për përcaktimin e moshës së një personi.</p>	<p>Gjykata çmoi se këto kërkesa nuk ishin përmbushur në këtë çështje.</p> <p>Parimet: Kërkesat minimale procedurale për vlerësimin e moshës së të miturve në procesin e azilit janë si në vijim: (i) azilkërkueti duhet të njoftohet, me fjalë të thjeshta, për qëllimin e intervistës; (ii) azilkërkueti ka të drejtën që t'i thuhet me fjalë të thjeshta arsyeja ose motivet pse intervistuesi konsideron të pasaktë moshën e deklaruar dhe t'i jepet mundësia të shpjegohet për këtë çështje; (iii) azilkërkueti ka të drejtë të vihet në dijeni për rezervat që mund të ketë intervistuesi kundrejt dokumenteve të identitetit dhe t'i jepet mundësia të shpjegohet për këtë çështje; (iv) në rast se vendimi është në kundërshtim me aplikimin e azilkërkuetit, ai duhet të njoftohet në mënyrë të qartë dhe të menjëhershme për vendimin dhe arsyet e tij; dhe (v) mundësia dhe procedura e rivlerësimit i komunikohen me gojë dhe me shkrim.</p>

Legjislacioni dhe jurisprudenca kombëtare	
Itali	<p>Dekreti legjislativ Nr. 142/2015, Nenet 17-18-19 (transpozim i Rregullores së BE-së 2013/33)</p> <p>Dekret (në proces shqyrtimi nga Këshilli i Ministrave): ‘regolamento recante definizione dei meccanismi per la determinazione dell’età dei minori stranieri non accompagnati vittime di tratta, in attuazione dell’art. 4, comma 2, del decreto legislativo 4 marzo 2014, n. 24’.</p> <p>Art. 8, DPR 22.9.1988, n. 448 (nei processi penali, in caso di incertezza sulla minore età il giudice dispone, anche d’ufficio, una perizia) Art. 28, co. 3, D.Lgs. 286/98 (interesa më të larta të fëmijës) Art. 19, co. 2, lett. a), D.Lgs. 286/98 (divieto espulsione minori stranieri) Art. 19, D.Lgs. 25/2008 që transponon Direktivën BE 2005/85 (vlerësimi i moshës mund të ndodhë në çdo moment të procedurës). L’art. 4, co. 2, D.Lgs. 4.3.2014, n. 24, që transponon Direktivën BE 2011/36 (e cila përcakton procedurën globale për vlerësimin e moshës; në rast dyshimi supozohet se personi është i mitur).</p> <p>Në vitin 2017 u miratua një dekret i ri ku përskruhet procedura që duhet ndjekur për vlerësimin e moshës së të miturve të pashoqëruar, të dyshuar se janë viktime të trafikimit http://www.gazzettaufficiale.it/eli/16/2016/12/22/16G00248/sg</p>
Letoni	<p>Më 19 janar 2016, në Letoni hyri në fuqi Ligji i ri për Azilin. Sipas dispozitave të Ligjit për Azilin, Roja e Kufirit Shtetëror të Letonisë është përgjegjëse për pranimin e aplikimeve të azilkerkuesve dhe për kryerjen e aktiviteteve fillestare të lidhura me to, ku përfshihet edhe përcaktimi i identitetit të azilkerkuesit.</p> <p>Pjesa 2 e Seksionit 7 të Ligjit për Azilin parashikon se Roja e Kufirit Shtetëror, për qëllime të identifikimit dhe të vërtetimit të kombësisë së azilkerkuesit, ka të drejtë të kontrollojë azilkerkuesin dhe sendet e tij dhe të sekuestrojë objekte dhe dokumente, nëse ato mund të kenë peshë në shqyrtimin e aplikimit ose nëse mund të përbëjnë kërcënim për azilkerkuesin ose personat rreth tij.</p> <p>Pasi përcakton nevojën për ekzaminim mjekësor të kryer nga një specialist, Roja e Kufirit Shtetëror njofton të miturin e pashoqëruar pa vonesë dhe në praninë e përfaqësuesit, në një gjuhë që ai e kupton ose ka arsye për të menduar se e kupton, për mundësinë që moshë e tij të përcaktohet nga një ekzaminim mjekësor të kryer nga një specialist. Azilkerkuesi duhet të njoftohet edhe për zhvillimin e këtij ekzaminimi, për ndikimin e mundshëm të rezultateve të ekzaminimit mjekësor në shqyrtimin e aplikimit dhe për pasojat që mund të ndodhin nëse përfaqësuesi i të miturit të pashoqëruar refuzon ekzaminimin mjekësor.</p> <p>Nëse gjatë procedurës së vlerësimit të moshës, moshë e personit të ekzaminuar nuk përcaktohet me siguri të plotë, vendimi përfundimtar merret në favor të personit nën ekzaminim duke e konsideruar të mitur.</p>
	<p>27.01.2014 Gjykata e Torinos: vlerësimi radiologjik nuk mund të përfshijet, në raste individuale, marzhin e gabimit në vlerësimin e moshës. Në rast dyshimi, mbizotëron mosha e mitur http://www.questionegiustizia.it/articolo/i-metodi-di-accertamento-dell-etacronologica-dei_05-03-2015.php</p>
	<p>Sipas Seksionit 182 të Ligjit të Procedurës Administrative “Vlerësimi i mendimit të ekspertit”, gjykata duhet të vlerësojë mendimin e ekspertit në pajtim me dispozitat e Seksionit Nr.154 të këtij ligji “Shqyrtimi i provave”. Seksioni Nr. 154 parashikon se gjykata duhet të shqyrtojë provat në pajtim me bindjen e saj, e cila duhet të krijohet në fakte të provuara dhe të verifikuara tërësisht dhe objektivisht dhe në pajtim me ndërgjegjen gjyqësore të bazuar në ligjet e logjikës, në zbulimet shkencore dhe në parimet e drejtësisë. Asnjë provë nuk mund të ketë efekte kaq paracaktuese sa të krijojë detyrime për gjykatën; vendimi i gjykatës duhet të shprehet përse janë preferuar disa prova krahasuar me të tjera dhe përse disa fakte janë konsideruar si të vërtetuara, ndërsa faktet e tjera jo.</p> <p>Nëse mendimi i ekspertit nuk është aq i qartë ose është i paplotë, gjykata mund të urdhërojë ekzaminime shtesë të kryera nga ekspertë, duke ia caktuar kryerjen e tyre po të njëjtit ekspert.</p> <p>Në rast se mendimi i ekspertit nuk është i justifikuar ose i motivuar, apo mendimet e disa ekspertëve kundërshtojnë njëri-tjetrin, gjykata mund të urdhërojë përsëritjen e ekzaminimeve, duke ia caktuar kryerjen e tyre një ekspertit tjetër ose disa ekspertëve.</p>

Legjislacioni dhe jurisprudenca kombëtare	
	<p>Fakti që përfaqëuesi i një të mituri të pashoqëruar ka refuzuar ekzaminimin mjekësor për përcaktimin e moshës së personit, nuk mund të jetë arsyeja e vetme për ta lënë pa shqyrtim aplikimin e të miturit të pashoqëruar ose për të refuzuar dhënien e statusit të refugjatit ose një status alternativ. Sipas Nenit 3 të Rregullores Nr. 776 të Kabinetit të Ministrave të Letonisë, datë 7 shtator 2004, "Rregullorja e Qendrës Shtetërore të Mjekësisë Ligjore", Roja e Kufijve Shtetërorë ia dërgon Qendrës Shtetërore të Mjekësisë Ligjore kërkesën për ekzaminim mjekësor për të vlerësuar moshën e personit. Kjo Qendër kryen vlerësimin duke përdorur metodologjinë e regjistruar sipas ligjeve dhe rregullave ("Metodologjia e vlerësimit të moshës" Nr. 2-20/VTMEC-1/336, miratuar më 07.02.2013).</p> <p>Neni 11 i Rregullores së Brendshme të Rojës së Kufirit Shtetëror Nr.1, datë 16.01.2015, " Rregullore për aktivitetet e funksionarëve të Rojës së Kufirit Shtetëror në rastet kur një i huaj kërkon azil" parashikon se në rastet kur azilkërkuesi është subjekt ekzaminimi për vlerësimin e moshës, mendimi i ekspertit do t'i dërgohet gjykatës për të çmuar sipas Seksionit 182 të Ligjit të Procedurës Administrative.</p>
Lituani	<p>Ligji për statusin ligjor të të huajve, Neni 123 dhe Urdhri i Ministrit të Punëve të Brendshme të Republikës së Lituanisë për dhënien dhe tërheqjen e azilit në Republikën e Lituanisë, Seksioni 2 (paragrafët 104-114)</p>
Luksemburg	<p>Sipas Nenit 12, paragrafi 3, të Ligjit për azilin dhe format e tjera të mbrojtjes, i ndryshuar, i datës 5 maj 2006, Ministri mund të urdhërojë ekzaminimin mjekësor për të përcaktuar moshën e azilkërkuetit. Duhet thënë se përcaktimi i moshës ndikon në procedurën për dhënien e mbrojtjes ndërkombëtare. Në këtë aspekt, i referohemi Neni 9, paragrafi 2, të ligjit të lartpërmendur, i cili thotë se çdo azilkërkuet ka për detyrë të komunikojë të gjithë informacionin e nevojshëm për identifikimin e legjitimitetit të aplikimit të tij, duke përfshirë dhe moshën. Në rast se azilkërkuet refuzon t'i nënshtrohet ekzaminimit mjekësor, nuk paraqitet ose rezulton se është madhor, ai do të njoftohet se këto rrethana do të kenë ndikim negativ në vendimmarrjen e lidhur me aplikimin për mbrojtje ndërkombëtare. Në këtë rast, aplikimi për mbrojtje ndërkombëtare mund të përpunohet me procedurë të përshpejtuar siç parashikon Neni 20 i ligjit të lartpërmendur. Nga ky moment, azilkërkuet do të konsiderohet madhor për sa i takon aplikimit të tij. Refuzimi për t'iu nënshtuar ekzaminimit mjekësor nuk e pengon ministrin që të marrë vendim për aplikimin për mbrojtje ndërkombëtare. Gjithsesi, vendimi i Ministrit nuk do të mbështetet vetëm te ky refuzim.</p>
	<p>Gjykatat nuk kanë nxjerrë vendime për vlerësimin e moshës.</p>
	<p>E padisponueshme</p>

Legjislacioni dhe jurisprudenca kombëtare	
Maltë	Opinionii juridik 243, viti 2008 Opinionii juridik 320, vittit 2005, Neni 14
Holandë	Dispozitat janë parashikuar në dekretin për të huajt ("vreemdelingenbesluit") Neni 3.109d, hyrë në fuqi më datë 20 korrik 2015.
Norvegji:	Ligji për imigracionin, Seksioni 88 për vlerësimin e moshës Në rastet ku, në çështjet e lidhura me azilin ose me lejet e qëndrimit për një pjesëtar të familjes, nuk është e mundur të vërtetohet me siguri nëse shtetasi i huaj është mbi apo nën 18 vjeç, këtij shtetasi mund t'i kërkohet që të japë pëlqimin për t'u ekzaminuar me qëllim vlerësimin e moshës. Rezultati i ekzaminimit duhet të vlerësohet në raport me informacionet e tjera në dosje. Në rast se shtetasi i huaj refuzon ta japë pëlqimin për t'u ekzaminuar, atij do t'i bëhet me dije se kjo mund të ketë peshë në vlerësimin e aplikimit. Mbreti mundet që, sipas rregullores, të nxjerrë dispozita të tjera për zbatimin e ekzaminimeve të moshës.
Poloni	Ligji i datës 13 qershor 2003 për dhënien e mbrojtjes për të huajt brenda territorit të Republikës së Polonisë. Nuk ka ndryshime në legjislacion për procesin e vlerëimit të moshës.
Portugali	Ligji Nr. 27/2008, datë 30.06.2008 për Azilin, Neni 28 n.3 Ligji Nr. 67/98 26.10.1998 për mbrojtjen e të dhënave personale Ligji Nr. 45 /2004, datë 19 gusht 2004, përcakton regjimin ligjor të mjekësisë ligjore
	E padisponueshme
	23 tetor 2003, ABR 200304904/1 Ministri duhet të sigurojë që vlerësimi të kryhet me besueshmëri dhe kujdes, në mënyrë që ai të justifikojë konkluzionet. Ministri ka për detyrë të thërrasë një ekspert me njohuritë e kërkuara. Për t'u siguruar se vlerësimi është kryer me besueshmëri dhe është i plotë, Ministri duhet të marrë një raport gjithëpërfshirës për të cilin mban përgjegjësi eksperti, edhe nëse eksperti nuk dëshiron që emri i tij të bëhet publik. 3 mars 2004, ABR 200307415/1 Raporti për vlerësimin e moshës konsiderohet si opinionion ekspertësh. Argumenti që radiografia konvencionale nuk mund të përdoret për të nxjerrë imazh të qartë të klavikulës rrëzohet. Metoda kërkimore e përdorur në vlerësim është e besueshme. Nuk ka
	Ligji i 13 qershorit 2003 për dhënien e mbrojtjes për të huajt brenda territorit të Republikës së Polonisë. Nuk ka ndryshime në legjislacion për procesin e vlerëimit të moshës. E padisponueshme

Legjislacioni dhe jurisprudenca kombëtare	
Nuk ka	<p>Rumani</p> <p>Ligji Nr. 122/2006 për azilin në Rumani (botuar në Gazetën Zyrtare Nr. 428/18.05.2006, hyrë në fuqi më datë 16 gusht 2006) parashikon si më poshtë:</p> <p>Neni 16 “ Garancitë për azilërkuesit e mitur të pashoqëruar”</p> <p>(1) Aplikimi për azil i një të mituri të pashoqëruar duhet të shqyrtohet me përparësi.</p> <p>(2) Inspektorati i Përgjithshëm i Imigracionit merr masat që brenda një afati sa më të shkurtër të caktohet një përfaqësues ligjor, i cili duhet të asistojë të miturin e pashoqëruar azilërkues gjatë procedurës së azilit, ku përfshihet edhe procedura e vendit të parë të azilit, ajo e vendit të tretë të sigurt, procedura e vendit të tretë evropian të sigurt ose procedura për përcaktimin e Shtetit Anëtar përgjegjës, sipas rastit.</p> <p>(21) I mituri i pashoqëruar njoftohet menjëherë për caktimin e kujdestarit ligjor. Kujdestari ligjor përmbush detyrat e tij në pajtim me interesat më të larta të fëmijës dhe ka ekspertizën e nevojshme për përmbushjen e këtyre detyrave.</p> <p>(3) Nuk është e nevojshme që azilërkuesit të mitur e të pashoqëruar t’i caktohet një përfaqësues ligjor, në rast se azilërkuesi arrin moshën madhore brenda 15 ditëve nga data e dorëzimit të aplikimit.</p> <p>(4) Inspektorati i Përgjithshëm i Imigracionit:</p> <p>(a) siguron që përfaqësuesit ligjor t’i jepet mundësia të njoftojë të miturin e pashoqëruar për domethënien dhe pasojat e mundshme të intervistës personale dhe si të përgatitet për këtë intervistë.</p> <p>(b) njofton të miturin dhe përfaqësuesin ligjor për procedurat ligjore të njoftimit të përmendura në Nenin 17 (Të drejtat e azilërkuesit) dhe për procedurat në rast tërheqjeje të mbrojtjes ndërkombëtare.</p> <p>(c) njofton përfaqësuesin ligjor dhe të miturin (në një gjuhë që ky i fundit e kupton ose ka arsye të mendohet se e kupton), për mundësinë e kryerjes së ekzaminimit për vlerësimin e moshës të kryer nga ekspertë të mjekësisë ligjore. Ky informacion duhet të përmbajë të dhëna për metodat e ekzaminimit mjekësor, për pasojat e mundshme të rezultateve të këtij ekzaminimi dhe pasojat e refuzimit potencial për t’iu nënshtruar ekzaminimit mjekoligjor.</p>

	Legjislacioni dhe jurisprudenca kombëtare
	<p>(4) Ekzaminimi mjekoligjor për vlerësimin e moshës kryhet në respekt të plotë të dinjitetit individual të të miturit, duke përdorur metodën më pak invazive të mundshme, çka jep rezultate të besueshme për aq sa është e mundur.</p> <p>(5) Për zbatimin e dispozitave të këtij neni, Inspektorati i Përgjithshëm për Imigracionin duhet të bashkëpunojë me strukturat e administratave publike vendore që kanë për detyrë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, për të sqaruar situatën ligjore të të miturit ose në rast se atij i është dhënë një masë e veçantë mbrojtjeje.</p> <p>Neni 41 “Përcaktimi i moshës së azilërkuesit të mitur të huaj”</p> <p>(1) Në rast se azilërkuesi deklaron se është i mitur dhe nuk ka dyshime serioze për moshën e tij, atëherë ai duhet të konsiderohet i mitur.</p> <p>(2) Në rast se i mituri i pashoqëruar nuk mund të provojë moshën e tij dhe ka dyshime serioze nëse është vërtet i mitur, struktura e specializuar për çështjet e azilit në Inspektoratin e Përgjithshëm për Imigracionin, para se të merret vendimi për aplikimin për azil në fazën administrative, kërkon që të kryhet ekzaminimi mjekoligjor i moshës së azilërkuesit, duke marrë parapikësit pëlqimin e dhënë me shkrim nga i mituri dhe përfaqësuesi i tij ligjor.</p> <p>(3) Në rast se azilërkuesi dhe/ose përfaqësuesi i tij ligjor refuzojnë kryerjen e ekspertizës mjekoligjore për të vlerësuar moshën dhe nuk paraqet prova bindëse për moshën e tij, ai duhet të konsiderohet madhor.</p> <p>(4) Në rastin e parashikuar në paragrafin 3, do të konsiderohet se personi ka arritur moshën 18 vjeç në datën që ka dorëzuar aplikimin për azil.</p> <p>(5) Dispozitat e paragrafit 3 nuk zbatohen në rastet ku ka pasur arsye të bazuara për të refuzuar ekzaminimin mjekoligjor, arsye të zbuluara pas vlerësimit të një psikologu brenda Inspektoratit të Përgjithshëm për Imigracionin.</p> <p>(6) Interpretimi i rezultatit të ekzaminimit mjekoligjor për vlerësimin e moshës së azilërkuesit bëhet duke pasur parasysh parimin e interesave më të larta të të miturit.</p> <p>(7) Refuzimi i të miturit të pashoqëruar për t’iu nënshtruar ekzaminimit mjekoligjor për vlerësimin e moshës nuk mund të përbëjë arsyen e vetme të rrëzimit të aplikimit të tij për azil dhe nuk i pengon autoritetet kompetente të nxjerrin vendimin mbi aplikimin e tij për mbrojtje ndërkombëtare.</p>

Legjislacioni dhe jurisprudenca kombëtare	
	<p>Neni 49 "Ekzaminimi mjekoligjor"</p> <p>(1) Kur konsiderohet e dobishme për t'i dhënë përgjigje aplikimit për mbrojtje ndërkombëtare të azilërkuesit dhe nëse ky i fundit jep pëiqimin, azilërkuesit do t'i nënshtrohet ekzaminimit mjekoligjor për të zbuluar shenja të ekspozimit ndaj përndjekjes ose rrezikut serioz në të shkuarën.</p> <p>(2) Refuzimi i azilërkuesit për t'iu nënshtruar ekzaminimit mjekoligjor, i parashikuar në paragrafin 1, nuk e pengon Inspektoratin e Përgjithshëm për Imigracionin që të marrë vendim mbi aplikimin për azil.</p> <p>(3) Ekzaminimi mjekoligjor i parashikuar në paragrafin 1 kryhet nga institucionet mjekoligjore dhe rezultati i tij i transmetohet menjëherë Inspektoratit të Përgjithshëm për Imigracionin. Pagesën e shpenzimeve e siguron Ministria e Brendshme nga buxheti i akorduar Inspektoratit të Përgjithshëm për Imigracionin për këtë qëllim.</p> <p>(4) Kur ekzaminimi mjekoligjor nuk kryhet në pajtim me paragrafin 1, Inspektorati i Përgjithshëm për Imigracionin njofton azilërkuesin me shkrim se mund ta kryejë këtë ekzaminim me shpenzimet e veta për të zbuluar shenja që në të shkuarën ka qenë ekspozuar ndaj përndjekjes ose rrezikut serioz.</p> <p>(5) Inspektorati i Përgjithshëm për Imigracionin merr në konsideratë rezultatit e ekzaminimit mjekoligjor, parashikuar në paragrafët 1 dhe 4, bashkë me elemente të tjera kur duhet të marrë vendim mbi aplikimin për mbrojtje ndërkombëtare.</p> <p>Nuk ka ndryshime legjislacioni në proces për vlerësimin e moshës.</p>

Legjislacioni dhe jurisprudenca kombëtare	
Slovaki	<p>Ligji për Azilin 480/2002 Coll, i ndryshuar, Seksioni 23, paragrafi 7</p> <p>Në rast se ministria ka dyshime për moshën e azilkërkuetit, ky është i detyruar t'i nënshtrohet ekzaminimit mjekësor; për të huajt që përmbushin kushtet e Seksionit 16, paragrafi 2, duhet marrë pëlqimi i përfaqësuesit ligjor ose kujdestarit. Në rast se ekzaminimi mjekësor përcakton se moshë e azilkërkuetit është madhore, ministria duhet ta trajtojë si të rritur dhe njofton pa vonesë përfaqësuesin ligjor ose kujdestarin dhe gjykatën kompetente për rezultatit e ekzaminimit mjekësor. Në rast se i huaji refuzon t'i nënshtrohet ekzaminimit mjekësor ose nëse përfaqësuesi ligjor apo kujdestari nuk bie dakord me këtë ekzaminim, në pajtim me këtë ligj, i huaji do të konsiderohet person në moshë madhore për qëllimet e procedurës. Në rast se vlerësimi mjekësor nuk arrin të përcaktojë nëse personi është i mitur apo madhor, sipas këtij Ligji, personi do të konsiderohet i mitur për qëllimet e procedurës së azilit. Përfaqësuesi ligjor dhe kujdestari njoftojnë pa vonesë azilkërkuetin për këtë. Sipas udhëzimit të parashikuar në Seksionin 4, paragrafi 2, ministria do të njoftojë azilkërkuetin për mundësinë e kryerjes së ekzaminimit mjekësor për të përcaktuar moshën e tij, për mënyrën e kryerjes dhe për pasojat e ekzaminimit në kuadrin e shqyrtimit të aplikimit për azil si dhe për pasojat e refuzimit të ekzaminimit.</p> <p>* Seksioni 4, paragrafi 2: Para se të plotësohet pyetësori, por jo më vonë se 15 ditë pas fillimit të procedurës, punonjësi i autorizuar i ministrisë duhet të udhëzojë azilkërkuetin për të drejtat dhe detyrimet e tij gjatë procedurës së azilit, për pasojat e mundshme të mospërbushjes ose shkeljes së detyrimeve të tij sipas këtij Ligji, për mundësinë për t'u përfaqësuar gjatë procedurës së azilit dhe për ofrimin e ndihmës juridike. Ministria duhet edhe ta informojë azilkërkuetin për organizata jo-fitimprurëse që kujdesen për azilkërkuetit dhe personat të cilëve u është dhënë azili; nëse është e mundur, udhëzimet dhe informacionet duhet të jepen me shkrim dhe në gjuhën të cilën mendohet se azilkërkueti e kupton.</p> <p>* Seksioni 16, paragrafi 2: aktet ligjore në emër të të huajit që nuk ka arritur moshën madhore, duhet të kryhen nga përfaqësuesi i tij ligjor. Nëse ky i huaj qëndron në territorin e Republikës së Sllovakisë pa përfaqësues ligjor, gjykata i cakton atij një kujdestar</p>
Sloveni	<p>Ligji për Mbrojtjen Ndërkombëtare (ZMZ-1), miratuar në vitin 2016</p>
	Nuk ka

Legjislacioni dhe jurisprudenca kombëtare	
Spanjë	<p>Kushtetuta e Spanjës 1978</p> <p>Ligji spanjoll 2/2009, datë 11 dhjetor 2009, i cili ka ndryshuar ligjin organik 4/2000 për të drejtat dhe detyrimet e të huajve në Spanjë dhe integrimin e tyre shoqëror.</p> <p>Dekreti mbretëror 557/2011, 20 prill 2011, i cili miraton rregulloren që zhvillon ligjin organik 4/2000 për të drejtat dhe detyrimet e të huajve në Spanjë dhe integrimin e tyre shoqëror, pas reformës së tij të bërë nga ligji organik 2/2009.</p> <p>Ligji spanjoll për mbrojtjen gjyqësore të të miturve 1/1996, datë 15 janar 1996, i cili reformon pjesërisht Rregullat e Ligjit të Procedurës Civile.</p> <p>Kodi Civil</p>
Suedi	<p>Aplikimet për azil vlerësohen sipas Ligjit për të Huajt të vitit 2005 (SFS 2005:716). Ligji bën dallimin midis procedurës për të rriturit dhe fëmijët. Shumë rregullore janë më të favorshme për fëmijët. Prandaj, vlerësimi i moshës është i nevojshëm si pjesë e rëndësishme e shqyrtimit të aplikimeve për azil sipas këtij ligji.</p> <p>Më 20 korrik 2016 hyri në fuqi një ligj i përkohshëm i cili zëvendësoi disa pjesë të Ligjit për të Huajt për një periudhë 3 vjeçare, deri më 19 korrik 2019. Qëllimi i ligjit të përkohshëm është të kufizojë mundësinë e marrjes së lejes së qëndrimit në Suedi. Sipas këtij ligji, ndër të tjera, refugjatëve dhe atyre që kanë nevojë për mbrojtje plotësuese u jepet vetëm leje e përkohshme qëndrimi. Ligji nuk zbatohet për të miturit dhe familjet me fëmijë që kanë aplikuar për azil para datës 24 nëntor 2015.</p> <p>Më datë 1 maj 2017, hyjnë në fuqi ndryshimet në Ligjin për të Huajt dhe në Urdhri për të Huajt, të cilat rregullojnë vlerësimin e moshës në rastet kur personi ka aplikuar për azil pas datës 1 shkurt 2017. Sipas dispozitave të reja, Agjencia Suedeze e Migracionit do të kryejë vlerësimin në ato raste ku personi deklaron se është nën 18 vjeç dhe ka arsye për ta vënë në dyshim këtë deklaram. Ky vlerësim i moshës duhet të kryhet që në fazat e hershme të procesit të azilit. Agjencia do të marrë një vendim të përkohshëm për moshën. Ky vendim mund të ankimohet dhe merret veçmas vendimit përfundimtar për lejen e qëndrimit. Tani ligji parashikon se azilërkuesve që nuk kanë paraqitur prova të mjaftueshme për të provuar moshën e tyre të mitur, duhet t'u jepet mundësia për t'u nënshtruar vlerësimit mjekësor të moshës. Kjo mund të bëhet vetëm nëse azilërkuesi ka dhënë pëlqimin e tij me shkrim. Vlerësimi mjekësor i moshës kryhet para se të merret vendimi i përkohshëm. Në fund Agjencia do të marrë vendimin për moshën e azilërkuesit në raport me vendimin përfundimtar për lejen e qëndrimit.</p>
	<p>Urdhri i gjykatës “Audencia Provincial de Madrid” (Seksioni 22), datë 2 shkurt 2012, për kriteret e vlerësimit të moshës. Urdhri gjykon se Komisioni për Mbrojtjen e të Miturve të Rajonit të Madridit ka konsideruar vlerësimin mjekësor të moshës si të vetmen provë dhe ky vlerësim nuk nxjerr kurrë rezultate të sakta. Prandaj, nevojiten më shumë prova për të përcaktuar moshën e të miturit.</p> <p>Vendimi më i fundit dhe domethënës për jurisprudencën në fushën e vlerësimit të moshës është vendimi i Gjykatës së Lartë të Migracionit, datë 11 shkurt 2014 (MIG 2014:1) ku gjykata thekson, ndër të tjera, se barra e provës bie mbi azilërkuesin për të vërtetuar moshën e deklaruar dhe se Agjencia e Migracionit nuk ka detyrimin të ofrojë ekzaminim mjekësor, por vetëm të njoftojë për mundësinë e kryerjes së këtij ekzaminimi.</p> <p>Për këtë vendim nuk është gjetur asnjë lidhje në internet, por vendimi mund të gjendet në faqen e internetit të Gjykatës Administrative (vetëm në gjuhën suedeze) http://www.rattsinfosok.dom.se/lagrummet/index.jsp</p>

Legjislacioni dhe jurisprudenca kombëtare	
	<p>Për rastet ku personi ka aplikuar për azil para datës 1 shkurt 2017 nuk ka ligj specifik vendas që të ketë për objekt rregullimin e vlerësimit të moshës ose kohën se kur duhet kryer ky vlerësim gjatë procesit të azilit. Kemi të bëjmë kryesisht me një vlerësim të provave që respekton parimet e përgjithshme të së drejtës, të barrës së provës etj. Më në fund, vlerësimi i moshës kryhet kur agjencia merr vendimin përfundimtar për lejen e qëndrimit, i cili mund të ankimohej.</p> <p>Suedia zbaton vlerësimin e lirë të provave, që do të thotë se nuk ka rregulla të paracaktuara për vlerën që ka një lloj prove dhe se nuk ka rregulla për llojin e provës që duhet paraqitur për të vërtetuar moshën (sigurisht brenda të arsyeshme). Përveç kësaj, duhet thënë se nuk ka përkufizim ligjor të identitetit (ku të përfshihet moshë e personit) në legjislacionin e brendshëm në Suedi. Ky nocion është përkufizuar vetëm me vendime gjyqësore.</p>
Zvicër	Neni 7, 8 dhe 17 paragrafi 3bis i Ligjit federal për azilin (LAsi).
Mbretëria e Bashkuar	<p>Mbretëria e Bashkuar nuk ka legjislacion të drejtpërdrejtë që të parashikojë kur kërkohet apo është i nevojshëm vlerësimi i moshës ose si duhet kryer ky vlerësim.</p> <p>Nëpunësve të imigracionit në kufi u lejohej të bëjnë një vlerësim fillestar kur hasin një të ri të pashoqëruar për herë të parë. Ky vlerësim bazohet te deklaratimet e individit, te dokumentet që disponon dhe te vlerësimet e vetë nëpunësit të imigracionit për pamjen fizike dhe sjelljen e të riut. Ky vlerësim nuk është ligjor i detyrueshëm sepse mund të vihet në diskutim ose të kundërshtohet nga i interesuari. Përveç kësaj, nëpunësit e imigracionit mund të kërkojnë sqarime shtesë sa i takon opinionit të krijuar për moshën e individit. Në të dyja këto situata, nëse individit kundërshton vendimin e nëpunësit ose nëpunësi i imigracionit ka një dyshim se individit është nën 18 vjeç, zbatohet parimi i prezumimit të pafajsisë dhe individit trajtohet si i mitur. Kjo do të thotë se ai do të transferohet te departamenti i shërbimeve për fëmijët të autoritetit vendor, të cilit më pas do t'i kërkohet të kryejë vlerësimin e moshës.</p>
	<p>Jurisprudenca e Gjykatës Administrative Federale (JICRA 2004/30 dhe JICRA 2005/16)</p> <p>Fushat e mëposhtme mbulohen me vendime gjyqësore:</p> <p>Kërkesat bazë para fillimit të intervistës</p> <p>1) Vlerësimi mund të kryhet nga dy punonjës socialë të trajnuar, siç saktësohet në vendimet e mëposhtme:</p> <p>AS v London Borough of Croydon [2011] EWHC 2091, paragrafi 19</p> <p>R (FZ) v London Borough of Croydon [2011] EWCA Civ 59, paragrafi 2</p> <p>J v Secretary of State for the Home Department [2001] EWHC 3073 (Admin), paragrafi 13</p> <p>2) Nëse është e nevojshme duhet caktuar një përkthyes, siç saktësohet në vendimin R (FZ) v London Borough of Croydon [2011] EWCA Civ 59</p> <p>3) Individit i duhet dhënë mundësia për t'u shoqëruar nga një i rritur i pavarur dhe i përshtatshëm, siç e saktësojnë vendimet më poshtë:</p> <p>A v London Borough of Croydon [2009] EWHC 939 (Admin)</p> <p>R (NA) v London Borough of Croydon [2009] EWHC 2357 (Admin), paragrafi 50 R (FZ) v London Borough of Croydon [2011] EWCA Civ 59, paragrafi 25</p>

Legjislacioni dhe jurisprudenca kombëtare	
<p>Sipas legjislacionit për fëmijët në Mbretërinë e Bashkuar, fëmijë është një person nën moshën 18 vjeç dhe që këtu nis pushteti jo i drejtpërdrejtë i autoriteteve vendore për të përcaktuar moshën, me qëllim që të sigurohen se shërbimet e ofruara për fëmijët po merren pikërisht nga një person nën 18 vjeç. Mjetet me të cilat autoriteti kryen vlerësimin nuk parashikohen me ligj, por praktika e krijuar përcakton që vlerësimi të kryhet nga dy punonjës socialë dhe moshë të përcaktohet në bazë të këtij vlerësimi. Për të dalë në këtë përfundim, këta punonjës do të përdorin trajnimet dhe përvojën e punës me të rinjtë. Edhe pse mënyra me të cilën autoritetet vendore duhet të kryejnë vlerësimin e moshës nuk parashikohet me ligj, gjykatat kanë dhënë udhëzime dhe kanë vendosur standardet minimale që duhen ruajtur nga këto autoritete. Vendimi gjyqësor themelor ishte ai që përfshinte njësinë administrative Merton në Londër (B v London Borough of Merton [2003] EWHC 1689 (Admin)). Që pas këtij vendimi, gjykatat i kanë zhvilluar më tej pikëpamjet e tyre dhe tërësia e kërkesave të parashtruara tashmë duhet të ndiqen në mënyrë që vlerësimi i moshës të jetë i ligjshëm. Ky quhet vlerësim i moshës “në pajtim me vendimin Merton” ose “në pajtim me jurisprudencën”.</p>	<p>4) Autoritetet vendore duhet të zbatojnë udhëzimet e nxjerra nga ato vetë kur kryejnë vlerësimin e moshës, sipas vendimeve të mëposhtme: A v London Borough of Croydon [2009] EWHC 939 (Admin) R (NA) v London Borough of Croydon [2009] EWHC 2357 (Admin)</p> <p>5) Në rast se rrethanat e çështjes janë të atilla që individi duhet t'i nënshtrohet një vlerësimi të dytë (rivlerësim i moshës për shembull), preferohet që të mos marrin pjesë personat që kanë marrë pjesë në vlerësimin e parë, siç e saktëson vendimi R (NA) v London Borough of Croydon [2009] EWHC 2357 (Admin), paragrafët 50 dhe 69.</p> <p>6) Përveç rasteve të pastra (ku është e qartë se personi është nën ose mbi 18 vjeç dhe normalisht nuk ka nevojë për hetime të zgjatura), personat që vlerësojnë moshën nuk mund ta përcaktojnë atë vetëm në bazë të pamjes së jashtme të azilkërkuetit, sipas vendimeve të mëposhtme: Merton, paragrafët 27, 37 dhe 38</p> <p>R (FZ) v London Borough of Croydon [2011] EWCA Civ 59, paragrafi 3 Intervista</p> <p>Personat që merren me vlerësimin e moshës duhet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) t'i shpjegojnë azilkërkuetit qëllimin e intervistës, siç është specifikuar në vendimin Merton, paragrafi 55. 2) të përpiqen të kuptojnë situatën e përgjithshme të azilkërkuetit, sidomos rrethanat dhe historikun e familjes, nivelin e tij arsimor dhe aktivitetet e azilkërkuetit gjatë viteve të mëparshme (informacionet për etninë dhe kulturën e tij mund të kenë gjithashtu rëndësi), sipas parashikimeve të vendimit Merton, paragrafi 37. 3) të vlerësojnë besueshmërinë e azilkërkuetit përmes pyetjeve, nëse ka arsye për të vënë në dyshim deklaratimet e tij për moshën, sipas parashikimeve të vendimit Merton, paragrafi 37. 4) t'i japin azilkërkuetit mundësinë të shpjegojë mospërputhjet në rrëfimet e tij ose në çdo gjë që do të kompromentonte besueshmërinë e tij (sa më shpejt të jetë e mundur dhe për sa kohë azilkërkueti “e ka mendjen të freskët”) sipas parashikimeve në: vendimin Merton, paragrafi 55 R (FZ) v London Borough of Croydon [2011] EWCA Civ 59, paragrafi 20 R (NA) v London Borough of Croydon [2009] EWHC 2357 (Admin), paragrafi 52

Legjislacioni dhe jurisprudenca kombëtare	
<p>5) Duhet mbajtur mend se rastet ndryshojnë nga njëri-tjetri dhe niveli i hetimit të kërkuar në një rast mund të mos jetë i nevojshëm në një rast tjetër, siç e saktëson vendimi Merton, paragrafi 50.</p> <p>Përfundimet</p>	<p>1) Autoriteti vendor që vlerëson moshën mund të marrë në konsideratë informacione e dhëna nga Ministria e Brendshme, megjithatë vendimmarrja i takon autoritetit vendor dhe për ta bërë këtë duhet të ketë informacione të disponueshme, siç e saktëson vendimi Merton, paragrafi 39.</p> <p>2) Raporti mjekësor nuk është i nevojshëm dhe autoriteteve vendore nuk u kërkohet që ta kërkojnë atë. Në rast se këto raporte paraqiten nga vetë azilkërkuesi, raportet mjekësore të pediatrit nuk kanë peshë më të madhe se raportet e nxjerra nga punonjësit socialë me përvojë, por nuk mund të anashkalojnë nga autoritetet vendore apo nga Ministria e Brendshme. Nëse këto raporte paraqiten, ato duhet të merren në konsideratë, siç e përcakton:</p> <p>vendimi Merton, paragrafët 50 dhe 51</p> <p>vendimi A v London Borough of Croydon [2009] EWHC 939 (Admin), paragrafët 33, 34 dhe 47.</p> <p>3) Përfundimet dhe arsyet ku mbështeten ato duhet të marrin parasysh të gjitha dokumentet e paraqitura nga azilkërkuesi, sipas vendimit R (NA) v London Borough of Croydon [2009] EWHC 2357 (Admin), paragrafët 61-64.</p> <p>4) Vendimet të cilat shprehen se azilkërkuesi që pretendon se është i mitur nuk është i mitur duhet të japin arsye të përshtatshme (ndonëse nuk është e nevojshme të jenë të gjata dhe me detaje), sipas vendimeve: Merton, paragrafët 45 dhe 48 A v London Borough of Croydon [2009] EWHC 939 (Admin)</p> <p>5) Intervista duhet zbardhur me shkrim shumë shpejt dhe shënimit duhet të jenë të sakta dhe koherente, siç e kërkon vendimi R (NA) v London Borough of Croydon [2009] EWHC 2357 (Admin), paragrafët 50 dhe 60. Periudha 2 mujore midis intervistës dhe zbardhjes së saj është gjykuar se bie në kundërshtim me praktikën ekzistuese.</p> <p>6) Fakti që nuk janë shënuar ora e fillimit dhe e mbarimit të intervistës ose fakti që ka shkëputje në raportin e vlerësimit nuk e zhvlerësojnë procesin, sado të dëshirueshme të jenë këto informacione, siç e përcakton edhe vendimi ZS (Afghanistan) v Secretary of State for the Home Department [2015] EWCA Civ 1137, paragrafi 36.</p>

3. (a) Orientimet dhe instrumentet juridike kombëtare për vlerësimin e moshës

Shteti	
AT	-
BE	<p>Kur i mituri i pashoqëruar paraqitet në Departamentin e Imigracionit për të aplikuar për azil, plotësohet formulari i identifikimit dhe regjistroheshen të dhënat për identitetin e të miturit të pashoqëruar, si për shembull datëlindja dhe vendlindja e deklaruar.</p> <p>Në rast se Shërbimi i Kujdestarisë, Zyra e të huajve ose Komisionieri i Përgjithshëm për Refugjatët dhe Personat pa shtetësi kanë dyshime për moshën e mitur të personit të interesuar, mund të kërkohet vlerësimi mjekësor i moshës, me shpenzimet e autoritetit që e ka kërkuar këtë vlerësim. Në rast dyshimi në lidhje me pamjen fizike, sjelljen ose mënyrën e të folurit të të miturit ose kur nuk është paraqitur asnjë dokument identiteti ose kur vërtetësia e këtyre dokumenteve nuk mund të verifikohet, duhet kryer vlerësimi i moshës. Të miturit i shpjegohen testimet me ndihmën e një përkthyesi, kështu ai merr shpjegime për testimet në gjuhën e vet.</p> <p>Vlerësimi i moshës bëhet me anë të testeve mjekësore. Testimi mjekësor është ai i që quhet testi i trefishtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - testi i parë: opinioni klinik i një dentisti plus ekzaminimi radiografik dentar, - ekzaminimi i kyçit dhe dorës jo dominante, - dy teste shtesë të kryera pas testit të parë të skajeve të dy klavikulave <p>Belgjika zgjidh një kombinim të këtyre tre testeve për të rritur vlefshmërinë dhe besueshmërinë (2). Në rast se këto tre teste japin rezultate të ndryshme, për bazë do të merret moshë më e ulët. Për më tepër, për këtë test të veçantë përdoret deviacioni standard “mosha minus 1” për të përcaktuar nëse personi është vërtet nën apo mbi 18 vjeç (3). Neni 7 i Ligjit për Kujdestarinë parashikon se nëse ka dyshime për rezultatin e testeve mjekësore, duhet marrë në konsideratë mosha më e ulët.</p> <p>Në bazën e informacioneve të mbledhura gjatë kryerjes së ekzaminimeve të ndryshme mjekësore, mjeku harton një raport që i dërgohet Shërbimit të Kujdestarisë, i cili merr vendimin. Ky vendim i dërgohet personit të interesuar dhe Zyrës për të huajt.</p> <p>Vlerësimi i moshës përmes disiplinave të ndryshme rekomandohet nga specialistë, si Prof. Dr. G. Willems (KU Leuven, Fakulteti i Mjekësisë, Departamenti i Shkencave të Shëndetit të Gojës, Qendra për Odontologjinë Mjekoligjore), i cili ka kryer kërkime të gjera në fushën e vlerësimit të moshës përmes dhëmbëve dhe është ekspert i njohur në shkallë ndërkombëtare në këtë fushë. Kjo praktikë respekton edhe rekomandimet e AGFAD (Grupi i Studimit për Vlerësimin Mjekoligjor të Moshës i Shoqatës gjermane të Mjekësisë Mjekoligjore). Ky grup studimi, i përbërë nga mjekë, dentistë, radiologë dhe antropologë mjekoligjorë, ka botuar një udhëzues për këtë temë dhe rekomandon përdorimin e metodave të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • ekzaminim fizik gjatë të cilit kontrollohen të dhënat antropometrike (gjatësia dhe pesha, lloji i trupit), treguesit e pjekurisë seksuale dhe çrregullimet e mundshme të zhvillimit; • radiografi e dorës së majtë; • ekzaminim dentar gjatë të cilit kontrollohet gjendja e dhëmbëve dhe vlerësohet ortopantomografia; • në rast se radiografia tregon se kockat e dorës janë plotësisht të zhvilluara, rekomandohet radiografia ose tomografia e kompjuterizuar e klavikulës (skaneri CT) për të përcaktuar nëse individi e ka arritur moshën 21 vjeçare. <p>Këto metoda duhet të kombinohen për të rritur saktësinë e diagnozës dhe për të identifikuar çrregullimet e mundshme në zhvillim. Përveç kësaj, ky udhëzues përshtet kushtet që studimet referencë duhet të përmbushin për t'u përdorur në vlerësimin e moshës.</p> <p>Të gjitha spitalet, te të cilët drejtohet Shërbimi i Kujdestarisë, ndjekin udhëzimet e këtij grupi studimi kur bëjnë vlerësimet e moshës.</p>

(1) Pika e kontaktit të Belgjikës në Rrjetin Evropian të Migracionit “Unaccompanied minors in Belgium, Reception, Return and Integration Arrangements”, fq. 26.

(2) ECRE/BCHV-CBAR, AIDA National Country Report Belgium, 2013, fq. 43.

	<p>Përgjithësisht vërehet se ekzaminimet mjekësore nuk arrijnë të përcaktojnë moshën me saktësi. Në fakt, të gjithë ekspertët si Prof. Dr. G. Willems pranojnë se ekzaminimet e skeletit dhe të dhëmbëve janë hamendësime të informuara, por nuk arrijnë ta përcaktojnë moshën me saktësi. Ata theksojnë se rezultati është një vlerësim i moshës dhe duhet të merret parasysh marzhi i gabimit me 1 deri 2 vjet. Kjo metodë i mundëson Shërbimit të Kujdestarisë të përcaktojë në mënyrë të besueshme nëse duhet caktuar apo jo kujdestar, sidomos për të rinjtë që nuk paraqesin asnjë dokument original apo thjesht nuk e dinë datëlindjen e tyre (sipas Unicef-it, në vendet në zhvillim vetëm gjysma e fëmijëve të lindur nën moshën 5 vjeç janë të regjistruar. Në Afrikën Sub-Sahariane, 64% e lindjeve nuk regjistrohen dhe në Azinë jugore përqindja e lindjeve të paregjistruara është 65%).</p> <p>Në rast se personi konsiderohet se është mbi 18 vjeç, i takon Zyrës së të huajve të përcaktojë moshën e tij. Këtu përdoret "Iakorja e Gausit", sipas së cilës mbahet mosha mesatare nisur nga probabiliteti i ulët që personi të jetë në skajet e lakores (p.sh. doktori në raportin e tij shprehet se azilkërkuesi është 20,6 vjeç, me një marzh gabimi prej 2 vjetësh, prandaj mosha më e mundur është 20,6 vjeç. Mundësia që ai të jetë më i vogël se 18,6 vjeç ose më i madh se 22,6 vjeç është shumë e ulët). Në rast se, sipas raportit të mjekut, mosha mund të jetë ajo e deklaruar nga i mituri i pashoqëruar, data e lindjes pranohet siç e ka deklaruar azilkërkuesi. Në rast se azilkërkuesi deklaron se është 15 vjeç, por testimet tregojnë se mosha është midis 16,6 dhe 18,6, personi konsiderohet se është 16,6 vjeç. Në këtë rast, Shërbimi i Kujdestarisë quan të vlefshme moshën 16,6 vjeç për të përcaktuar vitin e lindjes dhe datën në të cilën do të mbarojë kujdestaria.</p> <p>Pasi Shërbimi i Kujdestarisë të ketë vendosur për kryerjen e vlerësimit të moshës, Zyra për të huajt dhe Komisionieri i Përgjithshëm për Refugjatët dhe Personat pa shtetësi duhet ta respektojë këtë vendim dhe ta korrigjojë moshën e regjistruar në dosjen e azilit dhe në të gjitha dokumentet e tjera. Për këtë, përdoret një "pseudonim" në të cilin shënohet mosha e deklaruar në momentin e regjistrimit.</p> <p>Kujdestari dhe/ose i mituri mund të japin prova shtesë për moshën e të miturit (p.sh. certifikatë zyrtare lindjeje të marrë përmes ambasadës së vendit të origjinës në Belgjikë ose në vendet fqinje). Kujdestari mund të shprehë mendimin e tij për moshën e të miturit. Në rast se i mituri dhe/ose kujdestari i tij nuk bien dakord me vendimin e Shërbimit të Kujdestarisë, me ndihmën e një avokati ata mund ta ankimojnë para Këshillit të Shtetit.</p>
BG	Po. Në Ligjin për Azilin dhe Refugjatët ekziston një nen që parashikon kryerjen e vlerësimit të moshës.
CH	-
CY	Po, procesi i vlerësimit të moshës së të miturve të pashoqëruar kryhet në kuadrin e procedurës së azilit
CZ	-
DE	<p>Shtetet federale (Länder) janë përgjegjëse për përcaktimin e moshës së të miturve të pashoqëruar. Ky përcaktim kryhet në momentin e marrjes së tyre në ngarkim (Inobhutnahme), sapo ata bien në kontakt me autoritetet gjermane. Vendimi i marrë prej tyre shërben edhe si bazë për procedurën e azilit.</p> <p>Në parathënie e ligjit që ndryshon Kodin e Sigurimeve Shoqërore në vitin 2015, përmenden rekomandimet e Grupit të Punës të Shërbimeve Federale për Mbrojtjen e të Rinjve (Bundesarbeitsgemeinschaft der Landesjugendämter) http://www.bagjae.de/downloads/118_handlungsempfehlungen-umf_2014.pdf</p> <p>Kështu, Seksioni 42, germa f) e Kodit të Sigurimeve Shoqërore përbën bazën e procesit të përcaktimit të moshës, i cili zhvillohet me etapa:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. verifikim i dokumenteve personale, kërkim për informacione shtesë 2. intervistë (nga dy anëtarë të personelit të kualifikuar dhe me përvojë) dhe përshtypje e përgjithshme për zhvillimin, përfshirë inspektimin e kualifikuar pamor 3. në rast dyshimi, ekzaminim mjekësor me metodën që ka ndikimin më të ulët në shëndetin e fëmijës. <p>Grupi i Punës së Shërbimeve Federale për Mbrojtjen e Rinisë rekomandon që, për procesin e përcaktimit të moshës, të merren parasysh rekomandimet e grupit të studimit për diagnostikimin mjekëgjor të moshës (Arbeitsgemeinschaft für Forensische Altersdiagnostik, AGFAD; http://campus.uni-muenster.de/fileadmin/einrichtung/agfad/empfehlungen/empfehlungen_ausserhalb_strafverfahren.pdf Kërkim në internet: më 05/07/2016)</p>
DK	-

EE	-
EL	Protokollin për të miturit e pashoqëruar
ES	-
FI	Ligji finlandez për të huajt thotë se kryerja e ekzaminimit kërkon që personi i cili i nënshtrohet testeve të japë një pëlqim të informuar me shkrim, me vullnet të lirë. Gjithashtu kërkohet pëlqimi me shkrim i prindit ose kujdestarit ose përfaqësuesit ligjor. Para se të merret pëlqimi, azilërkuesi/sponsori dhe prindi, kujdestari ose përfaqësuesi ligjor i azilërkuesit/sponsorit informohet për rëndësinë e vlerësimit të moshës, për metodat e ekzaminimit që përdoren, pasojat potenciale në shëndet dhe pasojat nëse e kryen apo e refuzojnë ekzaminimin. Informacioni jepet në një gjuhë që ai e kupton ose ka arsye të mendojë se e kupton. Vlerësimi i moshës së një azilërkuesi kryhet nga Departamenti i mjekësisë ligjore të Helsinkit me kërkesë të policisë, Rojës së Kufirit ose Shërbimit Finlandez të Imigracionit. Vlerësimi hartohet bashkërisht nga dy ekspertë. Të paktën njëri prej ekspertëve duhet të jetë punonjës i Departamentit të mjekësisë ligjore të Universitetit të Helsinkit. Ekspertët mund të jenë mjekë ose dentistë të miratuar dhe të kenë kualifikimet e nevojshme.
FR	Në kuadrin e zbatimit të Nenit L. 221-2-2 të Kodit për mbrojtjen sociale dhe familjet, dekreti i datës 24 qershorit 2016 shpjegon kushtet e pritjes dhe të vlerësimit të moshës së personave që deklarohen se janë të mitur dhe që janë përkohësisht ose përfundimisht të privuar nga mbrojtja e familjes së tyre.
HR	-
HU	-
IE	Jo. Si rregull i përgjithshëm, në rastet ku Agjencia e Shërbimeve ndaj Fëmijës dhe Familjes (TUSLA) ka krijuar një opinion profesional se personi që i është referuar është i mitur ose i rritur, ORAC (Zyra e Komisionit për Aplikimet e Refugjatëve) e pranon opinionin e TUSLA-s. Rezultati i vlerësimit të TUSLA-s duhet t'i njoftohet ORAC-ut me shkrim në formën e një raporti të detajuar. Ky raport duhet të përfshihet në dosjen e azilërkuesit. Një kopje e raportit futet në dosjen e referimit. ORAC-u merr shënim për raportin duke u shprehur se e pranon opinionin profesional të HSE-së.
IT	Jo, por ekzistojnë disa udhëzime rajonale. Shih për shembull varie\minor\protocollo_identificazione_msna.pdf
LT	Nuk ka politika formale ose udhëzime në nivel kombëtar për vlerësimin e moshës.
LU	-
LV	Ligji për Azilin (Seksioni 27) parashikon se të miturit e pashoqëruar duhet t'i nënshtrohen ekzaminimit mjekësor për të përcaktuar moshën e personit.
MT	-
NL	Udhëzimet për vlerësimin e moshës në procedurën e azilit specifikohen në Udhëzimet për Zbatimin e Ligjit për të Huajt ("Vreemdelingencirculaire"), Neni C1/2.2.
NO	Politika orientuese: PN 2012-011 Politikat orientuese japin udhëzime për trajtimin e dosjeve të azilit të paraqitura nga të miturit e pashoqëruar. Një nga problematikat kryesore në udhëzim është vlerësimi i moshës dhe përcaktimi i saj.
PL	Zyra për të huajt dhe Roja e Kufirit kanë udhëzime të brendshme të përgjithshme se në cilat raste duhet bërë vlerësimi i moshës dhe çfarë informacionesh i duhen dhënë azilërkuesve për vlerësimin.

PT	-
RO	Nuk ka
SE	Po. Politikat për vlerësimin e moshës brenda Agjencisë së Migracionit janë në fazë rishikimi, por udhëzimi i shtatorit 2015 është ende në fuqi (SR 35/2015). Politika SR 35/2015 u zhvillua kryesisht mbi bazën e vendimit të Gjykatës së Lartë të Migracionit që u përmend në Pyetjen 2, por edhe nisur nga kritikrat e Ndërmjetësit Parlamentar Suedez në vitin 2012 (vendimi nr. 4107-2011) dhe vitin 2015 (vendimi nr. 6942-2013) për disa vlerësime të moshës të kryera nga agjencia. Vendimet mund të gjenden në faqen http://www.jo.se/en
SI	Për vlerësimin e moshës nuk ka politika ose udhëzime zyrtare në nivel kombëtar. Procedura për vlerësimin e moshës është në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen Ndërkombëtare dhe ka të bëjë vetëm me vlerësimin e moshës së të miturve të pashoqëruar.
SK	Vlerësimi mjekësor i moshës kryhet nga Departamenti i Radiologjisë me radiografi të dorës dhe të nyjave të bërrylit. Pastaj në raportet mjekësore shënohet nëse vrojtimi i kockave në grafi përkon me zhvillimin dhe rritjen e një individi më të madh se 18 vjeç. Vlerësimet mjekësore të moshës kryhen me kërkesë të policisë, vendimmarrësve dhe të kujdestarit.
UK	Ministria e Brendshme ka nxjerrë udhëzime për personelin e saj, të cilat i gjeni në adresën https://www.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/257462/assessing-age.pdf Udhëzimet aktualisht janë në fazë rishikimi. Shoqata e Drejtorëve të Shërbimeve për Fëmijët (ADCS) në Mbretërinë e Bashkuar ka miratuar udhëzimet e mëposhtme që u drejtohen punonjësve socialë të cilët merren me kryerjen e vlerësimeve të moshës http://adcs.org.uk/assets/documentation/Age_Assessment_Guidance_2015_Final.pdf http://adcs.org.uk/assets/documentation/information_sharing_proforma_april_2015.doc Një variant më i shkurtër gjendet në adresën http://www.makeitlooknice.co.uk/adcs/age-assessment-guidance/index.html Përveç sa më lart, për punonjësit socialë që kryejnë vlerësime për moshën janë miratuar udhëzimet e mëposhtme. Ato quhen “udhëzimet Hillingdon dhe Croydon” dhe bazohen në përvojën e autoriteteve vendore që kanë trajtuar një numër të lartë fëmijësh emigrantë të pashoqëruar.

Instrumente të tjera juridike kombëtare
[Vendosni referencën]

Jurisprudenca kombëtare
[Vendosni referencën]

Udhëzimet brenda vendit
[Vendosni referencën]

4. Jurisprudenca përkatëse⁽⁶⁶⁾

Çështja ECLI:EU:C:2013:367 C-648/11 — MA dhe të tjerë — Interesat më të larta të fëmijës	http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/ALL/?uri=CELEX:62011CJ0648
<i>Tarakhel k Zvicrës</i> , Kërkesa Nr. 29217/12, Këshilli i Evropës: Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, 4 nëntor 2014	https://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":["001-148070"]}
<i>Abdullahi Elmi dhe Aweys Abubakar k Maltës</i> , Kërkesat Nr. 25794/13 dhe 28151/13 Këshilli i Evropës: Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në fuqi që më datë 22 nëntor 2016	http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-168780
Së fundmi, në Britaninë e Madhe, Gjykata e Lartë dhe Gjykata e Apelit kanë konstatuar se politika britanike e përcaktimit të moshës së të miturve të pashoqëruar bazuar në pamjen/sjelljen e tyre është e paligjshme, sidomos kur ky vlerësim mund të shkaktojë edhe mbajtje në burg.	http://www.asylumlawdatabase.eu/en/case-law/uk-queen-application-aa-v-secretary-state-home-department-interested-party-wolverhampton#content http://www.asylumlawdatabase.eu/en/case-law/uk-r-application-aa-sudan-v-secretary-state-home-department-9-march-2017#content https://www.refugeecouncil.org.uk/latest/news/4866_court_confirms_government_s_age_policy_is_unlawful

5. Instrumentet kuazi-ligjore

Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (CRC), <i>Komenti i përgjithshëm Nr. 14 (2013) "Për të drejtën e fëmijës që interesat e tij/saj më të lartë të merren si një konsideratë parësore"</i> (Neni 3, paragrafi 1), 29 maj 2013, CRC/C/GC/14.
Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (CRC), <i>Komenti i përgjithshëm Nr. 6 (2005): "Për trajtimin e fëmijëve të pashoqëruar dhe të ndarë jashtë vendit të tyre të origjinës"</i> 1 shtator 2005, CRC/GC/2005/6.
Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (CRC), <i>Komenti i përgjithshëm Nr. 12 (2009) "Për të drejtën e fëmijëve për t'u dëgjuar"</i> 1 korrik 2009 CRC/C/GC/12.
KOMUNIKATA E KOMISIONIT DREJTUAR PARLAMENTIT EVROPIAN DHE KËSHILLIT Mbrojtja e fëmijëve emigrues {SWD(2017) 129 final}, ku përmendet qartë se EASO duhet të përditësojë udhëzimet e saj për vlerësimin e moshës, në adresën: https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/policies/european-agenda-migration/20170412_communication_on_the_protection_of_children_in_migration_en.pdf
Plani i Veprimit të Këshillit të Evropës për mbrojtjen e refugjatëve dhe fëmijëve emigrantë (2017-2019) gjendet në adresën https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=090000168071484e

⁽⁶⁶⁾ Nisur nga zhvillimi dinamik dhe i shpejtë i jurisprudencës në këtë fushë, lidhjet me bazat e të dhënave të mëposhtme mund t'ju ndihmojnë të informoheni për vendimet më të fundit gjyqësore për këtë temë: Baza evropiane e të dhënave për legjislaionin e azilit (EDAL) <http://www.asylumlawdatabase.eu/en>, Refworld <http://www.refworld.org/cases.html> dhe "British and Irish legal information institute" <http://www.bailii.org>

Shtojca 4 Përmbledhje e metodave dhe garancive procedurale të përdorura në proceset e vlerësimit të moshës ⁽⁶⁷⁾

⁽⁶⁷⁾ Tabelat e paraqitura në këtë shtojcë janë pasqyrë e saktë e gjetjeve të pyetësorit të shpërndarë nga EASO në vitet 2016 dhe 2017, me synimin për të pasur një pamje të qartë të veçantive dhe ngjashmërive në praktikat kombëtare.

Përmbledhje e garancive procedurale të përdorura në proceset e vlerësimit të moshës (I)

Shtetet BE+	Gjatë procesit të vlerësimit të moshës mbrohen interesat më të larta të fëmijës	Përdoren qasje të tjera para kryerjes së vlerësimit të moshës	Një person i pavarur ndihmon azilkerkuesin gjatë procesit	Pikëpamjet e azilkerkuesit dëgjojnë dhe merrin parasysh në varësi të pjekurisë së tij	Azilkerkuesi njoftohet për arsyet, metodat, pasojat dhe rezultatet e të gjitha vlerësimeve	Azilkerkuesi njoftohet vetëm për vlerësimet mjekësore	Pëlqimi i informuar i azilkerkuesit kërkohet pavarësisht metodës së vlerësimit të moshës	Pëlqimi i përfaqësuesit të azilkerkuesit kërkohet në të gjitha rastet
Austri	Po	Po	Po	Përmes përfaqësuesit ligjor	Jo	Po	Jo	Jo
Belgjikë	Po*	Po	Vetëm për dosjet komplekse**	Po	Po	Jo	Vetëm për metodat mjekësore	Jo
Bullgari	Po**	Po	Po**	Përmes përfaqësuesit ligjor	Jo	Po	Po	Po
Kroaci	I paspecifikuar	Po	Po**	Po**	Po	Jo	Vetëm për metodat mjekësore të vlerësimit të moshës	Vetëm për metodat mjekësore të vlerësimit të moshës
Qipro	Po**	Po	Po**	Po	Po	Jo	Vetëm për metodat mjekësore të vlerësimit të moshës	Vetëm për metodat mjekësore të vlerësimit të moshës
Republikë Çeke	*	I paspecifikuar	Po	I paspecifikuar	I paspecifikuar	I paspecifikuar	Vetëm për metodat mjekësore të vlerësimit të moshës	I paspecifikuar
Danimarkë	Po**	Po	Po	Po	Jo	Po	Vetëm për metodat mjekësore të vlerësimit të moshës	I paspecifikuar
Estoni	*	I paspecifikuar	Po	I paspecifikuar	I paspecifikuar	I paspecifikuar	Vetëm për metodat mjekësore të vlerësimit të moshës	Vetëm për metodat mjekësore të vlerësimit të moshës
Finlandë	I paspecifikuar	Po	Po**	I paspecifikuar	Po, faqe informacioni	Jo	Po	Po
Francë	I paspecifikuar	Po	Jo	Po	Po	Jo	Vetëm për metodat mjekësore të vlerësimit të moshës	I paspecifikuar
Gjermani	I paspecifikuar	Po	Po**	Po	Po	Jo	Po	I paspecifikuar
Greqi	*	Po	Po	I paspecifikuar	Po	Jo	Po	I paspecifikuar
Hungari	I paspecifikuar	Po	Po**	I paspecifikuar	Po	Jo	Po	Vetëm për azilkerkuesit nën 14 vjeç
Irlandë	**	Po	Po**	Po	Po	Jo, përdoren vetëm metoda jo mjekësore	Jo, përdoren vetëm metoda jo mjekësore	Jo, përdoren vetëm metoda jo mjekësore
Itali	*	Po	Po	Po	Po	Jo	Po	Po
Letoni	*	I paspecifikuar	Po	Jo	Jo	Po	Jo	Jo
Lituani	Po**	Po	Po**	Po**	Jo	Po	Po	Po
Luksemburg	I paspecifikuar	I paspecifikuar	Po	I paspecifikuar	I paspecifikuar	I paspecifikuar	I paspecifikuar	I paspecifikuar
Maltë	*	I paspecifikuar	I paspecifikuar	I paspecifikuar	I paspecifikuar	I paspecifikuar	Po	I paspecifikuar
Hollandë	Po**	Po	Punonjësi i IND-së	Po	Po, broshura për MN mbulon VM	Jo	Vetëm për metodat mjekësore	Vetëm për metodat mjekësore

Shtetet BE+	Gjatë procesit të vlerësimit të moshës mbrohen interesat më të larta të fëmijës	Përdoren qasje të tjera para kryerjes së vlerësimit të moshës	Një person i pavarur ndihmon azilkerkuesin gjatë procesit	Pikëpamjet e azilkerkuesit dëgohen dhe merren parasysh në varësi të pjekurisë së tij	Azilkerkuesi njoftohet për arsyet, metodat, pasojat dhe rezultatet e të gjitha vlerësimeve	Azilkerkuesi njoftohet vetëm për vlerësimet mjekësore	Pëlqimi i informuar i azilkerkuesit kërkohet pavarësisht metodës së vlerësimit të moshës	Pëlqimi i përfaqësuesit të azilkerkuesit kërkohet në të gjitha rastet
Norvegji	*	Po	Po**	Po	Jo	Po	Vetëm për metodat mjekësore	Vetëm për metodat mjekësore
Poloni	I paspecifikuar	Po	Po**	Po	Jo	Po	Vetëm për metodat mjekësore të vlerësimit të moshës	Vetëm për metodat mjekësore të vlerësimit të moshës
Portugali	I paspecifikuar	I paspecifikuar	Po	I paspecifikuar	I paspecifikuar	I paspecifikuar	Po	I paspecifikuar
Rumani	Po	Po	Gjatë ekzaminimeve mjekoligjore	Po	Jo	Po	Vetëm për metodat mjekësore të vlerësimit të moshës	Vetëm për metodat mjekësore të vlerësimit të moshës
Sllovaki	Po**	Gjatë vlerësimit	Po** ⁽⁷⁰⁾	Po	Po	Po	Jo	Po (pëlqimi me shkrim i kujdestarit ose përfaqësuesit)
Slloveni	Po**	Po	Po**	Po**	Po	Jo	Po	Po
Spanjë	Po*	I paspecifikuar	I paspecifikuar	I paspecifikuar	I paspecifikuar	I paspecifikuar	Po	I paspecifikuar
Suedi	Po	Gjatë vlerësimit	Po	Po	Po	Jo	Vetëm për metodat mjekësore të vlerësimit të moshës	I paspecifikuar
Zvicër	Po	Po	Vetëm për rastet e trajtuara sipas rregullores së Dublinit	Vetëm për rastet ku vlerësimi nuk konfirmon moshën e mitur	Jo	Jo	I paspecifikuar	I paspecifikuar
Mbretëri e Bashkuar	Po	Po	Po**	Po	Po	Jo	Jo, sepse përdoren vetëm metoda jo mjekësore	Jo

(*) Deri në daljen e rezulttit azilkerkuesi trajtohet si i mitur

(**) Kujdestari/përfaqësuesi/shërbimet sociale për mbrojtjen e fëmijëve mbrojnë interesat më të larta

⁽⁷⁰⁾ Sllovaki: Interesat më të larta përfaqësohen nga kujdestari dhe pranimi i çdo personi të pavarur në procedurë duhet të bëhet me miratim paraprak të kujdestarit (ose të përfaqësuesit ligjor).

Përmbledhje e garancive procedurale të përdorura në proceset e vlerësimit të moshës (II)

Shtetet BE+	Gjatë procesit zbatohet prezumimi i pafajësisë	Azilkërkuesi mund të refuzojë vlerësimin e moshës, pavarësisht metodës së përdorur	Refuzimi për t'iu nënshtruar vlerësimit të moshës nuk shkakton automatikisht vlerësimin si i rritur	Refuzimi për t'iu nënshtruar vlerësimit të moshës nuk merrret parasysht kur vendoset për dhënie e mbrojtjes ndërkombëtare	Azilkërkuesi njoftohet për rezultatet në gjuhën që kupton	Rezultatet jo përfundimtare të vlerësimit të moshës konsiderohen në favor të azilkërkuetit	Azilkërkuesi ka zgjidhje efektive ligjore kundër vendimit të vlerësimit të moshës
Austri	Po, në rast rezultati jo përfundimtar	Po	Nuk konsiderohet automatikisht si i rritur, sqarohen arsyet	Po, ndikon në aplikimin për mbrojtje ndërkombëtare	Po	Po	Po, si pjesë e vendimit për mbrojtjen ndërkombëtare
Belgjikë	Po	Po	Nuk konsiderohet automatikisht si i rritur	Refuzimi nuk merrret parasysht	Po (nga asistentët socialë)	Po	Po
Bullgari	Po	Vetëm metodat mjekësore	Nuk konsiderohet automatikisht si i rritur	Refuzimi nuk merrret parasysht	Po	Jo	I paspecifikuar
Kroaci	Po, në rast rezultati jo përfundimtar	Po	Vetëm kur refuzimi është i pajustifikuar	Po, ndikon në aplikimin për mbrojtje ndërkombëtare	Po	Po	Po, njëkohësisht me vendimin për mbrojtjen ndërkombëtare
Qipro	Po	Po	I paspecifikuar	Refuzimi nuk merrret parasysht, përjashto rastet ku moshë e mitur ka rëndësi për aplikimin për MN	Po	I paspecifikuar	Jo
Republikë Çeke	Po	Po	Konsiderohet automatikisht si i rritur	I paspecifikuar	Po	I paspecifikuar	I paspecifikuar
Danimarkë	I paspecifikuar	Vetëm metodat mjekësore	Nuk konsiderohet automatikisht si i rritur	I paspecifikuar	Vetëm nëse rezultati tregon moshë më të madhe	Po	Po
Estoni	Po	Po	Nuk konsiderohet automatikisht si i rritur	Po, ndikon në aplikimin për mbrojtje ndërkombëtare	Po	I paspecifikuar	I paspecifikuar
Finlandë	Jo	Po	Vetëm kur refuzimi është i pajustifikuar	Refuzimi nuk merrret parasysht	Po	Jo (anashkalohet)	Po, njëkohësisht me vendimin për mbrojtjen ndërkombëtare
Francë	Po	Vetëm metodat mjekësore	Nuk konsiderohet automatikisht si i rritur	I paspecifikuar	Po	Po	Po
Gjermani	Po	Po	Nuk konsiderohet automatikisht si i rritur	Refuzimi nuk merrret parasysht	Po	Po	Po, njëkohësisht me vendimin për mbrojtjen ndërkombëtare
Greqi	Po	Po	Nuk konsiderohet automatikisht si i rritur	I paspecifikuar	Po	Po	I paspecifikuar
Hungari	Po	Po	Konsiderohet automatikisht si i rritur	I paspecifikuar	I paspecifikuar	Po	Po, si pjesë e vendimit për mbrojtjen ndërkombëtare
Irlandë	Po	I paspecifikuar	I paspecifikuar	I paspecifikuar	I paspecifikuar	I paspecifikuar	Po
Itali	Po (hapësirë me 2 vjet në favor të azilkërkuetit)	Po	Nuk konsiderohet automatikisht si i rritur	Refuzimi nuk merrret parasysht	Po (përmes ndërmjetësimit kulturor dhe për-kthyesit)	Po (hapësirë me 2 vjet në favor të azilkërkuetit)	Po
Letoni	Po	I paspecifikuar	I paspecifikuar	Mund të ndikojë, por rrethanat merren dhe vlerësohen individualisht	I paspecifikuar	I paspecifikuar	I paspecifikuar
Lituani	Po, në rast rezultati jo përfundimtar	Vetëm metodat mjekësore	Vetëm kur refuzimi është i pajustifikuar	Po, ndikon në aplikimin për mbrojtje ndërkombëtare	Po	Po	Po, si pjesë e vendimit për mbrojtjen ndërkombëtare

Shtetet BE+	Gjatë procesit zbatohet prezumimi i pafajësisë	Azilkërkuesi mund të refuzojë vlerësimin e moshës, pavarësisht metodës së përdorur	Refuzimi për t'iu nënshtruar vlerësimin të moshës nuk shkakton automatikisht vlerësimin si i rritur	Refuzimi për t'iu nënshtruar vlerësimin të moshës nuk merret parasysh kur vendoset për dhënien e mbrojtjes ndërkombëtare	Azilkërkuesi njoftohet për rezultatet në gjuhën që kupton	Rezultatet jo përfundimtare të vlerësimit të moshës konsiderohen në favor të azilkërkuetit	Azilkërkuesi ka zgjidhje efektive ligjore kundër vendimit të vlerësimit të moshës
Luksemburg	Po	Jo	Konsiderohet automatikisht si i rritur	Po, ndikon në aplikimin për mbrojtje ndërkombëtare	I paspecifikuar	I paspecifikuar	I paspecifikuar
Maltë	Po	Po	Nuk konsiderohet automatikisht si i rritur	I paspecifikuar	Po	Po	Po, vihet në dijeni për të drejtën e ankimit
Holandë	I paspecifikuar	Po	Konsiderohet automatikisht si i rritur	Po, ndikon në aplikimin për mbrojtje ndërkombëtare	Po	Jo	Po, si pjesë e vendimit për mbrojtjen ndërkombëtare
Norvegji	I paspecifikuar	Vetëm metodat mjekësore	Nuk konsiderohet automatikisht si i rritur	Po, ndikon në aplikimin për mbrojtje ndërkombëtare	Po	Jo	Po, si pjesë e vendimit për mbrojtjen ndërkombëtare
Poloni	Po, në rast rezultati jo përfundimtar	Vetëm metodat mjekësore	Konsiderohet automatikisht si i rritur	Po, ndikon te besueshmëria	I paspecifikuar	Po	I paspecifikuar
Portugali	I paspecifikuar	I paspecifikuar	I paspecifikuar	I paspecifikuar	I paspecifikuar	I paspecifikuar	I paspecifikuar
Rumani	Jo	Po	Vetëm nëse arsyet e refuzimit janë të pajustificuara	Po, ndikon në aplikimin për mbrojtje ndërkombëtare	Po	Po	I paspecifikuar
Slovaki	Po	Po, por konsiderohet automatikisht si madhor	Konsiderohet automatikisht si i rritur	Refuzimi nuk merret parasysh	Po	Po	Jo
Sloveni	Po, në rast rezultati jo përfundimtar	Po	Vetëm nëse arsyet e refuzimit janë të pajustificuara	Po, ndikon në aplikimin për mbrojtje ndërkombëtare	Po	Po	I paspecifikuar
Spanjë	I paspecifikuar	I paspecifikuar	I paspecifikuar	I paspecifikuar	I paspecifikuar	I paspecifikuar	I paspecifikuar
Suedi	Po	Vetëm metodat mjekësore	Vetëm nëse arsyet e refuzimit janë të pajustificuara	Po, ndikon në aplikimin për mbrojtje ndërkombëtare	Po	Jo	Po (Merret vendim i përkohshëm për moshën që ankimohet gjatë procedurës së azilit)
Zvicër	Po	I paspecifikuar	Nuk konsiderohet automatikisht si i rritur	Po, ndikon në aplikimin për mbrojtje ndërkombëtare	Po	Po	Po, si pjesë e vendimit për mbrojtjen ndërkombëtare
Mbretëri e Bashkuar	Po	Po, por do të thotë pranimit të moshës që është caktuar	Refuzim do të thotë pranimit të moshës që është caktuar	Refuzimi nuk merret parasysh	Po	Jo	Po

Përmbledhje e përfundimeve kryesore

- Interesat më të larta të fëmijës mbrohen gjatë procesit të vlerësimit të moshës
 - Garancitë procedurale parashikohen në kuadrin ligjor : **AT, CH, RO, SE, UK**.
 - Duke trajtuar çdo individ si fëmijë gjatë procesit: **BE CZ, EE, EL, IT, LV, MT, NO, ES**.
 - Duke garantuar praninë e përfaqësuesit ose kujdestarit: **BG, CY, DK, IE, LT, NL, SK, SI**.
- Para se të kryhen procedurat e vlerësimit të moshës, përdoren metoda të tjera për marrjen e informacionit për moshën e azilkërkuesit
 - 21 shtete BE+ zakonisht përpiqen të marrin informacione para se të vendosin për kryerjen e vlerësimit të moshës: **AT, BE, BG, HR, CH, CY, DK, FI, FR, DE, EL, HU, IE, IT, LT, NL, NO, PL, RO, SI, UK**.
 - 2 shtete BE+ përpiqen të marrin informacion gjatë vlerësimit të moshës: **SK, SE**.
- Një person i pavarur ndihmon azilkërkuesin gjatë procesit
 - 22 shtete BE+ lejojnë praninë e një personi të pavarur gjatë vlerësimit të moshës: **AT, BG, HR, CY, CZ, DK, EE, FI, DE, EL, IE, IT, LV, LT, LU, NO, PL, PT, SK, SI, SE, UK**.
 - Ndër to, 13 shtete BE+ (**BG, HR, CY, FI, DE, HU, IE, LT, NO, PL, SK, SI, UK**) pohuan se ky person është kujdestari ose përfaqësuesi.
 - Në **BE** kujdestari mund të jetë i pranishëm vetëm në rastet komplekse.
 - Në **NL** fëmija mbështetet vetëm nga punonjësit e autoriteteve të emigracionit/azilit, të cilët nuk janë të pavarur.
 - Në **CH** personi i pavarur është i pranishëm vetëm në rastet që trajtohen sipas rregullores së Dublinit.
 - Në **RO** personi i pavarur është i pranishëm vetëm gjatë ekzaminimeve mjekoligjore.
 - Në **SK** personi i pavarur është i pranishëm vetëm me pëlqimin e kujdestarit ose përfaqësuesit ligjor
 - Në **FR** azilkërkuesi mbështetet nga departamenti për azilin.
- Pikëpamjet e azilkërkuesit dëgjohen dhe merren parasysh në varësi të pjekurisë
 - 14 shtete BE+ kanë parasysh dhe marrin në konsideratë pikëpamjet e azilkërkuesit: **BE, CY, DK, FR, DE, IE, IT, NL, NO, PL, RO, SK, SE, UK**.
 - 5 shtete BE+ e marrin këtë pikëpamje nëpërmjet përfaqësuesit ose kujdestarit: **AT, BG, HR, LT, SI**.
 - CH** i merr parasysh vetëm kur rezultati i vlerësimit është negativ (personi është madhor).
- Azilkërkuesi njoftohet për arsyet e vlerësimit të moshës, për metodën e vlerësimit, për pasojat dhe rezultatet e mundshme në funksion të procedurës së azilit dhe për rrjedhojat e refuzimit për t'iu nënshtruar këtij vlerësimi
 - Në 15 shtete BE+ **azilkërkuesi** njoftohet për arsyet e vlerësimit të moshës, për metodën e vlerësimit, për pasojat e rezultateve të vlerësimit në funksion të procedurës së azilit dhe për rrjedhojat e refuzimit për t'iu nënshtruar këtij vlerësimi, cilado qoftë metoda: **BE, HR, CY, FI, FR, DE, EL, HU, IE, IT, NL, SK, SI, SE, UK**.
 - 9 shtete BE+ e njoftojnë azilkërkuesin vetëm për metodat mjekësore: **AT, BG, DK, LV, LT, NO, PL, RO**.
 - Në **CH** kjo ndodh vetëm nëse vlerësimi i moshës del në përfundimin se personi është madhor.

6. Pëlqimi i informuar i azilkërkuesit dhe/ose përfaqësuesit të tij kërkohet për vlerësimin e moshës pavarësisht metodës së vlerësimit që zbatohet
 - 11 shtete BE+ kërkojnë pëlqimin e azilkërkuesit për të gjitha metodat: **BG, FI, DE, EL, HU, IT, LT, MT, PT, SI, ES.**
 - 12 shtete BE+ kërkojnë pëlqimin e azilkërkuesit vetëm për metodat mjekësore: **BE, HR, CY, CZ, DK, EE, FR, NL, NO, PL, RO, SE.**
 - 4 shtete nuk e kërkojnë pëlqimin: **AT, LV, IE, UK** (IE dhe UK nuk e kërkojnë pasi nuk përdorin metoda mjekësore).
 - **SK** nuk kërkon pëlqimin e azilkërkuesit, por të përfaqësuesit ose kujdestarit.
 - 6 shtete BE+ kërkojnë pëlqimin nga përfaqësuesi në të gjitha rastet: **BG, FI, IT, LT, SI, SK.**
 - 7 shtete BE+ kërkojnë pëlqimin e përfaqësuesit vetëm për ekzaminimet mjekësore: **HR, CY, EE, NL, NO, PL, RO.**
 - **HU** kërkon pëlqimin e përfaqësuesit nëse moshja e azilkërkuesit duket se është nën 14 vjeç
 - 5 shtete BE+ (**AT, BE, IE, LV, UK**) nuk kërkojnë fare pëlqim nga përfaqësuesi. ■ **IE** dhe **UK** nuk e kërkojnë pasi nuk përdorin metoda mjekësore.
7. Gjatë procesit të vlerësimit të moshës zbatohet prezumimi i pafajësisë
 - 17 shtete BE+ zbatojnë parimin e prezumimit të pafajësisë: **BE, BG, CY, CZ, EE, FR, DE, EL, IE, IT** (me 2 vjet marzh gabimi) **LV, LU, MT, SK, SE, CH, UK.**
 - Në **FI** dhe **RO** ky parim nuk zbatohet.
8. Azilkërkuesi ka mundësinë të refuzojë vlerësimin e moshës, pavarësisht metodës së përdorur
 - 15 shtete BE+ i njohin azilkërkuesit të drejtën e refuzimit të vlerësimit të moshës pavarësisht metodës së përdorur: **AT, BE, HR, CY, CZ, EE, FI, DE, EL, HU, IT, MT, NL, RO, SI.**
 - 7 shtete BE+ i japin mundësinë të refuzojë vetëm ekzaminimet mjekësore: **BG, DK, FR, LT, NO, PL, SE.**
 - Në **UK** refuzimi nënkupton të pranohet moshja e hamendësuar.
 - **LU** nuk njeht mundësinë e refuzimit për t'iu nënshtruar procesit të vlerësimit të moshës.
9. Refuzimi për t'iu nënshtruar vlerësimit të moshës nuk shkakton automatikisht vlerësimin si madhor
 - 12 shtete BE+ nuk e konsiderojnë azilkërkuesin automatikisht madhor në rast refuzimi: **AT, BE, BG, DK, EE, FR, DE, EL, IT, MT, NO, CH.**
 - 6 shtete BE+ e konsiderojnë azilkërkuesin madhor nëse refuzimi nuk është i justifikuar ose nuk ka prova të tjera se është i mitur: **HR, FI, LT, RO, SI, SE.**
 - Në **UK** refuzim do të thotë se azilkërkuesi pranon moshën e hamendësuar.
 - 6 shtete BE+ e konsiderojnë azilkërkuesin automatikisht madhor nëse ai refuzon t'iu nënshtrohet vlerësimit të moshës: **CZ, HU, LU NL, PL, SK.**
10. Refuzimi për t'iu nënshtruar vlerësimit të moshës nuk merret parasysh kur merret vendimi për mbrojtjen ndërkombëtare
 - 7 shtete BE+ nuk e marrin parasysh refuzimin kur marrin vendimin për mbrojtjen ndërkombëtare: **BE, BG, CY** (me kusht që moshja e mitur të jetë kriter për aplikimin), **FI, DE, IT, SK, UK.**
 - 14 shtete BE+ e marrin parasysh refuzimin kur shqyrtojnë aplikimin: **AT, HR, EE, HU, LV, LT, LU, NL, NO, PL, RO, SI, SE, CH.**
11. Azilkërkuesi njoftohet për rezultatet në gjuhën që kupton ose mund të mendohet se kupton
 - në 23 shtete BE+ azilkërkuesi njoftohet për rezultatet në gjuhën që kupton ose mund të mendohet se kupton: **AT, BE, BG, HR, CY, CZ, EE, FI, FR, DE, EL, HU, IT, LT, MT, NL, NO, RO, SK, SI, SE, CH, UK.**

- **DK** njofton për rezultatet vetëm kur moshja e azilkërkuesit vlerësohet më e madhe nga moshja e deklaruar.
12. Rezultatet jo përfundimtare të vlerëimit të moshës konsiderohen në favor të azilkërkuesit
- § 16 shtete BE+ zbatojnë parimin e prezumimit të pafajësisë në rast se rezultatet janë jo përfundimtare: **AT, BE, HR, DK, FR, DE, EL, HU, IT, LT, MT, PL, RO, SK, SI, CH.**
 - § 6 shtete BE+ nuk e zbatojnë parimin e prezumimit të pafajësisë: **BG, FI, NL, NO, SE, UK.**
13. Azilkërkuesit i ofrohen zgjidhje efektive ligjore kundër vendimit të vlerëimit të moshës
- 8 shtete BE+ ofrojnë mundësinë për të kundërshtuar veçmas vendimin për vlerësimin e moshës: **BE, DK, FR, IE, IT, MT, SE, UK.** Për vendet e mëposhtme nevojiten informacione shtesë: **BG, CZ, EE, EL, ES, LV, LU, PL, PT, RO, SI.**
 - 9 shtete BE+ ofrojnë mundësinë për të ankimuar vendimin për vlerësimin e moshës në kuadrin e vendimit për mbrojtjen ndërkombëtare ose njëkohësisht: **AT, HR, FI, DE, HU, LT, NL, NO, CH.**
 - 2 shtete BE+ nuk i ofrojnë azilkërkuesit zgjidhje ligjore kundër vendimit për vlerësimin e moshës: **CY, SK.**

Shtojca 5 Bibliografia

ADCS, *Age assessment joint working guidance*, 2015.

al, Eid RMR et. n.d., *Assessment of dental maturity of Brazilian children aged 6 to 14 years using Demirjian's method*.

Al-Krenawi, A. and Graham, J. R., "The cultural mediator: bridging the gap between a non-Western community and professional social work practice", *British Journal of Social Work*, 2001.

British Association of Social Workers, *BASW position statement*, 2015.

Busler, D., "Psychosocial age assessments in the UK", *Forced Migration Review*, 2016.

FRA, *Guardianship for children deprived of parental care*, 2014, <http://fra.europa.eu/en/publication/2014/guardianship-children-deprived-parental-care-handbook-reinforce-guardianship>

Dedouit, F., Auriol, J., Rousseau, H., Rougé, D., Crubézy, E. and Telmon, N., "Age assessment by magnetic resonance imaging of the knee: a preliminary study", *Forensic Science International*, 2012, fq. 217-232.

Demirjian, A., Goldstein, H. and Tanner, J. M., 'A new system of dental age assessment', *Human biology*, 1973, fq. 211, <http://www.bristol.ac.uk/media-library/sites/cmm/migrated/documents/dental-age-assessment.pdf>

Dvorak, J., George, J., Junge, A. and Hodler, J., "Age determination by magnetic resonance imaging of the wrist in adolescent male football players", *British Journal of Sports Medicine*, 2007, fq. 45-52.

Dyball, K., Mcphie, G. and Tudor, C., "Age assessment practice guidance: an age assessment pathway for social workers in Scotland", 2012.

European Council on Refugees and Exiles, *Right to justice: quality legal assistance for unaccompanied children — Comparative report*, ECRE, 2014.

Food and Agriculture Organisation of the United Nations, *Guidelines for estimating the month and the year of birth of young children*, 2008.

Frontex, *VEGA handbook: children at airports*, 2015, http://frontex.europa.eu/assets/Publications/Training/VEGA_Children_Handbook.pdf

Gertych, A., Zhang, A., Sayre, J., Pospiech-Kurkowska, S. dhe Huang, H. K., "Bone age assessment of children using a digital hand atlas — Computerised medical imaging and graphics", *The Official Journal of the Computerized Medical Imaging Society*, 2007, fq. 322-331.

Gleiser, I. dhe Hunt, E. E., "The permanent mandibular first molar: its calcification, eruption and decay", *Am. J. Phys. Anthropol.*, 1955, Vol. 13, fq. 253-283, doi:10.1002/ajpa.1330130206.

Greulich, W. W. dhe Pyle, S. I., "Radiographic atlas of skeletal development of the hand and wrist", botimi i dytë, Stanford University Press, Stanford, 1959.

Inter-Agency Working Group on Unaccompanied and Separated Children, *Inter-agency guiding principles on unaccompanied and separated children*, 2004, <http://www.refworld.org/docid/4113abc14.html>

Kt, Professor Sir Al Aynsley-Green, "The assessment of age in undocumented migrants", Aynsley-Green consulting, 2011.

Ladwig, K-H., Brockhaus, A. C., Baumert, J., et al., "Post-traumatic stress disorder and not depression is associated with shorter leukocyte telomere length: findings from 3 000 participants in the population-based", KORA F4 Study, Ouellette MM, bot. PLoS ONE, 2013.

Olze, A., Schmeling, A., Taniguchi, M., Maeda, H., van Niekerk, P., Wernecke, K-D. dhe Geserick, G., "Forensic age estimation in living subjects: the ethnic factor in wisdom tooth mineralisation", *International Journal of Legal Medicine*, 2004, fq. 170-173.

Ritz-Timme, S., Cattaneo, C., Collins, M. J., et al., "Age estimation: the state of the art in relation to the specific demands of forensic practise", *International Journal of Legal Medicine*, 2000, fq. 29-136.


- Cameriere, R., De Luca, S., Cingolani, M. dhe Ferrante, L., "Are the common age estimation procedures useful for assessing age of unaccompanied children and adolescents?", 2017.
- Schutt, R. K., "Investigating the social world: the process and practice of research", University of Massachusetts Boston, botimi i 8-të, 2015.
- Serin, J., Rérolle, C., Puchoux, J., Dedouit, F., Telmon, N., Savall, F. dhe Saint-Martin, P., "Contribution of magnetic resonance imaging of the wrist", *International Journal of Legal Medicine*, 2016.
- Schmeling, A. et al., "Age estimation of unaccompanied minors", *Forensic Science International*, Part 1. General considerations, 2006.
- Schmeling, A. et al., "Studies on the time-frame for ossification of the medial clavicular epiphyseal cartilage in conventional radiography", *International Journal of Legal Medicine*, 2004, Vol. 118, Nr. 1, fq. 5-8.
- Schmeling, A., Dettmeyer, R., Rudolf, E., Vieth, V. dhe Geserick, G., "Forensic age estimation: methods, certainty, and the law", *Dtsch Arztebl Int*, 2016, fq. 44-50.
- Schmeling, A., Garamendi, P. M., Prieto, J. L. dhe Landa, M. I., "Forensic age estimation in unaccompanied minors and young living adults", *Forensic medicine — From old problems to new challenges*, 2011, edited by Prof. Duarte Nuno Vieira, InTech, ISBN: 978-953-307-262-3, <http://www.intechopen.com/books/forensic-medicine-from-old-problems-to-new-challenges/forensic-ageestimation-in-unaccompanied-minors-and-young-living-adults>
- Schmeling, A., Grundmann, C., Fuhrmann, A., Kaatsch, H-J., Knell, B., Ramsthaler, F., Reisinger, W., Riepert, T., Ritz-Timme, S., Rösing, F. W., Röttscher, K. dhe Geserick, G., "Criteria for age estimation in living individuals", *International Journal of Legal Medicine*, 2008, fq. 457-460.
- Schmidt, S. et al., "Sonographic evaluation of apophyseal ossification of the iliac crest in forensic age diagnostics in living individuals", *International Journal of Legal Medicine*, 2011.
- Separated children in Europe programme, "Review of current laws, policies and practices relating to age", nga një grup pune për këtë temë, 2011.
- Separated children in Europe programme, *Statement of good practice*, SCEP, 2009.
- Settersten, R. A., Mayer, J. dhe Ulrich, K., "The measurement of age, age structuring, and the life course", *Annual Review of Sociology*, Annual Reviews Stable, Vol. 23, 1997, fq. 233-261, <http://www.jstor.org/stable/2952551>
- Smith, T. dhe Brownlees, L., "Age assessment practices: a literature review and annotated bibliography", *Child protection section UNICEF*, 2011, http://www.unicef.org/protection/Age_Assessment_Practices_2010.pdf.
- Solari, A. C. dhe Abramovitch, K., "The accuracy and precision of third molar development as an indicator of chronological age in Hispanics", *Journal of Forensic Science*, Vol. 47, Nr. 3, 2002, fq. 531-535.
- Tanner, J. M., Oshman, D., Lindgren, G., Grunbaum, J. A., Elsouki, R. dhe Labarthe, D., "Reliability and validity of computer-assisted estimates of Tanner-Whitehouse skeletal maturity (CASAS): comparison with the manual method", *Journal Hormone Research in Paediatrics*, 1994, fq. 288-294.
- Thevissen, P. W., Kvaal, S. I., Dierickx, K. dhe Willems, G., "Ethics in age estimation of unaccompanied minors", *Journal of Forensic Odontostomatology*, 2012, fq. 85-102.
- Tscholl, P. M., Junge, A., Dvorak, J. dhe Zubler, V., "MRI of the wrist is not recommended for age determination in female football players of U-16/U-17 competitions", *Scandinavian Journal of Medicine and Science Sports*, 2016, fq. 324-328.
- UNHCR, *Child protection issue brief: birth registration*, UNHCR, 2013.
- UNHCR, *Field handbook for the implementation of UNHCR BID guidelines*, 2011, <http://www.refworld.org/docid/4e4a57d02.html>
- UNHCR, *Guidelines on international protection No 8: child asylum claims under Articles 1(A)2 and 1(F) of the 1951 Convention and/or 1967 Protocol relating to the Status of Refugees*, 2009.

UNHCR and UNICEF, *Safe and sound: what states can do to ensure respect for the best interests of unaccompanied and separated children in Europe*, UNHCR/UNICEF, 2014.

UNHCR, *“The heart of the matter: assessing credibility when children apply for asylum in the European Union”*, UNHCR, 2014, <http://www.refworld.org/docid/55014f434.html>.

UNHCR, *Guidelines on determining the best interests of the child*, 2008, <http://www.unhcr.org/4566b16b2.pdf>

UNHCR, *“Note on burden and standard of proof in refugee claims”*, UNHCR 1998



SI MERREN BOTIMET E BE-së

Botime falas:

- një kopje:
te libraria e BE-së (<http://bookshop.europa.eu>);
- më shumë se një kopje ose afishe dhe harta:
nga përfaqësitë e Bashkimit Evropian (http://ec.europa.eu/represent_en.htm);
nga delegacionet e BE-së në vendet jo anëtare (http://eeas.europa.eu/delegations/index_en.htm);
duke kontaktuar shërbimin Europe Direct (http://europa.eu/europedirect/index_en.htm) ose duke telefonuar në numrin 00 800 6 7 8 9 10 11 (thirrjet janë pa pagesë nga çdo shtet i BE-së)(*).

(*) Informacioni jepet falas, ashtu siç janë shumica e thirrjeve telefonike (megjithatë disa operatorë, kabina telefonike ose hotele mund të aplikojnë tarifa).

Botime me pagesë:

- në librarinë e BE-së (<http://bookshop.europa.eu>).



Publications Office
of the European Union